



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË**



DISERTACION

**Për mbrojtjen e gradës shkencore
“Doktor i shkencave”**

**ALTERNATIVAT E DËNIMIT NË SHQIPËRI
VËSHTRIM KRAHASUES ME REPUBLIKËN E
MAQEDONISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Disertanti:

Adrian LEKA

Udhëheqësi Shkencor:

Prof.Dr Skënder KAÇUPI

Tiranë, 2015



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS PENALE**

DISERTACION

**Për mbrojtjen e gradës shkencore
“Doktor i shkencave”**

ALTERNATIVAT E DËNIMIT NË SHQIPËRI VËSHTRIM KRAHASUES ME REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE REPUBLIKËN E KOSOVËS

Disertanti:

Adrian LEKA

Udhëheqësi Shkencor:

Prof.Dr Skënder KAÇUPI

Tiranë, 2015

© E drejta e autorit: Adrian Leka

Ky punim shkencor është formatuar sipas kërkesave të Rregullores së Rektoratit “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratave”, miratur në Mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës me vendimin nr.20, datë 13.11.2008.

Falenderim

Falenderoj për udhëheqjen gjatë realizimit të këtij punimi shkencor si dhe për mbështetjen e vazhdueshme Prof. Dr. Skënder Kaçupi.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

I. HYRJE.....	6
II. METODOLOGJIA.....	11
III. MBI DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE.....	18
1. Format e reagimit ndaj kriminalitetit.....	18
2. Teoritë mbi bazën ligjore dhe shoqërore të ndëshkimit.....	19
3. Llojet më të përhapura të dënimeve penale.....	23
4. Faktorët që ndikuan në krijimin e dënimeve alternative.....	24
5. Avantazhet dhe rreziqet e përdorimit të dënimeve alternative.....	30
IV. DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.....	32
1. Vështrim historik mbi dënimet penale dhe alternativat e tyre në Shqipëri.....	32
2. Akte ligjore të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.....	37
2.1. Kushtetuta.....	37
2.2. Akte të të drejtës ndërkombetare.....	38
2.3. Kodi Penal dhe ligje të tjera.....	55
3. Dënimet penale sipas legjislacionit shqiptar aktual.....	61
3.1. Dënimet kryesore dhe plotësuese.....	62
3.3. Alternativat e dënimit.....	69
V. DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	97
1. Dënimet kryesore dhe plotësuese.....	97
2. Alternativat e dënimit.....	100
VI. DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË.....	113

1. Dënimet kryesore dhe plotësuese.....	113
2. Dënimet alternative	119
VII. PROCEDURAT ALTERNATIVE NË DISA VENDE TË TJERA.....	140
1 Konsiderata të përgjithshme.....	140
2.Procedurat alternative në legjislacionin aktual shqiptar.....	143
3.Procedurat alternative ne disa shtete të tjera.....	143
VIII. DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE PËR TË PANDEHURIT E MITUR.....	153
1. Republika e Shqipërisë.....	153
2. Republika e Kosovës.....	161
3. Republika e Maqedonisë.....	167
IX. SHËRBIMI I PROVËS.....	178
1. Çfarë është shërbimi i provës?.....	178
2. Çfarë është vënia në provë?.....	179
3. Historia dhe zhvillimi i shërbimit të provës.....	181
4. Çështjet e të miturve, si shtysë e zhvillimit të shërbimit të provës.....	184
5. Shërbimi i provës në Shqipëri.....	187
6. Shërbimi i provës në Kosovë.....	219
X. KONLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	224
XI. LITERATURA.....	230
ABSTRAKT/ABSTRACT.....	234

HYRJE

Sanksionet penale janë një nga çështjet themelore të së drejtës penale; këto janë edhe pjesa më dinamike e kësaj dege të së drejtës. Rrjedhimisht, gjatë historisë së të drejtës penale, ndryshimet më të shpeshta dhe më të mëdha janë shprehur në këtë fushë. Teoritë për qëllimin e dënimit kanë evoluuar nga koncepti i hakmarrjes dhe ndëshkimit ndaj autorit, drejt konceptit të riedukimit, risocializimit dhe rehabilitimit të tij, duke përfaqësuar këto të fundit idetë themelore të drejtësisë rehabilituese¹.

Që këto koncepte të vihen praktikisht në zbatim, nuk mjafton hedhja e tyre në letër, por nevojitet një analizë e sistemit tonë të dënimit, evidentim i mundësive për reformim dhe ndërmarrja e hapave konkretë në këtë drejtim.

Aktualisht sistemi ynë i dënimit penal nuk ofron mundësinë e dialogut ose të komunikimit mes palëve të konfliktuara, por i lë marrëdhëniet mes tyre të ndera e të karakterizuara nga ndjenja e kundërshtisë ose dhe më keq, e armiqësisë mes tyre.

I dënuari e shlyen detyrimin e tij ndaj shtetit, që në rastin e sistemit tonë përfaqëson “komunitetin”; ai nuk arrin të riparojë dëmin drejtpërdrejt ndaj viktimës, të ndërgjegjësohet plotësisht për pasojat e veprimit të tij dhe të veprojë aktivisht për t’i rregulluar këto pasoja. Ai veçohet ose, edhe më keq, stigmatizohet, duke iu zvogëluar kështu shanset për rehabilitim e risocializim.

Gjendja bëhet edhe më shqetësuese, nëse kemi parasysh kushtet e institucioneve të vuajtjes së dënimit, mbipopullimin e tyre, respektimin e të drejtave të të dënuarve, mundësitë reale për rishoqërim që ofrohen brenda burgjeve etj. Ky problem nuk mund të zgjidhet vetëm duke ngritur institucione të reja për vuajtjen e dënimit ose duke përmirësuar disi kushtet e tyre, por kërkohet të përmirësohet legjislacioni, në mënyrë të tillë që krahas dënimeve me burgim, të zbatohen edhe masa ose sanksione të tjera, që synojnë nxitjen e zhvillimit të aftësive shoqërore e të cilësive vetjake të të dënuarve², duke përmirësuar kështu perspektivat që parashikohen në kreun VII të Kodit Penal, nën titullin “Alternativat e dënimit me burgim”, por, se sa i është arritur qëllimit, mbetet për t’u diskutuar.

Për një kuptim sa më të drejtë është e domosdoshme dhe e rëndësishme të kuptohet thelbi i nocionit. Megjithëse në shumë aspekte alternativat e dënimit me burgim kanë shumë të përbashkëta me dënimin, mendoj se duke patur parasysh dispozitat konkrete në Kodin Penal, këto nuk mund të konsiderohen dënime për disa arsye: Gjykata, kur vendos të zbatohet njëri prej neneve të alternativave, pasi vendos dënimin dhe vetëm në qoftë se vendos dënim me burgim, në raste të caktuara në bazë të kritereve ligjore dhe bindjes së saj të brendshme urdhëron që ky dënim të ekzekutohet në një nga mënyrat e parashikuara nga nenet 58,59 dhe 63 të Kodit Penal. Pra, ajo nuk vendos një dënim të ri, por urdhëron mënyrën se si do të ekzekutohet dënimi me burgim³.

¹ Hysi. V, Kriminologjia, (2005), Crystallina-KH, Tirana dhe Hysi.V, Penologjia, (2006), PEGI,Tirana.

² Elezi Ismet. ”E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme I dhe II, Tiranë 1999.

³ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2002.

Alternativat nuk jepen për atë çfarë ka bërë personi si ndëshkim, por për shkak të individualitetit të rastit të ardhur për gjykim⁴ duke pasur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të ulët të veprës, rrethanave të kryerjes, autorit dhe të cilësive vetjake të tij, gjykata vlerëson se nuk do të ishte e përshtatshme dërgimi i personit në burg (ekzekutimi sipas mënyrës tradicionale), pasi kjo nuk do t'i shërbente qëllimit të dënimit në rastin konkret, por të ekzekutohet në një prej mënyrave të parashikuara në kreun e VII të Kodit Penal.

Gjithashtu, në mjaft legjislacione dhe doktrina të ndryshme këto i konsiderojnë si përfitime ose privilegje⁵, çka nuk mund të thuhet për dënimet pasi ato nuk mund të konsiderohen kurrësi përfitime. Rekomandimi nr. R(92) i Këshillit të Europës parashikon masat dhe sanksionet në interes të komunitetit, ku parashikohen edhe masat alternative që i referohen masave që merr gjykata para zhvillimit të procesit gjyqësor.

Duhet thënë se koncepti i sanksionit penal është një koncept më i gjerë që e përfshin në vetvete edhe konceptin e dënimeve dhe të masave. Kështu, sanksioni penal përkufizohet si: “Masa të dhunshme penalo-juridike që jepen nga gjykata me procedurën e përcaktuar me ligj ndaj kryerësit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe të individit nga kriminaliteti, që konsistojnë në heqjen ose kufizimin e lirisë dhe të drejtave të caktuara ose në tërheqjen e vërejtjes autorit se do t'i merren ose kufizohen liritë ose të drejtat, nëse sërish kryen vepër penale⁶”.

Pra, sanksioni përfshin të gjitha llojet e masave të karakterit parandalues, ndëshkues, edukues etj., të cilat merr shteti në kuadrin e politikës penale për t'ia arritur qëllimit të tij për të parandaluar dhe luftuar kriminalitetin. Në këtë kontekst, mund të themi me bindje se alternativat e dënimit janë sanksione penale. Por nuk mund të themi se këto janë masa penale, pasi, kur përdoret terminologjia e masave, gjithmonë mbahet parasysh fakti se ato kanë më tepër karakter parandalues, ndërsa alternativat kanë më tepër të theksuar karakterin edukues.

Mendoj se përkufizimi më i përshtatshëm për dispozitat e Kodit Penal që përcaktohen si “Alternativat e dënimit me burgim”, do të ishte “Alternativat e ekzekutimit të dënimit me burgim”, pasi në të gjitha dispozitat e këtij kreu nuk parashikohen lloje dënimi të tjera, por jepet një mundësi, që disa dënime me burgim të mos ekzekutohen në mënyrën tradicionale, por të ekzekutohen në një mënyrë të ndryshme që do t'i shërbente më mirë qëllimit të dënimit. Në favor të kësaj teze shkon edhe fakti që alternativat zbatohen vetëm në rastin kur jepen dënime me burgim. Është i veçantë për legjislacionin shqiptar ky fakt, në një kohë kur në legjislacione të tjera këto alternative aplikohen edhe ndaj dënimeve me gjobë. Megjithëse Kodi Penal nuk e njeh konceptin e sanksioneve penale, mund të themi se alternativat e dënimit me burgim mund të përkufizohen si: “Sanksione penale të vendosura nga shteti, që konsistojnë në vuajtjen e dënimit me burgim në një mënyrë të ndryshme nga sistemi tradicional i qelisë, duke pasur parasysh që

⁴ Hysi.V, Penologjia, (2006), PEGI,Tirana.

⁵ Aos, S., Miller, M. & Drake, E. (2006). Evidence-based public policy options to reduce future prison construction, criminal justice costs, and crime rates. Ëashington State Institute for Public Policy. Olympia: WA.

⁶ Elezi Ismet. ”E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme I dhe II, Tiranë 1999, por edhe E drejta penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1973, fq. 2010, si edhe Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.

për autorë dhe vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore, riedukimi dhe Risocializimi i tyre do të ishte më efektiv në gjirin e bashkësisë.

Alternativat e dënimit me burgim kanë karakteristika të përbashkëta dhe të veçanta me dënimin penal: Ashtu sikurse dënimi, edhe alternativat zbatohen vetëm ndaj personave fajtorë që kryejnë vepra penale. Parimi “nulla poena sine lege” ashtu sikundër nuk mund të zbatohet në një dënim penal që nuk është parashikuar në ligj, nuk mund të zbatohet as dhe në një alternativë (sanksion në interes të komunitetit) të parashikuar në ligj⁷. Nëpërmjet dënimit shoqëria mbron nga kriminaliteti vlerat më të rëndësishme të individit dhe shoqërisë. Edhe qëllimi i alternativave pak a shumë është i njëjtë, por duhet thënë se në ndryshim nga dënimi, këtu të bie në sy karakteri i theksuar humanitar i këtyre dispozitave që i mëshon më shumë idesë së mënyrës sesi duhet të trajtohen të dënuarit si një qenie humane. Pra qëllimi i mësipërm mund të arrihet së pari duke i mbrojtur të dënuarit nga shprehjet kriminale⁸. Ashtu sikurse dënimi, edhe alternativat janë në diskrecionin e gjykatës, për të vendosur në lidhje me zbatimin ose jo të tyre. Por në ndryshim nga dënimi, diskrecioni i gjykatës në rastin e alternativave është më i gjerë, për faktin se në rast se një person do të konsiderohet fajtor nga gjykata, ndaj tij do të jepet patjetër një dënim. Diskrecioni në këtë rast qëndron vetëm në përcaktimin e llojit ose të masës në varësi të dispozitës konkrete, ndërsa në rastin e alternativave është plotësisht në diskrecionin e gjykatës të vendosë jo vetëm llojin e alternativës, por edhe nëse do t’i zbatojë ose jo, megjithëse rasti konkret mund t’i plotësojë të gjitha kushtet që kërkon dispozita ligjore⁹.

Gjykata, si në rastin e zbatimit të alternativave, edhe në rastin e caktimit të dënimit zbaton të njëjtat parime, rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe autorit, shkallën e fajit dhe rethanat rënduese dhe lehtësuese duke pasur parasysh parimin e individualizimit të dënimit. Por në rastin e zbatimit të alternativave duhet që rrezikshmëria shoqërore e veprës dhe autorit të jetë e ulët, shkalla e fajit e lehtë dhe të zotërojnë rethanat lehtësuese.

Dënimi penal ka karakter individual¹⁰, sepse drejtohet vetëm ndaj personave përgjegjës që kostatohen fajtorë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale. Por nëse individualizimi i dënimit penal bëhet në momentin e shpalljes fajtor, individualizimi i alternativës, bëhet në një moment të dytë pasi është vendosur dënimi dhe sidomos lloji i tij, pasi alternativat sipas kodit tonë penal zbatohen vetëm kur jepet dënim me burgim.

Dënimi penal ka kryesisht karakter ndëshkimor, ndërsa alternativat kanë kryesisht karakter humanitar dhe jepen në funksion të ekzekutimit të dënimit jo në burg¹¹, por në një mënyrë të veçantë dhe si të tilla ato të japin përshtypjen se nuk kanë karakter ndëshkimor, por duhet thënë se edhe personat ndaj të cilëve zbatohen një prej alternativave e ndiejnë forcën shtrënguese të shtetit në një mënyrë ose në një tjetër, pasi ata kufizohen në liritë dhe të drejtat e tyre, ndiejnë vrojtimin dhe mbikëqyrjen e autoriteteve zbatuese, dhe kështu ata në këtë mënyrë vuajnë pasojat

⁷ McNeil, F. (2006). A desistance paradigm for offender management. In *Criminology & Criminal Justice*. Vol. 6(1): 39-62. Sage Publications.

⁸ Hysi.V, Penologjia, (2006), PEGI,Tirana.

⁹ Merrington, S., Stanley, S. (2007) “Effectiveness: who counts what?” in Gelsthorpe, L. and Morgan, R. (eds) *Handbook of Probation*.

¹⁰ Tournier, P.V. (2004). Aspects of good practice in the criminal justice system. In *Crime Policy in Europe*. Council of Europe Publishing.

¹¹ Hysi.V, Penologjia, (2006), PEGI,Tirana.

e veprës së kryer prej tyre, pasi ata nuk gëzojnë më statusin e personit të padënuar. Pra, vetë gjendja, të cilën ata po kalojnë, është një ndëshkim për atë që kanë kryer, sepse ata nuk do të ndodheshin në këtë gjendje nëse nuk do të kishin kryer vepër penale.

Ashtu sikurse dënimi penal edhe alternativat e dënimit me burgim zbatohen vetëm ndaj personave penalisht të përgjegjshëm që do të thotë se personi, në momentin e kryerjes së veprës penale, ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij, kjo lidhet edhe me faktin se vetëm një person i tillë mund të kuptojë qëllimin e vërtetë të dënimit dhe aq më tepër të alternativës së dënimit me burgim.

Dënimi penal sjell pasoja në statusin juridik të të dënuarit. Ai, edhe pas vuajtjes së dënimit, derisa të mos jetë parashikuar ekzekutimi i vendimit të dënimit ose amnistuar, pëson disa kufizime¹², ndërsa për sa i përket statusit të personit ndaj të cilit zbatohet një prej alternativave, kjo është një çështje e diskutueshme, që mendoj ta trajtoj si një çështje të veçantë duke e parë të lidhur edhe me institutin e rehabilitimit.

Instituti i Rehabilitimit, i parashikuar rishtazi në Kodin Penal, shpreh parimin se çdo qenie njerëzore vazhdimisht evoluon, vetëkorrigjohet a ndryshon, si në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, por edhe në relacion me shoqërinë dhe institucionet e saj¹³. Me rehabilitim, në kuptimin e përgjithshëm, do të kuptohet rivendosja e të drejtave të mëparshme personit të dënuar, pasi të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara në ligj. Nga ana e vet rehabilitimi, ndahet në: Rehabilitim ligjor, i cili ka të bëjë me rastin kur rehabilitimi bëhet automatikisht për personat që pas vuajtjes së dënimit dhe që gjatë afatit ligjor të parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal, nuk kryejnë vepër tjetër penale. Rehabilitim ajvadorsor, i cili realizohet vetëm mbi bazën e vendimit të gjykatës, me kërkesën e subjekteve që legjitimohen dhe me kalimin e afatit të provës gjatë të cilës nuk duhet të ketë kryer vepër tjetër penale¹⁴. Pra, ky institut përcakton një afat kohor me kalimin e të cilit pa konsumuar vepra të tjera penale, personi konsiderohet i padënuar. Është e rëndësishme të theksohet se ky afat fillon menjëherë pas vuajtjes së dënimit.

Në lidhje me alternativat, nëse do të merrnim në konsideratë copëzimin e dënimit me burgim, problemi se kur fillon afati i rehabilitimit dhe në cilin moment personat do të konsiderohen të rehabilituar varet nga momenti i vuajtjes së dënimit dhe nga masa e dënimit. Pra, në këtë rast është e qartë se periudha e rehabilitimit fillon kur personi ka vuajtur plotësisht burgimin në mënyrë të copëzuar dhe afati për rehabilitimin varet nga masa e dënimit që është vendosur për të.

Një pikëpyetje tjetër që mund të vendoset në këtë rast është edhe nëse shprehjet “person i padënuar” dhe “dënim i paqenë” janë e njëjta gjë. Duhet thënë se në Kodin Penal nocioni i rehabilitimit është njësoj me heqjen e dënimit, ndonëse këto nocione trajtohen në mënyra të ndryshme: a) Me heqje ose shuarje të dënimit kuptohet kur personi më parë është marrë në përgjegjësi penale mbi baza ligjore dhe është dënuar për kryerjen e veprës penale; b) përkundrazi me rehabilitimin kuptojmë në radhë të parë mohimin e faktit të kryerjes së veprës penale.

¹² Conklin, J. “Criminology”, Tufts University, USA, 1995.

¹³ Halili, R. Penalogjia, Blendi publishing, August (2000), Prishtina.

¹⁴ Foundation “Conflict Resolution and Reconciliation of Disputes”, Restorative justice and mediation in resolving criminal despotes, Manual for judges and prosecutors, UNICEF, (2007), Tirana.

Në këtë kontekst mbase është rasti të themi se shprehja “dënimi konsiderohet i paqenë” është e lidhur me faktin që dënimi është shuar, dhe jo me statusin e personit si i rehabilituar ose jo. Megjithatë, është fakt që neni 69 i Kodit Penal nuk parashikon afat për këto raste dhe, në qoftë se do ndjekim linjën e arsyetimit të mësipërm, duhet që në këtë nen të parashikohet një afat i veçantë, ashtu sikurse legjislacionet e vendeve të tjera që e parashikojnë një gjë të tillë.

A janë masat edukative për të miturit alternativa të dënimit me burgim? Në literaturën juridike janë konturuar dy mendime¹⁵ lidhur me edhe pse nuk janë në kreun përkatës. Nga pikëpamja formale duket sikur thelbi është i njëjtë në të dy rastet, pasi qëllimi edhe në këtë rast është shmangia e burgimit dhe e pasojave të tij, madje në këtë kontekst mund të përmendim edhe nenin 52 të Kodit Penal. “Gjykata, nisur nga rrezikshmëria e pakët e veprës penale, nga rrethanat konkrete të kryerjes së saj, nga sjellja e mëparshme e të miturit, mund ta përjashtojë atë nga dënimi. Në këto raste gjykata mund të vendosë dërgimin e të miturit në një institucion edukimi.”

Por nga një analizë më e hollësishme mund të evidentohen lehtësisht disa ndryshime midis masave edukative dhe alternativave të dënimit me burgim. Ashtu sikurse e kam përmendur edhe më sipër, duhet theksuar se vërtet dispozitat e Kodit Penal, që parashikojnë alternativat, kanë probleme formulimi në vetvete. Por problemi më i madh në lidhje me të është ekzekutimi i tyre në praktikë dhe sidomos mosparashikimi me ligj konform rekomandimeve të Këshillit të Europës, i një autoriteti që do të mbikëqyrte dhe do të kontrollonte ekzekutimin e alternativave, madje do të ndihmonte edhe gjykatën ose prokurorinë në individualizimin e alternativës më të përshtatshme, përpara se gjykata të japë vendimin¹⁶.

Do të ishte e kotë të propagandojmë aplikim më të gjerë të alternativave, përderisa nuk kemi infrastrukturën e nevojshme institucionale për të mbikëqyrur ekzekutimin e tyre. Madje, çdo përmirësim legjislacioni në funksion të futjes së instituteve të reja do të rezultonte thjesht me një përmirësim legjislacioni pa asnjë vlerë në praktikë në qoftë se nuk ngrihet një strukturë e tillë, e cila, përveç mbikëqyrjes së personave ndaj të cilëve janë zbatuar alternativat, do të kujdesej edhe për një trajtim të përshtatshëm të të dënuarve pas daljes nga burgu, në funksion të rehabilitimit dhe të kthimit të tyre në gjirin e shoqërisë.

Zbatimi i sanksioneve në interes të komunitetit do të bazohet në menaxhimin e programeve të individualizuara dhe në zhvillimin e marrëdhënieve të përshtatshme të punës midis shkelësit të ligjit, mbikëqyrësit dhe çdo lloj organizate pjesëmarrëse ose individësh të marrë nga komuniteti.

Në këtë kontekst ngarkimi i prokurorisë ose i institucioneve të tjera të ekzekutimit të dënimeve penale me detyra mbikëqyrëse në këtë drejtim nuk do të ishte një strategji e frytshme, për vetë natyrën e veçantë që paraqesin alternativat. Nga studimi i modeleve të ndryshme vihet re se organet me funksione mbikëqyrëse më shumë se karakterin represiv karakterizohen nga humanizmi dhe kanë më dhe të individualizuar për çdo person, mund të arrihet qëllimi për një rikthim të suksesshëm në shoqëri dhe rifutja në jetën normale pa etiketime, pa stigmatizime.

¹⁵ Mandro. A The juvenile justice system in Albania, an analysis of the juvenile justice system and of the situation of juveniles in conflict with the law in Albania, a publication of the Center for Protection of Child Rights in Albania, (2007), Visi Design, Tirana.

¹⁶ Albanian Helsinki Committee, Criminal justice system for juveniles in Albania, (2005) PEGI, Tirana.

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Ky kapitull do të përshkruajë metodologjinë e përdorur në këtë punim. Në këtë kapitull do të përshkruhen tipet e metodave të zgjedhura për kryerjen e analizave nga një perspektivë e caktuar, si dhe arsyet përse u zgjodhën këto metoda në morinë e metodave të tjera alternative. Gjithashtu, do të zenë vend në këtë kapitull dhe diskutimet mbi zgjedhjen e subjektit të studimit, paragjykimet, perspektiva, qasja e kërkimit, konceptimi i kërkimit dhe metodat e mbledhjes së të dhënave për këtë studim.

Me qëllim që përfshirja në një studim të jetë objektive, patjetër duhet që të ketë një fazë të mëparshme të shfaqjes së interesit për subjektin apo fushën në fjalë. Kjo përfshirje e mëhershme ndihmon në zgjedhjen e metodave të përshtatshme si dhe instrumenteve për mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre. Të qenurit i panjohur me fushën ku kërkon të bësh një studim specifik të bën konfuz dhe rrezikon të zgjedhësh objektiva që nuk lidhen mes tyre apo me fushën e studimit. Një gjë e tillë krijon premisat që të mos kesh shumë të qartë nga t'ia fillosh e për më tepër të mos arrish në rezultatet përfundimtare.

Përcaktimi i objektivave nuk është një detyrë e thjeshtë, dhe për qëllime të këtij punimi më është dashur të kaloj përmes shumë diskutimeve me veten dhe të tjerë kolegë apo profesorë të mi, me qëllim që të specifikoj qartë objektivat e këtij studimi. Si autor i këtij punimi, vij me një background tërësisht të lidhur me objektivin e studimit. Padiskutim, që në hapat e parë të idesë time për të zgjedhur këtë subjekt për studimin, i jam referuar shumë artikujve të publikuar në gazeta dhe revista shkencore të njohura në fushën perkatese. Një ndihmesë shumë e madhe kanë qenë materialet shkencore profesionale të publikuara në websitet e organizmave ndërkombëtare profesionale dhe organizatave te ndryshme.

Filozofia e kërkimit është shumë e rëndësishme për të zgjedhur konceptimin e duhur të kërkimit i cili mundëson arritjen e përfundimeve. Ka dy filozofi kërkimi: filozofia epistemologjike dhe ajo ontologjike.

Epistemologjia ka të bëjë me studimin e dijes. Termi 'Epistemology' vjen nga Greqishtja e vjetër, [Epistemo – do të thotë "dije, të kuptuarit", dhe - logos, do të thotë "studimi i"). Epistemologjia është degë e filozofisë që merret me natyrën dhe qëllimin e dijes e gjithashtu njihet ndryshe si "teoria e dijes". Me pak fjalë kjo degë e filozofisë shpjegon çfarë është dija dhe si mund të përfitohet ajo si dhe shkallën në të cilën një subjekt apo një entitet mund të njihet. Shumë debate në këtë fushë fokusohen në analizimin e natyrës së dijes dhe marrëdhënien e saj me konceptet e lidhura me të si: e vërteta, besimi dhe justifikimi. Termi epistemologji u prezantua për herë të parë nga filozofi skocez James Frederick Ferrier (1808–1864).

Epistemologjia përshkruan mënyrën si mund të mësojmë rreth botës, pra si mund të studiojmë mbi realitetin. Më pas, kjo degë e filozofisë ndahet në dy pjesë: pozitivizmi dhe interpretivizmi (fenomenologjia). Pozitivizmi është të studiuarit e një realiteti shoqëror dhe përtej, që do të thotë si mund të interpretohet bota sociale si një shkencë natyrore. Ndërsa interpretivizmi është e kundërta e pozitivizmit dhe ka të bëjë me element të tillë si vlerat dhe normat.

Në anën tjetër, ontologjia, apo supozimet ontologjike i referohen subjektit të ekzistencës. Ontologjia si degë e filozofisë merret me studimin filozofik të natyrës së të qenurit, të bërit, ekzistencës ose realitetit, si dhe me kategoritë kryesore të qenieve dhe marrëdhëniet e tyre. Tradicionalisht, e renditur si dega më e madhe e filozofisë, që quhet ndryshe edhe metafizika, ontologjia interesohet për çështje të tilla si: çfarë entitetesh ekzistojnë ose thuhet se ekzistojnë, dhe për mënyrën si mund të grupohen brenda një hierarkie, e më pas vjen një nënndarje në përputhje me të përbashkëtat dhe ndryshimet me tyre. Pra, ontologjia trajton natyrën e botës dhe qenieve njerëzore në kontekstin social (Bryman & Bell, 2007). Kjo degë vetë ndahet në: objektivizëm dhe konstruktivizëm. Objektivizmi është një theksim normativ që pohon se fenomenet shoqërore dhe kuptimi i tyre kanë një ekzistencë të pavarur nga aktorët shoqërorë (Bryman & Bell, 2007). Konstruktivizmi si qëndrim, pranon se fenomenet shoqërore dhe kuptimi i tyre mund të realizohen nga aktorët shoqërorë, pra realiteti i botës sociale ndërtohet dhe nuk mund të ekzistojë jashtë tyre (Bryman & Bell, 2007).

Qasja e kërkimit ka të bëjë me rrugën në të cilën mblidhen të dhënat për të formuluar më pas përgjigjen për pyetjen e kërkimit (Saunders et al., 2000). Filozofia e kërkimit zakonisht mbështetet në interpretimet e kërkuesit të të dhënave, fakteve dhe njohurive. Është thjesht rruga që bëjmë gjatë kërkimit për të zhvilluar njohuritë dhe dijet, më shumë se sa thellimi në to, pra jo diçka që shpreh mendimin tuaj (Saunders et al., 2000). Kështu që implementimi i metodave të përshtatshme për arritjen e një baze të shëndoshë për studimin është thelbësore për çdo lloj kërkimi.

Dy janë çështjet kryesore që orientojnë përgjigjen mbi qasjen e kërkimit. Së pari, për çfarë forme teorie flitet në studim dhe së dyti, nëse janë mbledhur të dhënat e nevojshme për të testuar ose për të ngritur një teori (Bryman & Bell, 2007). Sipas Bryman & Bell, qasjet e kërkimit mund të ndahen në tre tipe të ndryshme: induktive, deduktive dhe abduktive. Në qasjen deduktive zhvillohet fillimisht struktura konceptuale dhe teorike (modeli) e më pas ai testohet nga të dhënat empirike. Në këtë qasje përdoren hipotezat testuese për të nxjerrë rezultatet dhe përfundimet. Zakonisht, kjo qasje të çon nga e përgjithshmja tek specifika dhe të dhënat mblidhen për të testuar teorinë. Sipas kësaj qasje, teoria zhvillohet nga vëzhgimet e realitetit empirik dhe të gjitha gjetjet lidhen me kërkimin e fakteve se cili është realiteti (Bryman & Bell, 2007).

Në teori ka disa tipe të ndryshme të konceptimit apo hartimit të një kërkim (Bryman & Bell, 2007, p. 39):

- Konceptimi historik (Historical Research Design) – qëllimi është të mbledhë, verifikojë, sintetizojë prova për të përcaktuar faktet që mbrojnë ose që hedhin poshtë hipotezën/at e ngritura. Ky konceptim përdor burimet primare, burime dytësore dhe shumë prej burimeve cilësore të të dhënave të tilla si artikujt, punimet shkencore, të dhënat zyrtare, raporte të ndryshme, etj. Kufizimi është se burimet duhet të jenë të dyja autentike dhe të vlefshme.
- Konceptimi sipas një rasti studimi (Case and Field Research Design - quajtur ndryshe hulumtim etnografik, përdor vëzhgime të drejtpërdrejta për të dhënë një pamje të plotë të një rasti që është duke u studiuar. Kjo është e dobishme kur nuk dihet shumë në lidhje me një fenomen. Përdor disa subjekte.

- Konceptimi përshkrues ose i mbështetur mbi pyetësorë (Descriptive or Survey Research Design) – tenton të përshkruajë dhe të shpjegojë kushtet aktuale duke përdorur shumë subjekte dhe pyetësorët për të përshkruar plotësisht një fenomen. Metodologjia e anketimit dhe pyetësorëve është një nga më të përdorurat për kërkim shkencor. Ka shumë avantazhe për vetë shkallën e gjerë të përfshirjes së palëve të interesit.
- Konceptimi korelativ ose prospektiv (Correlational or Prospective Research Design)- një përpjekje për të shqyrtuar marrëdhëniet e më pas për të bërë parashikime. Përdor disa tregues me dy ose më shumë variabla për secilin.
- Konceptimi shkaksor krahasimor ose një post analizë e fakteve të ndodhura (Causal Comparative or Ex Post Facto Research Design) – përpiqet të shqyrtojë marrëdhëniet shkak pasojë ku tashmë shkaqet ekzistojnë dhe nuk mund të manipulohen. Ky konceptim nënkupton që të përdoret gjithçka që tashmë ekziston për të shikuar prapa dhe për të shpjeguar se pse.
- Konceptimi i zhvillimit të serive kohore (Developmental or Time Series Research Design) – nënkupton se të dhënat janë mbledhur në momente të caktuara në kohë të shkuar. Theksi vihet mbi modelet kohore, rritjeve ose ndryshimeve gjatësore.
- Konceptimi eksperimental (Experimental Research Design)– është më i përshtatshëm në mjedise të kontrolluara të tilla si laboratorët. Sipas këtij konceptimi përzgjidhen në mënyrë të rastësishme subjektet, po ashtu dhe grupet. Më pas përpiqet të shqyrtojë marrëdhënien shkak pasojë për shkaqe që mund të manipulohen për të prodhuar lloje të ndryshme të efekteve. Për shkak të kërkesës së përzgjedhjes së rastit, ky konceptim mund të jetë i vështirë për tu realizuar në botën reale (jo laboratorike).
- Konceptimi pothuaj eksperimental (Quasi Experimental Research Design) – i përafrohet konceptimit eksperimental, por nuk ka një grup kontrolli. Ka më shumë mundësi të ketë gabime në rezultatet e eksperimentit.

Dy metodat kryesore që aplikohen në përgjithësi nga kërkuesit në punimet e tyre janë: metoda sasiore dhe metoda cilësore. Secila prej tyre ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi metodat që implikohen në kërkim për mbledhjen e të dhënave (Kekwle, de Weerd-Nederhof, Cervai and Borelli, 2009).

“Kërkimi sasior fokusohet kryesisht në ndërtimin e një baze të dhënash sasiore dhe të dhënat sasiore janë një regjistrim sistematik i numrave që dalin nga kërkimi duke përdorur procesin e matjes dhe sipas një strukture të caktuar” (Ray Kent, 2007).

Kërkimi cilësor është një metodë që përdoret në disiplina akademike të ndryshme. Përmes kësaj metode, kërkuesit synojnë të kuptojnë më thellë sjelljen e individëve apo të shoqërisë si dhe arsyet e qëndrimit të tyre. Metoda cilësore investigon “përse” dhe “si” merret një vendim, jo “çfarë”, “ku” dhe “kur” merret një vendim. Në këtë metodë kampionet e përzgjedhur të studimit janë më të vegjël dhe më të fokusuar se ato të përzgjedhur në metodat sasiore.

Nga një pikëpamje konvencionale, metoda cilësore prodhon informacion vetëm mbi rastet e marra në studim dhe konkluzionet e përgjithshme janë vetëm propozime (pohime informuese). Më pas përdoren metodat sasore për të provuar në mënyrë empirike çdo hipotezë të kërkimit (Denzin, Norman K. & Lincoln, Yvonna S. (Eds.), 2005).

Në studim do të përdoren të dyja strategjitë e kërkimit, kërkimi cilësor përse i përket opinioneve të profesionistëve dhe të ekspertëve të fushës (për pasojë do të përdoren intervista të gjysmë-strukturuara për mbledhjen e të dhënave) dhe kërkimi sasior përse i përket mbledhjes së të dhënave mbi disa variabla të tjerë përcaktues të mbështetjes së pohimit të punimit. Përzgjedhja e metodës cilësore u bë për disa arsye:

- Së pari, pjesë e interesit tim në këtë punim janë qëndrimet, pasi përmes intervistave synoj të gjeneroj një përfundim teorik. Paraprakisht do të skicoj një pamje të qartë të asaj që kërkoj në studim duke përdorur këtë metodë;
- Së dyti, si pjesë e një kërkimi abduktiv, të gjitha aspektet e studimit janë konceptuar me kujdes përpara fillimit të mbledhjes së të dhënave me qëllim që fazat e mëtejshme të studimit të mund të realizohen me sukses;
- Së treti, në këtë studim interesi im është i lidhur me subjektivitetin dhe mundësinë për të “hyrë në brendësi” të eksperiencave të realitetit njerëzor;
- Së katërti, në punim, synoj një përfshirje nga afër të të intervistuarve. Kjo është e mundur vetëm përmes metodës cilësore. Në metodat sasore kërkuesit nuk përfshihen në qëndrimet e të intervistuarve apo anketuarëve, madje në shumicën e rasteve nuk kanë fare kontakte me ta.

Mbledhja e të dhënave është procesi i “shfrytëzimit” të burimeve nga ku do të mblidhet informacioni përkatës i cili do të përdoret për të siguruar përgjigjet e kërkimit. Burimet nga ku do të mblidhen të dhënat janë parësore dhe dytësore. Burimet parësore u referohen burimeve nga ku mblidhen të dhënat origjinale për problemet e identifikuar të studimit. Të dhënat parësore përfshijnë vëzhgimet, krahasimet, anketat në formë pyetësorësh si dhe intervistat e drejtpërdrejta. Ndërsa të dhënat dytësore janë ato që mblidhen nga kontributet e të tjerëve në kërkime të ngjashme apo të ndryshme. Burimet dytësore të të dhënave përfshijnë librat, revistat, artikujt apo websitet, të gjitha këto kur trajtojnë të njëjtin subjekt specifik (Ghauri & Gronhaug, 2005, p. 91-102).

Mbledhja e të dhënave në këtë studim filloi nga burimet dytësore, mbi bazën e të cilave është ndërtuar kuadri teorik. Filliova fillimisht me leximin e një literature të shkruar dhe nga leximi më rezultoi se jo vetëm kishte shumë interes për subjektin e zgjedhur nga unë për studim por më bindi më tepër në përcaktimin e objektivave kyç të studimit. Të gjithë pikërisht ato burime dytësore që kanë lidhje të ngushtë me studimin është një aktivitet shumë specifik dhe në një farë mënyrë është një punë e vështirë pasi duhet të ndjekësh sipas një logjike të caktuar një punë të bërë në vazhdimësi.

Të dhënat dytësore që përdora si pika referimi në këtë studim kryesisht i gjeta duke shfrytëzuar internetin. Përmes tij munda të vë në dispozicion shumë libra, artikuj, revista, materiale zyrtare të institucioneve rregullatore të shteteve të ndryshme, etj. Përse i përket të shkruarit të kësaj

doktorature, një nga burimet dytësore më të rëndësishme kanë qenë librat elektronik që më janë vënë në dispozicion në një prej kurseve të shkollës së doktoraturës.

Për mbledhjen e të dhënave primare kam punuar në dy drejtime. Burimi i parë janë matricat krahasuese dhe intervista që ishin burimi i dytë primar i të dhënave. Me të intervistuarit kam realizuar intervista gjysëm të strukturuar. Intervistat gjysëm të strukturuar të japin mundësinë të bësh një sërë pyetjesh për çështje të ndryshme specifike të cilat lindin qoftë edhe gjatë intervistimit. (Bryman & Bell, 2007). Gjatë intervistimit u bënë pyetje me fund të hapur për t'ju dhënë më shumë mundësi të intervistuarve të shprehnin qëndrimet e tyre dhe arsyet përkatëse. Në intervistat gjysëm të strukturuar rradha sipas të cilës bëhen pyetjet mund edhe të ndryshojë, por është e preferueshme të mbahen gjurmët e pyetjeve sipas të njëjtës rradhë si në udhëzuesin e intervistës (Bryman & Bell, 2007). Udhëzuesin ua dërgova të intervistuarve disa ditë përpara intervistës formale kështu që të intervistuarit patën një ide më të qartë lidhur me pyetjet po gjithashtu dhe me përgjigjet lidhur me qëndrimin e tyre. Udhëzuesi u ndërtua në një mënyrë të tillë që të mund të strukturohej në dy pjesë. Pjesa e parë përmbante të dhëna lidhur me vetë intervistuesin si p.sh, detyra që mban, eksperiencia, etj. Ndërsa pjesa e dytë ishin pyetjet lidhur me çështjen që shtron për zgjidhje ky studim.

Në këto lloj intervistash, gjestet plotësojnë shumë mirë përgjigjen e të intervistuarit. Nga vetë formulimi, theksimi, renditja e mendimit, etj, mund të kuptohet akoma më shumë për përgjigjen e dhënë. Intervista u ndërtua e tillë që të gjeneronte maksimumin e mundshëm madje edhe të detajeve të përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit për përgjigjet e intervistës (Bryman & Bell, 2007).

Intervistat u zhvilluan në mjedise shumë të përshtatshme, për të dyja palët. Gjithashtu, për të intervistuarit u respektua me shumë përpikmëri kodi i etikës, sidomos kur bëhet fjalë për anonimatin. Përdorimi i të dhënave do të bëhet duke ruajtur anonimatin e të intervistuarit. Pyetjet kishin në fokusin e tyre vetëm aspekte profesionale dhe aspak nuk kishin për qëllim të vinin në vështirësi të intervistuarin. Të dhënat më pas u regjistruan në mënyrë të strukturuar në formate të caktuara duke krijuar kështu bazën e të dhënave të përgjigjeve. Këto të dhëna do të organizohen dhe formalizohen në një format specifik të shkrimit të një teze, kështu që nuk është e nevojshme të rithuhet fjalë për fjalë përgjigjet e të intervistuarve. Kohëzgjatja e intervistave ishte nga 30 deri në 60 minuta.

Pasi të arrihet në konkluzionet e punimit, të cilat do të japin përmbledhtazi përfundimet për secilin prej argumenteve të marra në analizë, përmes një modeli të vendimmarrjes cilësore (matrica 2 përmasore e opsioneve) do të formulohet edhe rekomandimi kryesor i punimit. Prej këtyre opsioneve janë formuar më pas katër alternativat e mundshme për rekomandim:

- Në një kërkim, qëndrueshmëria apo cilësia e kërimit është shumë e rëndësishme për të përcaktuar vlerën e fakteve (Ritchie and Lewis, 2005). Në vlerësimin e një studimi ka dy kritere të cilësisë: siguria dhe vlefshmëria. Ka dhe kritere të tjera alternative të propozuara nga Lincoln and Guba (1985) për vlerësimin e cilësisë së një studimi: besueshmëria dhe vërtetësia (si citohet në Bryman and Bell, 2007, p.411). Këto koncepte janë shumë të ngjashme me dy të parat. Prandaj në këtë studim jam përpjekur gjithnjë të siguroj besueshmërinë dhe vërtetësinë e kërimit.

- Besueshmëria: Në çmuarjen e besueshmërisë së një kërkimi përdoren katër kritere të tjera shtesë: kredibiliteti, transferueshmëria, siguria dhe konfirmueshmëria. (Bryman and Bell, 2007, p.411).
 - Kredibiliteti: Kredibiliteti shkon paralel me vlefshmërinë e brendshme. Përcaktimi i kredibilitetit të gjetjeve përfshin sigurinë se kërkimi është realizuar dhe mbështetur në qasjet e praktikave të mira si dhe sigurinë se gjetjet e kërkimit do t'u jepen të tjerëve të cilët do të gjykojnë nëse kërkimi është i kuptueshëm dhe i vlefshëm për shoqërinë (Bryman and Bell, 2007, p. 411). Reagimi për miratimin e kërkimit është një perspektivë e rëndësishme për kredibilitetin e tyre. Për të marrë këtë miratim, gjetjet e kërkimit ndahen me të tjerë që marrin pjesë në këtë kërkim për të marrë prej tyre konfirmimin se ata kanë të njëjtin kuptim për atë që shkruhet në analizimin e të dhënave empirike.
 - Transferueshmëria: Transferueshmëria shkon paralel me vlefshmërinë e jashtme. Kjo ka të bëjë me faktin nëse gjetjet e kërkimit mbeten të vërteta edhe në kontekste të tjera apo në të njëjtin kontekst por në një kohë tjetër (Lincoln and Guba, 1985, p 316). Transferueshmëria e këtij kërkimi në Shqipëri do të jetë e vlefshme por s'mund të thuhet e njëjta gjë për transferueshmërinë e tij në vende të tjera.
 - Siguria: Siguria shkon paralel me seriozitetin. Siguria do të thotë seriozitet në mbajtjen e të gjitha shënimeve dhe regjistrimeve për çdo fazë të procesit të kërkimit (Bryman and Bell, 2007, p.414). Në kërkimin tim, do të ruaj të gjitha shënimet apo regjistrimet që nga formulimi i problemit, referencat, literatura e shfletuar, intervistat e bëra, e gjithçka tjetër. Kjo arshivë e kërkimit e bën atë serioz, pra të sigurtë.
 - Konfirmueshmëria: Konfirmueshmëria shkon paralel me objektivitetin. Konfirmueshmëri nënkupton që kërkimi drejtohet në mënyrën e duhur gjithashtu që të tjerë të angazhuar në kërkim do të sillen me mirëbesim (Bryman and Bell, 2007, p.414).
- Autenticiteti: Cilësia e një kërkimi varet shumë dhe nga kriteri i autenticitetit. Me autenticitetet në këtë rast të kuptojmë vërtetësinë me të cilën paraqitën këndvështrimet e ndryshme të kuadrit shoqëror. Për qëllime të autenticitetit, opinionet e intervistuesve të mbledhura përmes pyetësorëve apo intervistave, u janë dhënë dhe një herë mbrapsht atyre për të konfirmuar përgjigjet e transkriptuara apo të interpretuara.

Etika në përgjithësi përkufizohet si tërësia e kodeve dhe udhëzimeve që çdo kërkues duhet të ndjekë në studimin e tij. Etika është e lidhur me normat, vlerat dhe përgjegjësitë shoqërore të njëjësive ekonomike. Meqenëse ky do të jetë në pjesën më të madhe një studim cilësor dhe do të përdoren për analizë kryesisht të dhëna primare, është përgjegjësi e imja të mbaj standarde të larta të etikës përgjatë gjithë procesit. Çështjet e etikës nuk duhen injoruar pasi lidhen drejtpërdrejt me integritetin e kërkimit (Bryman dhe Bell, 2007) dhe është e vetmja mënyrë për të punuar me ndershmëri dhe përgjegjshmëri. Literatura e përdorur gjatë studimit, si librat, gazetatat shkencore apo burime të tjera janë cituar në mënyrën e duhur me qëllim që të evitohet plagjarizmi.

Gjithashtu gjatë punimit janë mbajtur shumë parasysh katër fushat e parimeve etike të klasifikuara nga Diener dhe Grandall (si është cituar në Bryman dhe Bell, 2007): dëmtim të pjesëmarrësit, mungesë e pëlqimit, thyerje të privacisë dhe mashtrim. Të gjithë këta faktorë joetik janë përjashtuar duke treguar një kujdes shumë të veçantë. Takimet me të intervistuarit janë bërë me dakordsinë e tyre për momentin dhe kohëzgjatjen e bisedës. Identiteti i tyre mbahet anonim përderisa ata do të kërkojnë të kundërtën. Personalisht jam plotësisht dakord me qëndrimin e Bryman dhe Bell (2007) se gjatë një kërkimi është shumë e dëshiruar që kërkuesi të jetë i vetëdijshëm për sa i përket çështjeve të etikës pasi vetëm kështu do të arrijë në vendime të plota dhe mirinformuara.

MBI DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE

1. Format e reagimit ndaj kriminalitetit

Format e reagimit ndaj kriminalitetit kanë evoluar nga format e reagimit privat (përzënia, dëbimi, hakmarrja, gjakmarrja, pajtimi me shpërblim) në format e reagimit publik. Edhe vetë format e reagimit publik kanë evoluar në etapa të ndryshme; nga etapa e shpagimit dhe e frikësimit në etapat humanitare, të individualizimit të dënimit dhe të ri-integrimit¹⁷t. Secila etapë ka qenë e karakterizuar nga lloje të ndryshme reagimesh ndaj kriminalitetit, pra lloje të ndryshme dënimesh.

Duke qenë se dënimi është forma e reagimit të shoqërisë kundër autorit të veprës penale, i përcaktuar si i tillë në norma të detajuara ligjore, ai duhet të studiohet si dukuri e veçantë. Me fjalë të tjera, nocioni i dënimit duhet të shprehë në të njëjtën kohë thelbin e vetë, rolin që luan si dukuri shoqërore dhe karakteristikat e veta ligjore, në formën në të cilën paraqitet. Duke u nisur nga uniteti i elementëve formalë e materialë të tij, dënimi penal përcaktohet si masë e detyruar, e përcaktuar në ligj, të cilën gjykata e cakton kundër personit penalisht të përgjegjshëm për kryerjen e një veprë penale, në funksion të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe vlerave të tjera shoqërore të garantuara me kushtetutë dhe të drejtën mderkombëtare¹⁸.

Nga ky përkufizim i kuptimit të dënimit rezultojnë edhe elementet themelore të tij:

- 1) Dënimi, si masë e dhunshme, paraqet një të keqe që i behet personit që ka kryer veprën penale, nëpërmjet heqjes apo kufizimit të lirive dhe të drejtave të tij¹⁹.
- 2) Dënimi duhet të ketë një qëllim të caktuar që dëshirohet të arrihet nëpërmjet ekzekutimit të tij (dënimit). Ky qëllim përfshin shprehjen e gjykimit shoqëror ndaj autorit të veprës penale, ndikimin ndaj tij që në të ardhmen të mos kryejë më vepra penale, ndikimin ndaj të tjerëve që të mos kryejnë vepra penale, ndikimin ndaj vetëdijes së qytetarëve për pasojat e veprave penale, si dhe dënimin e arsyeshëm të autorëve të veprës penale²⁰.
- 3) Dënimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj. Me fjalë të tjera, dënimi duhet t'i përmbahet parimit të ligjshmërisë, në mënyrë që të garantohen qytetarët nga keqpërdorimi i pushtetit dhe arbitrariteti. Dënimet penale përcaktohen vetëm me ligj dhe, në asnjë rast, me akte nënligjore²¹.
- 4) Ekzekutimi i dënimit penal varet nga ekzistenca e veprës penale dhe e përgjegjësisë penale të autorit të saj. Dënimi penal nuk mund t'i caktohet një personi që nuk ka kryer një vepër penale apo që nuk është i përgjegjshëm penalisht.
- 5) Dënimi penal mund të caktohet vetëm nga gjykata, pas përfundimit të një procedure shqyrtimi të përcaktuar me ligj.

Përveç elementëve thelbësorë, tek disa dënime paraqiten edhe elementët relativë, të cilët kanë karakter jo të përhershëm:

¹⁷ Halili. R, Penalogjia, Blendi publishing, August (2000), Prishtina, Hysi. V, Kriminologjia, (2005), Crystallina-KH, Tirana, por edhe Hysi.V, Penologjia, (2006), PEGI, Tirana.

¹⁸ Elezi Ismet, "Mbrojtja juridike penale e jetës së njeriut në Republikën Popullore të Shqipërisë", Tiranë, 1962.

¹⁹ Elezi Ismet. "E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme I dhe II, Tiranë 1999.

²⁰ Halili Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, 2005.

²¹ Halili Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, tetor 2007, bot. i V-të.

- 1) Dënimi penal duhet të jetë personal, pra duhet t'i drejtohet vetëm autorit të veprës penale dhe jo personave të afërt të tij, të cilët nuk kanë lidhje me veprën penale. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve për përmbushjen e kësaj kërkesë, pothuajse çdo dënim penal godet edhe persona të tjerë të afërt me autorin e veprës penale.
- 2) Dënimi penal duhet të jetë human, pra njerëzor, gjë që do të thotë se dënimi nuk mund të ketë elementë që të konsiderohen torturë, mundim apo sjellje çnjerëzore ndaj autorit të veprës penale²².
- 3) Dënimi duhet të jetë i moralshëm, që do të thotë se dënimi nuk duhet ta demoralizojë autorin e veprës penale²³.
- 4) Dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të autorit të saj.
- 5) Dënimi duhet të jetë i përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë, në mënyrë që dënimi për veprën konkrete të mund të jepet i ulët ose i lartë, në varësi të rëndësisë së veprës penale, rrethanave të kryerjes së saj dhe rrezikshmërisë së autorit.
- 6) Dënimi duhet të jetë i revokueshëm, që do të thotë se ekzekutimi i tij mund të ndërpritet në rastet kur ai është caktuar në kundërshtim me ligjin. Kjo karakteristikë e dënimit ka rëndësi të madhe, për shkak të rëndësisë që ka e drejta për liri personale për individin dhe mbrojtja e tij nga gabimet gjyqësore.
- 7) Dënimi duhet të jetë i përmirësueshëm²⁴, në mënyrë që të shmangen pasojat që mund të vijnë nga natyra e tij. Kjo karakteristikë është gjithashtu e rëndësishme për shkak të mundësisë së caktimit të dënimit të paligjshëm apo të bazuar në prova të rreme. Dënimi me gjobë është i përmirësueshëm, kurse ai me burgim nuk është, pasi koha e kaluar në burg nuk mund të kthehet. Megjithatë, personi i burgosur pa të drejtë mund të kompensohet në para për kohën e kaluar në burg.
- 8) Dënimi duhet të jetë i ndërrueshëm, në mënyrë që të mundësohet zëvendësimi i tij me një lloj më të lehtë dënimi se sa ai që është caktuar në vendimin fillestar.

2. Teoritë mbi bazën ligjore dhe shoqërore të ndëshkimit

Në teorinë e së drejtës penale qysh herët është parashtruar çështja e bazës juridike të dënimit, pra dhënia përgjigje pyetjes së çfarë qëndron në bazë të të drejtës së shtetit për të dënuar autorët e veprave penale. Gjatë procesit të gjetjes së përgjigjes së kësaj pyetjeje, janë zhvilluar shumë teori, nga të cilat më të njohurat janë:

- 1) Teoria idealiste;
- 2) Teoria e kontrates shoqërore;
- 3) Teoria juridike;
- 4) Teoritë sociologjike.

Sipas teorive idealiste, baza e të drejtës së shtetit për të dënuar është kërkesa e të drejtës absolute. E drejta absolute është kategori ideore, nga e cila rrjedh e drejta e shtetit në përgjithësi dhe, për rrjedhojë, edhe e drejta për zbatimin e dënimit. Me kryerjen e veprës penale, vjen edhe shkelja e

²² Hysi, V, Kriminologjia, (2005), Crystallina-KH, Tirana.

²³ Pallazzo, F, Papa, M “Lezioni di diritto penale comparato”, (2000), Giappichelli editors, Padova.

²⁴ Kambovski, V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje.

të drejtës absolute, e cila mund të rivendoset vetëm pasi të jetë zbatuar dënimi përkatës ndaj autorit të veprës penale. Drejtësia absolute mund të kuptohet në mënyra të ndryshme dhe, në kuadër të teorive të ndryshme²⁵, veçohen tre qasje ndaj drejtësisë absolute:

- 1) Teoria e të drejtës së perëndisë;
- 2) Teoria e të drejtës morale;
- 3) Teoria e të drejtës zakonore.

Sipas teorisë së të drejtës së perëndisë, e drejta e dënimit është me prejardhje hyjnore, por, me krijimin e shtetit, kjo e drejtë u transferua nga perëndia tek shtetet. Prandaj, sipas kësaj teorie, shteti është vetëm një zbatues i thjeshtë i një të drejte të perëndisë, e drejtë që është e karakterit imperativ, sepse mbështetet në kërkesën që të dënohet çdo person që shkel rregullat nëpërmjet kryerjes së ndonjë veprë penale²⁶.

Teoria e të drejtës morale konsideron se baza e të drejtës së shtetit në aplikimin e dënimit penal rrjedh nga normat morale, të cilat zotërojnë botën dhe të cilat gjenden në vetëdijen e secilit individ. Sipas Kantit, normat morale janë të përmbledhura në vetëdijen e secilit individ me mendje të shëndoshë, kështu që çdo njeri i arsyeshëm është në gjendje të vlerësojë veprimet e veta dhe të kuptojë se çfarë është e lejuar dhe çfarë jo²⁷. Personi që sillet në mënyrë të palejuar e kupton në vetëdijen e vet kërkesën për zbatimin e dënimit, e cila ka karakter të imperativitetit kategorik.

Teoria e të drejtës ligjore (Hegeli) konsideron se baza e të drejtës për dënim qëndron në domosdoshmërinë dialektike. Në çdo shtet, si forma më e lartë e idesë absolute, ekziston një e drejtë ligjore e përcaktuar²⁸. Me kryerjen e veprës penale, kjo e drejtë refuzohet (sulmohet), kështu që ndaj personit që ka kryer veprën duhet të zbatohet dënimi, si kundërmasë përmes së cilës rivendoset e drejta. Pra, vepra penale është negacion i të drejtës, kurse dënimi është negacion i negacionit, përmes të cilit rivendoset rendi i shkelur juridik.

Teoria e kontratës shoqërore (Ruso, Grocius, Lok, Hobs) konsideron se individët, si pjestarë të shoqërisë në shkallën e caktuar të zhvillimit të saj, e kanë kuptuar se nuk janë në gjendje të kujdesen individualisht për mbrojtjen e të mirave dhe interesave të tyre. Përpara se kriminaliteti të marrë në zotërum gjithçka, ata kanë vendosur të formojnë shtetin dhe t'i transferojnë atij të drejtat e tyre për mbrojtjen nga sjelljet e palejuara dhe të kundërligjshme. Në këtë mënyrë, duke hequr dorë nga e drejta për të dënuar në dobi të shtetit, individët gjithashtu kanë pranuar që edhe vetë të dënohen nëse shkelin ligjin dhe kryejnë vepra penale. Kështu që, në bazë të kësaj teorie,

²⁵ G. Fiandaca, E. Musco: "Diritto penale parte generale", Bologna, 1995, fq. 648 e vijues.

²⁶ G. Fiandaca, E. Musco, op. cit., fq. 648 e vijues.

²⁷ G. Fiandaca, E. Musco, op. cit., fq. 648, shënimi 37, ku pasqyrohet afirmimi i Kant-it, i cili në veprën "Die Metaphysik der Sitten", § 49 E I, Kant Studienausgabe der Eissenschaftlichen Buchgesellschaft, IV, 1956, fq. 455, vijon: "Edhe nëse shoqëria civile do të shkrihej me konsensusin e të gjithë anëtarëve (për shëmbull, nëse populli që banon në një ishull vendosin të ndahen, duke u shpërndarë në të gjithë botën), vrasësi i fundit, që gjendet në burg, duhet ekzekutuar paraprakisht në mënyrë që secili të marrë atë që veprimet e tij meritojnë dhe faji i gjakut të mos bjerë mbi popullin, që nuk ka kërkuar këtë dënim". Është e njohur gjithashtu formula dialektike e Heghel, Grundlinien der Philosophie des Rechts, § 104, sipas të cilit dënimi përfaqëson "mohimin e mohimit të së drejtës".

²⁸ G. Fiandaca, E. Musco, op. cit., fq. 648 e vijues.

del se baza juridike e dënimit gjendet në kontratën shoqërore të individit, nga e cila u themelua shteti.

Teoritë juridike mbi bazën juridike të dënimit e shohin përgjigjen e kësaj pyetjeje në normat e të drejtës pozitive. Shteti ka kompetenca të nxjerrë norma, përmes të cilave rregullohet jeta e njerëzve. Nga kjo rezulton edhe kompetenca e shtetit që të sigurojë zbatimin e ligjit. Kjo do të thotë se shteti ka të drejtë të nxjerrë norma, përmes të cilave rregullohet sjellja e individëve, kërkohet nga qytetarët bindje, si dhe ndëshkim për ata që nuk i respektojnë normat.

Njëri ndër përfaqësuesit e këtyre teorive është autori Binding, i cili vlerëson se shteti ka të drejtë për vetëmbrojtje kundrejt autorëve të veprave penale, të cilët kanë shkelur ndonjë normë juridike dhe kanë vënë në rrezik të mirat juridike të mbrojtura.

Teoritë sociologjike e shohin bazën juridike të dënimit në funksionin social të së drejtës penale. Sipas teorisë utilitare (Bentam), dënimi ka si arsye, ashtu edhe dobinë e zbatimit të tij. Sipas Listit, baza juridike e dënimit rezulton nga nevoja për të ruajtur rendin juridik dhe sigurinë e shtetit. Nevoja e shtetit për të zbatuar dënimet rezulton nga nevoja e ruajtjes dhe sigurimit të të mirave dhe vlerave më të rëndësishme shoqërore nga të gjitha format e shkeljes dhe rrezikimit të tyre.

Në teorinë e së drejtës penale qysh herët është diskutuar edhe pyetja se cili është qëllimi i dënimit, pra çfarë dëshirohet dhe çfarë mund të arrihet nëpërmjet zbatimit të dënimit ndaj autorëve të veprave penale. Gjatë procesit të gjetjes së përgjigjes së kësaj pyetjeje janë zhvilluar teori të ndryshme:

- 1) Teori absolute;
- 2) Teori relative;
- 3) Teori të përziera (eklektike).

Sipas teorisë absolute, qëllimi i dënimit është hakmarrja, represioni ndaj autorit për veprën e kryer. Me këtë veprë, ai i shkakton shoqërisë një të keqe, kurse shoqëria ia kthen të keqen nëpërmjet caktimit të dënimit. Ky person e përjeton të keqen që i shkakton caktimi i dënimit gjatë vuajtjes së këtij dënimi. Prandaj qëllimi i dënimit është hakmarrja, shpagimi nga ana e shoqërisë, pikërisht vuajtja që i shkaktohet autorit të veprës. Teoritë shpaguese bazohen, nga ana tjetër, edhe në një parim në thelb utilitarist: dënimi aplikohet thjesht sepse fajtori e ka merituar. Këto teori nuk përpiqen të rindërtojnë çarjet sociale të krijuara nga akti kriminal. Ajo që është thelbësore në teorinë shpaguese është respektimi i proporcionalitetit i përqëndruar mbi rëndësinë e raportit rrezik-dëm dhe mbi intensitetin e shkallës së fajit, qoftë ajo dashje apo pakujdesi.

Teoritë relative hedhin poshtë qasjen, sipas së cilës hakmarrja është i vetmi qëllim i dënimit dhe konsiderojnë se dënimi paraqet mjetin e mbrojtjes së shoqërisë nga kriminaliteti. Qëllimi i dënimit gjendet në dobishmërinë shoqërore, që do të thotë në faktin se sa mund të shërbejë dënimi si mjet efikas në luftën kundër kriminalitetit (edhe ky një funksion utilitar). Në këtë kuptim, qëllimi themelor i dënimit është parandalimi i kryerjes së veprave penale në të ardhmen. Autori nuk dënohet për atë që ka bërë, por që të mos gabojë më në të ardhmen. Në varësi të mënyrës se si realizohet ky qëllim, dallohen:

- 1) Teoria e prevencionit individual dhe special;
- 2) Teoria e prevencionit të përgjithshëm.

Teoritë e prevencionit individual dhe atij special konsiderojnë se qëllimi i denimit është parandalimi i kryerjes së veprave të tjera nga ana e autorit. Ky qëllim arrihet me aplikimin e mjeteve të veçanta dhe metodave ndikuese mbi autorin, të cilat janë të mjaftueshme që ai në të ardhmen të mos kryejë vepra të penale²⁹.

Në varësi të metodës, përmes së cilës ushtrohet ndikimi, dallohen tri variantë të kësaj teorie:

- 1) Teoria e frikësimit;
- 2) Teoria e përmirsimit;
- 3) Teoria e kujdestarisë.

Sipas teorisë së frikësimit, dënimi duhet të zbatohet në mënyrë të tillë që të shkaktohet frikë tek autori i veprës në një masë të tillë ai të pengohet që të kryejë vepra penale në të ardhmen. Teoria e përmirsimit nisët nga supozimet se autori i veprës penale është person, tek i cili mbizotërojnë tipare negative. Për këtë arsye, ndikohet me anë të dënimit që ato karakteristika negative të shuhen dhe të zhvillohen karakteristika pozitive. Në mënyrë që kjo të arrihet, dënimi duhet të jetë mjet për përmirësim, pra mjet që mund të ndërrohet, zëvendësohet, për t'iu përshtatur karakteristikave psikologjike të autorit të veprave penale.

Teoritë e prevencionit gjeneral konsiderojnë se qëllimi i dënimit është ndikimi në masa të gjëra të qytetarëve në mënyrë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale. Me të vepruarit e tillë të denimit paraprakisht parandalohen qytetarët, të cilët janë të prirur për kryerjen e veprave penale që të mos i kryejnë ato dhe, në këtë mënyrë, t'i shmangen zbatimit të denimit. Në varësi të mënyrës se si mund të arrihet ky qëllim, dallohen tre variante të kësaj teorie: 1) Teoria e frikësimit të përgjithshëm, 2) Teoria e tërheqjes së vërejtjes, 3) Teoria e frikësimit me ekzekutimin e denimit.

Sipas teorisë së frikësimit të përgjithshëm me dënimin e përcaktuar (teoria e detyrimit psikologjik), i bëhet me dije secilit qytetar se atyre do t'u ndodhë diçka e keqe në qoftë se ata kryejnë vepra penale. Kërcënimi me dënim ndikon si detyrim psikologjik në të gjithë delikuentët potencial që të përmbahen nga shkëlja e rregullave dhe të mos kryejnë vepra penale. Sipas teorisë së vërejtjes mbi dënimin e përcaktuar (teoria e detyrimit moral), u bëhet me dije qytetarëve se kryerja e veprave penale është amorale dhe e ndaluar dhe, natyrisht, e dënueshme. Në këtë mënyrë, dënimi lufton karakteristikat amorale, të cilat ekzistojnë te disa qytetarë dhe, në anën tjetër, ngre moralin e përgjithshëm të shoqërisë.

Teoria e frikësimit me ekzekutimin e dënimit konsideron se parandalimi i kriminalitetit arrihet me ekzekutimin e dënimit ndaj të gjykuarve. Ky ekzekutim duhet të jetë i tillë që të shkaktojë

²⁹ Shih L. Eusebi: "La nuova retribuzione", në *Diritto penale in trasformazione* nën kujdesin e Marinucci e Dolcini, Milano, fq. 93 e vijues, 97 e vijues, 106 e vijues, në të cilin trajtohet raporti midis teorisë shpaguese, parandalimit të përgjithshëm, dhe qëllimet politiko-kriminale.

frikë në masë. Në mënyrë që kjo të arrihet, dënimet duhet të ekzekutohen hapur dhe të jenë të ashpra apo në mënyrë të tillë që për to të flitet në masë nga një person tek tjetri.

Sipas teorisë së kujdestarisë, autori i veprës është person që nuk ka rezistencë ndaj ndikimeve të jashtme, prandaj ai ka rezultuar të jetë i përshtatshëm për kryerjen e veprave penale.. me caktimin e dënimit ndaj tij, ai vihet nën perkujdesje të organeve shtetërore, të cilat kanë për detyrë që ta aftësojnë për t'u sjellë në pajtim me rregullat e shoqërisë dhe për të respektuar normat e rendit juridik dhe të disiplinës shoqërore.

Teoritë e përziera (eklektike) kanë lindur si bashkim i elementeve të teorive absolute dhe atyre relative. Sipas kësaj qasjeje, qellimi i dënimit nuk mund të realizohet vetëm me hakmarrje e as vetëm me parandalim. Dënimi duhet të ketë qellim parandalimin, pra parandalimin e kryerjes së veprave në të ardhmen. Megjithatë dënimi zbatohet me rastin e kryerjes së ndonjë vepre penale konkrete dhe, natyrisht, ndaj autorit të asaj vepre dhe, në një këndvështrim të ngushtë, paraqet detyrimin dhe masën retributive (masën e kufizimit apo marrjen e të mirave juridike, lirinë dhe të drejtën), pra autori dënohet për veprimin e gabuar, por edhe që të mos gabojë më.

Duke interpretuar dispozitat e caktuara të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë, rezulton se qellimi i dënimit është:

- që të shprehet gjykimi shoqëror për veprën e kryer penale;
- që të ndikohet mbi autorin që në të ardhmen të mos kryejë vepra të tilla;
- që të ndikohet mbi qytetarët tjerë që të mos kryejnë vepra penale;
- që të ndikohet në vetëdijen e qytetarëve mbi anën e dëmshme të veprave penale, si dhe mbi dënimin e drejtë të autorëve³⁰.

Kjo do të thotë që ligjvënësi niset nga ideja se qellimi final i dënimit është mbrojtja e shoqërisë, konkretisht e të mirave dhe vlerave tjera shoqërore, nga kriminaliteti dhe qellimi i tij i drejtëpërdrejtë është përcaktuar si i dyfishtë:

- Prevensioni special (i veçantë), si parandalimit i autorit për të kryer vepra penale dhe përmirësimin, edukimi i tij;
- Prevensioni i përgjithshëm, si ndikimi edukativ mbi qytetarët e tjerë që të mos kryejnë vepra penale dhe ndikimin në vetëdijen e tyre mbi anën e dëmshme të veprave penale dhe domosdoshmërinë e dënimit të autorëve të tyre³¹.

Edhe ligje të tjera penale bashkëkohore e përcaktojnë në mënyrë të ngjashme qëllimin e dënimit.

3. Llojet më të përhapura të dënimeve penale

Sistemi i dënimeve është tërësia e dënimeve të përfshira në legjislacionin penal të një vendi, mënyra e përcaktimit të tyre, si dhe raportin e ndërsjellë. Per qellim të luftimit më të suksesshëm të kriminalitetit, të gjitha legjislacionet parashikojnë shumëllojshmëri të dënimeve. Për këtë

³⁰ E drejta penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1973, fq. 2010.

³¹ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.

arsye është e domosdoshme të realizohet individualizimi i dënimit, që do të thotë që ndaj secilit person që kryen vepra penale të caktohet ai dënim që realizon në mënyrën më të mirë qëllimet e dënimit penal.

Ne baze të kësaj që u tha, ekzistenca e një numri të madh të dënimeve ka për pasojë:

- nevojën e një lufte me efikasë dhe me cilesore kundër kriminalitetit;
- nevojën e pershtatjes së llojit dhe masës së dënimit me autorin përkatës të veprës, në mënyrë që të arrihet risocializimi i tij.

Duke qenë se legjislacionet penale parashikojnë shumë lloje të dënimeve, atëherë ato mund të ndahen në baze të kriterëve të ndryshme:

- Në varesi të pavaresisë në caktimin e tyre, dënimet ndahen në dënime kryesore dhe dënime plotësuese. Dënimet kryesore janë ato që mund të caktohen më vete, kurse dënimet plotësuese janë ato të cilat nuk mund të caktohen më vete, por vetëm bashkë me dënimet kryesore³².
- Në varesi të kohëzgjatjes, dënimet ndahen në të gjata dhe në dënime të përcaktuara në kohë. Dënimet e gjatë (të përjetshme) janë ato dënime të cilat caktohen për tërë jetën e të denuarit. Dënimet e përcaktuara në kohë janë ato dënime që caktohen nga gjykata për një kohë të caktuar³³.
- Në varesi nga të mirat që godet dënimi, dënimet ndahen në dënime kundër jetës, dënime kundër integritetit trupor, dënime kundër lirisë, dënime kundër pasurisë dhe dënime kundër të drejtave qytetare, etj³⁴.
- Në varesi të procedurës legjislative, dënimet mund të jenë alternative dhe kumulative. Ateherë kur dënimet janë të paraqitura si alternative, gjykata cakton vetëm njerin prej tyre. Në rastin e dënimit të parashikuara si kumulative, gjykata cakton të gjithë dënimet e parashikuara në ligj kundër autorëve të veprave penale³⁵.

4. Faktorët që ndikuan në krijimin e dënimeve alternative

Tek dënimi, tradicionalisht identifikohet dhe një funksion parandalues, mbrojtës dhe ruajtës i komunitetit social të cilit i përket. Mbi të gjitha dënimi ka për objekt të realizojë heqjen dorë të personave nga kryerja e veprës penale, nëpërmjet rrezikut konkret të ushtrimit ndaj tij të ndjekjes penale në rastet kur kjo do të verifikohet.

Nga këndvështrimi i personit të dënuar, dënimi luan një rol neutralizues, duke identifikuar personat që konsiderohen të aftë për të kryer vepra penale në të ardhmen. Pavarësisht se në

³² Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.

³³ Salihu Ismet, "E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme", Prishtinë, 2003.

³⁴ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.

³⁵ Salihu Ismet, "E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme", Prishtinë, 2003.

radhët e gjyqtarëve nuk ekziston besimi në funksionin neutralizues të dënimit, në realitet më pas ata kërkojnë të arrijnë këtë qëllim duke aplikuar masat e sigurimit.

Kjo traditë është kritikuar nga jurisprudenca, me arsyetimet që vijojnë:

- Efekti shpagues nuk mban në asnjë rast parasysh personalitetin e të pandehurit dhe aftësitë e tij transformuese, negative apo pozitive qofshin ato³⁶.
- Efekti parandalues që dënimi mbart në abstrakt, nuk është konfirmuar në asnjë rast nga statistikat shkencore³⁷.
- Efekti parandalues i vendimit gjyqsor është praktikisht null në raste të caktuara, sidomos po të mbajmë parasysh faktin e ndalimit të publikimit të vendimit të dhënë ndaj të miturve, rregull ky plotësisht i pranueshëm me qëllim mbrojtjen e të miturit por që, në këndvështrimin e një analize objektive çon në mos perceptimin prej tij të asaj që ka ndodhur në të vërtetë; dhe është kjo pikërisht që duhet të ndodhë, për ti ndihmuar që të ndërjegjësohen dhe të kuptojnë te keqen, dhimbjen që kanë shkaktuar³⁸.
- Është e pamundur të përcaktohet (me përjashtim të rasteve të rralla) se kush është i prirur për të qenë përsëritës (recidiv) e kush jo³⁹.
- Është e pamundur të përcaktohet (në terma kohorë) funksioni neutralizues i dënimit⁴⁰.
- Ky kriter nuk jep shkas, argumenta apo ide konkrete për të konkretizuar masën e dënimit⁴¹.

Për më tepër është kërkuar të identifikohet tek dënimi një funksion rehabilitues, nëpërmjet një qasjeje trajtuese, duke e asimiluar krimin me një simptomë patologjike. Edhe në rastet kur i mituri nuk ka demonstruar asnjë simptomë patologjike, i është bërë referim gjithmonë një nevojë të pakufizuar “riedukimi”.

Bazuar në këto dështime dhe tek këto limite të pakapërcyeshme të funksionit tradicional të dënimit, është tentuar që të spostohet vëmendja nga vepra penale si një ngjarje/e dhënë statistikore, tek vepra penale si një ngjarje-konflikt raportesh, nga shpagimi-pagimi i dhimbjes tek riparimi-dëmshtëpërlimi i dhimbjes, nga trajtimi-mbështetja ndaj fajtorit tek ndërjegjësimi i tij.

Nga ky këndvështrim, edhe figura e viktimës apo e personit të dëmtuar nga vepra penale, largohet nga pozicioni klasik i të konsideruarit si “dytësor”, i përjashtuar nga “larja e hesapeve” që ndodh midis Shtetit-Shoqërisë dhe fajtorit: përkundrazi, ai shndërrohet në elementin thelbësor e final të të gjithë procesit sanksionues, proces i konsideruar mbi të gjitha si shpërblyes i dëmit apo i dhimbjes së shkaktuar, e konsideruar jo vetëm në terma materialë. Në rast të kundërt do të asistoni në një “jo rregull” që bart me vete një seri efektsh zinxhir, pikë së pari humbjen e besimit ndaj sistemit nga ana e qytetarëve. Deri më sot, kemi asistuar nga njëra anë në një rritje

³⁶ Elezi Ismet. ”E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme I dhe II, Tiranë 1999.

³⁷ Halili Ragip, “Kriminologjia”, Prishtinë, 2005.

³⁸ Halili Ragip, “Kriminologjia”, Prishtinë, tetor 2007, bot. i V-të.

³⁹ Salihu Ismet, ”E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme “, Prishtinë, 2003.

⁴⁰ Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999.

⁴¹ Foundation “Conflict Resolution and Reconciliation of Disputes”, Restorative justice and mediation in resolving criminal despotes, Manual for judges and prosecutors, UNICEF, (2007), Tirana.

galopante të dominimit penal, falë rritjes së funksioneve disiplinuese të Shtetit dhe nga ana tjetër në krizën e sistemeve të socializimit parësor e për refleks rritjes së vazhdueshme të kërkesës për disiplinën formale. Gjithë kjo shpie në një kolaps të brëndshëm - “endo kolaps” - të sistemit; dhuna brënda familjes, mikrokriminaliteti, vandalizmi, degradimi shoqëror, intolerancat sociale, prodhojnë vuajtje në masë dhe përkthehen në një nevojë gjithmonë e në rritje për riafirmim normativ, natyrisht e papërbalueshme krahasuar me numrin e madh të të parave.

Në këtë kontekst politiko-social shpërbërjeje, është e mundur të asistojmë në daljen në pah të dinamikave sociale që kanë si objektiv të bëjnë përgjegjëse shoqërinë civile, të ri-vendosin aftësinë dhe virtutin e autorregullimit të konflikteve.

Modeli i drejtësisë restauruese, i vendosur në rend kohor, përfaqëson modelin e fundit të sistemeve të drejtësisë që kanë pësuar në vite, model i përpunuar rishtaz, por në të njëjtën kohë më i vjetri, i cili i referohet shoqërive para-shtetërore, brënda të cilëve konfliktet midis individëve ishin fakte/ngjarje që i përkisnin vetëm raportit midis agresorit dhe viktimës, duke përjashtuar kështu veprimtarinë ndërmjetësuese të Shtetit. Ky afirmim bëhet jashtë çdo kriteri vlerësimi, pasi lindja e shtetit të së drejtës dhe njohja ndaj këtij të fundit të së drejtës për të administruar drejtësinë, përbën një arritje thelbësore duke u konsideruar ende një garanci thelbësore për mbrojtjen e të drejtave. Pra, nëse duhet ti referohemi formave alternative të drejtësisë, siç mund të konsiderohet drejtësia restauruese, theksojmë se ajo duhet të aplikohet brënda administratës së institucioneve, nëpërmjet veprimit aktiv të përfaqësuesve të saj dhe gjithmonë në respekt të së drejtës.

Në rradhë të parë, çfarë do të thotë model alternativ dhe përse vallë konsiderohet alternativ? Modele të ndryshëm të administrimit të drejtësisë kanë zëvendësuar njëri tjetrin, të influencuar jo vetëm nga ndryshimet e orientimeve filozofike dhe kërkimore, por edhe nga ndryshimet politike që kanë ndihmuar në afirmimin apo rënien e këtyre modele. Autorët Gatti dhe Marugo⁴² identifikojnë tre modele substanciale të drejtësisë (modelin shpagues, modelin rehabilitues dhe modelin restaurues), natyrisht të ndryshëm përsa i përket objektit, mjeteve që përdoren apo objektivave që i vënë vetes.

Në modelin e parë, krimi është objekt i ndjekjes penale. Pra, ndjekja penale ushtrohet në rastin e kryerjes së një krimi. Qëllimi është: ai i përcaktimit të fajësisë dhe mjetet janë: aplikimi i dënimit. Në modelin e dytë, objekti identifikohet me autorin e veprës penale, objektivi është ai i rehabilitimit social dhe mjetet janë: trajtimi socio-rehabilitues i orientuar drejt modifikimit të sjelljes të autorit të veprës penale. Modeli restaurues, dallohet nga dy të parët, sepse ka si objekt dëmet që i janë shkaktuar viktimës si pasojë e kryerjes së veprës penale dhe si objektiv, eliminimin e këtyre pasojave nëpërmjet aktivitetit riparues të ndërmarrë nga autori i veprës penale. Brënda këtij modeli, palët (agresori dhe viktimja) marrin një rëndësi të veçantë dhe një rol operativ central merr ndërmjetësuesi, i cili zëvendëson institucionet.

Është pikërisht në këtë kontekst socio-institucional që sot gjejnë hapësirë dhe sukses praktikat alternative.

⁴² Merrington, S., Stanley, S. (2007) “Effectiveness: who counts what?” in Gelsthorpe, L. and Morgan, R. (eds) Handbook of Probation. Cullompton: Willan Miller, W. & Rollnick, S. 2002, Motivational Interviewing: Preparing People for Change. 2nd edn. London: Guildford Press.

Autorët Zehr dhe Umbreit mbështesin tezën se nevoja për të kërkuar dhe aplikuar forma të tjera të drejtësisë shkon në kohë rreth viteve 80' kur, veç krizës së ËelfareState, imponohet nevoja për burgje më pak të mbushura dhe për pakësimin e kostove të administrimit të tyre. Po në këtë periudhë konstatohet dhe një zhvillim gjithmonë në rritje i studimeve e kërkimeve mbi viktimat e krimit (shkenca e viktimologjisë) dhe zbatimi i politikave sociale në favor të viktimave të krimit.

Disa kohë më vonë, Umbreit dhe Umbreit e Coates (respektivisht në dy shkrime, i pari në vitin 1989 "Crime victims seeking fairness, not revenge: toward restorative justice"; dhe i dyti në vitin 1993 "Crime victims and offenders in mediation: an emergin area of social work practice"), konceptit të "drejtësisë shpaguese" i bashkëngjisin konceptin e "drejtësisë restauruese" brënda të cilit zhvillohet një konceptim i ri mbi krimin, jo më i konsideruar si një ofendim ndaj Shtetit, por si një dëmtim i të drejtave të individit: është pikërisht ky i fundit dhe jo Shteti ai që duhet "kënaqur", meqenëse shpesh dënimi i fajtorit nuk përbën drejtësi për viktimën (Ealgrave).

Autorët Zehr dhe Umbreit⁴³ japin një përkufizim të përshtatshëm të drejtësisë restauruese - "restorative justice" – dhe një klasifikim të qartë në raport me modelet e tjera të drejtësisë. Sipas përkufizimit të Zehr, në fakt, modeli i drejtësisë restauruese, për autorin e veprës penale, zëvendëson dënimin me pagimin e një borxhi ndaj shoqërisë, por bazohet mbi rekuperimin e sensit të përgjegjësisë për atë që ka ndodhur dhe mbi ndërmarrjen e disa veprimeve në favor të viktimës. Në vënd që të paguajë një borxh abstrakt ndaj shoqërisë duke vuajtur dënimin, autori i veprës penale paguan drejtpërsëdrejti në favor të viktimës, duke riparuar dëmin me anë të veprimeve konkrete.

Në mënyrë analoge, Umbreit⁴⁴ pranon postulatit në të cilin bazohet teoria e drejtësisë restauruese - "restorative justice" – për të cilin sjellja kriminale është mbi të gjitha një konflikt midis individëve, dhe të dy, viktimat dhe autori i veprës penale, mbulojnë një rol aktiv në zgjidhjen e problemit - "problem solving" – i orientuar drejt riparimit të pasojave psikologjike e materiale të shkaktuara nga sjellja kriminale. Në këtë pikë është e nevojshme të bashkëngjisin një përmbledhje të faktorëve që kanë bërë të mundur afirmimin e një modeli alternativ të administrimit të drejtësisë dhe të faktorëve që e dallojnë.

Përfundimisht, zhvillimi i një modeli të drejtësisë restauruese merr shkas qoftë bazuar në krizën e sistemeve tradicionale të drejtësisë, atij shpagues dhe rehabilitues, qoftë në nevojën për të konsideruar viktimën si një palë e rëndësishme dhe jo marginale/anësore të veprës penale të kryer e të procesit. Duhet të qartësojmë gjithashtu faktin se modeli i drejtësisë restauruese mund të aplikohet në mënyra të ndryshme operative, qofshin ato edhe me karakter restitativ, pra duke dëmshpërblyer viktimën për dëmet e shkaktuara, shërbime në interes publik, apo programe që orientohet drejt arritjes së paqes midis autorit dhe viktimës.

⁴³ Wright, Martin. (1996), Justice for victims and offenders: A Restorative Response to crime, Winchester, Watergate Press, 2nd edition.

⁴⁴ Zehr, Howard. (2002) The Little Book of Restorative Justice.

Disa autorë, si Zehr, Van Ness, Harris⁴⁵, tentojnë të përshkruajnë një model operativ i cili vë theksin mbi të gjitha tek aksioni dinamik dhe i përbashkët i shtetit, komunitetit, viktimës dhe autorit të krimit, me objektivin që të pakësojnë disekulibrin e krijuar nga vepra penale.

Diku tjetër, në të njëjtën rrugë, autori Van Ness⁴⁶ thekson se procesi ndërmjetësues i drejtësisë restauruese mund të zhvillohet në dy drejtime: njëri formal në kompetencë të institucioneve dhe tjetri informal i bazuar në komunitet. Qëllimi i përbashkët është që të mbajnë parasysht interesat e viktimës, por duke qëndruar secili në pozicionin e tij që dallohet nga ai i tjetrit: qëllimi i procesit formal është që të verifikohet përgjegjësia e autorit, dëmshpërblimi në masën e përcaktuar, ndërsa procesi tjetër shkon tej këtyre objektivave me qëllimin e përmbushjes së nevojave të viktimës. Mbeten për tu përcaktuar, sipas Autorit, se cilat duhet të jenë palët dhe çfarë lloj raportesh duhet të ndërmerren, cilat rezultatet e pritshme dhe me çfarë mjetesh duhen arrirë. Këto pyetje kanë marrë përgjigje me adoptimin e programeve të diferencuara për aplikimin e drejtësisë restauruese.

Siç kemi mundur të përmendim shkurtimisht deri këtu, parimet e brëndshme të drejtësisë restauruese, edhe pse në forma inovative, nuk braktisin totalisht idealin rehabilitues dhe bazohen në çdo rast në krizën e efikasitetit të dënimit me burgim dhe në nevojën e dyfishtë për të humanizuar aplikimin e dënimeve dhe të pakësojnë kostot – në sensin ekonomik – e administrimit në lidhje me rritjen e vazhdueshme të popullatës së burgjeve.

Modeli i drejtësisë restauruese imponohet si një model gjithpërfshirës me shumëllojshmëri aplikimesh. Nga ana tjetër, Ërigh t ngre disa problematika rreth aplikimit të drejtësisë restauruese që në thelb konsistojnë në ekzistencën e rrezikut që viktima të ndjehet e detyruar, duke qenë në dijeni të avantazheve që autori i veprës penale mund të ketë; në rrezikun që të shkelen të drejtat e të pandehurit i cili mund të ndjehet i detyruar të vetëakuzohet për të përfituar nga avantazhet, edhe në prani të provave të vlefshme në shfaqësim të tij; në mungesën e qartësisë së rezultateve, pasi mund të verifikohen kërkesa të ndryshme nga ana e viktimave karshi autorëve të veprave penale të ngjashme, pasi siç kemi thënë, objektivi kryesor i drejtësisë restauruese është ti ofrojë hapësirën maksimale (të mundshme) kërkesave të palës së dëmtuar. Autori përfundon duke përkufizuar drejtësinë restauruese, jo shumë si një model alternativ që lind në kontrast me modelet e mëparshme, por si një proces evolutiv dhe i vazhdueshëm i kalimit nga objektiva shtypës në objektiva restaurues. Konsiderojmë se pjesërisht është kështu, pasi asnjë ndryshim nuk mund të ndodhë pa marrë parasysht se çka qenë përpara.

Duhet të theksojmë gjithashtu që nuk mund të mbrohet në asnjë rast teza se lindja e një modeli të ri të administrimit të drejtësisë, korrespondon me rënien totale të modelit të vjetër, por që modelet e ndryshme alternohen dhe rikthehen në raport me ndryshimet shoqërore dhe politike, siç është rasti i modelit shpagues, i gatshëm të rishfaqet sapo të lindë nevoja e forcimit “të përgjigjes ndëshkuese” dhe rivendosjes së garancive procedurale dhe modeli socio-rehabilitues që natyrisht nuk ka përënduar, sidomos nëse i referohemi sistemit të drejtësisë për të miturit, ku në çdo rast mund të integrohet me modelin e ri të drejtësisë restauruese.

⁴⁵ Wagrave, Lode. RJ and beyond – an Agenda for Europe, Paper presentation at the Conference of the European Forum for RJ, Barcelona, Spain 15-17 June 2006.

⁴⁶ Thorpe, D. et al (1980) Out of Care, London London: George Allen and Unwin Tournier, P.V. (2004). Aspects of good practice in the criminal justice system. In Crime Policy in Europe. Council of Europe Publishing.

Kushdo që propozon aplikimin e programeve të ndërmjetësimit në fushën e drejtësisë (dhe jo vetëm), propozon një lexim të dyfishtë të çështjes së ndërgjegjësimit apo të bërit përgjegjës: e para më tepër e lidhur me specifikën e funksionimit të ndërmjetësimit, e dyta në lidhje me formën e përfshirjes së palëve. Nëse, siç mendon De Leo, mendojmë për ndarjen tendencioze që ekziston midis përgjegjësive së hekurt që gjejmë në botën e drejtësisë dhe përgjegjësive së ndryshme e të hapur që mund të gjejmë në fushën e psikologjisë dhe në shumë sektorë të tjerë të shkencave humane, shumë larg nga bota e së drejtës, vërejmë se ndërmjetësimi punon për të vënë në lëvizje lidhje të reja ndërvepruese e dinamike, midis përgjegjësive relative me kontekstet e ndryshme sociale dhe atyre që vërehen në çështjet e drejtësisë. Por De Leo⁴⁷ na ka mësuar mbi të gjitha se përgjegjësia mund të kuptohet si një nga funksionet që janë baza e proceseve të diferencimit social. Për shëmbull, duke mos konsideruar përgjegjës disa subjekte (të miturit, të sëmuret mendore etj.), apo duke i konsideruar përgjegjës vetëm pjesërisht, mund të thotë se këtyre subjekteve i njohim më pak pushtet, më pak rëndësi shoqërore, më pak mundësi për të socializuar apo për të kuptuar, si dhe më pak aftësi dhe vetëvlerësim, për rrjedhojë më pak mundësi për të recuperuar ndaj një akti/veprimi negativ të kryer, qoftë materialisht, qoftë psikologjikisht.

Në proceset sociale, në fakt, përgjegjësia është drejtpërdrejt e proporcionuar me pushtetin e poseduar, me statusin social, me autoritetin që kemi mbi veten dhe mbi të tjerët. Pikërisht mbi bazën e këtyre konsideratave, në njëzet vitet e fundit studiuesit, politikanët, operatorët socialë dhe të së drejtës kanë punuar për të ndërtuar një model të drejtësisë për të miturit, i aftë që të shkojë – shikojë - tej dënimit, si sanksion impersonal dhe institucionalizues.

Kjo do të thotë se përgjegjësia është diçka që ndërtohet në raportet midis subjektit – veprimit – institucionit – shoqërisë, dhe jo vetëm një cilësi e brëndshme e koshiencës dhe vullnetit, e thënë ndryshe, e aftësisë për të kuptuar dhe dëshiruar.

Përkrahësit e ndërmjetësimit marrin shkas pikërisht nga bindja se ajo çka përjeton dhe eksperiencia e të miturit, lidhja që ai ka me sjelljet e tij devijuese, njohja dhe këndvështrimi nga pikëpamja normative, sociale, institucionale, janë pikat kyçe për një politikë “përgjegjshmërie” (politica della responsabilita).

Për sa i përket aspektit dhe përmbajtjes së çështjes së përgjegjësive dhe të bërit përgjegjës, mund të afrojmë problemin në këto terma. Kush propozon programe ndërmjetësimi në fushën e drejtësisë (dhe jo vetëm), propozon një këndvështrim të dyfishtë për sa i përket çështjes së përgjegjësive: e para e lidhur më shumë me aspektin specifik të “funksionimit” të ndërmjetësimit, e dyta “restorative justice” – në sensin e vërtetë të fjalës, që implikon kushtin paraprak të rolit aktiv të viktimave në procesin dhe impenjin në një aktivitet riparues-pajtues nga ana e autorit të veprës penale.

Nëse, siç sugjeron De Leo, mendojmë për ndarjen që zakonisht ekziston midis përgjegjësive së fortë dhe të kushtëzuar që ekziston në fushën e drejtësisë, dhe përgjegjësive së diferencuar e të

⁴⁷ Merrington, S., Stanley, S. (2007) “Effectiveness: who counts what?” in Gelsthorpe, L. and Morgan, R. (eds) Handbook of Probation. Cullompton: Willan Miller, W. & Rollnick, S. 2002, Motivational Interviewing: Preparing People for Change. 2nd edn. London: Guildford Press.

hapur, të pakushtëzuar që gjejmë në fushën e psikologjisë dhe në shumë sektorë të tjerë të shkencave humane, larg botës së të drejtës, vërejmë se ndërmjetësimi punon për të vënë lëvizje shumë lidhje dinamike dhe evolutive, midis përgjegjësive që lidhen me kontekstet e ndryshme shoqërore dhe atyre që përdoren nga praktikant gjyqsore. Por De Leo na ka mësuar, mbi të gjitha, se procesi i ndërgjegjësimit (i të bërit përgjegjës) mund të kuptohet si një nga funksionet që i paraprijnë proceseve shoqërorë diferencuese. Për shëmbull, të mos ngarkosh me përgjegjësi disa subjekte (të miturit, të sëmuretë mendore etj.), apo ti ngarkosh ata pjesërisht me përgjegjësi, nënkupton më pak pushtet tek këto kategori subjektsh, më pak vlerësim social ndaj tyre, më pak mundësi për të socializuar dhe për të kuptuar, si dhe më pak aftësi dhe vetëvlerësim, për rrjedhojë më pak mundësi për të rekuperuar karshi një veprimi negativ të kryer, qoftë e parë nga një këndvështrim material, qoftë nga një këndvështrim psikologjik.

Në fakt, në proceset sociale, përgjegjësia është drejtpërdrejtë e proporcionuar me pushtetin e poseduar, me statusin social, me autoritetin mbi vete apo mbi të tjerët. Është pikërisht mbi valën e gjatë të këtyre konsideratave që në vitet e fundit, studiuesit, politikanët, operatorët socialë dhe ato të drejtësisë kanë punuar për të ndërtuar një model të drejtësisë për të miturit, të aftë për të tejkaluar konceptin e dënimit të ashpër, impersonal, institucionalizues, duke lënë në të njëjtën kohë pas krahëve konceptin e papërgjegjshmërisë paternaliste-asistencialë që ka karakterizuar politikën e viteve shtatëdhjetë⁴⁸.

Kjo do të thotë se përgjegjësia është diçka që ndërtohet në raportet midis subjektivit-veprimit-institucionit-shoqërisë, dhe jo vetëm një cilësi e brendshme e koshicës dhe e vullnetit, e thënë ndryshe, e aftësisë për të kuptuar dhe dëshiruar (për të shprehur një vullnet).

Përkrahësit e ndërmjetësimit nisen pikërisht nga bindja se përjetimi dhe eksperiencia e të miturit, lidhja që ai ka me sjelljen devijuese, perceptimi i tij i kryer nga një këndvështrim normativ, social dhe institucional, janë të gjithë hapa që duhen ndërmarrë drejt një politike të të bërit përgjegjës.

Të zhvillosh ndërmjetësimin në fushën e drejtësisë për të miturit (dhe jo vetëm) do të thotë, mbi të gjitha, të tejkalohet vizioni i krimit si një akt i izoluar dhe abstrakt i kryer nga një subjekt “i vështirë”, dhe të fillohet të lexohet si një segment i disa marrdhënieve komplekse shoqërore. E përkthyer ndryshe, do të thotë ti ofrohet më shumë vëmendje protagonistëve të ngjarjes kriminale: karshi viktimës, subjekt tradicionalisht i lënë në harresë nga jeta procesuale, i garantohet një pjesëmarrje dhe një rol më aktiv se ç’ndodh në procesin penal; karshi fajtorit lihet mënjane – në çdo rast që gjyqtarët, operatorët socialë dhe ndërmjetësuesit do ta konsiderojnë të arsyeshme – koncepti i dënimit në këndvështrimin shpagues – siç na mëson dhe

Përgjegjësia, çdo herë që flitet për ndërmjetësimin, nuk ka të bëjë më (vetëm) me “të qenit përgjegjës” të diçkaje apo për diçka, por kuptohet si një rrugëtim që në përfundim të tij, do të çojë subjektet në konflikt të jenë “përgjegjës ndaj” (që të përgjigjen njëri karshi tjetrit).

Rrugëtimi nis me dëgjimin e vetes dhe të tjetrit, dëgjim që prodhon si rezultat njohjen me bashkëbiseduesin pasi ndodh brënda një marrdhënieje që ndërtohet në prani të të tretit; në fakt, ndërmjetësuesi nuk gjykon kurrë, nuk këshillon, nuk gjen dhe nuk jep zgjidhje, por ndërhyt në

⁴⁸ McWilliams, W. (1985) The Mission Transformed, The Howard Journal, Vol. 24.

konflikt për ti dhënë fjalën njërit apo tjetrit, për të lejuar në këtë mënyrë identifikimin e origjinës së situatës problematike. Në këtë mënyrë, përgjegjësia lind nga marrdhënia. Nuk bëhet më fjalë për të gjetur format apo përmbajtjen e të qënit përgjegjës. Faktet objekt i veprës penale, apo dhe vetë konfliktet sociale të krijuar prej tyre, bëhen shkas për ti dhënë hapësirë një rrugëtimi, i cili sheh përballë njëri tjetrit dy subjekte që pyesin reciprokisht njëri tjetrin, të përfshirë në një projekt relational që ndërmjetësuesi nuk mund (nuk duhet) të përshkruajë paraprakisht³⁸. Diskutimi rreth ndërmjetësimit, hap horizonte të reja që kombinohen më së miri me kuadrin e krizës socio-institucionale të përshkruar më lart.

Në fakt, është e rëndësishme që të mendohet rreth ndërmjetësimit jo si një mënyrë e aftë të aktivizojë “shpresat mesianike të ndryshimit dhe të shlyerjes”⁴⁹, jo si një, apo më keq akoma, si zgjidhja e atyre problemeve të cilëve drejtësia e zakonshme nuk ka ditur dhe nuk di ti japë zgjidhje, por thjesht si mënyra më e hapur për tu njohur dhe më e disponueshmja karshi mënyrave që çojnë drejt sanksionit penal, si një mjet i nevojshëm për të kaluar nga momenti destruktiv në atë kurativ, për të pranuar çrregullimin që paraqitet në shoqëritë e sotme.

5. Avantazhet dhe rreziqet e përdorimit të dënimeve alternative

Dënimet alternative, nga njëra anë, u japin mundësinë autorëve të veproave penale të cilët kanë mundësi për ri-integrim dhe rehabilitim në shoqëri të rifillojnë më shpejt jetën në komunitet, ndërsa, nga ana tjetër, kontrollojnë dhe ndëshkojnë autorët e veprave penale duke vepruar si mburojë për komunitetin. Sigurisht për të arritur rezultate të kënaqshme veprohet në bashkëpunim me shërbimet lokale sociale dhe të mirëqënies për të nxitur dhe rritur mundësitë e përfshirjes në shoqëri⁵⁰. Në mënyrë të përmbledhur avantazhet e dënimeve alternative mund të renditen si më poshtë:

- Dënimet alternative zvogëlojnë probabilitetin e rikthimit në rrethin e krimit.
- Dënimet alternative i kushtojnë më pak taksapaguesve.
- Dënimet alternative ofrojnë një mundësi për të zhdëmtuar dëmin dhe viktimën.
- Dënimet alternative zhdukin “Shkollën e krimit në burg”. Dënimet alternative shmangin marrjen e kulturës së burgut, në mënyrën e të jetuarit, të të shprehurit dhe zakonet e ndryshme që fitohen gjatë qëndrimit në burg.
- Dënimet alternative ndihmojnë në mbajtjen e lidhjeve familjare dhe sociale.
- Dënimet alternative i japin të dënuarit një mundësi për t'u ri-integruar në shoqëri;
- Dënimet alternative eliminojnë stigmën e dënimit me burgim. Turpi i të qenit në burg është kaq real, sa dhe anëtarët e pafajshëm të familjes e vuajnë atë edhe më shumë se vetë i dënuari;
- Komuniteti përfiton nga anëtarët e tij të rregullt dhe që kanë një plan të qartë për jetën. Ky plan përfshin pjesëmarrjen në jetën ekonomike, një punë të rregullt dhe i japin një kontribut konkret komunitetit në vend të krijimit të problemeve.
- Financiarisht dënimet alternative kanë më pak shpenzime krahasuar me mbajtjen në institucion të të dënuarit.

⁴⁹ McWilliams, W. (1985) The Mission Transformed, The Hoëard Journal, Vol. 24.

⁵⁰ Leskoviku, M. “Teoritë e kontrollit social të krimit, njohja dhe vlerësimi i tyre” Revista Shkencore-Juridike e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Nr.1, 2005.

DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

1. Vështrim historik mbi dënimet penale dhe alternativat e tyre në Shqipëri

Që në vitet e para pas Luftës së II-të Botërore u bënë përpjekje për krijimin e bazës ligjore ku do të mbështeteshin vendimet penale. Nga të paret mund të përmendim Ligjin nr. 382, datë 24.12.1946 “Mbi dispozitat e përgjithshme penale”, i cili veproi deri në vitin 1948. Në këtë ligj ishin parashikuar dënimi me vdekje, dënimi me heqje lirie të përjetshëm dhe me punë të detyruar, privim lirie me punë të detyruar nga 6 muaj deri në 20 vjet, me humbje të shtetësisë, me humbjen e të drejtave civile dhe politike, humbja ose ulja në gradë, ndalimi i ushtrimit të profesionit ose aktivitetit, gjobë, konfiskim i pasurisë dhe internim⁵¹.

Në vitin 1948 u shpall Ligji nr. 599, datë 13.5.1948 “Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Penal”. Ky ligj penal mbështetej në parimet e Kushtetutës së vitit 1946. Në këtë kod parashikoheshin shprehimisht qëllimi i dënimit dhe karakteri i tij edukues dhe shtrëngues, parashkrimi dhe heqja e dënimit, amnistia, falja, etj. Sipas këtij Kodi, qëllimi i dënimit ishte zhdukja e cdo veprimtarie shoqërisht të rrezikshme, zmbropsja dhe ndalimi i ekzekutorit që të kryente faje penale te reja, riedukimi dhe përmirësimi i autorit, ushtrimi i një influence të përgjithshme edukonjëse mbi pjesët e tjera të shoqërisë që të mos kryenin faje penale⁵².

Në ishin parashikuar dënimi me vdekje, dënimi me heqje lirie dhe punë të detyruar nga 6 muaj deri në 20 vjet dhe me privim të lirisë nga 7 ditë deri në 5 vjet, dënimi me punë korektonjësë, humbje të shtetësisë, përveç dënimeve të parashikuar në ligjin e sipërpërmendur⁵³. Dënimet kryesore që parashikonte pjesa e përgjithshme e Kodit Penal të vitit 1948 ishin: me vdekje, privimi i lirisë me punë të detyruar, privimi i lirisë, puna korektonjëse, humbja e shtetësisë, konfiskimi i pasurisë, humbja e të drejtës civile, humbja e gradës, ndalimi i ushtrimit të një profesioni të caktuar, dëbimi, gjoba, riparimi i dëmit⁵⁴.

Parimi kryesor i këtij Kodi ishte se, për të caktuar një dënim penal, gjykata duhet të mbështetej në dispozitat e kodit, në kufijtë e dënimit që caktonte ligji dhe në rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit, sigurisht duke marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Në vitin 1952, u miratua Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, i cili ishte një kod i plotë, me pjesën e tij të përgjithshme dhe të posacme. Edhe ky kod mbështetej në Kushtetutën e vitit 1946, por sigurisht me plotësimet e saj të mëvonshme. Burimi kryesor i të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore ishte eksperiencia jugosllave, me të cilën Shqipëria kishte marrëdhënie të ngushta deri në vitin 1948, kurse pas viteve ‘50 burim kryesor ka qenë eksperiencia e ish-Bashkimit Sovjetik. Kodi penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, ishte miratuar një vit pas Kodit Penal të Jugosllavisë dhe thuajse ishin të njëjtë. Krahas eksperiencës së vendeve të shteteve komuniste të Europës Lindore, në vitet e para pas çlirimit legjislativ penal trashëgon deri diku edhe frymën e legjislativitetit të periudhës së monarkisë, sidomos mbi parimet e

⁵¹ R. Gashi, “Zbatimi i vendimeve penale në Shqipëri”, Prishtinë, 2001, fq. 85.

⁵² Neni 2.

⁵³ Shih R. Gashi, op. cit., fq. 86.

⁵⁴ Neni 28.

përgjithshme, gjuhën e përdorur, veprat penale ordinere etj. Padyshim që në këtë periudhë vendi ynë po bënte përpjekje për antarësim në Kombet e Bashkuara dhe autoritetet politike dhe shtetërore ishin më të kujdesshëm në qasjen ndaj këtyre çështjeve. Megjithëse Kodi Penal mbështetej në politikën e PPSH-së që udhëhiqte jetën e vendit, parimet kryesore penale nuk mungonin. Këto parime në këtë Kod ishin ato që kishin mbetur nga e kaluara.

Në Kodin Penal të vitit 1952, neni 2, theksohet se: *“Askush nuk mund të merret në përgjegjësi penale për vepra që nuk parashikohen nga ligje si krime⁵⁵”*, që përbën sanksionimin e parimit të njohur të shkollës klasike të së drejtës penale (nullum crimen, nulla poena sine lege). Ky parim është i sanksionuar edhe në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në të cilën thuhet: *“Asnjëri nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë një vepër penale, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, në kohën kur janë kryer. Gjithashtu nuk mund të vendoset një dënim më i rëndë nga ai që ka qenë zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale⁵⁶”*. Parimi i mosdënimit pa ligj ishte sanksionuar formalisht, sepse Kodi Penal i vitit 1952, në kapitullin e krimeve kundër shtetit, përmbante një nen të veçantë⁵⁷ që kriminalizonte “veprimtarinë armiqësore para çlirimit”, i cili parashikonte një dënim jo më pak se dhjetë vjet heqje lirie ose me vdekje dhe kurdoherë konfiskimin e pasurisë.

Kodi parashikonte edhe qellimin e denimit në nenin 15 të tij. Sipas kesaj dispozite parashikohej se denimi është masa penale që ka për qëllim të denojë fajtorin dhe ta ndalojë të kryejë krime të tjera, të edukojë dhe të përmirësojë fajtorin, të ushtrojë influencë mbi anetaret e tjere të shoqërisë.

Në Kodin Penal të vitit 1952 ishin parashikuar si dënime kryesore: dënimi me vdekje, heqja e lirisë, internimi me punë korrektonjëse dhe qortimi shoqëror, kurse si dënime plotësuese dhe kryesore njëkohësisht parashikoheshin: heqja e gradës, humbja e nëpunësisë, gjoba. Si dënime vetëm plotësuese parashikoheshin: konfiskimi i pasurisë, humbja e të drejtave dhe ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie të caktuar ose të një mjeshtërie⁵⁸. Dënimi me heqje të lirisë ishte parashikuar të jepej për një periudhë nga një muaj deri në 25 vjet dhe kryhej në kampet e punës korrektonjëse. Gjykata mund të vendoste që gjithë dënimi me heqje të lirisë të kryhej në burg, kur i dënuari ishte përsëritës i rrezikshëm, si dhe kur ai kishte kryer një krim të rrezikshëm.

Kodi parashikonte gjithashtu mënyrën e caktimit të dënimit dhe shprehte parimin e individualizimit të dënimit që nënkuptonte që gjykata caktonte kundër autorit të një krimi një masë dënimi në përshtatje me karakterin dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të krimit dhe të fajtorit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, përjashtimin nga dënimi, zbutjen e dënimeve për të miturit, bashkimin e krimeve dhe dënimeve, dënimin me kusht, parashkrimin e ndjekjes penale dhe të vendimit të dënimit, heqjen e dënimit, lirimin para kohe me kusht.

Në tetor 1977 hyri në fuqi Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Kodi Penal përbëhej nga 3 pjesë: pjesa e përgjithshme, pjesa e posaçme, krimet dhe kundravajtjet penale. Si burim i Kodit ishte Kushtetuta e vitit 1976. Një ndryshim që u vu re nga Kodi i vitit

⁵⁵ Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1952.

⁵⁶ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me rezoluten e saj 217 A(III) të 10 dhjetorit 1948.

⁵⁷ Neni 77.

⁵⁸ Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1952.

1953 ishte heqja e parashkrimit të ndjekjes penale për krimet dhe u la vetëm për kundravajtjet penale. Edhe lirimi para kohe me kusht ishte hequr. U rrit numri i dispozitave që parashikonin dënimin me vdekje, gjë kjo që tregonte se edhe ashpërsia e dënimit ishte rritur mjaft.

Sipas këtij Kodi, dënimi perkufizohej si masë shtrënguese shtetërore që zbatohet kundër personave, të cilët kanë kryer vepra shoqërisht të rrezikshme dhe që, sipas ligjit, kanë përgjegjësi penale.

Ky kod parashikonte si dënime kryesore: dënimi me vdekje, riedukimi nëpërmjet punës, heqja e lirisë. Këto dënime ishin të parashikuara për krimet. Për kundravajtjet penale parashikoheshin këto dënime: gjoba, riedukimi nëpërmjet punës, heqja e lirisë. Dënimet plotësuese ishin heqja e dekoratave, ndalimi i ushtrimit të një mjeshtërie ose veprimtarie, dëbimi, internimi.

Në vitin 1988 Kodit Penal iu bënë ndryshime që kishin të bënin me pjesën e përgjithshme të tij, pra me dënimet. Kur dhënia e dënimeve kryesore cmohej e papërshtatshme dhe kur ligji penal parashikonte dënim me heqje lirie deri në 10 vjet ose dënime të tjera më të lehta për veprën e kryer, gjykata mund të mjaftohej vetëm me caktimin e një dënimi plotësues. Pra, në ndryshim nga kodi i mëparshëm, qortimi shoqëror nuk ishte më dënim kryesor, por masë edukuese. Gjithashtu, u hoq dënimi me vdekje nga disa dispozita. Ai jepej vetëm për vepra me rrezikshmëri të madhe shoqërore, si: krimet kundër shtetit, krimet kundër pasurisë shtetërore, krimet kundër jetës, etj. Dënimi me heqje lirie jepej me vendim të gjykatës për një kohë nga 5 ditë deri në 25 vjet dhe vuhej në vendet e riedukimit, nëpërmjet punës ose në burg. Fillimisht, minimumi i dënimit me burgim ishte 1 muaj, kurse ligji i ndryshuar e uli këtë minimum në 5 dite.

Në të gjitha aktet ligjore dhe kodet e periudhës pas çlirimit ishte sanksionuar dënimi me punë korrektonjëse, si dhe dënimi me privim lirie dhe punë të detyruar. Kjo dispozitë ishte në funksion të sigurimit të krahut të punës të detyruar për të punuar në frontet më të vështira të punës, si: miniera, bonifikime, ndërtime rrugesh, bujqësi, etj. Por edhe kategoritë e tjera të të dënuarve, si të dënuarit me heqje lirie dhe të dënuarit me internim-dëbim, ishin të detyruar të punonin. Këtë e kishte parashikuar si Kodi Penal, ashtu edhe Kodi i Procedures Penale, ku thuhej se të dënuarit me heqje lirie e kryejnë dënimin në kampet e punës, ndërsa në raste përjashtimore e kryenin në burgje.

Mosha e përgjegjesisë penale ishte parashikuar 14 vjeç, gjë që përbënte një aspekt pozitiv të krahasuar edhe me Kodin Penal të vitit 1928, si dhe me shume vende madje edhe të Europës, të cilët akoma edhe sot, vazhdojnë ta mbajnë moshën e përgjegjesisë penale të ulët, pavarësisht se i kanë shmangur dënimet e rënda dhe janë kufizuar vetëm në masa edukative. Kodi e shpreh qëllimin e dënimit si mjet ndëshkimor për shkelësit e ligjit, si mundësi të edukimit dhe përmirësimit dhe si mjet parandalimi dhe ndikimi mbi publikun, për të mos u përfshirë në veprimtari kriminale⁵⁹. Në pjesën e posaçme të Kodit Penal, nga neni 64 deri tek neni 78, ishin parashikuar krimet kundër shtetit. Ndër veprat më të njohura penale që përbënin krim politik, përmenden tradhëtia ndaj atdheut, e cila kishte shtrirje aq të gjerë, sa që edhe një veprim i pamenduar mirë ose një komunikim një shtetas të huaj, mund të merrej për tradhëti ndaj atdheut dhe dënimi ishte shumë i rëndë, nga 10 vjet heqje lirie deri në pushkatim dhe kurdoherë me

⁵⁹ Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, 1952.

konfiskim të pasurisë. Vepra të tjera të kësaj natyre ishin spiunazhi, organizimi dhe pjesëmarrja në banda të armatosura, sabotimi dhe, më e përhapura në periudhën pas konsolidimit të diktaturës, agjitacioni dhe propaganda kundër pushtetit popullor.

Ekzekutimi i vendimeve penale bazohe në Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për ekzekutimin e dënimeve penale, miratuar me dekretin nr. 390, datë 10 janar 1947⁶⁰ dhe në Udhëzimin për administrimin e burgjeve e të kampeve, nr. 32, datë 11 janar 1952, të miratuar nga Ministri i Punëve të Brendshme⁶¹.

Këto akte parashikonin angazhimin e të gjithë të dënuarve në punë fizike në mënyrë të detyruar. Për t'i nxitur të dënuarit të realizonin normat e parashikuara në punë fizike, u miratua Dekret-ligji nr. 1188, datë 5.12.1950 “Mbi llogaritjen e punës së të dënuarve, shpërblimin, ushqimin dhe veshmbathjen”, i cili parashikonte një përfitim në uljen e dënimit kundrejt normës së tejkaluar sipas tabelës përkatëse.

Ne periudhën e diktaturës komuniste, heqja e lirisë është dhënë si dënim kryesor për veprat penale që përbëjnë krime, por edhe për kundravajtjet kur pasojat kanë qenë të rënda dhe rrezikshmëria shoqërore e lartë. Në kodet penale të viteve 1952 dhe 1977, si edhe në ndryshimet e mëvonshme është përdorur termi “heqje lirie” që nënkupton burgosjen. Edhe në dispozitat ligjore penale të periudhës 1945-1952 është përdorur i njëjti term. Në kodin aktual përdoret termi “burgim”. Mendoj se përdorimi i termit “heqje lirie” në vend të termit “burgim” lidhet me infrastrukturën e institucioneve të ekzekutimit të dënimeve penale deri në vitin 1991, e cila paraqitej me kampe pune në pjesën më të madhe. Termi “dënim me heqje lirie” ka një kuptim më të gjërë se termi “dënim me burgim”. Heqja e lirisë nuk nënkupton vetëm burgimin, pra vendosjen e personit të dënuar në burg, por edhe forma të tjera të dënimeve alternative të dënimit me burgim, si arrest në shtëpi.

Gjatë periudhës së sistemit komunist, terminologjia dhe gjuha e përdorur janë ndryshuar në përshtatje me zhvillimet e sistemit, në funksion të ndikimit ideologjik mbi individin. Në Kodin Penal të vitit 1952 përdoret termi “kampe korrektonjëse”, në Kodin Penal të vitit 1970 përdoret termi “vende riedukimi nëpërmjet punës”. Në Kodin Penal të vitit 1952 parashikohej që heqja e lirisë, si rregull, vuhet në kampet e punës korrektonjëse. Gjykata mund të vendoste që gjithë koha ose një pjesë e heqjes së lirisë të vuhej në burg, kur vlerësonte se i dënuari ishte përsëritës i rrezikshëm, si dhe kur kishte kryer një krim të rëndë. Zakonisht, gjykatat nuk i vendosnin të dënuarit në burgje bazuar në faktin se ishin përsëritës. Në burgje vendoseshin detyrimisht të dënuarit për krime kundër shtetit, që jo vetëm verbalisht, por edhe në dokumenta zyrtare, quheshin “armiqtë e popullit”. Dekreti nr. 3584, datë 12.11.1962 “Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore” parashikonte që burgjet konsideroheshin një formë më e rëndë ndëshkimi krahasuar me kampet e punës. Të burgosurit e dënuar dërgoheshin në burgje nëse kryenin “dhunime të rënda apo të përsëritura” të rregullit të kampit ose nëse mbajtja e tyre në një kamp pune “përbënte rrezik” ose kur ata nuk ishin në gjendje të punonin për shkak të gjendjes fizike.

Në vitet 1990, ndryshimet e gjithanshme ekonomike, politike dhe shoqërore u pasuan edhe nga ndryshime të mëdha të të drejtës në tërësi dhe, vecanërisht në të drejtën penale. U parashikuan

⁶⁰ Gazeta zyrtare nr 5, datë 22 kallnor 1947.

⁶¹ Arkivi Qendror i Shtetit (AQSh) F.Prokuroria e Përgjithshme (492), V.1952, D.21, fl 15.

institutet e rehabilitimit dhe heqjes së denimit. Pra, njerëz që më parë kishin qenë të dënuar për vepra penale, mund të riedukoheshin dhe të ktheheshin në shoqëri.

Rehabilitimi është rivendosja e të drejtave të mëparëshme të personave të dënuar, për të cilët është pushuar çështja penale ose gjykata ka dhënë pafajësi ose në rastin e dhënies së amnistisë ose faljes ose kur vepra është parashkruar. Pra, mohimi i faktit të kryerjes së veprës penale, rivendosja e të drejtave të personave të akuzuar padrejtësisht, për të cilët është pushuar çështja penale ose është dhënë vendim pafajësie nga gjykata (neni 42 i Kodit Penal). Ndërsa heqja e dënimit ndodh atëherë kur personi është dënuar me të drejtë dhe, pasi ka vuajtur dënimin, quhet i padënuar.

Rehabilitimi është ligjor dhe gjyqësor. Rehabilitimi ligjor ndodh automatikisht për personat, të cilët pas vuajtjes së dënimit dhe gjatë kohës së provës nuk kanë kryer vepër penale tjetër. Nga ky rehabilitim perfitonin vetëm personat e dënuar me kusht dhe ata që ishin dënuar me deri 5 vjet burgim. Kurse rehabilitimi gjyqësor aplikohet edhe për persona që kishin kryer krime më të rënda dhe vendosej nga gjykata.

Në këtë kohë u vendos edhe instituti i parashkrimit të ndjekjes penale. Ky institut u parashikua në Ligjin nr. 7380, datë 8.05.1990. Në një vështrim historik mund të themi se, në vitin 1948, kemi parashkrimin e padisë penale dhe parashkrimin e dënimeve, në vitin 1952 u caktuan vetëm afate parashkrimi, pa dhënë përkufizimin e tij, kurse kodi i vitit 1977 parashikonte vetëm parashkrimin për kundravajtjen penale.

Pra, në këtë periudhë, si qëllim i rehabilitimit, heqjes së denimit dhe parashkrimit të ndjekjes penale ishte që personi i dënuar të kishte mundësi të rikthehej në jetën normale pas vuajtjes së dënimit dhe të ri-integrohej në shoqëri.

Në të tre ligjet e mësipërm (kodet e viteve 1948, 1952 dhe 1977, megjithëse nga ky i fundit u shfuqizua më vonë) parashikohej lirimi para kohe me kusht. Kjo masë zbatohet për të dënuarit me heqje lirie, internim, dëbim dhe me riedukim nëpërmjet punes, si dhe për dënimet plotësuese të internimit, dëbimit e ndalimit. Kjo masë me karakter demokratik zbatohet vetëm kur i dënuari, me punën dhe sjelljen e tij, kishte treguar se ishte përmiresuar.

Kërkesa për lirimin para kohe me kusht bëhet nga institucioni i vuajtjes së dënimit, këshilli popullor, komiteti ekzekutiv, prokurori, si dhe organizatat shoqërore të vendbanimit ose të qendrës së punës së personit, sigurisht pasi ishin bindur se personi nuk paraqiste më rrezikshmëri shoqërore. Sidoqoftë, i dënuari duhet të kishte vuajtur të paktën gjysmën e dënimit dhe të mos ishte dënuar gjatë kohës së vuajtjes për një vepër po aq të rëndë ose më të rëndë.

Në fillimet e viteve 1990 u bënë vazhdimisht ndryshime në Kodin Penal. Në vitin 1993 u vendos dënimi me burgim të përjetshëm në rreth 20 dispozita, si edhe u hoq dënimi me vdekje për disa të tjera.

2. Akte ligjore të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë

2.1. Kushtetuta

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të drejta që lindin bashkë me çdo qenie njerëzore dhe kanë karakter universal. Mbrojtja dhe promovimi i tyre është detyrimi parësor i çdo shteti dhe qeverie. Ka një sërë arsyesh që na shtyjnë ta nisim analizën e të drejtave të njeriut pikërisht nga Kushtetuta. Kushtetuta është ligji suprem me anë të së cilit deklarohen politikat dhe vlerat më të larta të shtetit shqiptar. Sipas nenit 3 të Kushtetutës: “... Dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij..., janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”. Gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese. Kjo do të thotë se parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë pjesë integrale e të gjithë legjislationit në përgjithësi dhe e çdo ligji e akti nënligjor në veçanti. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk trajton në mënyrë të veçantë çështje që kanë të bëjnë me alternativat e dënimit me burgim, por në mënyrë të përmbledhur ajo u ka gjetur vendin e duhur drejtësisë penale dhe standardeve kryesore që lidhen me të.

Pjesa e dytë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u kushtohet “Të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”. Kjo pjesë është e ndarë në katër krerë. “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”. Kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Për efekt të këtij punimi vlen të ndalemi shkurtimisht në kreun e dytë (pjesa e dytë) të Kushtetutës ku trajtohen liritë dhe të drejtat vetjake, ndër të cilat përmendim se veç të drejtave të tilla si e drejta e jetës; e drejta e informimit; ndalimi i torturës; dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës; e drejta e ankimit, në këtë pjesë një vend të rëndësishëm zënë disa të drejta dhe garanci procedurale të cilat ndikojnë në pozitën e subjektit në një procedim penal. Kushtetuta paraqet në mënyrë të përmbledhur parimet kryesore të drejtësisë penale dhe garancitë procedurale të të pandehurit. Në këtë kategori përfshihet:

- Prezumimi i pafajësisë (neni 30): kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Fuqia prapavepruese (neni 29): askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se sa ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.
- E drejta për një proces të rregullt ligjor: gjykim të drejtë publik brenda afateve të arsyeshme dhe prej një gjykate të pavarur e të paanshme të caktuar me ligj (neni 42): Liria, dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.
- E drejta për integritet moral e fizik (neni 25): Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues.

- Heqja dhe kufizimi i lirisë (neni 27): askujt nuk mund t'i hiqet dhe/ose kufizohet liria përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashkuara nga ligji. Në rastin e të miturve, kufizimi i lirisë lidhet me mbikëqyrjen e tij për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent.
- Të drejtat dhe garancitë procedurale penale “kushtetuese” të personit të cilit i është hequr ose kufizuar liria gjatë procesit penal (nenet 28, 31, 32, 33 dhe 34) të tilla si: njoftimi mbi shkaqet e marrjes së masës dhe ngritjes së akuzës dhe të drejtave ligjore të garantuara; gjykimi brenda një afati të arsyeshëm i të paraburgosurit; dërgimi për gjykim brenda 48 orëve të personit të cilit i është hequr liria sepse ka pasur dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale, ose për të parandaluar kryerjen e një veprë penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj; e drejta e ankimit kundër vendimeve gjyqësore; e drejta e mbrojtjes; e drejta për të pasur një përkthyes; e drejta e bërjes së pyetjeve dëshmitarëve; e drejta për t'u dëgjuar para gjyqësorit; mosdeklarimi fajtor mbi bazën e mbledhjes së të dhënave në mënyrë të paligjshme; dhe mos dënimi më shumë se një herë për të njëjtën veprë; parimi i gjësë së gjykuar.

Pa dyshim që shtjellimi i çështjeve të tilla më në detaje është detyrë kryesisht e legjislacionit në fushën penale, por nisur nga rëndësia e këtyre garancive dhe të drejtave, vëmë re kujdesin e veçantë të ligjit më të lartë që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, Kushtetutës. Këto të drejta dhe garanci nuk janë të njohura vetëm për shtetasit shqiptar, por në mënyrë të barabartë edhe për të huajt edhe për personat pa shtetësi.

2.2. Akte të të drejtës ndërkombëtare

Shqipëria ka ratifikuar një pjesë të konsiderueshme të instrumenteve ndërkombëtare. Kushtetuta ka përcaktuar vendin që zënë instrumentet ndërkombëtare në sistemin e brendshëm si edhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Atëherë, çfarë vendi zënë standardet ndërkombëtare dhe cili është statusi i tyre? Këtu vlen të nënvizojmë:

- Karakterin e vetëzbatueshëm ose jo të së drejtës ndërkombëtare: cdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.
- Edhe nëse nuk është bërë përjasja dhe përfshirja e parimeve të së drejtës ndërkombëtare në të drejtën kombëtare, në rrethana të caktuara është e mundur që një normë që përfshihet në të drejtën ndërkombëtare të ketë fuqi në një rend ligjor të një shteti. I tillë është rasti kur një normë e tillë mundet të përmendet në një çështje gjyqësore, në të cilin është bërë ankesë se shteti apo individët kanë shkelur të drejtat e njeriut. Në gjuhën ligjore kjo quhet “vetëzbatim” apo efekt i drejtpërdrejtë i së drejtës ndërkombëtare.
- Shumica e konventave ndërkombëtare nuk janë të vetëzbatueshme. Ato kanë nevojë për dispozita shtesë më të sakta për t'u zbatuar drejtpërdrejtë. Por nëse Kushtetuta parashikon që instrumentet ndërkombëtare bëhen pjesë e sistemit ligjor kombëtar, siç

është rasti i vendit tonë, qeveria mund të mos ketë nevojë të bëjë përshtatje të ligjeve kombëtare në mënyrë që detyrimet ndërkombëtare të sjellin pasoja. Në këtë rast gjykatat dhe gjyqtarët vendas mund të zbatojnë këto norma, pavarësisht nëse ato janë përfshirë në dispozita kombëtare.

- Epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare ndaj ligjeve të vendit: Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka përparësi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej saj. Për shkak të këtyre karakteristikave, gjyqtarët dhe aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë duhet të zbatojnë këto norma, pavarësisht faktit nëse ato janë marrë apo jo në të drejtën e brendshme.
- Ratifikimi i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)⁶² reformoi dhe përqaqi gjithë legjislacionin shqiptar me standardet dhe praktikën ligjore të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës.

Analiza e instrumenteve ndërkombëtare do të bëhet duke i renditur këto norma nisur nga organizata ndërkombëtare, e cila e ka hartuar dokumentin normativ. Kështu, trajtimi i standardeve ndërkombëtare do të bëhet në tri nivele të ndryshme: në atë të Kombeve të Bashkuara (KB), të Këshillit të Evropës (KE) dhe të Bashkimit Evropian (BE). Ndonëse Shqipëria nuk është vend anëtar i BE-së, nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe marrja e statusit të vendit kandidat prodhon një sërë detyrimesh në drejtim të njohjes, harmonizimit, koordinimit të kuadrit ligjor dhe të strukturave të sistemit të drejtësisë me këto standarde⁶³.

Është për t'u nënvizuar se, pavarësisht organizatës ndërkombëtare, parimet dhe standardet e vendosura janë unike, plotësim ose detajim i atyre që gjenden tek instrumenti i miratuar prej organizatës tjetër. Kjo është shumë e rëndësishme sepse tregon se ka një qëndrim unik dhe harmoni të qartë në mbrojtjen e këtyre të drejtave, çka bën që edhe nëse shtetet anëtare (Shqipëria) i ratifikojnë këto instrumente, kjo nuk sjell instalimin e qëndrimeve të ndryshme për të njëjtën çështje. Përkundrazi, përforsim të mëtejshëm të parimit dhe të shtrirjes së tij. Ndërkohë, standardet ndërkombëtare përcaktojnë detyrime të cilat konsistojnë në standardet minimum. Kjo nënkupton se çdo shtet nuk mund të ulë këtë nivel në kuadrin e tij ligjor dhe në zbatimin e së drejtës, por nga ana tjetër është plotësisht i inkurajuar për një standard më të lartë se sa përcaktohet në konventë.

⁶² Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore".

⁶³ Burimet kryesore të së drejtës komunitare janë traktatet dhe direktivat. Mekanizmi zbatues i së drejtës komunitare është Komisioni Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka juridiksion mbi rastet e paraqitura nga një shtet anëtar kundër një shteti tjetër anëtar për shkelje të traktatit prej një institucioni të Bashkimit Evropian kundër një shteti dhe prej qytetarëve të veçantë ose organizatave kundër institucioneve të Bashkimit Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë nuk arbitron ankesat e sjella nga individë kundër shteteve anëtarë. Megjithatë, një gjykatë kombëtare mund të kërkojë mendim prej Gjykatës Evropiane të Drejtësisë lidhur me zbatimin e drejtë të së drejtës komunitare në një rast të veçantë.

Kur flasim për të drejtën ndërkombëtare kryesisht mendojmë për ato norma që vendosin një lloj detyrimi ligjor mbi një shtet. Kuptohet që shteti është përgjegjës për plotësimin dhe zbatimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare për shkak të anëtarësimit në të. Dy ose më shumë shtete mund të bashkohen në një organizatë të nivelit rajonal, ndërkombëtar ose ndërshtetëror dhe të përcaktojnë rregulla të përbashkëta me qëllim rregullimin e marrëdhënies së tyre në bashkësinë rajonale/ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe çështje të së drejtës penale. Këto rregulla krijojnë rendin ligjor ndërkombëtar në një fushë të caktuar ose në përgjithësi.

E drejta ndërkombëtare është tërësia e rregullimeve ligjore që zbatohen në një shtet që ka aderuar në të, si edhe ndërmjet shteteve sovraane dhe entiteteve të tjera të tilla të cilave u është dhënë personaliteti ndërkombëtar prej shteteve sovraane⁶⁴. Ndryshe nga e drejta e brendshme e shtetit që rregullon sjelljet e individëve dhe entiteteve të tjera ligjore brenda juridiksionit të këtij shteti, e drejta ndërkombëtare zbatohet vetëm ndërmjet entiteteve që kanë personalitet ndërkombëtar (kryesisht shtetet sovraane ose organizatat ndërkombëtare dhe ndërshtetërore të tilla si Bashkimi Evropian). Në të përcaktohen standardet bazë që duhet të garantojë çdo shtet përmes legjislacionit dhe mekanizmave të tij. Në të drejtën ndërkombëtare një vend të veçantë zënë standardet lidhur me të drejtat e njeriut. Këto janë të drejtat që çdo njeri ka dhe gëzon thjesht për shkak të qenies së tij/saj njerëzore.

Ato bazohen në parimin themelor se të gjitha qeniet njerëzore kanë një dinjitet njerëzor të trashëguar dhe se ata janë të barabartë në gëzimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra, gjuha, origjina kombëtare, moshja, klasa, apo besimet politike ose fetare⁶⁵. Të drejtat e njeriut janë universale, të zbatueshme njëjloj dhe pa diskriminim për të gjithë njerëzit.

Në konceptin dhe përmbajtjen e të drejtës ndërkombëtare ka shumë lloje normash. Disa norma ndërkombëtare janë më detyruese se sa të tjerat. Në përgjithësi, normat ligjore janë më detyrueset, rekomandimet e ekspertëve janë normat më të dobëta dhe normat politike janë diku aty ndërmjet tyre. Instrumentet ligjërish të detyrueshme krijojnë të drejtën, e cila mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve ligjore nëse nuk ka përputhshmëri. Ky është qëndrimi edhe i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përdërisa në sistemin normativ që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në hierarkinë e normave konventat ndërkombëtare të ratifikuara janë renditur menjëherë pas Kushtetutës. KEDNJ përmban norma ligjore detyruese, të mbikëqyrura prej një gjykate siç është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (në Strasburg të Francës) dhe të aplikueshme prej qytetarëve. Instrumentet ligjërish jo detyruese krijojnë angazhime, gjithashtu edhe detyrime politike ose morale, ose të ashtuquajturat “instrumente rekomanduese” (soft law)⁶⁶. Ky nuk është aspak ligj në një kuptim strikt të fjalës, por ndërkohë ka një ngacmim dhe pritshmëri të fortë që këto dispozita do të respektohen dhe ndiqen nga shtetet. Kjo është arsyeja që në këtë punim do të ndalemi shkurtimisht edhe në disa prej

⁶⁴ Përkufizim i dhënë prej Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO). Shih <http://www.itcilo.it/english/actrav/telearn/global/ilo/law/>

⁶⁵ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

⁶⁶ Soft law (instrumente rekomanduese) në të drejtën ndërkombëtare janë udhëzimet, rekomandimet, deklaratat ose kodet e sjelljes, të cilat vendosin standarte të sjelljes, por nuk janë të detyrueshme ligjërish. Black's Law Dictionary, Eighth Edition, Thomson West).

rekomandimeve të cilat ndonëse janë “instrumente rekomanduese” kanë një rëndësi dhe ndikim të veçantë të zbatuesit e së drejtës.

Normat politike janë në përmbajtjen e rekomandimeve, rezolutave ose deklaratave të organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë (të tilla si Këshilli i Evropës apo Parlamenti Evropian) dhe nuk kanë fuqi ligjore detyruese. Ndonëse nuk janë ligjërish të detyrueshme, këto norma mund të jenë me vlerë të madhe për krijimin e detyrimeve konkrete që shtetet kanë në fushën e drejtësisë penale. Ndërkohë edhe interpretimet e normave ligjore të detyrueshme dhe dokumenteve politike prej ekspertëve dhe prej organizatave ndërkombëtare nuk janë aspak detyruese, por mund të jenë shumë të dobishme në ndërtimin e një argumenti të fortë për të kërkuar masa të caktuara apo për të sjellë një rast përpara një gjykatë.

Ekziston një korpus i madh i normave të së drejtës ndërkombëtare përfshirë edhe ato në fushën penale. Në ditët e sotme, standardet e të drejtës ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut ndalojnë qartë në çështje të drejtësisë penale, rehabilitimit dhe drejtësisë restauruese.

Për zbatuesit e të drejtës është shumë e rëndësishme të dinë në parim se cilat janë burimet e së drejtës ndërkombëtare dhe cili është vendi, roli dhe efekti i këtyre burimeve në sistemin e brendshëm të së drejtës.

Këto burime janë forma në të cilat rregullat e të drejtës ndërkombëtare vijnë në jetë, dhe janë të renditura përkatësisht në nenin 38 (1) të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë si më poshtë vijon:

- Konventat ndërkombëtare ose traktatet, të cilat janë të detyrueshme vetëm për palët në to.
- Zakoni ndërkombëtar, i cili përmban rregullën që rrjedh nga praktika e përgjithshme, bazuar mbi perceptimin e një kërkesë ligjore, ndërmjet shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare; këto, me pak përjashtime, janë të detyrueshme për të gjitha shtetet.
- Parimet e përgjithshme të së drejtës, të tilla si “mirëbesimi” i njohur nga kombet e civilizuar, të cilat gjithashtu janë të detyrueshme për të gjitha shtetet.
- Vendimet gjyqësore, për shembull, ato të gjykatave ndërkombëtare dhe shkrimet e akademikëve të shquar; këto ndihmojnë në përcaktimin e ekzistencës së interpretimeve të këtyre normave detyruese.

Lidhur me nivelin e Kombeve të Bashkuara, instrumentet që duhen përmendur janë:

- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 shkurt 1992;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) (1948);
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit, 1985);
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës, 1990);
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit, 1990);

- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios, 1990).

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) është një instrument sintetik ku në mënyrë gjithëpërfshirëse gjenden parimet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në tërësi, por dhe standardet bazë për zbatimin e drejtësisë penale për të miturit⁶⁷. Mesazhi që vjen prej këtyre dokumenteve është se duke qenë ndryshe, pikërisht sepse është një qenie në zhvillim e sipër, fëmija, ka ende kohë e mundësi për t'u rehabilituar, ka nevoja të ndryshme prej të rriturve dhe terapistë që sistemi do të përdorë për "shërimin" e tyre janë dhe duhet të jenë krejt të ndryshme e të veçanta prej atyre të të rriturve. Në këtë rast, prioritet kanë trajtimet ambulatorë dhe jo ato institucionale. Me çdo fëmijë duhet të merresh në mënyrë të individualizuar. Ka një interes të fortë publik për mbrojtjen e veçantë të të miturve, interesi parësor dhe mirëqenia e të miturve janë substanciale.

Çështjet që lidhen me drejtësinë penale për të miturit janë kryesisht ato të përfshira në nenet 37, 39 dhe 40 të KDF-së. Në të vërtetë KDF parashtron një listë të tërë të detyrimeve për t'u ndërmarrë nga shtetet palë. Ndonëse neni 40 iu referohet drejtpërdrejtë çështjeve të drejtësisë penale për të miturit, kjo nuk do të thotë se ky nen trajtohet në mënyrë të izoluar. Nenet e KDF-së janë të ndërruarura nga njëra-tjetra dhe të gjitha së bashku formojnë të tërën.

Neni 40 i KDF-së duhet parë i lidhur ngushtë me parimet e përgjithshme të parashtruara lidhur me fëmijët përkatësisht në: nenin 2 të KDF-së ku nënvizohet se të gjitha të drejtat u njihen të gjithë fëmijëve pa asnjë lloj diskriminimi; nenin 3(1) mbi interesin më të lartë të fëmijës si konsiderata parësore; nenin 6 mbi të drejtën e jetës; nenin 12 mbi respektimin e të drejtës për të shprehur lirisht pikëpamjet, dhe duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë. E drejta e fëmijës që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.

Neni 40 mbulon në mënyrë më specifike të drejtat e të gjithë fëmijëve të akuzuar për shkeljen e legjislacionit penal. Prandaj, ai mbulon trajtimin e fëmijës nga momenti kur bëhet një akuzë, përmes hetimit, arrestimit, akuzimit, periudhës para gjyqit, gjykimit dhe dënimit. Neni kërkon që shtetet palë të promovojnë një sistem të ndarë të drejtësisë për minimale për fëmijën (të drejtat e një procesi të rregullt ligjor) dhe kërkon që shtetet palë të vendosin një moshë minimale të përgjegjësisë penale dhe të japin masat për trajtimin e fëmijëve që mund të kenë shkelur ligjin penal, pa iu drejtuar procedurave gjyqësore, si dhe masa alternative ndaj kujdesit institucional.

Neni 39 njih të drejtën e rehabilitimit dhe të riintegrit social të fëmijëve që janë viktimë të pakujdesisë, shfrytëzimit dhe keqtrajtit.

Të lidhura ngushtë me zbatimin e nenit 40 të KDF-së janë: neni 16 - e drejta për jetë private; neni 19 – mbrojtja nga çdo lloj dhune; neni 20 – përkujdesja alternative; neni 25 – ekzaminimi

⁶⁷ A. Mandro, Drejtësia për të miturit në Shqipëri, një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të miturit dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri, Botim i Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA).

periodik i trajtimit; neni 39 - përkujdesja për rehabilitimin e viktimave. Sa më sipër dhe të tjera, japin formatin e disa standardeve kryesore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Neni 37 i KDF-së ka në përmbajtjen e tij ndalimin e torturës dhe trajtimit mizor, degradues, çnjerëzor. Nuk duhet të ketë as dënim kapital as dënim me vdekje, dhe as burgim të përjetshëm për fëmijët; arrestimi, ndalimi ose burgimi i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër; çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore, duhet të jetë i veçuar nga të rriturit dhe duhet të jetë gjithnjë në kontakt me familjen e tij; fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtë për asistencë juridike dhe të drejtë për të kundërshtuar privimin e lirisë dhe të merret një vendim i shpejtë në lidhje me çështjen, etj.

Neni 40 i KDF-së parashikon disa garanci standarde lidhur me të miturit në drejtësinë penale: Standardi i trajtimit të veçantë dhe dinjitoz të çdo fëmije të dyshuar, akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, me qëllim për të ndihmuar në riintegrimin e tij/saj në shoqëri dhe në mënyrë që ai/ajo të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj (neni 40/1 i KDF-së); Standardi i pasojave jo prapavepruese të ligjit penal; Garancitë procedurale për fëmijët në procesin penal të cilat përfshijnë: prezumimin e pafajësisë, të drejtën e informimit; shqyrtimin pa vonesë; trajtimin e fëmijëve në përputhje me mirëqenien e tyre, etj.

Një ndër rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve për Shqipërinë është pikërisht sigurimi i një zbatimi të plotë të standardeve të përcaktuara në dokumentet e sipërpërmendura e veçanërisht nenet 37, 40 dhe 39 të KDF-së, si edhe Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit, 1985), Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit, 1990), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës, 1990), Udhëzimet e Vjenës lidhur me Veprimin për Fëmijët në Sistemin e Drejtësisë Penale dhe duke pasur parasysh ditën e diskutimit të Komitetit në 1995 mbi administrimin e drejtësisë për të rinjtë⁶⁸.

Në mënyrë të përmbledhur dokumentet e sipërcituar vendosin theksin mbi:

- Mirëqenien e të miturit duke siguruar që çdo reagim ndaj të miturve të dënuar të jetë gjithmonë në përputhje me rrethanat e të dënuarit dhe të veprës penale;
- Nxitjen e riintegrit të të miturit he rifitimin e një roli konstruktiv të tij në shoqëri;
- Zhvillimin e alternativave ndaj trajtimit me burgim ose institucional ose të kujdesit (edhe në rastet kur çështja është në gjykim e sipër) për të parandaluar kryerjen dhe përsëritjen e krimin dhe që të dënuarit e mitur të trajtohen sipas të drejtave që gëzojnë;
- Sigurimin që të miturit të trajtohen në komunitetin e tyre sa më shumë të jetë e mundur. Në rastet kur ata mbahen në paraburgim, të miturit duhet të veçohen nga të rriturit, duhet të ndërmerren të gjitha masat dhe mjetet për të siguruar që ata të mbajnë lidhje me familjet e tyre; duhet të merren të gjitha masat për të përgatitur riintegrimin e tyre dhe që kur ata të rikthehen në komunitetin e tyre t'u sigurohet ndihma dhe përkrahja e duhur;
- Domosdoshmëria e një stafi të kualifikuar dhe të rajnuar në të gjithë pjesët dhe komponentët e sistemit;

⁶⁸ Rekomandimet përfundimtare të vëzhgimeve të Komitetit të të Drejtave të Fëmijës. Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve, Sesioni 38.

- Nënvizojnë se parandalimi i kriminalitetit të të miturit kërkon përpjekje nga tërë shoqëria (familja dhe komuniteti). Mirëqenia e të rinjve që nga fëmijëria e tyre e hershme duhet të jetë në vëmendjen e çdo programi parandalimi. Duhet të hartohen programe dhe shërbime të orientuara drejt komunitetit për të parandaluar kriminalitetin të të miturit.

Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios) vendosin një sërë parimesh që kanë për qëllim promovimin e masave të tjera të sigurisë përveç arrestit në burg, si edhe disa standarde minimale lidhur me personat të cilët janë në kushtet e vuajtjes së alternativave të dënimit me burgim.

Rregullat nënvizojnë se nuk duhet të ketë diskriminim në zbatimin e tyre për sa i përket moshës (Rregulli 2.2). Këto rregulla promovojnë sanksionet në komunitet dhe ndalen kryesisht në:

- Sistemi i drejtësisë duhet të përmbajë në masë të konsiderueshme sanksionet në komunitet si në fazën para procedimit gjyqësor ashtu edhe pas dhënies së dënimit;
- Shmangia sa më shumë nga dënimi me burgim në rastet e panevojshme;
- Autorët e veprave penale duhet të kenë përgjegjësi ndaj shoqërisë;
- Inkurajimin në rritje të sanksioneve në komunitet dhe shmangien nga proceset formale kur kjo është e mundur (drejtësia restauruese);
- Inkurajimi i përfshirjes së komunitetit në zbatimin e sanksioneve në komunitet.

Udhëzimet e Riadit⁶⁹ i dedikohen parandalimit të kriminalitetit të të miturit bazuar në këto parime themelore:

- Parandalimi i kriminalitetit të të miturve është pjesë esenciale e parandalimit të krimit në shoqëri. Të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime jo kriminale nëpërmjet përfshirjes në aktivitete të ligjshme e të dobishme për shoqërinë dhe nëpërmjet mbajtjes së një qëndrimi humanist ndaj shoqërisë dhe këndvështrimit mbi jetën.
- Parandalimi i suksesshëm i kriminalitetit të të miturve kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria për të siguruar një zhvillim harmonik të adoleshentëve, duke respektuar dhe mbrojtur personalitetin e tyre që në fëmijërinë e hershme.
- Për interpretimin e këtyre Udhëzimeve duhet ndjekur një orientim që në qendër të vendoset fëmija. Të rinjtë duhet të kenë një rol aktiv dhe partneritet brenda shoqërisë dhe nuk duhen trajtuar thjesht si objekte shoqërizimi ose kontrolli.
- Në zbatimin e këtyre Udhëzimeve, në përputhje me sistemin ligjor kombëtar, mirëqenia e të rinjve duhet të jetë fokusi i të gjitha programeve parandaluese.
- Duhet të njihet dhe të vlerësohet nevoja dhe rëndësia e politikave të parandalimit progresiv të kriminalitetit dhe të studimit sistematik e përpunimit të masave të nevojshme. Këto duhet të shmangin inkriminimin dhe penalizmin e fëmijës për sjellje që nuk i shkaktojnë dëme të rëndësishme zhvillimit të tij apo nuk dëmtojnë të tjerët. Këto politika dhe masa duhet të përfshijnë:
 - Sigurimin e mundësive, në mënyrë të veçantë të atyre edukuese, për të plotësuar nevojat e ndryshueshme të të rinjve dhe të shërbejnë si një kuadër mbështetës për sigurimin e zhvillimit personal të të gjithë të rinjve, veçanërisht të atyre që janë të

⁶⁹ Adoptuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/112, datë 14 dhjetor 1990.

- rrezikuar në mënyrë të dukshme ose ndodhen në një rrezik social dhe kanë nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë;
- Filozofinë dhe mënyrat e specializuara për parandalimin e kriminalitetit në bazë të ligjeve, proceseve, institucioneve, lehtësive dhe të një rrjeti që siguron shërbime me qëllim të reduktimit të motivimit, nevojës dhe mundësive apo kushteve që inkurajojnë shkeljen e ligjit;
 - Ndërhyrjen zyrtare që duhen ndjekur vetëm për/dhe në interesin e përgjithshëm të të rinjve duke u udhëhequr nga drejtësia dhe barazia;
 - Ruajtjen e mirëqenies, zhvillimit, të të drejtave dhe interesave të të gjithë të rinjve;
 - Faktin që sjelljet ose veprimet e të rinjve që nuk përputhen me normat dhe vlerat e përgjithshme shoqërore janë shpesh pjesë e procesit të rritjes e pjekurisë dhe kanë prirje të zhduken spontanisht në pjesën më të madhe të individëve gjatë kalimit në moshën e rritur;
 - Ndërgjegjësimin që në masën më të madhe të opinionit të ekspertëve, përcaktimi i një të riu si “devijant” ose “delinkuent” shpesh i atribuohet zhvillimit të një karakteristike të padëshirueshme të sjelljes së të rinjve.
- Duhet të zhvillohen shërbime dhe programe të bazuara në komunitet për parandalimin e kriminalitetit të të miturve, në mënyrë të veçantë aty ku ende nuk ka agjenci. Agjencitë formale të kontrollit social zakonisht duhen përdorur vetëm si mjet i fundit.

Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit)⁷⁰ synojnë krijimin e një sistemi të specializuar të drejtësisë për të miturit dhe krijimin e një legjislacioni të posaçëm. Këtu veçojmë:

- përjashtimin e të miturit prej dënimit kapital dhe prej ndëshkimeve trupore;
- trajtimin e paanshëm dhe njerëzor;
- mbajtjen parasysh të mendimeve të të miturit;
- burgimi të jetë mundësia e fundit dhe qëndrimi në burg të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur;
- heqja e lirisë duhet të aplikohet për raste shumë të rënda;
- dhënia e vendimeve sa më shpejt që të jetë e mundur;
- specializimi i organeve të drejtësisë;
- riintegrimi i të miturit.

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës)⁷¹ nënvizojnë disa nga parimet për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria të tilla si:

- heqja e lirisë është masa e fundit dhe kjo duhet të ketë kohëzgjatje të kufizuar;
- heqja e lirisë për të miturit nuk mund të bëhet pa një motiv juridik objektiv;
- të jetë prioritet krijimi i njësive të institucioneve të hapura;
- përgatitja e të miturve të cilëve u është hequr liria për rikthimin e lirisë dhe rikthimin në komunitet. Rëndësia e programeve edukuese për ta;

⁷⁰ Miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33, datë 29 nëntor 1985.

⁷¹ Miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45 / 113, datë 14 dhjetor 1990.

- mbajtja e kontakteve me familjen;
- trajnimi i personelit të institucioneve ose të qendrave.

Këshilli i Evropës, si një organizatë ndërqeveritare rajonale, e ka drejtuar vëmendjen e vet që nga themelimi në vitin 1948, në mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Sistemi i të drejtave të njeriut në Këshillin e Evropës bazohet në konventa të cilat përcaktojnë detyrime për shtetet anëtare dhe në dokumente jo të detyrueshme, si direktiva, rekomandime dhe rezoluta. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka një peshë të veçantë. Konventa ka efekt të drejtpërdrejtë në ligjet e brendshme dhe si rrjedhojë, gjyqësori në nivel kombëtar mund të mbështetet në dispozitat e Konventës Evropiane. Konventa Evropiane përmban një mekanizëm zbatimi relativisht të fortë me një Gjykatë të veçantë (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e vendosur në Strasburg), me një procedure ankimesh individuale dhe me Këshillin e Ministrave që mbikëqyr nëse shteti ndjek në të vërtetë vendimet e Gjykatës.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg nuk është një zëvendësim i gjykatave kombëtare, por është shtesë për sistemet kombëtare që mbron të drejtat njerëzore. Si individët ashtu edhe OJQ-të e shteteve anëtare kanë të drejtë t’u drejtohen Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por atyre u kërkohet që së pari të ezaurojnë mjetet e brendshme përpara se rasti të mund të konsiderohet si i pranueshëm nga Gjykata. Vendimet përfundimtare të Gjykatës janë ligjërish të detyrueshme për shtetin në fjalë.

Dokumentet e të drejtave të njeriut në Këshillin e Evropës referojnë përvijimin e parimeve të traktateve të Kombeve të Bashkuara dhe të dokumenteve të tjera. Neni 14 i Konventës Evropiane shpreh se “gëzimi i të drejtave dhe lirive të vendosura nga kjo Konventë duhet të sigurohen pa diskriminim...”. Konventa garanton të drejtën për jetën (neni 2), të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit (neni 5) dhe të drejtën për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues (neni 3).

Në këtë kontekst si me rëndësi rendisim:

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Protokollet nr. 1; 2; 4; 6; 5; 11;7;
- Karta Sociale Evropiane (e ndryshuar)⁷²;
- Konventa Evropiane “Për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues” dhe Protokollet nr. 1 dhe 2⁷³;
- Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht”⁷⁴;
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”⁷⁵;
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale”⁷⁶;
- Konventa e Këshillit të Evropës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale”⁷⁷;

⁷² Karta Sociale Evropiane (e ndryshuar), nënshkruar më 21.9.1998, hyrë në fuqi më 1.01.2003 me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.

⁷³ Ligji nr. 8135, datë 31.7.1996.

⁷⁴ Ligji nr. 8724, datë 26.12.2000.

⁷⁵ Ligji nr. 8499, datë 10.6.1999.

⁷⁶ Ligji nr. 8498, datë 10.6.1999.

⁷⁷ Ligji nr. 9068, datë 15.5.2003.

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”⁷⁸.

Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” përbën instrument të rëndësishëm në kontekstin e lirit me kusht si edhe të mbikëqyrjes së personave të dënuar. Nga vetë emërtimi i këtij instrumenti, del i qartë ridimensionimi i drejtësisë penale në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Konventa evidenton rëndësinë që ka rehabilitimi social i autorëve të veprave penale të dënuar apo të liruar me kusht, si edhe nga ana tjetër vënia në ekzekutim e sanksioneve të vendosura nga gjykata në rastin kur kushtet e parashikuara prej saj nuk janë përmbushur.

Përmes këtij instrumenti nënvizohet edhe një herë rëndësia e bashkëpunimit në luftën kundër kriminalitetit si edhe qëllimi unik sa i përket respektimit të vendimeve (përfundimtare dhe të ekzekutueshme) të ndërmarra nga autoritetet gjyqësore qoftë edhe në njërin prej shteteve anëtare dhe kur përmbushja e tyre bëhet në territorin e një shteti tjetër.

Konventa është e ndarë në pesë tituj. Në titullin e parë trajton parime themelore dhe termat e referencës si keqbërës⁷⁹ dhe dënim. Konventa është e aplikueshme vetëm për vendime të cilat janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme, si edhe kur bëhet fjalë për vepra penale të cilat janë të dënueshme nga legjislacioni i të dy shteteve që bashkëpunojnë në këtë drejtim. Në këtë instrument janë renditur të gjitha modalitetet e paraqitjes së kërkesës (prej shtetit që ka dhënë vendimin e dënimit) e të përmbajtjes së saj dhe të reagimit ose mënyrave të pranimit të kësaj kërkesë (prej shtetit në territorin e të cilit “keqbërësi” ka vendbanimin e zakonshëm⁸⁰).

Konventa parashikon gjithashtu detyrimin për refuzim, si edhe mundësinë e refuzimit të mbikëqyrjes, ekzekutimit ose zbatimit të plotë. Shteti kërkues dhe shteti i kërkuar informojnë, kur është e nevojshme, reciprokisht njeri-tjetrin për çdo rrethane që ka të bëjë me përmbushjen e masave të mbikëqyrjes në territorin e shtetit të kërkuar ose vënien në ekzekutim të dënimit në këtë shtet.

Në titullin e dytë trajtohen çështje që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen. Shteti kërkues i bën të njohur shtetit zbatues kushtet që i janë caktuar keqbërësit dhe, kur është rasti, masat e mbikëqyrjes, të cilave ky është i detyruar t’u nënshtrohet gjatë periudhës së provës. Në këtë rast, shteti zbatues ka diskrecion që mbikëqyrjen ta përshtatë me legjislacionin e vet duke mos rënduar asnjë masë qoftë në drejtim të llojit qoftë në drejtim të kohëzgjatjes.

Konventa i kushton një rëndësi të veçantë rregullave lidhur me komunikimin ndërmjet shteteve në çdo fazë të mbikëqyrjes dhe bërjen transparente të çdo veprimi nga ana e shtetit zbatues, kjo sepse është në kompetencë të shtetit kërkues nëse “keqbërësi” ka përmbushur kushtet.

Titulli III trajton çështje që lidhen me ekzekutimin e dënimeve. Edhe në këtë aspekt, vënia në lëvizje e shtetit zbatues varet nga shteti kërkues. Ekzekutimi behet në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar por duke respektuar sa më shumë të jetë e mundur parimin e analogjisë në

⁷⁸ Ligji nr. 8497, datë 10.6.1999.

⁷⁹ Termi “keqbërës” i referohet të “dënuarit”. Në variantin e përkthyer të Konventës, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 50/2000, është përdorur termi “keqbërës”.

⁸⁰ Shih nenin 5.

kuptimin e llojit dhe masës së dënimit, etj. Shteti zbatues është kompetent në çështje të lirimit me kusht.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kësaj Konvente është Ministria e Drejtësisë. Në raste urgjente, komunikimet mund të transmetohen nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” ka për qëllim arritjen e unitetit dhe zhvillimin e një bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale; çuarjen më tej e qëllimeve të drejtësisë dhe rehabilitimin shoqëror të personave të dënuar; mundësinë që të huajve të dënuar me heqje lirie, duke i transferuar në vendet e tyre, t’u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre.

Shqipëria ka deklaruar moszbatimin e procedurave të parashikuara në nenin 9 pika 1 shkronja “a” të kësaj Konvente; Konventa do të shtrihet edhe mbi personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, kur njëra është shqiptare; rezerva gjuhësore: Republika e Shqipërisë deklaroi se i pranon kërkesat për transferimin e personave të dënuar dhe të dokumenteve shoqëruese, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me një kopje të përkthimit në gjuhën shqipe ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës.

Konventa jep kuptimin e një sërë termave që përdoren në të⁸¹ dhe ndalet në parimet e përgjithshme të tilla si: parimi i bashkëpunimit; parimi i vlerësimit dhe respektimit të të drejtës së të dënuarit; e drejta reciproke e kërimit të transferimit. Veç sa më sipër, në këtë instrument do të gjejmë në mënyrë më të detajuar rregulla të cilat përmbledhtas po i japim në vijim, lidhur me:

Kushtet për transferim (neni 3, shih rezervat e bëra); detyrimin për të dhënë informacion ose detyrimin për respektimin e të drejtës së informimit të të dënuarit; rregullat lidhur me kërkesat dhe përgjigjet ndërmjet shteteve në rastet e transferimit të të dënuarve; detyrimin për paraqitjen e dokumenteve shtese dhe rregullat lidhur me to; rëndësinë për marrjen e pëlqimit të të dënuarit për transferim; efektet e transferimit, reciprokisht, për të dy shtetet qoftë parë në këndvështrimin e atij dënues dhe zbatues; rregullat lidhur me vazhdimin e ekzekutimit të dënimit në kuptimin që shteti zbatues është i detyruar t’i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është përcaktuar në shtetin dënues. Këtu përcaktohet se për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues.

Gjithashtu në Konventë gjejmë norma lidhur me konvertimin e dënimit ku ndër të tjera gjejmë disa rregulla si: nuk mund të konvertohet një dënim me burgim në një dënim me gjobë; ndalimin e rëndimit të dënimit, etj., (shih nenin 11). Gjithashtu, Konventa parashikon të drejtën e faljes, amnistisë e zëvendësimit si një të drejtë e çdo shteti dhe të rishikimit të vendimit si e drejtë vetëm e shtetit dënues i cili ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit. Sa i përket përfundimit të ekzekutimit, shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënim duhet të përfundojë.

⁸¹ Të tilla, si: dënim, vendim, etj.

Gjithashtu, Konventa ka parashikuar rregullime edhe lidhur me kalimin tranzit të personave të transferuar, duke përfshirë në këtë mënyrë një rregullim gjithëpërfshirës.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” është e ndarë në tetë tituj. Në titullin e parë trajtohen çështje të përgjithshme duke përfshirë këtu angazhimin për bashkëpunimin gjyqësor dhe mos zbatimin e konventës gjatë ekzekutimit të masës së arrestit dhe të dënimeve, si edhe për krimet ushtarake që nuk përbëjnë krime të së drejtës së përgjithshme. Konventa rendit rastet e refuzimit të ndihmës juridike: rastet e krimeve politike, rastet kur gjykohej se ekzekutimi i kërkesës mund të sjellë cenim të sovranitetit, të sigurisë, të rendit publik ose të interesave esenciale të vendit përkatës.

Në titullin e dytë gjen vend normimi i çështjes së letërporosisë. Në titullin e tretë trajtohet pranimi i akteve procedurale dhe të masave paraprake gjyqësore, dalja e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave që i nënshtrohen procesit penal. Në vijim (titulli 4) trajtohen çështje që kanë të bëjnë me gjendjen gjyqësore; titulli 5 ndalet në procedurën e rasteve të ndihmës juridike; titulli 6 në denoncimet me qëllim procedimi penal.

Protokolli shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale (ETS Nr. 99) në nenin 3/b nënvizon se Konventa zbatohet për masën që rregullojnë pezullimin e shpalljes së një dënimi ose ekzekutimin e tij, lirimin me kusht, shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të një dënimi ose ndërprerjen e tij.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale” nënvizon nevojën e ndjekjes së një politike penale të përbashkët në nivel evropian me qëllim mbrojtjen e shoqërisë dhe ndërmarrjen e përdorimit të mënyrave moderne dhe efikase kundër kriminalitetit, duke nënvizuar respektimin e dinjitetit njerëzor dhe nxitjen e rehabilitimit të autorëve të veprave penale. Për këtë dokument gjejmë me vend të nënvizojmë:

- Kapitulli I përmban përkufizimet;
- Kapitulli II trajton ekzekutimin e vendimeve penale evropiane. Është për t’u theksuar se në nenin 5/b, veç të tjerave renditet se “Shteti dënues mund t’i kërkojë një shteti tjetër palë të ekzekutojë sanksionin vetëm nëse është përmbushur “se ekzekutimi i sanksionit në shtetin tjetër duket se do të sjellë shtimin e mundësive për rehabilitimin social të personit të dënuar”. Pasojat e transferimit të ekzekutimit; Dispozita të ndryshme lidhur me tranzitimin, shpenzimet, etj. Po këtu, trajtohet me detaje kërkesa për ekzekutim në aspektin formal dhe substancial dhe të autoritetit përgjegjës; gjykimet në mungesë dhe vendimet penale; masat e përkohshme;
- Kapitulli III trajton pasojat ndërkombëtare të gjyqimeve penale evropiane.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale” synon arritjen e një uniteti më të madh midis anëtarëve, si edhe sigurimin, me frymën e një mirëbesimi reciprok të organizimit të procedimeve penale, duke shmangur konfliktet e kompetencave, si edhe arritjen së sanksioneve më të drejta dhe më frytdhënëse.

Konventa është e organizuar në pesë pjesë. Në pjesën e parë jepen termat e referencës. Pjesa e dytë trajton çështje të kompetencës duke nënvizuar se çdo shtet kontraktues në pajtim me një kërkesë për procedime të paraqitura nga një shtet tjetër kontraktues do të ketë kompetencën të ndjekë penalisht sipas ligjit të tij penal çdo vepër penale ndaj së cilës është i zbatueshëm ligji i një shteti tjetër kontraktues. Këtu gjithashtu zënë vend çështje të heqjes dorë nga ndjekja penale ose ndërprerja e procedimit deri në një vendim përfundimtar në shtetin tjetër, etj.

Pjesa e tretë (nenet 6-29) trajton gjithë problematikën e transferimit të procedimeve të realizuar në pesë seksione. Konventa ndalet gjithashtu edhe në shumëllojshmërinë e procedimeve penale (pjesa 4, shih nenet 30-34), si edhe në rëndësinë që ka kujdesi për respektimin e parimit “jo dy herë për të njëjtën vepër penale” [ne bis in idem] që zë vend në pjesën e 5-të të saj. Pjesa e gjashtë i dedikohet dispozitave përfundimtare dhe këtu trajtohen çështje të nënshkrimit, rezervave, etj.

Në kuadër të Këshillit të Evropës janë miratuar edhe një sërë aktesh jodetyruese- rekomanduese, si p.sh.:

- Rekomandimi Nr. R (92) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje në lidhje me Rregullat Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat Komunitare;
- Rekomandimi R (2000) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Përmirësimin e Zbatimit të Rregullave Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat komunitare;
- Rekomandim R (2003) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me lirimin me kusht (parole);
- Rekomandim R (97)12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për personelin i cili merret me zbatimin e dënimeve dhe masave;
- Rekomandimi Nr. R (82) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me dhënien e lejes së burgosurve;
- Rekomandimi Nr. R (87) 3 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane të Burgjeve;
- Rekomandimit Nr. R (89) 12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me edukimin në burgje;
- Rekomandimit Nr. R (92) 17 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me njëtrajtshmërinë (konsistencën) në dënime;
- Rekomandimit Nr. R (99) 22 në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Rritjen e Popullsisë në Burgje;
- Rekomandim R (2008)11 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane për të Dënuarit e Mitur që u nënshtrohen sanksioneve dhe masave;
- Rezoluta (65) 1 në lidhje me pezullimin e dënimit, vënien në provë dhe alternativave të tjera të dënimit me burgim;
- Rezoluta (70) 1 në lidhje me organizimin praktik të masave për mbikëqyrjen dhe kujdesin e mëpasshëm të të dënuarve apo të liruarve me kusht;
- Rezoluta (76) 2 e Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me trajtimin e të dënuarve me afate të gjata burgimi;
- Rezoluta (76) 10 e Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me disa masa alternative ndaj dënimit me burgim.

Rekomandimi Nr. R (92) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat Komunitare përmban një paketë të plotë rregullash lidhur me sanksionet dhe masat komunitare. Ka 90 rregulla dhe është i ndarë në tre pjesë dhe të shtrira në 11 kapituj, ku gjejmë parimet kryesore lidhur me sanksionet dhe masat në komunitet. Kështu, sipas pjesëve rendisim:

- Pjesa e parë: Parime të përgjithshme, përfshin:
 - Kuadrin ligjor lidhur me sanksionet dhe masat në komunitet (kapitulli 1, rregulla 3-11);
 - Garancitë gjyqësore dhe procedurat e ankimit (kapitulli 2, rregulla 12-19);
 - Respektimi i të drejtave themelore të autorit të veprës penale (kapitulli 3, rregulla 20-29);
 - Bashkëpunimi dhe dhënia e miratimit nga ana e autorit të veprës penale (kapitulli 4, rregulla 30-36);
- Pjesa e dytë: Burimet njerëzore dhe financiare, përfshin:
 - Personeli mbikëqyrës i specializuar (kapitulli 5, rregulla 37-41);
 - cështje lidhur me burimet financiare (kapitulli 6, rregulla 42-43);
 - Përfshirja dhe pjesëmarrja e komunitetit (kapitulli 7, rregulla 44-54);
- Pjesa e tretë: Aspektet e menaxhimit të sanksioneve dhe masave
 - Kushtet e zbatimit (kapitulli 8, rregulla 55- 69);
 - Metodat e punës (kapitulli 9, rregulla 70-75) ;
 - Zbatimi i sanksionit ose masës dhe pasojat e mospajtit nga ana e autorit të veprës penale (kapitulli 10, rregulla 76 -88);
 - Puna kërkimore dhe vlerësimi i sanksioneve e masave (në interes) të komunitetit (Kapitulli 11, rregulla 89 -90).

Një rëndësi të veçantë në këtë dokument merr fjalorthi i termave. Vlerësojmë që për efekt të këtij manuali të veçojmë disa prej tyre.

Çfarë kuptojmë me sanksione dhe komunitare?

“Sanksione dhe masa komunitare” janë sanksionet dhe masat e dhëna nga gjykata përmes një vendimi gjyqësor, të cilat e mbajnë të dënuarin në komunitet, por me disa kufizime të lirisë së tij nëpërmjet vendosjes së kushteve dhe/ose detyrimeve, të cilat zbatohen nga organet e përcaktuara në ligj për këtë qëllim. Me masë do të kuptojmë çdo veprim të ndërmarrë përpara ose në vend të një vendimi mbi një sanksion si dhe mënyrat e hyrjes në fuqi të një vendimi për burgim jashtë institucionit të burgut. Kështu për shembull “lirimi me kusht” është një masë përderisa është një mënyrë e zbatimit të dënimit me burg në komunitet.

Çfarë kuptojmë me mbikëqyrje?

“Mbikëqyrja” i referohet si aktiviteteve ndihmëse të kryera në emër të një autoriteti zbatues që kanë si qëllim të mbajnë të dënuarin në shoqëri, ashtu edhe veprimeve që ndërmerren për të siguruar që i dënuari të përmbushë çdo kusht ose detyrim të dhënë. Shërbimi i mbikëqyrjes (Shërbimi i Provës sipas legjislacionit shqiptar) është agjencia që sipas ligjit realizon mbikëqyrjen.

Çfarë kuptojmë me kontroll?

Termi “kontroll” u referohet aktiviteteve që kufizohen në përcaktimin nëse përmbushen detyrimet apo kushtet e vëna, si dhe aktiviteteve për të siguruar përmbushjen duke përdorur procedurat e disponueshme në rast mospërmbushjeje. Nocioni i kontrollit është më i ngushtë se ai i mbikëqyrjes.

Çfarë kuptojmë me pjesëmarrje të komunitetit?

Me këtë do të kuptojmë të gjitha format e ndihmës, me ose pa pagesë, të kryer me orë të plota ose të pjesshme, ose në mënyrë sporadike, që vihen në dispozicion të autoritetit zbatues (Shërbimit të Provës) ose organizatave publike ose private dhe individëve të komunitetit.

Rekomandimi R (2000) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Përmirësimin e Zbatimit të Rregullave Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat Komunitare paraqet nevojën për evoluim të disa rregullave (të paraqitura në rekomandimin R (92) 16), si edhe nevojën për disa “Parime udhëzuese për të arritur një përdorim më efektiv e të gjerë të sanksioneve dhe masave komunitare” duke i parë këto në disa drejtime (Shtojca 2) të tilla si:

- Legjislacioni;
- Praktika e dënimeve;
- Kërkesat bazë për zbatimin efektiv të sanksioneve e masave komunitare;
- Përmirësimi i kredibilitetit të sanksioneve dhe masave komunitare (me autoritetet gjyqësore, agjencitë përkatëse, publikun e gjerë dhe politikëbërësit);
- Krijimi i programeve e ndërhyrjeve efektive;
- Puna kërkimore për sanksionet e masat komunitare.

Rekomandimi R (2003) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me lirimin me kusht (parole) nënvizon se lirimi me kusht është një nga mënyrat më efektive dhe konstruktive për të parandaluar përsëritjen e veprës penale dhe për të promovuar risistemimin, duke i bërë të burgosurit një integrim të planifikuar e të asistuar. Por efikasiteti varet shumë nga përshtatja me kushtet individuale të të dënuarit dhe të vepruarit në pajtim me parimet e një procesi të rregullt dhe të drejtë ligjor. Në këtë mënyrë në Shtojcën e këtij rekomandimi gjenden parimet nga të cilat duhet të udhëhiqet legjislacioni, politikat dhe praktikat në lidhje me lirimin me kusht.

Në rekomandim gjejmë:

- Parimet e përgjithshme lidhur me lirimin me kusht;
- Përgatitja për lirim me kusht;
- Dhënia e lirit me kusht: (Sistem diskrecional i lirit dhe Sistemi i lirit të detyrueshëm);
- Vendosja e kushteve;
- Zbatimi i lirit me kusht;
- Mosrespektimi i kushteve të vendosura;
- Garancitë procedurale;
- Metoda për të përmirësuar vendimmarrjen;
- Informimi dhe konsultimi për lirimin me kusht;

- Studime dhe statistika.

Rekomandim R (97)12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për personelin i cili merret me zbatimin e dënimeve dhe masave. Pa dyshim që një zbatim i kënaqshëm i sanksioneve dhe masave të komunitetit mund të arrihet vetëm përmes koordinimit ndërinstitucional, bashkëpunimit të niveleve të ndryshme dhe një personeli me kualifikim të lartë, por njëkohësisht bashkëpunues. Pikërisht rekomandimi u kushton kujdes cilësive morale e profesionale që duhet të gëzojë personeli që do të angazhohet në këtë veprimtari. Rekomandimit i janë bashkangjitur dy shtojca të rëndësishme. Në Shtojcën I gjenden parimet për rekrutimin, përzgjedhjen, trajnimin, kushtet e punës dhe lëvizjen e personelit që merret me zbatimin e sanksioneve dhe masave, ndërsa në Shtojcën II jepen udhëzime etike për këtë personel duke përfshirë kërkesa të përgjithshme etike; kërkesa etike në lidhje me të dyshuarit ose të dënuarit. Rekomandimi është një instrument i rëndësishëm për të orientuar mirë dhe drejt institucionet që rekrutojnë dhe trajnojnë personelin e tyre përkatës.

Rekomandimi nr. R (99) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Rritjen e Popullsisë në Burgje. Çështja e mbipopullimit të burgjeve vë gjithnjë në dilemë disa standarde të rëndësishme lidhur me respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe sistemin e drejtësisë penale në tërësi. Rekomandimi lidhet ngushtësisht me rekomandimet e tjera të renditura në këtë punim (dhe të tjera) dhe ka për qëllim të nxisë marrjen e masave të duhura gjatë rishqyrtimit të legjislacionit dhe praktikave në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe rritjen e popullsisë së burgjeve, çka nënkupton një kujdes edhe më të madh ndaj sanksioneve dhe masave komunitare.

Rekomandim R (2008)11 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane për të Dënuarit e Mitur që u nënshtrohen sanksioneve dhe masave. Në këtë rekomandim me interes të veçantë gjejmë të renditura një tërësi rregullash nga më të rëndësishmet që kanë të bëjnë me të miturit të cilët kanë kryer vepra penale dhe ndaj të cilëve jepen sanksione ose masa. Qëllimi i këtij rekomandimi është interesi më i lartë i fëmijës.

Rekomandimi është i ndarë në tetë pjesë. Në secilën prej tyre trajtohen institute të rëndësishme që kanë të bëjnë me një trajtim me perspektivë të miturit. Ka rreth 142 rregulla dhe është e rëndësishme që profesionistët të lexojnë me kujdes përmbajtjen e këtij rekomandimi, i cili në fakt është hartuar në harmoni të plotë me një sërë instrumentesh ndërkombëtarë të OKB dhe të Këshillit të Evropës qoftë të nivelit të atyre të detyrueshme qoftë të nivelit të rekomandimeve.

Kështu, sipas pjesëve rendisim:

- Pjesa e parë: Parime të përgjithshme, qëllimi dhe përkufizime përfshin:
 - Parimet e përgjithshme si: trajtimi me respekt dhe respektimi i të drejtave të njeriut; moshë minimale, interesi më i lartë i fëmijës, anti-diskriminimi, inkurajimi i ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese, etj.
 - Qëllimi dhe përkufizimet: autor i veprës penale, i ri autor i veprës penale, veprë penale, masë dhe sanksion komunitar, heqje lirie, institucion.
- Pjesa e dytë: masat dhe sanksionet komunitare, përfshin:
 - Kuadrin ligjor (rregullat 23.1-30.2);

- Kushtet për zbatimin dhe pasojat për mospërbushjen e masave dhe sanksioneve (rregullat 31.1- 48.5);
- Pjesa e tretë: Kufizimi i lirisë
 - Pjesa e përgjithshme përfshin: trajtim gjithëpërfshirës, strukturat institucionale, vendosja në institucione, pranimi në institucione, akomodimi, higjiena, veshmbathja dhe fjetja, ushqimi, shëndeti, regjimi i aktiviteteve, kontaktet me botën e jashtme, liria e mendimit, besimit dhe ndërgjegjes, mbajtja e rregullit (kontrollet, përdorimi i forcës, armëve, veçimi për arsye sigurie dhe mbrojtjeje, disiplinimi dhe ndëshkimi, transferimi ndërmjet institucioneve), përgatitjet për lirim, të huajt e mitur, të miturit e minoriteteve etnike dhe gjuhësore.
 - Pjesa e posaçme: këtu përmbahen rregulla lidhur me paraburgimin, mbajtjen e polici, etj., përpara dhënies së dënimit; institucionet e mirëqenies; institucionet e shëndetit mendor; (rregullat 108 -119);
- Pjesa e katërt: këshillimi dhe ndihma ligjore;
- Pjesa e pestë: procedurat e ankimit. Inspektimi dhe monitorimi;
- Pjesa e gjashtë: Personeli;
- Pjesa e shtatë: Vlerësimi, puna kërkimore, media dhe publiku;
- Pjesa e tetë: përditësimi i rregullave.

Për sa i takon nivelin të **Bashkimit Evropian**, parimet e së drejtës së Bashkimit Evropian, të njohura si e drejta komunitare, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rendin ligjor kombëtar sepse e drejta komunitare në vendet anëtare të Bashkimit Evropian ka përparësi ndaj të drejtës kombëtare. Burimet kryesore të së drejtës komunitare janë traktatet dhe direktivat. Mekanizmi zbatues i së drejtës komunitare është Komisioni Evropian. Bashkimi Evropian lejon individët dhe grupet t'i paraqesin Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian ankesa dhe peticione rreth shkeljeve specifike të të drejtave të njeriut. Megjithatë, Komisioni Evropian nuk mund të japë vendime detyruese që do të siguronin lehtësimin e dhunimit të të drejtave të një individi.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka juridiksionin mbi rastet e paraqitura nga një shtet anëtar kundër një shteti tjetër anëtar për shkelje të traktatit, prej një institucioni të Bashkimit Evropian kundër një shteti dhe prej qytetarëve të veçantë ose organizatave kundër institucioneve të Bashkimit Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë nuk arbitron ankesat e sjella nga individë kundër shteteve anëtare. Megjithatë, një gjykatë kombëtare mund të kërkojë mendim prej Gjykatës Evropiane të Drejtësisë lidhur me zbatimin e drejtë të së drejtës komunitare në një rast të veçantë.

Hyrja në BE nuk është thjeshtë një dëshirë pa detyrime të caktuara. Procesi i integritetit është një rrugë e cila imponon detyrimisht përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë për të miturit. Megjithëse instrumentet e BE-së janë të lidhura vetëm me shtetet anëtare, vendet evropiane jo-anëtare siç është rasti i vendit tonë, që dëshiron të aplikojnë për anëtarësim duhet të harmonizojnë legjislacionin me standardet e BE-së. Plani Kombëtar për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së dhe zbatimin të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA)⁸² parashikon një sërë masash legjislative lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut.

⁸² Nënshkruar më 12 qershor 2006. Shih: <http://mie.gov.al/skedaret/1191399573-SAA%20Final%20Shqip%2002.06.06-1.pdf>. MSA-ja hyri në fuqi më 1 prill 2009.

Kjo do të thotë që një kuadër i tërë ligjor do të jetë në një proces analize për t'u harmonizuar me standardet e BE-së.

Në këtë drejtim, në kuadër të Bashkimit Evropian një instrument i rëndësishëm për t'u përmendur është Vendimi i Këshillit të BE-së 2008/947/JHA, datë 27 nëntor 2008 "Për zbatimin e parimit të njohjes reciproke të gjykimeve dhe vendimeve për vënien në provë me qëllim mbikëqyrjen e masave për vënien në provë dhe sanksioneve alternative"⁸³. Teksti tregon rëndësinë dhe konsideratat nisur nga perspektiva e BE-së dhe leximi i tekstit të Vendimit mund të shërbejë për një kuptim më të drejtë të rëndësisë që ka bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjellët juridike në fushën penale, përfshirë edhe çështje të alternativave të dënimit me burgim dhe të rolit të Shërbimit të Provës.

2.3. Kodi Penal dhe ligje të tjera

Alternativat e dënimit me burgim u përcaktuan për herë të parë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, në Kreun VII të Pjesës së Përgjithshme të tij, duke zënë vend jashtë Kreut V që trajton llojet e dënimeve penale, përpara Kreut VIII - shuarja e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimi i tyre. Interesant është fakti që titulli i tyre flet për alternativa të dënimit me burgim dhe jo për alternativa të dënimeve penale, ndonëse në doktrinë njihen si dënime alternative apo masa alternative. Megjithatë, emërtimi i tyre mund të shpjegohet duke analizuar përmbajtjen e secilës prej tyre, në të cilën bie në dukje se kërkesa bazë është që gjykata të ketë caktuar një dënim me burgim ndaj të dënuarit.

Në versionin fillestar, Kodi parashikonte katër lloje alternativash:

1. copëzimin e dënimit me burgim (neni 58);
2. pezullimin e dënimit me burgim dhe vënia në provë - i njohur si dënimi me kusht (neni 59);
3. pezullimin e ekzekutimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik (neni 63); dhe
4. lirim para kohe me kusht (neni 64).

Mirëpo, prezantimi i këtyre alternativave nuk u shoqërua me strukturën ekzekutive të nevojshme për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre dhe as me procedurën e detajuar të caktimit e mbikëqyrjes së tyre. Kjo mungesë është përcaktuar si faktori dominues në zbatimin e varfër praktik të këtyre masave alternative në jurisprudencën e gjykatave shqiptare. Për shkak të mungesës së strukturës mbikëqyrëse, masat alternative perceptoheshin të barabarta nga efektet me vendimet e pushimit të procedimit penal apo me vendimet e pafajësisë. Madje, prej rrethit prej katër lloje masash, alternativat e përdorura kanë qenë pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim e parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal dhe lirim para kohe me kusht, i parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal (e cila në fakt përbën një alternativë të llojit disi të veçantë në drejtim të momentit të caktimit të saj dhe të kushteve që duhen plotësuar).

⁸³ Teksti anglisht i këtij vendimi mund të gjendet në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:337:0102:0122:EN:PDF>

Nga statistikat zyrtare⁸⁴ rezulton se vetëm një apo dy dispozita përdoren nga gjykata në një numër relativisht të madh, ndërsa dispozitat e tjera ose janë zbatuar shumë pak ose aspak. Kështu, në vitin 2003 pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë sipas nenit 59 të Kodit Penal është zbatuar nga gjykata për 796 të dënuar; në vitin 2004 për 1300 persona; dhe për vitin 2005 për 1102 persona. Për ilustrim më të detajuar gjatë vitit 2006, në pesë gjykata të rretheve gjyqësore⁸⁵: aplikimi i alternativave të dënimit me burgim është kërkuar në 44 çështje penale; vetëm në 11 prej tyre gjykata ka dhënë vendim për pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal; në 11 prej rasteve, ku është pezulluar ekzekutimi i dënimit, të pandehurit kanë qenë të mitur nën moshën 18 vjeç; në 23 raste, në të cilat gjykata ka refuzuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në 4 prej tyre të pandehurit kanë qenë të mitur; në asnjë rast të vitit 2006 gjykata nuk ka aplikuar kryesisht (pa kërkesë të palëve) alternativa të dënimit me burgim.

Në këtë terren praktik lindi nevoja për ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të alternativave të dënimit me burgim. Me qëllim ndryshimin e këtij realiteti, u hartuan dhe miratuan:

1. ligji nr. 10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;’” dhe
2. ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale.’”

Nisma ligjore gjente nxitje në programin e qeverisë 2005-2009, të miratuar në Kuvend në datën 08.09.2005 në të cilin parashikohet garantimi i procesit të drejtë ligjor për çdo qytetar, akses të lehtë në drejtësi, drejtësi për të gjithë dhe barazi para ligjit të kujtdo, trajtim njerëzor në paraburgim dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi.

Në procesin hartues të paketës ligjore për reformimin e alternativave të dënimit me burgim u zhvillua një analizë e përqendruar në:

- kuadrin ligjor ekzistues dhe tendencat bashkëkohore të të drejtës penale;
- prioritetet që kërkohej të adresoheshin;
- thelbin e alternativave të dënimit me burgim;
- parimet që përshkojnë alternativat e dënimit me burgim;
- qëllimet dhe objektivat e alternativave të dënimit me burgim.

Nga një vështrim krahasues për ndryshimin e Kodit Penal në vite, rezulton se kreu i alternativave të dënimit me burgim është kreu që ka pasur edhe numrin më të paktë të ndërhyrjeve legislative ndër vite. Dënimet alternative zënë një vend të rëndësishëm në politikat penale që ndjekin shtetet evropiane dhe më gjerë, dhe posaçërisht vitet e fundit ato kanë gjetur një shtrirje shumë të gjerë edhe në vendet e Evropës Lindore. Mjafton të përmendet fakti se Kosova ka qenë nga vendet e fundit të rajonit që nisi projektin e aplikimit të alternativave të dënimit me burgim në vitin 2003 me ndihmën e një projekti të Këshillit të Evropës.

⁸⁴ Sipas vjetarit statistikor të botuar nga Ministria e Drejtësisë, bazuar në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.

⁸⁵ Tiranë, Fier, Vlorë, Shkodër dhe Kavajë.

Nisma për përmirësimin e kuadrit ligjor, që përbënte edhe reformën më të rëndësishme të sistemit penitenciar dhe të drejtësisë penale, adresonte prioritetin qeveritar për funksionimin efektiv të alternativave të dënimit me burgim për arsyet e shumta ekonomike, sociale shoqërore, humane dhe sidomos uljen e fenomenit të mbipopullimit në burgje. Është e vërtetë se dënimi me burgim e mban të dënuarin në kontroll të sigurt, e ndëshkon duke i hequr lirinë, e ruan që ai të mos kryejë vepra të tjera gjatë kohës së qëndrimit në burg dhe e rehabiliton atë gjatë periudhës së burgimit. Megjithatë, studimet dhe analizat tregojnë që pikërisht ky objektivi i fundit i burgimit ‘rehabilitimi’ nuk arrihet prej tij. Statistikat tregojnë që burgjet, jo vetëm që rehabilitojnë rrallë, por nxisin individët në kriminalitet të mëtejshëm, duke krijuar një proces zinxhir lirim dhe burgimi. Burgimi shkakton edhe fillimin e ciklit të varfërisë, humbjes së vendeve të punës, dobësimin e mundësive për punësim, dëmtimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe shtimin e rreziqeve shëndetësore për shkak të mbipopullimit në burgje.

Madje, mbipopullimi evidentohet edhe si faktor që nxit dhunën në burgje. Zgjidhja e mbipopullimit në burgje realizohet në dy mënyra:

- nëpërmjet ndërtimit të burgjeve të reja. Kjo zgjidhje nuk konsiderohet më si shumë e përshtatshme sepse ngritja dhe mirëmbajtja e tyre është e kushtueshme dhe rëndon në financat e shtetit dhe, në analizë të fundit, u rëndon qytetarëve në taksat e tyre.
- nëpërmjet reformimit të drejtësisë penale me prezantimin e masave dekriminalizuese për vepra të caktuara, zbutjen e masave të dënimit me burgim për vepra të lehta dhe shtimin e dënimeve alternative.

Megjithatë, dënimet alternative nuk shërbejnë vetëm për të adresuar çështjen e mbipopullimit në burgje. Thelbi i tyre është ndryshimi i fokusit të dënimit nga ndëshkim dhe izolim, në drejtësinë restauruese dhe riintegruese për individin. E drejta penale bashkëkohore është duke u shpëputur gjithnjë e më shumë nga efekti ndëshkues apo shpagues i dënimit, duke u orientuar drejt drejtësisë restauruese. Tashmë edhe nën ndikimin e parimit të humanizmit që përshkon legjislacionin penal, pranohet gjerësisht se dënimi penal ndjek qëllimin e edukimit, risocializimit dhe riintegritimit të autorit të veprës penale paralelisht me rehabilitimin/zhdëmtimin e të dëmtuarit prej saj⁸⁶.

Nga analiza e vendimeve gjyqësore penale konstatohet se gjykata, në caktimin e dënimit individual penal në mënyrën e përcaktuar në nenin 47 të Kodit Penal dhe pas vlerësimit të rrethanave të përcaktuara në nenet 48-50 të të njëjtit Kod, evidenton në vendimet e saj dy efekte kryesore:

- efektin e parandalimit të posaçëm, ndaj të dënuarit konkret që synon në edukimin dhe riintegrimin social të tij. Në këtë drejtim, pritshmëritë janë që i dënuari të mos kryejë në të ardhmen vepra të tjera penale, duke vazhduar një jetë normale pas kryerjes së dënimit;

⁸⁶ Një përjashtim bën dënimi me burgim të përjetshëm, i cili ndjek qëllimin e izolimit të përjetshëm të të dënuarit për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të theksuar të të dënuarit.

- efektin e parandalimit të përgjithshëm, duke dhënë mesazhin në shoqëri që vepra e kryer nga i dënuari arrin të zbulohet dhe procedohet penalisht nga shteti, si dhe rasti i veprimit të kryer nga autori i veprës penale nuk është një model për t'u ndjekur nga shoqëria.

Kodi Penal parashikon në nenin 1/c37 të tij se ai bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit. P arimet e përgjithshme të së drejtës gjenden në të gjitha sistemet ligjore dhe funksioni i tyre është padyshim të ndihmojë gjetjen e zgjidhjes konkrete aty ku burimet e shkruara të së drejtës nuk mjaftojnë të japin një zgjidhje sepse këto burime të shkruara nuk mund të mbulojnë të gjitha çështjet që shtrohen për zgjidhje përpara gjykatave. Nën këtë analizë, instituti i alternativave të dënimit me burgim përshkohet nga këto parime, të cilat duhet të mbahen gjithnjë në konsideratë nga zbatuesit e ligjit gjatë interpretimit të normave penale.

Dënimet alternative funksionojnë në përputhje të plotë me tendencën e të drejtës penale për nga drejtësia restauruese, si dhe me parimet e legjislacionit penal. Në doktrinë dënimet apo masat alternative i referohen vendimeve penale gjyqësore, me të cilat caktohen alternativa të dënimit me burgim, si dhe programeve rehabilituese të të dënuarve, që synojnë vendosjen e një ekuilibri midis interesave të shoqërisë për t'u mbrojtur nga kriminaliteti dhe nevojave të autorit që është në konflikt me ligjin.

Dënimet alternative përshkohen edhe nga fleksibiliteti (për t'iu përshtatur nevojave të një rasti konkret) si në vendimin e caktimit të tyre (nisur nga lloji i detyrimeve që cakton gjykata), ashtu edhe në drejtim të metodës me të cilën realizohen (programet e ofruara nga Shërbimi i Provës). Qëllimi i masave alternative është të reduktojë dëmin e ardhur nga vepra penale dhe të reduktojë përfshirjen e individit në sistemin e drejtësisë penale. Për realizimin e këtij qëllimi, ato ndjekin këto objektiva:

- Rivendosja e harmonisë, kur është e mundur, midis autorit të veprës penale dhe atyre që janë prekur nga vepra penale;
- Nxitja e nivelit të përgjegjësisë dhe të llogaridhënies të autorit të veprës penale për veprimet e kryera prej tyre;
- Mbrojtja e shoqërisë nëpërmjet shmangies së autorit të veprës penale nga sjellja e mëtejshme kriminale;
- Rritja e përfshirjes së komunitetit, duke përfshirë edhe të dëmtuarit/ viktimat në sistemin e drejtësisë penale.

Doktrina pranon që masat alternative paraqesin një dënim të zbutur të autorit të veprës penale dhe njihen edhe me termin “shmangie” (diversion). Ato u drejtohen autorëve të veprave penale që shkelin për herë të parë ligjin, të cilët e pranojnë akuzën dhe kur vepra penale në ngarkim të tyre nuk është shumë e rëndë.

Në përfundim të kësaj analize të vendosur në problematikën e evidentuar në jurisprudencën gjyqësore, u identifikuan dispozitat që kishin nevojë për përmirësim dhe reformim. Në hartimin e ligjit nr. 10023/2008 janë mbajtur parasysh rekomandimet e Këshillit të Europës (R(92) 16, R (97)12 dhe R (2000)22 të cilat fokusohen në fushën e alternativave të dënimit me burgim. Në

hartimin e tij kanë dhënë kontribut të rëndësishëm si Misioni EURALIUS, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Këshilli i Europës, Komisioni i Reformës Ligjore, UNICEF Albania, etj.

Me anë të ndryshimeve të prezantuara me ligjin nr. 10 023/2008 tashmë ka pesë alternativa:

- “gjysmëliria” (neni 58’);
- “pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” (neni 59); “qëndrimi në shtëpi” (neni 59/a);
- “pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik” (neni 63);
- “lirimi me kusht” (neni 64).

Pra, janë prezantuar dy alternativa të reja, njëra prej të cilave zëvendësoi alternativën e copëzimit të dënimit, si dhe është ndryshuar edhe përmbajtja e tri alternativave ekzistuese (pavarësisht faktit se mbeten si alternativa po të njëjtat).

Konkretisht, është ndryshuar neni 58 i Kodit Penal “copëzimi i dënimit me burgim”, duke u shndërruar në “gjysmëliria”. Alternativa e re synon përjashtimin me rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe traditat më të mira të legjislacioneve penale të vendeve evropiane. Termi “Gjysmëliria” është huazuar nga legjislacionet evropiane, në të cilat përdoret “semi-liberty”. Një terminologji dhe formulim i përafërt i tij përdoret edhe në Kodin Penal të Kosovës. Neni 58 i riformuluar parashikon ekzekutimin e vendimit gjyqësor gjer në një vit burg me “gjysmëliri” për shkaqet e renditura në këtë nen. Detyrimet kryhen në kohën e përcaktuar nga gjykata jashtë burgut dhe me mbarimin e tyre në përputhje me vendimin e gjykatës, shtetasi i dënuar kthehet në burg.

Ndryshimet e prezantuara në nenin 59 të Kodit Penal e kanë bazën në përvojën e marrë në legjislacionet penale të vendeve të tjera si kodet penale në Greqi, Itali, Gjermani, Spanjë, Britaninë e Madhe të cilët përcaktojnë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim deri në 5 vjet. Ky nen është riformuluar në mënyrë më të qartë mbi bazën e dispozitave të kodeve penale të vendeve të sipërcituara. E njëjta bazë ka shërbyer edhe për ndryshimin e rregullit të kryerjes së veprës penale po aq të rëndë apo më të rëndë gjatë periudhës së provës. Të gjitha legjislacionet penale të studiuar e konsiderojnë si kusht moskryerjen e ndonjë veprës penale tjetër gjatë periudhës së provës, pavarësisht nga rëndësia e saj (qoftë edhe një vepër të kryer nga pakujdesia dhe me masë dënimi më të vogël). Mbi bazën e praktikës së gjetur në kodet penale të vendeve të tjera si dhe praktikës e formulimit aktual të Kodit Penal është bërë gjithashtu edhe një renditje më e zgjeruar e shkaqeve se kur gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të personit të dënuar. Për sa kohë është një urdhërim i dhënë nga gjykata me vendim gjyqësor, shkelja e tij sjell pasoja mbi personin e dënuar posaçërisht, zëvendësimin, zgjatjen e afatit të provës brenda afatit të përgjithshëm ose revokimin e tij. Ky nen realizon dy qëllime të rëndësishme: përgjegjësinë e Shërbimit të Provës në këtë drejtim dhe detyrimin e personit të dënuar për të mbajtur kontakte me të.

Mbi bazën e legjislacioneve penale më të mira dhe rekomandimeve të dhëna nga Këshilli i Evropës është prezantuar edhe një alternativë e re e dënimit me burgim. Neni 59/a i Kodit Penal parashikon alternativën e emërtuar “qëndrimi në shtëpi”. Kjo dispozitë në zbatimin e saj është

përrjashtimore dhe mund të zbatohet në rastet kur të dënuarit janë gra shtatzëna ose nëna me fëmijë nën moshën 10 vjeç që jetojnë me të, me kushte të rënda shëndetësore që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor jashtë burgut, mbi 60 vjeç dhe që janë të paaftë nga ana shëndetësore apo të rinj nën moshën 21 vjeç me nevoja të dokumentuara shëndetësore studimore, të punës apo përgjegjësive familjare. Kur këto kushte nuk ekzistojnë më dhe në rast se ndodhin shkelje të tyre apo moszbatim të përcaktuar nga shërbimi i provës, dispozita parashikon edhe pasojat përkatëse që rrjedhin prej këtyre shkeljeve.

Ndryshimet në nenet 60 dhe 61 të Kodit Penal kanë të bëjnë me aspekte teknike të formulimeve të dispozitave aktuale. Ato përshkohen nga ideja për një kuptim më të mirë dhe zbatim më të lehtë nga prakticienët e së drejtës. Një prej parimeve të procesit legjislativ është edhe përdorimi i gjuhës së përshtatshme për të përputhur qëllimin e ligjvënësit me atë të zbatuesit të ligjit si një aspekt i rëndësishëm që garanton respektimin e sigurisë juridike.

Në nenin 64 të Kodit Penal synimi ka qenë rregullimi teknik i një prej instituteve më të njohura të drejtësisë penale “Parole”, e cila në kuptimin e saj të vërtetë konsiderohet si “lirim me kusht”.

Lidhur me pritshmëritë e ligjvënësit për zbatimin në praktikë të alternativave të reformuara mund të thuhet kjo nismë përpiqet të përmirësojë dispozitat përkatëse të kreut të dënimeve alternative duke i përjashtuar ato me praktikën më të mira të kodeve penale të tjera dhe duke iu përshtatur realitetit shqiptar njëkohësisht.

Ndërsa gjatë diskutimit të tij në Komisionet Parlamentare janë vënë në dukje se ndryshimet e Kodit Penal kanë të bëjnë me dënimet alternative ndaj dënimit me burgim, një nga reformat më të mëdha që u referohen standardeve të trajtimit të të dënuarve me burgim. Kjo reformë nuk është vetëm një kërkesë e Këshillit të Evropës, Komitetit kundër Torturës, por është nevojë e domosdoshme dhe e vonuar tashmë. Janë tri pika në të cilat kjo reformë ligjore referon. E para është komponenti social, pra, si do të trajtohen dhe konsiderohen të dënuarit – ata nuk do të jenë më si kategoria që duhen të ndëshkohen nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe shoqëria duhet t’i risocializojë. Komponenti i dytë është ai ligjor – ndryshimet bëjnë të mundur që të gjitha këto ndryshime që ofrojnë alternativa të jenë të aplikueshme nga sistemi gjyqësor, prokuroria, si dhe nga ata që do të merrem me ekzekutimin. Komponenti i tretë është një komponent praktik, financiar. Nga të gjitha përlllogaritjet, kostoja që të dënuarit mbahen në burgje shkon deri në 3000 lekë në ditë. Vendosja e këtyre alternativave do të sjellë uljen e kostos, por dhe përfitime të mëdha shoqërore. Gjithashtu, këto ndryshime sjellin lehtësi në zbatimin e ligjit, ulin marzhin e diskrecionit që mund të ketë sistemi i drejtësisë, japin siguri juridike, parashikueshmëri juridike. Këto ndryshime ecin paralel me ndryshimet në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, krijohet Shërbimi i Provës, si institucion me përgjegjësi të plotë në shërbim të pushtetit gjyqësor.

Këto dispozita kërkojnë që Kodin Penal ta bëjnë të aplikueshëm në të gjitha ato pjesë ku ka dështuar dhe kjo pjesë është aplikimi i dënimeve alternative. Shqipëria ka mbajtur qëndrim drastik, ka mbajtur njerëz në burg me afate më të gjata seç do t’i takonin, ka refuzuar të aplikojë dispozitat që lehtësonin dënimin penal sepse shteti nuk ka funksionuar sipas qëllimeve që i ka vendosur vetes. Nuk ka pasur Shërbimin e Provës, instrument i rëndësishëm për zbatimin e dispozitave të Kodit. Me anë të këtyre ndryshimeve synohet të saktësohen dispozitat që kanë të

bëjnë me dënimet alternative dhe këto ndryshime në Kodin Penal shoqërohen me ngritjen e strukturës që do të zbatohet këto dispozita.

Miratimi i paketës ligjore mbi alternativat e dënimeve alternative dhe Shërbimin e Provës përbën një zhvillim cilësor të legjislacionit penal shqiptar dhe një hap të rëndësishëm në drejtim të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me atë ndërkombëtar. Megjithatë, tanimë i përket sistemit të drejtësisë (mbrojtësve, organit të prokurorisë dhe gjykatave) të luajnë rolin e rëndësishëm në zbatimin e këtyre zhvillimeve ligjore, duke i dhënë jetë atyre.

3. Dënimet penale sipas legjislacionit shqiptar aktual

Me Ligjin nr. 7491, datë 31.05.1995 hyri në fuqi Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Ai solli ndryshim të menjëhershëm në sistemin e drejtësisë penale, por me kalimin e kohës edhe ai vetë pati nevojë për ndryshime. Ndryshimet më të rëndësishme u bënë me Ligjin nr. 8176, datë 23.12.1996. Këto ndryshime erdhën si pasojë e mangësive që viheshin re në Kod dhe si qëllim kryesor kishin rritjen e luftës kundër kriminalitetit dhe parandalimin e tij.

Kodi Penal i RSH-së nuk jep një perkufizim të dënimit penal, por paraqet vetëm llojet e dënimeve. Këto dënime janë të vecanta për krime, që kanë rrezikshmëri shoqërore të madhe, dhe për kundravajtje penale, që e kanë rrezikshmërinë shoqërore më të pakët.

Dënimi penal zbatohet për kryerjen e veprave penale. Pra, duhet të jetë kryer një veprë penale dhe kjo veprë të parashikohet shprehimisht në ligjin penal. Ky parim gjen zbatim edhe në Kushtetutë, në nenin 27 të saj, i cili parashikon se: *“Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara në ligj”*. I njëjti parim theksohet edhe në nenin 2 të Kodit Penal: *“Askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është parashikuar në ligj si krim ose si kundravajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj ose masë dënimi të paparashikuar në ligj”*.

Dënimi, si masë shtrenguese shteterore, zbatohet vetem ndaj personave fajtores për kryerjen e një krimi konkret dhe që parashikohet si i tillë nga ligji. Dënimi i një personi të pafajshëm është në kundërshtim me qëllimet e dënimit. Pikerisht neni 14 i Kodit Penal parashikon se askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si veprë penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj personi që e ka kryer veprën me dashje dhe pakujdesi.

Dënimi penal ka karakter personal. Ai zbatohet vetem ndaj personit konkret që ka kryer veprën penale dhe nuk vepron edhe ndaj personave të tjera të familjes ose të afërmeve të tij, përveçse në rastet kur këta janë bashkëpunetore në krim. Ky parashikim përben një ndryshim me Kodin e mëparshëm, i cili parashikonte se, në rast dënimi të personit si fajtor për kryerjen e një krimi, e gjithë familja e tij dënohej me internim në zonat me të thella të vendit.

Gjykata është organi i vetëm që ka të drejtë të caktojë një dënim dhe të përcaktojë llojin dhe masën konkrete të tij. Ky është një parim kushtetues që rrjedh nga neni 27 i Kushtetutës: *“Askujt nuk mund t’i hiqet liria përveçse kur është denuar me burgim nga gjykata kompetente”*. Kjo duke u ndjekur edhe nga parimi tjetër kushtetues i ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Masa të tjera shtrenguese mund të jepen nga organe të tjera shteterore por që

nuk e kanë karakterin e denimeve penale, p.sh: administrata shtetërore merr masa të karakterit administrativ

Masat e sigurimit ose masa të tjera procedurale nuk i konsiderojmë si denime, sepse, megjithatë ato merren nga gjykata, personi ndaj të cilit merren nuk është akoma fajtor, por vetëm një i dyshuar. Për këto flet qarte me qarte nën 4 i Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet prezumimi i pafajësisë.

As masat mjekësore dhe edukuese nuk janë denime. Që të zbatohet dënimi penal kundër një personi, kerkohet domosdoshmërisht ekzistenca e fajit. Kurse masat mjekësore dhe edukuese merren ndaj personave të papërgjegjshëm, për shkak moshe ose paaftësie mendore. Në këto masa mungon teresisht elementi ndëshkimor, që është karakteristikë themelore e dënimit.

Kodi Penal nuk jep një perkufizim të qellimit të dënimit. Kjo nuk do të thotë që dënimi penal nuk ndjek qëllime të caktuara. Në mënyrë indirekte nga dispozitat e Kodit Penal del në pah ky qëllim, pikërisht qëllimi për të zhdukur çdo veprimtari shoqërisht të rrezikshëm, për të dënuar personin fajtor për kryerjen e veprës penale, për të parandaluar personin fajtor nga kryerja e veprave penale të tjera, për të parandaluar kriminalitetin, pra për të ushtruar një influencë të përgjithshme edukuese mbi pjesët e tjera të shoqërisë, për të mbrojtur rendin kushtetues, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e personave të tjerë që rrezikojnë të cenohen nga veprimet e paligjshme.

Pra, teoria që ndjek legjislacioni shqiptar për qëllimin e dënimit është teoria e perzier, që do të thotë se, me anë të dënimit, synohet të edukohet personi autor i veprës penale, si dhe të parandalohet ai dhe persona të tjerë të nga kryerja e veprave të metejshme kriminale. Synimi i dënimit është parandalimi i veprimtarisë së rrezikshme të autorit, përmirësimi dhe edukimi i tij dhe ndikimi pozitiv edukues tek personat e tjerë, që mund të jenë kontigjente për kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

3.1. Dënimet kryesore dhe plotësuese

Nenet 29 deri 47 të Kodit Penal parashikojnë llojet e denimeve. Denimet klasifikohen në denime kryesore dhe dënime plotësuese. Të parat ndahen në dënime kryesore për krime dhe denime kryesore për kundravajtje penale. Kodi Penal nuk bën një ndarje në denime plotësuese për krime dhe denime kryesore për kundravajtje penale, ashtu siç e bente kodi penal i mëparshëm.

Denimet kryesore për krime janë:

- me burgim të përjetshëm;
- me burgim;
- me gjyke.

Për kundravajtjet penale denimet kryesore janë:

- me burgim;
- me gjyke

Denimet kryesore jane ato denime te cilat gjykata mund t'i jape me vete, ne menyre te pavarur. Per cdo veper penale jepet vetem nje denim i tille.

Denimet plotesuese jane ato denime qe mund te jepen si plotesuese te nje denimi kryesor. Ato, si rregull, nuk qendrojne ne menyre te pavarur dhe per cdo veper mund te jepet me shume se nje denim i tille. Keto denime jepen nga gjykata kur ajo cmon se personaliteti i fajtorit dhe rrethana te tjera kerkojne forcimin e efektit te denimit.

Kodi Penal parashikon gjithsej dhjetë lloje denimesh plotesuese qe jane:

1. ndalimi i se drejtes per te ushtruar detyra si nenpunes shtetror ose ne sherbim publik;
2. konfiskimi i mjeteve te kryerjes se vepres penale dhe perfitimeve prej saj;
3. ndalimi per te drejtuar automjete;
4. heqja e dekoratave dhe titujve te nderit;
5. heqja e se drejtes se ushtrimit te nje veprimtarie ose mjeshterie;
6. heqja e se drejtes per te ushtruar detyra prane personave juridike;
7. ndalimi per te qendryar ne nje ose disa njesi administrative;
8. nxjerrja jashte territorit;
9. detyrimi per publikimin e vendimit gjyqesor;
10. heqja e përgjegjësisë prindërore.

Sic thame, si rregull, denimet plotesuese nuk jepen me vetem, por te shoqeruara me denime kryesore. Perjashtimin nga ky rregull e ben vete neni 30 i Kodit Penal, ne paragrafin e tij te fundit, i cili lejon gjykatën që, ne raste te vecanta, kur dhenia e denimeve kryesore cmohet e papershtateshme dhe kur ligji parashikon denime me te lehta per vepren e kryer, te mjaftohet vetem me caktimin e denimit plotesues. Pra, ky paragraf i jep mundesi gjykates qe, kur ajo e cmon te arsyeshme dhe kur per vepren penale ligji parashikon denime deri ne tre vjet burgim ose denime te tjera me te lehta, mund te caktojë vetem nje denim plotesues. Kjo ndodh vetem ne qofte se gjykata eshte e bindur se qellimi i denimit per edukimin e personit arrihet pa qene nevoja per aplikimin e denimeve kryesore dhe, sigurisht, kur ligji parashikon nje denim jo me shume se tre vjet burgim.

Nje nga denimet kryesore qe parashikon Kodi Penal shqiptar eshte edhe *denimi me burgim* te perjetshem, i cili eshte nje denim qe jepet vetem per vepra penale dhe per autore qe paraqesin rrezikshmeri te madhe shoqerore. Ky denim ka te beje me burgimin e personit per nje kohe qe zgjat sa e gjithë jeta e tij. Per kete person nuk ka asnje lloj favorizimi, pervecse ne raste te rralla dhe kur sjellja e tij eshte shembullore.

Neni 31 i Kodit Penal e parashikon denimin me burgim te perjetshem. Sipas kesaj dispozite denimi me burgim te perjetshem jepet vetem per vepra me rrezikshmeri te madhe, per kryerjen e nje krimi te rende. Por Kodi nuk parashikon se kush futet tek krimet e renda prandaj ka qene praktika ajo qe e ka zgjidhur kete mangesi.

Neni 30 i Kodit Penal parashikonte edhe denimin me vdekje, i cili u shpall antikushetues me vendimin e dates 11.11.1999 nga Gjykata Kushtetuese. Megjithatë, që nga viti 1995 e deri ne heqjen e tij, ky denim nuk u ekzekutua ndaj asnje personi, per te cilin gjykata kishte aplikuar

kete lloj denimi. Kushtetuta, e cila u miratua pas Kodit Penal nuk e ndalonte denimin me vdekje, por as nuk e parashikon shprehimisht ate, ne ndryshim nga Dispozitat Kryesore Kushtetuese, qe e parashikonin shprehimisht denimin me vdekje.

Perkundrazi, ne nenin 21 te Kushtetutes parashikohet shprehimisht se jeta njeriut mbrohet me ligj. Kjo dispozite ngre ne nivel kushtetues mbrojtjen e jetes njerezore. Koncepti per jeten dhe dinjitetin njerezor paraqiten si vlera shume te rendesishme, te cilat konsiderohen burimi nga i cili rrjedhin te gjitha te drejtat e tjera, si te drejta themelore absolute. Megjithate per heqjen e denimit me vdekje gjykata kushtetuese eshte nisur edhe nga nje sere dispozitash te tjera, si: p.sh.: neni 1 i DKK te vitit 1991, kapitulli per te drejtat dhe lirite e njeriut ne Kushtetute shqiptare, etj.

Denimi me burgim eshte zbatuar ne Shqiperi ne te gjitha legjislacionet. Denimi me burgim jepet nga gjykata per nje kohe nga 5 dite deri ne 35 vjet per krime dhe nga 5 dite deri ne dy vjet per kundravajtje penale. Karakteri shtrengues i ketij lloj denimi eshte me i theksuar se ne llojet e tjera te denimeve. I denuari me burgim vecohet nga shoqeria dhe e vuan denimin ne vendet caktuara per kete qellim. Pra, burgimi eshte kufizimi i lirise se levizjes ndaj nje personi te shpallur fajtor per kryerjen e nje vepre penale me nje vendim gjykate dhe per nje afat te caktuar, te parashikuar ne vete dispoziten perkatese.

Eshte neni 32 i Kodit Penal qe parashikon denimin me burgim, ku kufiri minimal eshte 5 dite dhe ai maksimal eshte 35 vjet. Ky denim, duke qene nje nga denimet kryesore me te renda, parashikohet per shumicen dermuese te veprave te parashikuara nga Kodi Penal ne pjesen e posacme te tij. Denimi me 35 vjet burgim apo me burgim te perjetshem jepet vetem per krimet qe kane rrezikshmeri shume te madhe shoqerore. Sidomos pas heqjes së dënimit me vdekje u vendos theksi denimit me burgim, i cili per disa vepra eshte jo me pak se 5 vjet, duke arritur ne 10 vjet, 15 deri ne 35 vjet burgim. Me ashpersimin e denimit me burgim per personat qe paraqesin rrezikshmeri te madhe shoqerore synohet te arrihen qellimet e denimit, si ai i posacem ndaj vete autorit te krimit, ashtu edhe ai i pergjithshem ndaj personave te tjere te lekundshem te shoqerise.

Ky denim zbatohet edhe si alternative me denimin me gjobe per ato vepra qe nuk paraqesin rrezikshmeri shoqerore te madhe, ne varesi te rrezikshmerise shoqerore te vepres penale, te autorit te saj, duke pasur parasysh rrethanat lehtesuese dhe renduese.

Vecimi i te denuarit me burgim shprehet ne kufizimin e se drejtes per te levizur lirisht, por jo te se drejtes per t'u izoluar shpirterisht personi, si dhe te drejta te tjera qe perfshijne zhvillimin intelektual, arsimor, kulturor, lidhjet me shoqerine dhe me boten e jashtme. Per ekzekutimin e vendimeve penale vepron nenin 462 i Kodit të Procedurës Penale dhe Ligji nr. 8331, datë 21.04.1998.

Për ekzekutimin e nje denimi me burgim, duhet qe prokurori te nxjerre urdherin e ekzekutimit, i cili permban gjeneralitetet e te denuarit, dispozitivin e vendimit dh disponimet e nevojeshme per ekzekutim.

Ligji për ekzekutimin e denimeve penale percakton ne menyre te qarte dhe te detajuar menyren e ekzekutimit te denimit me burgim. Ligji eshte i ndertuar ne 4 pjese: e para permban dispozitat e

pergjithshme; e dyta permban venien ne ekzekutim te vendimeve penale, kompetencat per kete venie, dhe organet qe ekzekutojne vendimet penale te formes se prere; e treta rregullon menyren e ekzekutimit te denimeve penale dhe e katerta rregullon kontrollin ne ekzekutimin e denimeve penale.

Ndersa mbi menyren e vuajtjes se denimit, te drejttat dhe detyrat e te denuarve ka dale Ligji nr. 8328, datë 16.04 1998. Objektivat e trajtimit, sipas ketij ligji, perfshijne arsimimin, fomimin profesional, zhvillimin e aftesive te tjera individuale, veprimtarive clodhese e sportive, punen, asistencen shpirtore dhe veprimtari te tjera ne grup qe kane si qellim rikrijimin e aftesive per tu integruar ne shoqeri. Ky ligj sugjeron trajtimin e te denuarve sipas standarteve perendimore dhe permbush kerkesat e konventave nderkombetare mbi te drejttat e njeriut.

Institucionet e vuajtjes se denimit ne shqiperi ndahen ne:

- Burg i sigurise se larte;
- Burg i zakonshem;
- Burg i sigurise se ulet;
- Institute te vecanta.

Secili nga keto institucione ka nje regjim te vecante, te percaktuar ne ligjin ne fjale dhe ne rregulloren e institucionit. Ky klasifikim ka rendesi sepse ndikon ne organizimin me te mire te procesit te trajtimit dhe edukimit te te denuarve dhe ne klasifikimin e dhe ndarjen e tyre ne perputhje me rrezikshmerine e vepres dhe personalitetin e tyre.

Burgu i sigurise se larte sherben per egzekutimin e vendimeve me burgim per personat qe karakterizohen nga rrezikshmeria e madhe shoqerore. Neni 13 i ligjit parashikon se ne keto institucione e vuajne denimin ata persona qe ne kohen e kryerjes se vepres penale apo gjate vuajtjes se denimit jane karakterizuar nga sjellje dhe qendrime qe e bejne te pamundur qendrimin e tyre ne kategori te tjera te burgjeve. Pra, sic shihet, rregjimi i ketij burgu eshte me i rrepte se institucionet e tjera. Ne burgjet e sigurise se larte te denuarve u kufizohen disa te drejta, por jo te drejttat e njohura ne kushtetute dhe ne ligjin ne fjale.

Burgu i sigurise se zakonshme eshte institucioni ne te cilin vuhet denimi nga te gjithte te denuarit, pervec atyre te sigurise se larte dhe personave qe vuajne nga paaftesi mendore dhe fizike. Keto burgje kane nje rregjim me te bute dhe kane forma te larmishme ne trajtimin e te denuarve.

Ne burgun e sigurise se ulet e kryejne denimin personat qe kane kryer nje kundravajtje penale ose nje veper penale nga pakujdesia dhe qe jane perserites. Te denuarit ne burgje te sigurise se zakonshme, qe u ka mbetur edhe 6 muaj per te perfunduar denimin me burgim, mund te transferohen dhe te vuajne pjesen e mbetur te denimit ne burgje te sigurise se ulet.

Në institucionet per te semuret dhe te paafte vuajne denimin personat me shqetesime mendore ose psikike. Sipas nenit 16 te ligjit keto institucione mund te jene me vete, te posacme, ose seksione te vecanta prane burgjeve ose spitalet e tyre. Ne institucione te tilla mund te vendosen persona te semure para ose gjate vuajtjes se denimit, pra gjate fazes se ekzekutimit te denimit me burgim. Ne institucione te tilla mund te vendosen edhe te denuar qe kane nje profesion te lidhur

me mjekesine, si mjek, dentist, infermier, etj, por vetem ne rast se keta nuk jane te denuar per nje veper qe ka te beje me ushtrimin e profesionit te tyre.

Grate e vuajne denimin me burgim ne institucione te vecanta dhe, ne pamundesi, ne nje seksion te vecante te institucioneve te tjera. Ligji u njej te drejten nenave qe kane femije nen moshen 3 vjecare qe t'i mbajne ato me vete. Ne raste te tilla, prane institucionit funksionon nje vend i vecante per femijen.

Gjeja me e rendesishme qe bie ne sy ne ligj eshte fryma humane qe pershkon nenet e ligjit dhe siguron kryerjen e denimit nga te denuarit duke rrespektuar dinjitetin e te denuarit. Gjithashtu, ligji e ndalon tajtimin cnjerezor, degradues dhe depersonalizues. Trajtimi i te burgosurve behet pa njeanshmeri dhe diskriminim per shkak seksi kombesie, rrace, pikepamje politike, besimi fetar, etj. Trajtimi i te denuarve behet sipas individualizimit te tyre duke marre parasysh mjedisin ne te cilin i denuari ka jetuar, kushtet dhe shkaqet qe e kane shtyre deri ketu. Per t'ia arritur ketij qellimi, administrata e institucioneve te riedukimit pergatit nje program individualper trajtimin e te denuarve, duke pasur parasysh shkaqet qe permendem me siper.

Neni 34 i Kodit Penal, ne nje dispozite pershkruese, parashikon se cfare eshte *denimi me gjobe*, kur zbatohet ai dhe sa eshte minimumi dhe maksimumi i tij per krimet dhe kundravajtjet penale. Pra, denimi me gjobe konsiston ne pagimin ne favor te shtetit te nje shume te hollash brenda kufijve te parashikuar me ligj. Vete kjo dispozite ben nje ndarje te gjobes per krime dhe per kundravajtje penale. Per krime minimumi eshte 100 mije dhe maksimumi eshte 10 milion leke. Per kundravajtjet penale qe kane rrezikshmeri shoqerore me te vogel edhe sasia e gjobes eshte 50 mije deri ne 3 milion leke.

Nga nje veshtrim ne dispozitat e pjeses se posacme te Kodit Penal, vihet re se gjoba eshte nje nga llojet me te lehta te denimeve dhe zbatohet per krime me nje shkalle rrezikshmerie shoqerore te pakot. Percaktimin e gjobes ligjvenesit e le ne cmimin e gjykates, e cila percakton afatin e pagimit te gjobes dhe menyren e pagimit te saj, p.sh: me keste duke i percaktuar gjykata kestet, por kjo vetem ne rast se ajo cmon se gjendja ekonomike e personit te denuar eshte e tille sa nuk lejon pagimin e menjehershem te shumes ose kur nuk e lejojne kushtet vetjake dhe familjare te fajtorit.

Gjithashtu, neni 34 njej edhe te drejten e zevendesimit te gjobes me burgim ne rast mospagimi te saj ne afatin e caktuar nga gjykata. Por, kur gjoba eshte dhene si denim per nje krim, ajo nuk mund te kaloje 3 vjet dhe, per kundravajtjet penale, nuk mund te kaloje 1 vit burgim, por gjithmone pa kalur maksimumin e denimit me burgim qe parashikon dispozita perkatese. Ne Kodin Penal te meparshem, ne rast mospagimi te gjobes, ajo zevendesohet me riedukim nepermjet punes, duke llogaritur 5 leke per 1 dite pune.

Gjoba, si rregull, nuk zbatohet ndaj recidivisteve, sepse me dhenien e nje denimi me gjobe nje personi per te cilin nuk eshte hera e pare qe kryen krim nuk do te arrihej qellimi i denimit: parandalimi i pergjithshem, pra efekti qe do te kishte ndaj personave te tjere, dhe parandalimi i posacem, pra efekti qe do te kishte ky denim mbi vete autorin e vepres penale. Përsëritja tregon se ndaj ketij personi denimi i meparshem i dhene nuk i ka arritur qellimet e denimit, prandaj personit nuk mund ti jepet nje denim me i bute.

Per ekzekutimin e denimit me gjobe eshte kompetente Zyra e Permbarimit, sipas nenit 467 te Kodit të Procedurës Penale. Ne rast mospagimi te gjobes, me kerkese te prokurorit behet konvertimi i gjobes me burgim. Por, kur ka kerkese nga i denuari, gjykata mund ta shtyje deri ne 6 muaj pagimin e gjobes, kur rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e autorit nuk eshte e madhe, duke marre parasysh kushtet vetjake dhe familjare te tij. Ne rast mosrrespektimi te afateve te pagimit ose kur personi ndryshon vendbanimin dhe nuk njofton organin e permbarimit, gjykata vendos zevendesimin e gjobes me denimin me burgim. Ne kete rast gjykata vihet ne levizje ne baze te kerkeses se prokurori. Konvertimi i denimit me gjobe me denimin me burgim eshte 5 mije leke per nje dite burgim.

Heqja e se drejtes per te ushtruar detyra shteterore, per nga vete rendesia, qendron ne krye te denimeve plotesuese. Ky denim plotesues, i cili jepet krahas denimit kryesor, aplikohet ndaj personave qe kane punuar ne sherbim shteteror dhe i kane shperdoruar detyrat qe u jane caktuar dhe, per shkak te krimit, te kryer i denuari nuk ka me garancite e nevojshme per te plotesuar detyra te caktuara. Kur vepra penale e kryer nga fajtori eshte denuar mbi 10 vjet, e drejta e ushtrimit te profesionit hiqet perfundimisht. Kur denimi eshte nen 10 vjet, kjo e drejte mund te hiqet edhe per nje kohe nga 1 deri ne 5 vjet.

Gjithashtu, Kodi Penal parashikon si denim plotësues edhe **konfiskimin**. Ky denim plotesues ne kodin e meparshem ka qene, por jo i shprehur ne nje menyre te tille. Ky denim plotesues ka te beje me marrjen dhe kalimin ne favor te shtetit te sendeve qe kane sherbyer per kryerjen e veprave penale, te cdo pasurie qe rrjedh nga vepra penale, si dhe te shperblimit te dhene ose te premtuar per kryerjen e saj. Konfiskimi jepet nga gjykata detyrimisht ndaj personave qe kryejne krime ose kundravajtje penale, p.sh: sendet e kapura nga vepra penale e kontrabandes ose personit te kapur pas kryerjes se nje krimi i konfiskohen armet me te cilat ai e ka kryer kete krim.

Ndalimi per te drejtuar automjete gjendet per here te pare ne nje Kod Penal i shprehur ne menyre te tille. Ne kodin e meparshem ka qene përfshirë tek heqja e profesionit. Ky ndryshim erdhi si pasojë e rritjes shume te madhe te numrit te aksidenteve automobilistike. Ky denim plotesues jepet nga gjykata per nje kohe nga 1 deri ne 5 vjet pas vuajtjes se denimit, kur cmohet se do te kete efekt parandalues si dhe kur pajtohet me natyren e vepres se kryer, p.sh: ne rast te nje aksidenti automobilistik me pasoje vdekjen e personit gjykata vendos heqjen e se drejtes per te drejtuar automjete. Ne rast se gjykata e cmon se rrezikshmeria shoqerore e vepres dhe e autorit si dhe pasojat e vepres se kryer nuk jane te renda, vendos dhenien e ketij denimi edhe si denim kryesor. Por kete gjykata e ben ne qofte se ajo pajtohet me natyren e vepres se kryer, si dhe kur i arrihet qellimit paranalues te denimit.

Heqja e dekoratave dhe titujve te nderit parashikohej edhe nga Kodet Penale te meparshme. Kjo mase denimi merret ndaj personave qe jane denuar me burgim dhe kur gjykata e cmon se mbajtja e tyre nuk pajtohet me natyren e vepres se kryer. Pra, ky denim plotesues jepet si per krime ashtu dhe per kundravajtje penale, mjafton qe vepra te jete denuar me burgim, si dhe kur cmohet se mbajtja e tyre nuk pajtohet me natyren e vepres se kryer. Gjukata eshte e detyruar te vendose heqjen e titujve te nderit dhe dekoratave kur jep nje denim me shume se 10 vjet burgim. Kur fajtori denohet me burgim nen 10 vjet mund te vendoset heqja e titujve te nderit dhe dekoratave,

ne qofte se gjykata cmon se, per shkak te natyres se krimit, i denuari nuk eshte me i denje te mbaje titujt dhe dekoratat qe i jane dhene.

Ndalimi i ushtrimit te veprimtarise ose mjeshterise jepet per nje kohe nga 1 muaj deri ne 5 vjet. Ky eshte nje denim fakultativ. Gjykata ka te drejte te jape nje denim te tille plotesues kur konstaton se personi ka kryer nje krim duke shperdoruar mjeshterine ose profesionin e tij dhe cmon se, per kete shkak, nuk duhet t'i ushtroje per nje fare kohe ne te ardhmen, duke i hequr lejen, deshmine ose licencen. Ndalimi i nje veprimtarie te caktuar, si p.sh: ndalimi per te qene mesues, mjek, infermier, etj, zbatohet si ne rastet kur i denuari ushtron profesionin ne menyre private dhe shteti e ka pajisur me licence ose deshmi, ashtu edhe kur personi punon prane institucioneve shteterore.

Heqja e se drejtes se ushtrimit te detyrave drejtuese u vu si denim plotesues ne Kodin Penal, sepse u pa si nje domosdoshmeri per parandalimin e kryerjes se veprimeve kriminale ne personat juridike. Ky denim plotesues jepet krahas denimit kryesor dhe ka te beje me funksionet e vecanta te fajtorit, si drejtor, administrator, sipermarres, likuidator, pra me funksione drejtuese prane personave juridike. Ky denim plotesues jepet per nje kohe nga 1 muaj deri ne 5 vjet dhe nuk jepet asnjehere per gjithmone. Personi, i cili ka funksionet e mesiperme, ka shperdoruar funksionet e caktuara ose ka vepruar ne kundershtrim me rregullat qe lidhen me nje nga detyrimet qe i ka ngarkuar personi juridik perkates.

Ndalimi per te qendruar ne nje ose disa njesi administrative ka te beje me detyrimin e personit te denuar qe te mos qendroje ne nje vend te caktuar per nje kohe nga 1 deri ne 5 vjet. Kjo mase denimi jepet nga gjykata kur ajo cmon se qendrimi i fajtorit ne nje vend te caktuar eshte shoqerisht i rrezikshem per shkak te lidhjeve, mundesive dhe kushteve qe mund te favorizojne fajtorin te kryeje krime te tjera ose te krijojne kontakte me persona te rrethit te tij kriminal. Ky denim plotesues ngjason me debimin, qe parashikohej nga neni 26 i Kodit Penal te meparshem. Ky denim zakonisht ekzekutohet vullatarisht, ne te kundert ekzekutohet nga organet e rendit publik.

Nxjerrja jashte territorit eshte nje lloj debimi qe u jepet personave me shtetesi te huaj ose pa shtetesi, qe kryejne nje krim dhe kur gjykata cmon se qendrimi i tij ne territorin e RSH-së nuk duhet te vazhdoje ne te ardhmen. Ky denim plotesues jepet ndaj personave me shtetesi te huaj ose pa shtetesi kur ata kane kryer nje veper penale ne teritorin e RSH-së. Neni 7 i Kodit Penal shprehimisht thote shtetasi i huaj qe kryen veper penale ne territorin e RSH-së do te pergjigjet ne baze te ligjit penal te RSH-së. Me te perfunduar denimin e dhene nga gjykata, personi i huaj ose pa shtetesi do te largohet nga territori i RSH-së duke zbatuar keshtu edhe denimin plotesues te dhene nga gjykata. Pra, ky denim jepet vetem ndaj shtetasve te huaj dhe personave pa shtetesi, por, ne momentin qe keta persona marrin shtetesine shqiptare, kjo mase hiqet nga gjykata me kerkesen e te denuarit.

Publikimi i vendimit gjyqesor u vendos per here te pare ne Kodin Penal dhe qellimi i ligjvenesit eshte berja e njohur e permbajtjes se vendimit gjyqesor, per vete interesin e ketij vendimi personave fizike dhe personave juridike. Publikimi behet me shpenzimet e personit te denuar ne shtypin e shkruar ose ne TV, ne daten dhe kohezgjatjen e caktuar prej gjykatës. Ne rast se nga publikimi i vendimit gjyqesor i vijne deme personit ne jeten e tij private dhe kur ai perben sekret

shteteror, ky denim plotesues nuk vendoset nga gjykata. Ky denim plotesues vendoset nga gjykata ne rastin kur ajo e shikon te arsyeshem edhe sensibilizimin e opinionit publik ne lidhje me kete veper te kryer si edhe me autorin e saj, p.sh: ne rastin e perseritesave ose te personave qe merren me vjedhje ne vende publike, xhepisteve, etj.

Humbja e përgjegjësisë prindërore jepet nga gjykata ndaj personit që e ushtron përgjegjësinë prindërore, kur ai dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një veprë penale ndaj fëmijës ose si bashkëpunëtor me fëmijën në kryerjen e një veprë penale.

Neni 44 i Kodit Penal ka percaktuar menyren e vuajtjes se denimeve plotesuese. Ato ndahen ne denime plotesuese qe ekzekutohen ne te njejten kohe me denimin kryesor:

- heqja e dekoratave dhe titujve te nderit;
- konfiskimi i mjeteve te kryerjes se vepres penale;
- nxjerrja jashte territorit;
- heqja e përgjegjësisë prindërore.

dhe denime plotesuese qe ekzekutohen pas ekzekutimit te denimit kryesor:

- ndalimi i se drejtes per te ushtruar detyra si nepunes shteteror ose ne sherbim publik;
- ndalimi per te drejtuar automjete;
- heqja e se drejtes per te ushtruar detyra drejtuese prane personit juridik;
- ndalimi per te qendruar ne nje ose disa njesi administrative.

3.2. Alternativat e dënimit

Në kreun VII, nenet 58, 59, 59/a, 60, 61, 62, 63, 64 dhe 65 të Kodit Penal parashikohen “Alternativat e dënimit me burgim”. Këto alternativa janë njohur në Kodin Penal me miratimin e kodit të ri në vitin 1995. Nisur nga vetë fjalët e përdorura nga ligji, të krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me lloje të reja dënimesh. Por kjo përshtypje është e gabuar. Rastet që parashikojnë nenet e sipërpërmendura nuk janë llojet të reja dënimesh. Në këto raste, dënimi është vetëm një: burgimi. Nenet 59 – 65 të Kodit Penal parashikojnë format apo mënyrat e veçanta të vuajtjes së këtij dënimi.

Këto forma alternative të vuajtjes së dënimit synojnë :

- Shmangien e pasojave të dëmshme e të pariparueshme jo vetëm për të dënuarin por, edhe për komunitetin ku ai jeton;
- Çlirimin e të dënuarit nga vuajtja e dënimit nëse vërtetohen rrethana të caktuara, shumica e të cilave janë të parashikuara nga ligji;
- Edukimin dhe rehabilitimin e të dënuarit;
- Parandalimin e humbjes së cilësive edukuese dhe parandaluese të dënimit;
- Edukimin e shoqërisë;
- Parandalimin e kriminalitetit.

Format e alternativave me burgim janë të përcaktuara shprehimisht nga ligji por nuk janë detyruese për gjykatën. Gjithmonë është gjykata organi që ka kompetencën ekskluzive për të vendosur nëse, i dënuari duhet të vuajë dënimin me burgim jo në formën e tij klasike (izolimi nga shoqëria) por, në një formë tjetër. Sipas Kodit Penal format alternative të vuajtjes së dënimit me burgim janë:

Gjysmëliria (Neni 58 i Kodit Penal)

Gjysmëliria është forma e parë e alternativave të dënimit me burgim e parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, me ligjin e ri nr. 10 023, datë 27.11.2008. Në këtë nen parashikohet se :

“Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri.

Personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata.

Kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet, sipas këtij neni, zbatohet neni 62 i këtij Kodi”.

Nisur nga interpretimi i kësaj dispozite arrijmë në përfundimin se kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen dy kushte:

- Së pari: Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se një vit burgim;
- Së dyti : Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim: i pandehuri ka detyrime për punën, arsimin, kuafikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare, ose për trajtim apo rehabilitim mjekësor.

Këto dy kushte duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë pra, janë kumulative, për ndryshe gjykata nuk mund të aplikojë nenin 58 të Kodit Penal. Sa i përket kushtit të dytë – rrethanë e posaçme, sipas formulimit të nenit 58 të Kodit Penal rezulton se rrethanat e posaçme përfshijnë tre drejtime kryesore:

- detyrime për punën, arsimin, kuafikimin ose aftësimin profesional. Kjo nënkupton faktin që i pandehuri të jetë i angazhuar në një punë, e cila ka rëndësi të madhe jo vetëm për të, por edhe për komunitetin ku ai jeton. P.sh., nëse i pandehuri është mjek në një zonë ku prania e tij është e domosdoshme për të siguruar asistencën e nevojshme mjekësore ndaj komunitetit, apo është specialist i një fushe të caktuar me interes të veçantë për shoqërinë.
- përgjegjësitë thelbësore familjare të të pandehurit. Kjo rrethanë nënkupton faktin se i pandehuri ka nën kujdesin e tij fëmijë të mitur; ka nën kujdesin dhe përgjegjësinë e tij prindërit e tij apo persona të tjerë të paaftë për të punuar; kur i pandehuri është i vetmi person që siguron të ardhurat për jetesë të familjes së tij, apo kur pesha e të ardhurave që sigurohet nga puna e tij është vendimtare për jetesën e familjes së tij.
- nevojën e të pandehurit për trajtim apo rehabilitim mjekësor. Kjo nënkupton faktin se i pandehuri vuan nga një sëmundje e cila nuk mund të kurohet në kushtet e burgut, apo

kushtet e burgimit e vështirësojnë së tepërmi mjekimin e saj; kur i pandehuri është nën një terapi të vazhdueshme kundër varësisë ndaj alkoolit ose lëndëve narkotike dhe izolimi i tij në burg do të passillte ndërprerjen e kësaj terapie dhe për pasojë përkeqësimin e shëndetit të të pandehurit.

Pas identifikimit të rrethanës së posacme, gjykata përcakton kohën në të cilën i dënuari përmbush detyrimin, përgjegjësinë familjare apo trajtimin rehabilitues në liri, si dhe kohën në të cilën duhet të kthehet në institucionin e ekzekutimit të dënimit penal. Periudha kohore brenda së cilës do të përmbushet ky detyrim, përgjegjësi apo trajtim mjekësor do të shqyrtohet nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rëndësisë dhe kompleksitetit të veprimeve që realizojnë këtë detyrim, përgjegjësi apo trajtim mjekësor.

Sipas nenit 58 të Kodit Penal nuk parashikohet një periudhë të përcaktuar me saktësi dhe për pasojë, gjyqtari mund të vendosë lirisht për afatin e përmbushjes së detyrimit, përgjegjësisë apo trajtimit mjekësor, i cili mund të jetë nga disa orë deri në disa ditë. Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi, realizohet nga Shërbimi i Provës, në përputhje me nenet 35, 36 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009. Për këtë arsye, ky shërbim harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e dënimit me “gjysmëliri”.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë (Neni 59 i Kodit Penal)

I njohur ndryshe si “dënimi me kusht”, sipas nenit 59 të Kodit Penal parashikohet se:

“Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë, vjet, mund të urdhëroj, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi.

Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet.

Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit”.

Kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen njëkohësisht dy kushte:

- Së pari: Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se pesë vjet burgim;
- Së dyti: Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim :
 - I pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore;
 - I pandehuri është i mitur apo i moshuar;
 - I pandehuri ka kushte mendore apo shëndetësore të veçanta;

- I pandehuri ka detyrime për punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional;
- I pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familje;
- I pandehuri e ka kryer veprën në kushtet e disa rrethanave lehtësuese;
- I pandehuri ka patur një sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale.

Sa i përket kushtit të dytë – rrethanë e posaçme, edhe sipas formulimit të nenit 59 të Kodit Penal (sikundër parashikohet edhe në nenin 58 të Kodit Penal) rezulton se rrethanat e posaçme përfshijnë tre drejtime kryesore :

- Detyrimin e të dënuarit për punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional;
- përgjegjësitë thelbësore familjare të të dënuarit;
- nevojën e të dënuarit për trajtim apo rehabilitim mjekësor.

Nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal rezulton se këto rrethana janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Për të aplikuar në mënyrë sa më të drejtë nenin 59 të Kodit Penal, gjykata gjatë gjykimit ka për detyrë të identifikojë rrethanat e posaçme të të pandehurit. Nga një interpretim i dispozitave të ndryshuara në Kodin Penal, të cilat bëjnë fjalë për alternativat e dënimit me burgim në harmoni me dispozitat e ligjit nr. 10 024, rezulton se gjykata në përmbushjen e detyrave të saj për identifikimin e rrethanave të posaçme e ka të domosdoshëm mendimin e specializuar të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës. Për rrjedhojë, nëse gjatë gjykimit i pandehuri apo prokurori paraqet një kërkesë për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, gjykata është e detyruar (nëse një raport i tillë nuk është kryer nga Shërbimi i Provës gjatë fazës së hetimeve paraprake) që të thërrasë në gjykim një përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe t'i caktojë si detyrë kryerjen e raportit përkatës, i cili do të identifikojë në mënyrë të specializuar rrethanën e posaçme, të pretenduar nga palët. Gjithashtu, në këtë raport Shërbimi i Provës i sugjeron gjykatës aplikimin e një detyrimi të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal. Ky detyrim duhet të jetë i përshtatshëm me një nga rrethanat e veçanta si më poshtë vijon:

- Rrezikshmërinë e të pandehurit;
- Moshën e të pandehurit;
- Kushtet shëndetësore apo mendore të të pandehurit;
- Mënyrën e jetesës së të pandehurit dhe familjes së tij;
- Nevojën konkrete për rehabilitimin shëndetësor apo trajtimin mjekësor të të pandehurit;
- Nevojën apo detyrimin e të pandehurit për t'u arsimuar;
- Detyrimet apo përgjegjësitë thelbësore të të pandehurit kundrejt familjes apo personave në ngarkim;
- Detyrimet thelbësore të të pandehurit kundrejt punës.

Ky veprim i gjykatës mund të kryhet në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor, qoftë edhe pas paraqitjes së pretendimeve të fundit nga palët. Një veprim i tillë është në përputhje të plotë me nenet 378/5 dhe 367 të Kodit të Procedurës Penale.

Kur aplikohet dënimi me kusht, gjykata mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të vihet në provë për një periudhë nga 18 muaj deri në 5 vjet. Kushti i vënies në provë është që i dënuari të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale gjatë kohës së provës. Nëse gjykata çmon se i dënuari duhet të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, atëherë ajo është e detyruar të urdhërojë të dënuarin të plotësojë një nga detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal.

Nëse këto detyrime nuk plotësohen apo nëse shkelet kushti, gjykata urdhëron sipas rastit:

- zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër alternativ më të rëndë i cili, nuk duhet të jetë revokim i dënimit të parë. Kjo do të thotë që i dënuari të mos e kryejë dënimin me burgim në kushtet e izolimit nga shoqëria, në formën klasike burgim. Nisur nga përmbajtja e dispozitave të Kodit Penal, me dënim më të rëndë do të kuptojmë shtimin e detyrimeve ndaj të dënuarit. Pra, nëse ndaj një të dënuari është vendosur si detyrim p.sh.: mosshoqërimi me persona të dënuar apo bashkëpunëtorë në veprën penale, në varësi të kushteve dhe rrethanave konkrete në të cilat është vënë në zbatim ky dënim, gjykata mund të urdhërojë, p.sh.: edhe detyrimin e të dënuarit për të qëndruar në shtëpinë e tij gjatë natës, apo/dhe detyrimin e të pandehurit të mos frekuentojë lokale ku shërbehen pije alkoolike, etj. Sipas nenit 59 të Kodit Penal dënimi i dhënë mund të zëvendësohet me një tjetër më të rëndë nëse:
 - i dënuari gjatë kohës së provës kryen një veprë penale;
 - i pandehuri gjatë kohës së provës nuk mban kontakte me shërbimin e provës;
 - i dënuari gjatë kohës së provës nuk përmbush një nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, sikundër është urdhëruar nga gjykata.
- zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes. Në këtë rast gjykata vendos të zgjasë kohën e mbikëqyrjes nga Shërbimi i Provës brenda afatit të provës. Nga përmbajtja e nenit 59 nuk rezulton që ligjvënësi të ketë përmendur termin “mbikëqyrje”. Për pasojë, kohë e “mbikëqyrjes” do të kuptohet koha e vënies në provë e të pandehurit nga gjykata ndërsa, togfjalëshi “brenda periudhës së provës”, do të kuptohet periudha e përgjithshme e provës, e parashikuar nga ligjvënësi në nenin 59 të Kodit Penal, e cila është nga 18 muaj deri në 5 vjet. Çdo interpretim tjetër do të ishte i palogjikshëm dhe i pabazuar në ligj. Kështu p.sh.: nëse gjykata në vendimin e saj ka urdhëruar vënien në provë (nën mbikëqyrje) të të pandehurit për një periudhë 18 mujore, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale, nisur nga rrethanat konkrete, gjykata mund të urdhërojë që ky afat prove ose ndryshe afat mbikëqyrjeje, të zgjatet edhe për disa muaj të tjerë, gjithnjë brenda afatit 5 vjeçar. Nëse gjykata vendos zgjatjen e afatit të provës rrjedhimisht do të zgjatet edhe afati i detyrimit të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal, nëse gjykata ka vendosur një detyrim të tillë. Sipas nenit 59 të Kodit Penal, gjykata vendos ndryshimin e vendimit të saj duke zgjatur periudhën e mbikëqyrjes brenda afatit të provës. Kjo masë mund të ndërmerret nga gjykata në rastet kur nga Shërbimi i Provës shihet e nevojshme dhe e domosdoshme zgjatja e detyrimit për shkak se koha e vënë në dispozicion nga gjykata nuk arrin të plotësojë qëllimin për të cilin është vendosur detyrimi nga gjykata. Për shembull, në rastin e një të dënuari, i cili është përdorues i lëndës narkotike dhe gjykata ka caktuar ndaj tij si detyrim – “mjekim ose rehabilitim në një institucion shëndetësor”, parashikuar nga pika 11 i nenit 60 të Kodit Penal. Nëse koha që i nevojitet të dënuarit për t’u rehabilituar është më e madhe se koha që ka përcaktuar

gjykata në vendimin e saj, atëherë me kërkesë të prokurorit (i cili është vënë në lëvizje nga Shërbimi i Provës), gjykata, pasi analizon të gjitha provat mund të vendosë që të zgjasë periudhën e provës apo të mbikëqyrjes sikundër parashikohet në nenin 59 të Kodit Penal. Në këtë rast kërkesa e prokurorit për ndryshimin e vendimit duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm: raportet përkatëse të Shërbimit të Provës; raportet mjekësore që vërtetojnë nevojën e të dënuarit për të vazhduar terapinë rehabilituese, etj. Prokuroria është e detyruar që kërkesën e saj t'a shoqërojë edhe me dokumentacionin përkatës, i cili do t'i nënshtrohet më pas shqyrtimit gjyqësor mbi bazën e parimit të kontradiktorialitetit. Në rast të kundërt, gjykata duhet të vendosë rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova. Ndërkohë që në praktikë është vërejtur fenomeni që prokuroria paraqet kërkesën të shoqëruar me prova duke i kërkuar gjykatës të marrë provat e nevojshme nga Shërbimi i Provës. Kjo është një praktikë e gabuar dhe e pabazuar në parimet e një gjykimi akuzator. Të vetmet prova që mund të marrë gjykata janë ato që mund të paraqiten nga i dënuari për të kundërshtuar tërësisht apo pjesërisht kërkesën e prokurorit.

- revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit dhe dërgimin e të dënuarit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale (I.E.V.P.). Ky lloj vendimi është masa më ekstreme që gjykata është e detyruar të marrë ndaj të dënuarit nën mbikëqyrje, për shkak se asnjë nga masat e mësipërme nuk rezulton efikase për të garantuar: a) të drejtën e të dënuarit; b) të drejtën e të dëmtuarit, dhe c) interesin e shoqërisë. Pra, kjo masë do të aplikohet kur është e pamundur që dënimi alternativ të arrijë qëllimin e tij edukues për shkak të sjelljes shumë të keqe apo/dhe rrezikshmërisë shoqërore të lartë të të dënuarit. Sipas nenit 59 të Kodit Penal dënimi i dhënë mund të revokohet tërësisht apo pjesërisht duke dërguar të dënuarin në I.E.V.P. për vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit me burgim. Sikundër thamë më sipër, kjo është masa më e rëndë që mund të marrë gjykata edhe sipas nenit 62 të Kodit Penal. Sipas nenit 59 dhe 62 të Kodit Penal rastet e revokimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim janë :
 - I dënuari gjatë kohës së provës nuk përmbush në mënyrë të përsëritur detyrimet e vendosura nga gjykata;
 - I dënuari në mënyrë të përsëritur nuk mban kontakte me shërbimin e provës;
 - I dënuari kryen një vepër tjetër penale.

Sikundër shihet edhe nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal, ligjvënësi ka dëshiruar që ndryshimi i vendimit të mëparshëm nga gjykata të bëhet në mënyrë graduale, në përputhje me shkallën e moszbatimit nga i dënuari të detyrimeve të vendosura në vendimin e dhënë më parë nga gjykata. Për këtë arsye, në rast të kërkesës së prokurorit për ndryshimin e vendimit, gjykata duhet të vlerësojë: së pari, nëse ekzistojnë kushtet e zëvendësimit; së dyti, nëse ekzistojnë kushtet e zgjatjes së afatit të mbikëqyrjes dhe së treti, si masë më ekstreme të vendosë ndryshimin e vendimit, duke bërë revokimin e tij – urdhërimin e dërgimit të të dënuarit në I.E.V.P.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi, realizohet nga Shërbimi i Provës, në përputhje me nenet 37–44 të VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009. Për këtë arsye, ky shërbim harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, i cili ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit. Një ndër detyrat e Shërbimit të Provës është edhe inkurajimi dhe mbështetja e të dënuarit të vënë në provë për

përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga gjykata në vendimin e saj. Gjithashtu, ky shërbim verifikon dhe njofton prokurorin për rregullsinë e përmbushjes së këtyre detyrimeve.

Një çështje e diskutueshme që ka dalë në praktikën gjyqësore është çështja nëse do të aplikohet neni 59 i Kodit Penal edhe për të pandehurit me shtetësi të huaj dhe që kanë vendbanimin e tyre jashtë territorit të Shqipërisë. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë⁸⁷, personat e huaj të cilët nuk janë nënshtetas shqiptarë gëzojnë të njëjtat të drejta me shtetasit shqiptarë. Për pasojë, ata duhet të gëzojnë edhe të drejtën për të kërkuar dhe përfituar nga nenet 58, 59, 59/a, 63 apo 64 të Kodit Penal. Mbikëqyrja e këtyre dënimeve do të realizohet nga Shërbimi i Provës, mbi bazën e përcaktimeve dhe rregullimeve të parashikuara nga Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht”, nga akte të tjera ndërkombëtare dhe neni 60 I VKM nr. 302, datë 25.03.2009.

Gjithashtu, është për t’u diskutuar çështja nëse gjykata është e detyruar që të vendosë ndaj të pandehurit një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal në rastet kur vendos aplikimin e nenit 59 të tij. Një mendim është se duke u bazuar edhe në frymën e përgjithshme që përshkon dispozitat aktuale mbi alternativat me burgim si dhe frymën që përcjell ligjbërësi në ndryshimet e fundit të Kodit Penal dhe ligjeve të tjera të cilat parashikojnë dhe rregullojnë ekzekutimin e dënimit me burgim me qëllim riintegrimin social të të dënuarit, në çdo rast gjykata, kur aplikon nenin 59 të Kodit Penal, si rregull, duhet të urdhërojë të pandehurin të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit (varet nga rrethanat e çështjes). Ky përfundim bazohet në paragrafin e dytë të nenit 59 të Kodit Penal. Megjithatë, sikundër do ta theksojmë edhe më poshtë, duke qenë se sistemi ynë është një sistem i përzier me prirje akuzatore, ka edhe raste përjashtimore kur gjykata nuk ka përse të urdhërojë të pandehurin të përmbushë një nga detyrimet e nenit 60 të Kodit Penal. Për shembull, nëse një i pandehur i moshës mbi 70 vjeç deklarohet fajtor dhe dënohet me kusht për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve”, është e vështirë të gjendet një detyrim të përshtatshëm për t’u përmbushur nga ky i pandehur gjatë kohës së provës.

Gjithsesi, në përfundim mund të thuhet se është gjyqtari që në kushte dhe rrethana të caktuara vendos nëse është e përshtatshme t’i caktojë të dënuarit sipas nenit 59 të Kodit Penal, të përmbushë një nga detyrimet e parashikuara nga neni 60.

Gjykata nuk është e detyruar të shprehet që ky i pandehur (i dënuar), gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, pasi ky kontakt është i detyrueshëm në bazë të ligjit (nenit 61) dhe jo në varësi të të dënuarit apo të gjykatës. Nga ana tjetër mbajtja e kontakteve me Shërbimin e Provës nuk është ndër ato detyrime të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal, por është mënyrë për të kontrolluar përmbushjen e këtyre detyrimeve nga i dënuari. Megjithatë, në shumë vendime gjyqësore shprehet urdhërimi i të dënuarit të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës. Në këtë rast, gjykata nuk ka vepruar në kundërshtim me ligjin

⁸⁷ Neni 16 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 i cili parashikon se: “Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnjë njëjllor edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”.

duke urdhëruar të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, por ka patur si qëllim t'i bëjë të qartë të dënuarit se kontakti me Shërbimin e Provës është i detyrueshëm.

Qëndrimi në shtëpi (Neni 59/a i Kodit Penal)

“Qëndrimi në shtëpi” është një formë e re e vuajtjes së dënimit me burgim, e panjohur më parë në Shqipëri, e parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, shtuar me nenin 2 të ligjit nr. 10 023, datë 27.11.2008. Sipas nenit 59/a të Kodit Penal parashikohet se:

“Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

- a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.
- b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t'u kujdesur për të.
- c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.
- ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.
- d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësiive familjare.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t'u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat shërbimi i provës është dakord.

Në këtë rast gjykata përcakton masat që duhet të marrë shërbimi i provës.

Gjykata revokon qëndrimin në shtëpi dhe e zëvendëson atë me një ndëshkim tjetër, kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, zbatohet neni 62 i këtij Kodi”.

Kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen njëkohësisht dy kushte:

- Së pari: Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se dy vjet burgim, pavarësisht nëse i dënuari është ose jo nën një masë sigurimi arresti / kur të dënuarit i kanë mbetur për të vuajtur jo më shumë se dy vjet burgim, sipas një vendimi të dhënë më parë për një periudhë më të gjatë se dy vjet burgimi;
- Së dyti: Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat e mëposhtme:
 - e pandehura/ e dënuara të jetë shtatzënë ose nënë me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të;
 - i pandehuri/ i dënuari të jetë baba, të ketë përgjegjësi prindërore për fëmijën që jeton me të nën moshën 10 vjeç, kur nëna e fëmijës ka vdekur apo është e pazonja të kujdeset për të;

- i pandehuri/ i dënuari është në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.
- i pandehuri/ i dënuari të jetë mbi 60 vjeç dhe të jetë i paaftë nga ana shëndetësore;
- i pandehuri/ i dënuari të jetë nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, profesionale apo përgjegjësi familjare.

Për të aplikuar në mënyrë sa më të drejtë nenin 59/a të Kodit Penal, gjykata gjatë gjykimit ka për detyrë të identifikojë rrethanën e posaçme që ekziston në jetën e të pandehurit apo të dënuarit. Nga një interpretim i dispozitave të ndryshuara në Kodit Penal, të cilat bëjnë fjalë për alternativat e dënimit me burgim në harmoni me dispozitat e ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008, rezulton se gjykata në përmbushjen e detyrës së saj e ka të domosdoshëm mendimin e specializuar të Shërbimit të Provës. Për rrjedhojë, nëse gjatë gjykimit, i pandehuri/i dënuari apo prokurori paraqet një kërkesë për aplikimin e nenit 59/a, gjykata është e detyruar (nëse një raport i tillë nuk është kryer nga shërbimi i provës gjatë fazës së hetimeve paraprake) që të thërrasë në gjykim një përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe t'i caktojë si detyrë kryerjen e raportit përkatës, i cili do të identifikojë në mënyrë të specializuar rrethanën e posaçme të pretenduar nga palët. Gjithashtu, në këtë raport Shërbimi i Provës i sugjeron gjykatës aplikimin e një detyrimi të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal. Ky detyrim duhet të jetë i përshtatshëm me një nga rrethanat e veçanta dhe t'i shërbejë të pandehurit apo të dënuarit për riintegrimin e tij në shoqëri. Sikundër parashikohet edhe në nenin 59 të Kodit Penal këto rrethana edhe në nenin 59/a të këtij Kodi janë të ngjashme:

- Moshë e të pandehurit/ të dënuarit;
- Kushtet shëndetësore apo mendore të të pandehurit / të të dënuarit;
- Mënyra e jetesës së të pandehurit/ të të dënuarit;
- Detyrimet apo përgjegjësitë thelbësore të të pandehurit / të të dënuarit kundrejt familjes apo personave në ngarkim;
- Nevoja konkrete e të pandehurit/ të dënuarit për rehabilitimin shëndetësor apo trajtimin mjekësor;
- Nevoja apo detyrimi i të pandehurit/ të dënuarit për t'u arsimuar.

Thirrja e Shërbimit të Provës dhe caktimi i detyrës për përgatitjen e raportit nga ky shërbim janë veprime që mund të kryhen nga gjykata në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor, qoftë edhe pas paraqitjes së pretendimeve të fundit nga palët. Një veprim i tillë është në përputhje të plotë me nenet 378/5 dhe 367 të Kodit të Procedurës Penale. Nisur nga formulimi i nenit 59/a arrihet në përfundimin se në qoftë se këto kushte kanë ekzistuar edhe përpara dhënies së vendimit me burgim dhe gjykata nuk ka aplikuar nenin 59/a të Kodit për këtë të pandehur kur ky i fundit apo prokurori e ka kërkuar një dënim të tillë, atëherë ky i pandehur kur merr statusin e të dënuarit nuk mund të përfillojë “qëndrimin në shtëpi” sipas nenit 59/a të Kodit Penal. Pra, nëse i dënuari paraqet një kërkesë për aplikimin ndaj tij të nenit 59/a, gjykata duhet të vendosë rrezimin e kërkesës.

Në rastet kur gjykata pranon kërkesën për aplikimin e nenit 59/a, atëherë gjykata lejon që dënimi me burgim të ekzekutohet jo në një I.E.V.P., por:

- në shtëpinë e të pandehurit/të dënuarit,
- në një banesë tjetër,

- në një qendër të kujdesit dhe shëndetit publik.

Sipas formulimit të nenit 59/a të Kodit Penal dhe dispozitave të posaçme të ligjit “Për ekzekutimin e dënimeve penale”, nr. 10 024, datë 27.11.2008, rezulton se në të tria këto vende të vuajtjes së dënimit, i dënuari është nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës. Është ky shërbim, i cili i paraqet gjykatës raporte të detajuara për nevojat e ndryshme me karakter shëndetësor, profesional, familjar, arsimor, etj. që ka i dënuari, përmbushja e të cilave (nevojave) mund të kërkojnë largimin e tij nga vendbanimi. Në këto raste, pas referimit të fakteve nga i dënuari dhe nga Shërbimi i Provës, dhe marrjes së pëlqimit nga ky shërbim, gjykata mund të lejojë të dënuarin të largohet nga vendbanimi:

- për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare (përmbushja e detyrimeve familjare që lidhen me kujdesin dhe edukimin e fëmijëve, kujdesin ndaj prindërve, kujdesin ndaj personave në ngarkim, etj.);
- për t’u angazhuar në një veprimtari pune;
- për të marrë pjesë në një veprimtari edukuese ose për t’u arsimuar, veçanërisht në rastin e të dënuarve të mitur, ose të atyre nën 21 vjeç (ndjekja e shkollës apo kurseve të tjera profesionale dhe trajnuese);
- për të ndjekur një veprimtari rehabilituese, veçanërisht në rastet e të dënuarve që janë përdorues të lëndëve narkotike.

Pasi merr një nga vendimet e mësipërme, gjykata përcakton edhe masat që duhen marrë nga Shërbimi i Provës. Këto masa kanë të bëjnë me mënyrën e mbikëqyrjes së vendimit të gjykatës nga ana e Shërbimit të Provës.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi realizohet nga shërbimi i provës në përputhje me nenet 45 – 47 të VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009. Për këtë arsye, ky shërbim harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, i cili ka prokurorin për rregullsinë e përmbushjes së këtij vendimi dhe detyrimeve të tjera të vendosura nga gjykata në këtë vendim.

Në praktikë haset edhe një qëndrim tjetër nga ai i shpjeguar më sipër për zbatimin e nenit 59/a të Kodit Penal. Sipas mbështetësve të këtij qëndrimi, rezulton se neni 59/a i Kodit Penal do të aplikohet vetëm në rastet kur gjykata vendos ta deklarojë fajtor të pandehurin dhe ta dënojë atë me burgim deri në dy vjet, ose më shumë se dy vjet por për shkak të vuajtjes së paraburgimit të pandehurit i kanë mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur nga ky dënim i dhënë nga gjykata. Ky qëndrim përjashton aplikimin e nenit 59/a të Kodit Penal për të dënuarit me vendim të formës së prerë, të cilëve u ka mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur dhe që plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara nga neni 59/a i Kodit Penal. Argumenti kryesor ku bazohet ky qëndrim është vendosja e nenit 59/a menjëherë pas nenit 59 të Kodit Penal, pra, një interpretim sistematik i nenit 59/a të Kodit Penal në raport me nenet e tjera që parashikojnë dënimet alternative. Por një qëndrim i tillë është i gabuar dhe bie ndesh me formulimin e nenit 59/a të Kodit Penal. Si përfundim, neni 59/a do të aplikohet edhe për të dënuarit me vendim të formës së prerë, të cilëve u ka mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur dhe që plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara nga neni 59/a i Kodit Penal.

Një çështje tjetër e diskutueshme është ngjashmëria e “qëndrimit në shtëpi” me “lirimin me kusht” e parashikuar nga neni 64 i këtij Kodi. Nisur nga përmbajtja e këtyre dy dispozitave na rezulton se ka ndryshime të mëdha të cilat konsistojnë në:

- Mospërputhjen e masës së dënimit të vuajtur nga përfituesit e “qëndrimit në shtëpi” nga përfituesit e “lirimit me kusht”;
- Arsyet të cilat duhet të paraqesë dhe plotësojë përfituesi i “qëndrimit në shtëpi”;
- faktin e të qenit ose jo përsëritës në krim.

Prandaj, nisur edhe nga këto ndryshime thelbësore përforcohet mendimi se “qëndrimi në shtëpi” pëfitohet si nga të pandehurit, ashtu edhe nga të dënuarit, ndërkohë që lirimi me kusht” pëfitohet vetëm nga të dënuarit.

Sipas parashikimeve që ka bërë ligjvënësi, dënimi i dhënë sipas nenit 59/a i Kodit Penal revokohet nga gjykata kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara nga pikat a), b), c), ç) dhe d) të këtij neni. Më konkretisht, dënimi i dhënë sipas nenit 59/a do të revokohet tërësisht apo pjesërisht ose do të zëvendësohet me një dënim tjetër nëse:

- kalon gjendja e shtatzënisë së të dënuarës;
- fëmija e të dënuarës mbush moshën 10 vjeç;
- fëmija e të dënuarit, të cilit i ka vdekur bashkëshortja apo i është bërë e pazonja, mbush moshën 10 vjeç;
- gjendja shëndetësore e të dënuarit është përmirësuar, nuk është më e rëndë dhe nuk ka rrezik të përsëritet më;
- mundësohet kujdesi shëndetësor i vazhdueshëm brenda burgut;
- i dënuari mbush moshën 21 vjeç pavarësisht se ekzistojnë ende nevojat e dokumentuara shëndetësore, studimore apo përgjegjësitë familjare;
- i dënuari nën 21 vjeç nuk ka më nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore apo përgjegjësi familjare.

Ligjvënësi duhet të kishte parashikuar një moshë më të madhe për fëmijët e të dënuarve, të gjendur në situatat e parashikuara nga pikat a) dhe b) të nenit 59/a të Kodit Penal. Nisur edhe nga mosha e lejuar nga ligji për punë në Republikën e Shqipërisë⁸⁸, mosha e fëmijëve të parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal duhet të ishte më e madhe se 10 vjeç, të paktën 16 vjeç.

Detyrimet të dënuarit të vënë në provë (Neni 60 i Kodit Penal)

Nga formulimi gramatikor i neneve 59, 60 dhe 62 të Kodit Penal kanë lindur interpretime të ndryshme sa i përket çështjes nëse gjykata në rastet kur aplikon një “dënim me kusht” apo një “qëndrim në shtëpi” është ose jo e detyruar të urdhërojë të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës apo gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa nga detyrimet e

⁸⁸ Shih nenin 98 të Kodit të Punës, i cili parashikon se : “Ndalohet marrja në punë e të miturve nën moshën 16 vjeç. Bëjnë përjashtim rastet kur të miturit nga mosha 14 deri në 16 vjeç punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre”.

parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal. Në praktikë po hasen tre qëndrime lidhur me këtë çështje:

- Gjykata nuk është e detyruar të urdhërojë të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe as të përmbushë një ndër detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal;
- Gjykata urdhëron të pandehurin që gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa detyrime të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal, por nuk mund të urdhërojë të pandehurin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës;
- Gjykata urdhëron të pandehurin që gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa detyrime të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal, si dhe urdhëron të pandehurin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës.

Për t'u dhënë një përgjigje të saktë çështjeve të shtruara më sipër duhet të shohim se çfarë parashikojnë konkretisht dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Sipas nenit 60 të tij parashikohet se:

“I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve” të mëposhtme:

1. Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.
2. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.
3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.
4. Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.
5. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.
6. Të mos frekuentojë vende të caktuara.
7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.
8. Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.
9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.
10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.
11. Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.
12. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.

Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre”.

Ndërsa në nenin 61 të Kodit Penal parashikohet se:

“Gjatë kohës së provës i dënuari është i detyruar:

- a) të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;
- b) të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit”.

Nga sa shihet sistemi ynë i dënimeve alternative me burgim është një përzjerje e dy sistemeve botërore të këtyre dënimeve: a) sistemit kontinental, i cili ka parasysh vetëm pezullimin e dënimit me burgim duke i vënë si kusht të vetëm të dënuarit moskryerjen e veprave të tjera penale dhe b) sistemit të mbikëqyrjes, ose i quajtur ndryshe “Probacioni”. Ky sistem ka në thelb të tij nevojën për t’i vendosur të dënuarit një detyrim, i cili do të mbikëqyret edhe nga një person i specializuar, që sipas ligjit penal shqiptar është Shërbimi i Provës.

Nga analiza që i bëhet në tërësi neneve të Kodit Penal që parashikojnë alternativat e dënimeve me burgim dhe ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” na rezulton se sistemi ynë i dënimeve alternative është më shumë i prirur drejt sistemit të mbikëqyrjes (Probacionit – vënie në provë; latinisht - probatio), duke iu larguar sistemit kontinental, por jo të shkëputet tërësisht prej tij. Ky argument bëhet edhe më i besueshëm nga përdorimi i fjalës “mund” në nenin 60 të Kodit Penal (i cili parashikon detyrimet konkrete) si dhe në nenin 59 të këtij Kodi.

Gjykata në vendimin e saj të dënimit me burgim sipas neneve 59 dhe 59/a të Kodit Penal mund të japë një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal në varësi të rrethanave të cilat vërtetohen gjatë gjykimit. Përcaktimi i detyrimit në kuadër të aplikimit të dënimit alternativ synon të përmbushë tre qëllime kryesore:

- Të drejtën e të dënuarit;
- Të drejtën e të dëmtuarit;
- Interesin e shoqërisë⁸⁹.

Sipas renditjes së parashikuar në nenin 60 të Kodit Penal, i dënuari i vënë në provë mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:

- Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional. Ky është një ndër detyrimet që jepen më shpesh nga gjykata. Në dhënien e këtij detyrimi gjykata, si në të gjitha detyrimet e tjera, duhet të bazohet shumë në raportin dënuarit. Por mendimi i Shërbimit të Provës nuk është vendimtar, sikundër pa të drejtë pretendohet nga disa gjyqtarë. Raporti është një provë si të gjitha provat e tjera dhe për pasojë nuk ka vlerë të paracaktuar në procesin gjyqësor. Ky raport do të marrë vlerën e provës me qëllim përdorimin e tij nga gjykata në arsyetimin e vendimit të saj vetëm pasi të jetë debatuar nga palët gjatë shqyrtimit gjyqësor. Detyrimi i parashikuar nga pika 1 e nenit 60 të Kodit Penal jepet zakonisht kur të pandehurit janë moshë të reja dhe të papunë ose kur të pandehurit janë familjarë dhe kanë në ngarkim persona të tjerë.
- Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare. Ky është një lloj detyrimi i cili nuk ka gjetur ende aplikim. Qëllimi i këtij detyrimi është përdorimi i sanksionit penal kundër të dënuarit, me qëllim që ky i fundit të përmbushë detyrimet ndaj personave që ka në ngarkim. Në përcaktimin e masës së këtij detyrimi gjykata duhet të mbajë parasysh raportin mes detyrimeve dhe

⁸⁹ Shih Rregullat e Tokios (Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim), miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

gjendjes social-ekonomike të të pandehurit duke vendosur shfrytëzimin e pagës apo të ardhurave në një proporcion të drejtë me masën e detyrimit financiar të përcaktuar më parë nga një akt tjetër ligjor. Rasti tipik ku mund të gjejë zbatim ky detyrim është kur i dënuari dënohet për kryerjen e veprave penale të “Braktisje e fëmijëve të mitur” apo “Mosdhënies së mjeteve për jetesë” të parashikuara nga nenet 124 dhe 125 të Kodit Penal. Aktualisht në praktikën gjyqësore nuk kemi hasur raste të aplikimit të këtij detyrimi.

- Të riparojë dëmin civil të shkaktuar. Ky detyrim mund të jepet nga gjykata duke urdhëruar të dënuarin të shlyejë në tërësi apo edhe me këste dëmin civil të shkaktuar nga vepra penale. Rrjedhimisht, që të jepet ky detyrim, gjykata duhet të ketë qartësisht të përcaktuar masën e dëmit civil të shkaktuar. Në përcaktimin e kohës dhe mënyrës sesi do të shlyhet ky detyrim, gjykata duhet të udhëhiqet nga një analizë e thellë e gjendjes social-ekonomike të të pandehurit. Për pasojë, gjykatës i del për detyrë që të hetojë për gjendjen social-ekonomike të të pandehurit dhe të mos vendosë apriori këtë detyrim. Aktualisht në praktikën gjyqësore nuk kemi hasur raste të aplikimit të këtij detyrimi.
- Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara. Ky detyrim në pamje të parë rezulton të jetë një mbivendosje me pikën 3 të nenit 30 ose me nenin 37 të Kodit Penal, por në fakt mes tyre ka dallime. Në rastin e parashikuar nga pika 4 e nenit 60 të Kodit Penal, detyrimi nuk mund të ekzistojë i vetëm por jepet së bashku me një dënim alternativ nga ata të parashikuar nga nenet 59 dhe 59/a të Kodit Penal. Ndërsa detyrimi i parashikuar në nenin 37 të Kodit Penal aplikohet si dënim plotësues së bashku me një dënim me burgim, dënim me gjobë apo një dënim alternativ. Por mund të jepet edhe i vetëm nëse gjykata çmon se ekzistojnë kushtet dhe rrethanat. Në këtë rast “ndalimi për të drejtuar automjete” mund të jepet së bashku apo veçmas me dënimin kryesor; nuk ka rëndësi nëse dënimi kryesor është ose jo me burg, me gjobë apo dënim alternativ. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm është edhe periudha e ndalimit për të drejtuar automjete si dhe çasti kur fillon kjo periudhë. Në rastin e parashikuar nga neni 37 i Kodit Penal, periudha gjatë së cilës i dënuari ndalohet të drejtojë automjete është e pavarur nga koha e dënimit me burgim dhe, për më tepër, fillon të ekzekutohet pasi dënimi me burgim ka përfunduar (neni 44 i Kodit Penal). Ndërsa në rastin e “ndalimit për të drejtuar automjete” sipas pikës 4 të nenit 60 të Kodit Penal, kjo periudhë nuk mund të zgjatet tej periudhës për të cilën është pezulluar dënimi me burgim dhe i pandehuri është vënë në provë. Çasti i fillimit të këtij detyrimi është casti kur vendimi i dënimit merr formë të prerë.
- Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari. Ky detyrim është e udhës të zbatohet në rastet kur vepra penale e kryer nga i pandehuri ka lidhje të drejtpërdrejtë me një veprimtari profesionale. Nuk ka rëndësi nëse kjo veprimtari ushtrohet në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme nga i dënuari. Zakonisht ky detyrim ka gjetur zbatim në dënimet e dhëna për shkak të kryerjes së veprave penale të falsifikimit të dokumenteve, shpërdorimit të detyrës, mashtrimit, korrupsionit pasiv të punonjësve privatë apo shtetërorë; në dënimet për vepra penale ushtarake si dezertimi, mosparaqitja apo largimi pa leje nga reparti, etj.
- Të mos frekuentojë vende të caktuara. Ky detyrim ka për qëllim që të ndalojë të pandehurin të frekuentojë në mënyrë të përhershme apo periodike një ambient të caktuar, i cili mund të mbart mundësi potenciale, krijon kushte dhe rrethana të favorshme që i pandehuri të kryejë vepra të tjera penale të njëjta apo të ndryshme nga ajo për të cilën është duke vuajtur dënimin. Këto vende mund të jenë: banesa ku banojnë persona të

dëmtuar nga vepra penale apo të afërm të tyre, në rastet e veprave të kryera kundër jetës apo shëndetit apo mospërmblidhjes së detyrimeve familjare; vendet ku ka një dendësi të madhe personash mund të ndalohen për t'u frekuentuar nga persona të dënuar për vjedhje; vende publike, kinema, stadione, apo vende të tjera ku zhvillohen veprimtari publike me karakter argëtues mund të ndalohen të frekuentohen nga persona të dënuar për vepra penale të "Prishjes së qetësisë publike"; baret e natës, vende ku shërbehen pije alkoolike, etj., vende të ngjashme janë vende të cilat mund t'u ndalohen për t'u frekuentuar nga persona të dënuar për veprën penale të "Prostitucion", "Prodhim dhe shitje narkotikësh", etj.

- Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike. Ky detyrim ka për qëllim që të ndalojë të dënuarin të jetë sërish pjesë e ambienteve që mbartin rrezik potencial për realizimin e veprave penale nga i pandehuri. Në këto ambiente të dënuarit mund të konsumojnë pije të ndryshme alkoolike dhe për pasojë, ekuilibri mendor i tyre mund të ulet, duke u kthyer kështu në rrezik potencial për kryerjen e veprave penale. Gjithashtu, në këto ambiente të dënuarit mund të vihen sërish në kontakt me elementë kriminalë, të cilët mund t'i shtynë këta të dënuar në kryerjen e veprave të reja penale, të njëjta me atë që kanë kryer më parë apo të ndryshme. Zakonisht, ky detyrim aplikohet ndaj personave të mitur, të cilët janë dënuar për vepra penale të tilla si "Prodhim dhe shitje narkotikësh"; "Kundërshtim me dhunë i punonjësve të policisë së rendit publik"; "Prishje e qetësisë publike", etj. Ambientet të cilat u janë ndaluar kësaj kategorie të dënuarish janë kryesisht diskotekat, baret/klubet e natës, baret apo restorante në të cilat shërbehen pije alkoolike, stadiumet, etj...
- Të qëndrojnë në banesën e tij në orare të caktuara. Ka për qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale nga i dënuari. Zakonisht të tilla orare janë ato ku, elementët e sigurisë, kontrolli i policisë apo vëmendja e publikut ndaj sjelljeve kriminale është më e ulët në krahasim me orare të tjera. Të tilla orare mund t'i ofrojnë të dënuarit kushte të favorshme për të kryer vepra penale, pasi i dënuari nuk ka frikë se veprimet e tij mund të diktohen apo të hasin në rezistencën e personave të tjerë. P.sh: personat që shkaktojnë probleme të rendit publik nëpër stadione mund të detyrohen nga gjykata të qëndrojnë në shtëpitë e tyre gjatë kohës që zhvillohet ky aktivitet; të miturit apo përdoruesit e lëndëve narkotike mund të detyrohen të qëndrojnë në shtëpitë e tyre gjatë natës; apo mund të detyrohen që të mos frekuentojnë në orare të caktuara, kryesisht natën, vende të tilla si bare, diskoteka apo vende ku shërbehen pije alkoolike. Në këtë mënyrë, në dhënien e vendimit nga gjykata ndërthuren disa detyrime nga ato të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal.
- Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale. Edhe ky dënim mundëson parandalimin e kryerjes së veprave të tjera nga i pandehuri si dhe rehabilitimin e tij. Duke qëndruar larg ndikimit negativ të këtyre personave, të cilët kanë sjellje devijante dhe mund të rrezikojnë përfshirjen e të dënuarit sërish në kryerjen e veprave penale, rritet mundësia që i pandehuri të mos kryejë në të ardhmen vepra penale. Gjithashtu, rritet mundësia që i dënuari të integrohet në shoqëri.
- Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë. Në pamje të parë kjo dispozitë duket sikur është mbivendosje e neneve 278 dhe 279 të Kodit Penal, i cili parashikon veprën penale të "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake" dhe "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të ftohta". Por në fakt nuk është kështu. Kuptimi i saj është krejt tjetër. Është e vërtetë se mbajtja, zotërimi apo përdorimi i armëve pa lejen pa lejen e posaçme nga organi kompetent është si rregull vepër penale. Por ka edhe raste të tjera përjashtimore

kur persona të caktuar në situata të caktuara mund të lejohen të mbajnë, zotërojnë apo përdorin armë (veçanërisht bëhet fjalë për armët e zjarrit). Për pasojë, detyrimi i parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal do të zbatohet vetëm ndaj kësaj kategorie personash, të cilët janë të pajisur me leje të posaçme për mbajtjen e armëve, ose që i mbajnë këto armë për shkak të detyrës që kryejnë dhe që kanë kryer vepra penale duke përdorur armët e dhëna me leje ose që i mbajnë për shkak të detyrës që kryejnë. Të tillë persona janë ushtarakët, gjyqtarët, policët, rojet, gjahtarët, etj., p.sh., kur një gjahtar, punonjës policie apo i një shoqërie sigurimi dënohet për “Prishje të rendit publik” duke përdorur armën, ose kanos një person tjetër me armën e punës, etj.

- Mjekimi apo rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit mjekësor apo rehabilitues. Ky detyrim është i nevojshëm, madje i domosdoshëm të jepet nga gjykata në rastet kur i dënuari është përdorues i lëndëve narkotike apo alkoolit. Ky është një nga llojet e detyrimeve që është aplikuar gjerësisht nga gjykatat në Shqipëri.
- Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose i drogës. Ky detyrim rekomandohet të jepet nga gjykata në rastin e dënimit të personave përdorues të rregullt të lëndëve narkotike ose/dhe alkoolit. Një çështje që shtrohet për diskutim në rrethet akademike dhe gjyqësore është edhe çështja: A mund të japë gjykata një detyrim tjetër nga detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal? Sipas formulimit aktual të ligjit penal shqiptar rezultojnë se detyrimet e nenit 60 të Kodit Penal janë shteruese dhe jo indikative. Kjo do të thotë se gjykata nuk mundet t’i caktojë të dënuarit një detyrim tjetër nga ato të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal. Gjykata është e lirë t’i caktojë më shumë se një nga këto detyrime por asnjëherë një detyrim tjetër, i cili nuk është i parashikuar shprehimisht në nenin 60 të Kodit Penal.

Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës (Neni 62 i Kodit Penal)

Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës kryen një vepër tjetër penale apo shkel detyrimet ose kushtet e caktuara nga gjykata, hyn në fuqi dhe aplikohet neni 62 i Kodit Penal. Sipas nenit 62 të Kodit Penal parashikohet se:

“Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht apo pjesërisht, vendimin e pezullimit.

Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit.

Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit.

Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg”.

Nga formulimi i nenit 62 rezultojnë se ky nen aplikohet në dy situata;

1. i dënuari, gjatë afatit të provës kryen një vepër tjetër penale.
2. i dënuari gjatë afatit të provës shkel kushtet apo detyrimet që i janë vendosur nga gjykata.

Nisur nga këto dy situata, ky nen parashikon aplikimin e tij nga:

1. Prokurori. Prokurori ndërhyt dhe aplikon nenin 62 të Kodit Penal gjatë fazës së ekzekutimit (gjatë kohës së provës), nëse i dënuari i vënë në provë, gjatë kohës së provës shkel detyrimet që i janë vendosur nga gjykata. Në këtë rast, prokurori ka të drejtë t'i bëjë vetëm një paralajmërim të dënuarit, i cili vendoset në dosjen e të dënuarit. Sipas nenit 62 të Kodit Penal, Shërbimi i Provës ka një rol kryesor në identifikimin dhe raportimin e sjelljes së të dënuarit tek prokurori, nëse ajo është në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga gjykata.

2. Gjkata. Gjkata aplikon nenin 62 të Kodit Penal nëse i dënuari:

- gjatë kohës së provës kryen një vepër tjetër penale;
- gjatë kohës së provës kryen një shkelje të rëndë apo të përsëritur të detyrimeve apo kushteve të vendosura në vendimin e dënimit.

Në të dyja këto raste, gjykata investohet vetëm në bazë të një kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të vendit të vuajtjes së dënimit nga i dënuari. Në vendimin e saj gjykata ka të drejtë të vendosë:

- ndryshimin e detyrimit të vendosur më parë me një tjetër detyrim. Ky ndryshim do të bëhet i kushtëzuar nga ndryshimi i rrethanave të vuajtjes së dënimit dhe rrethanave në të cilat gjendet i dënuari;
- zëvendësimin e dënimit alternative me një dënim tjetër alternativ. Në këtë rast, gjykata mund të aplikojë, p.sh., në vend të nenit 58 të Kodit Penal nenin 59/a të këtij kodi apo nenin 63 të tij, etj.;
- revokimin tërësisht apo pjesërisht të dënimit alternative me burgim dhe dërgimin e të dënuarit në I.E.V.P. për vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit me burgim. Kjo është masa më e rëndë që mund të marrë gjykata sipas nenit 62 të Kodit Penal. Për pasojë, kjo masë do të aplikohet kur është e pamundur që dënimi të arrijë qëllimin e tij edukues për shkak të sjelljes shumë të keqe apo/dhe rrezikshmërisë shoqërore të lartë të të dënuarit.

Çështja e kompetencës

Sipas formulimit të nenit 470 të Kodit të Procedurës Penal dhe ligjit nr. 8331, datë 16.04.1998, i ndryshuar, "Për ekzekutimin e dënimeve penale", shqyrtimi i kërkesave për revokim apo zëvendësim do të bëhet nga gjykata e vendit ku është duke u ekzekutuar vendimi, me përjashtim të rastit kur, vendimi ekzekutohet në një shtet të huaj. Në këtë rast kompetente do të jetë gjykata që ka dhënë vendimin. Kjo mënyrë do të sjellë një ndjekje më të mirë të ekzekutimit të dënimit alternativ, si një kosto të ulët të proceseve gjyqësore.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik (Neni 63 i Kodit Penal)

Kjo është një formë tjetër alternative e vuajtjes së dënimit me burgim. Sipas nenit 63 të

Kodit Penal parashikohet se:

“Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së paket të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore.

Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.

Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën. Gjykata, në këtë rast, vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi”.

Kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen dy kushte:

- Së pari: Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se një vit burgim;
- Së dyti: Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se rrezikshmëria shoqërore e personit që ka kryer veprën penale dhe e rrethanave të kryerjes së kësaj vepre penale është e pakët.

Ky dënim ka një veçanti: nuk mund të jepet nga Gjykata nëse i dënuari nuk e dëshiron. Puna në interes publik konsiston në kryerjen e një pune pa shpërblim, në favor të interesit publik, të komunitetit ku banon i dënuari apo më gjerë. Kjo punë mund të kryhet në një institucion publik apo në një shoqatë të përcaktuar në vendimin e gjykatës. Kohëzgjatja e saj është nga 40 deri në 240 orë dhe duhet të kryhet nga i dënuari brenda një afati prej 6 muajsh.

Neni 63 i Kodit Penal parashikon edhe mënyrën e vuajtjes së këtij dënimi, duke mbajtur parasysh detyrimet familjare të të dënuarit; interesat dhe aftësitë e tij, etj. Në çdo rast koha ditore e punës nuk mund t’i kalojë 8 orë në ditë.

Edhe ky dënim do të revokohet apo do të zëvendësohet nëse i dënuari nuk i përmbahet kushteve të përcaktuara nga gjykata në vendimin e dënimit. Për revokimin apo zëvendësimin e këtij dënimi do të zbatohen të njëjtat rregulla që janë përshkruar më sipër, si në rastin e neneve 58, 59 e 59/a të Kodit Penal.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi realizohet nga Shërbimi i Provës, në përputhje me nenet 48 – 55 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009. Për këtë arsye, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të

gjykatës. Gjithashtu, Shërbimi i Provës verifikon dhe njofton prokurorin për rregullsinë e përmbushjes së këtij vendimi dhe detyrimeve të tjera të vendosura nga gjykata në këtë vendim.

Lirimi me kusht (Neni 64 i Kodit Penal)

Në Kreun VII të Kodit Penal, në nenin 64 të këtij Kodi është parashikuar si një alternativë dënimi edhe lirimi me kusht. Kjo dispozitë ka pësuar në përmbajtjen e saj ndryshime me ligjet nr. 8733, datë 24.01.2001 dhe nr. 10 023, datë 27.11.2008. Në ndryshim nga alternativat e tjera, kjo alternativë dënimi si dhe alternativa e qëndrimit në shtëpi (neni 59/a i Kodit Penal) mund të jepen në fazën e ekzekutimit të dënimit. Kjo do të thotë që nëse plotësohen kriteret ligjore të këtyre dispozitave, shtetasit e dënuar mund t'i drejtohen gjykatës së vendit të vuajtjes së dënimit me kërkesë, duke kërkuar sipas rastit qëndrimin në shtëpi ose lirimin me kusht për pjesën e mbetur të dënimit.

Në përmbajtjen e tij neni 64 i Kodit Penal, i emërtuar lirimi me kusht, parashikon se:

“I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në tridhjetë e pesë vjet burgim;

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.

Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve”.

Praktika gjyqësore në lidhje me lirimet me kusht është e pasur për ato gjykata që kanë në juridiksionin e tyre institucione të ekzekutimit të vendimeve penale. Për pasojë edhe problematikat e ndeshura gjatë aplikimit të nenit 64 të Kodit Penal janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Ajo që është vënë re gjatë praktikës është pikërisht fakti se nocioni “arsye e veçantë” nuk mbahet parasysh në çdo rast. Praktikienët dhe studiuesit e së drejtës që nuk mbajnë parasysh këtë nocion mjaftohen vetëm me plotësimin e kushteve të tjera. Nga ana tjetër, konstatohet se ka një grup tjetër praktikienësh dhe studiuesish, të cilët mbajnë parasysh në analizat e tyre nocionin “arsye e veçantë”. Këta përkrahës të kësaj ideje i referohen interpretimit literal të dispozitës nga ku rezulton se përcaktohet si një kusht sine qua non (domosdoshmëri) nocioni arsye e veçantë, duke u përdorur terminologjia “vetëm për arsye të veçanta”.

Përkufizimi i “arsyes së veçantë” nuk jepet nga Kodi Penal, por është lënë në çmim të gjykatës. Është gjykata dhe asnjë organ tjetër që vlerëson arsyet e paraqitura nga i dënuari nëse janë apo jo arsye të veçanta, në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal, por në çdo rast sipas formulimit ligjor duhet të ekzistojë një arsye e veçantë. Sipas formulimit të ri të nenit 64 të Kodit Penal janë dhënë në mënyrë indikative dhe jo shteruese, disa raste të cilat konsiderohen si “arsye të veçanta”. Këto raste janë zhvilluar më tej nga praktika gjyqësore shqiptare deri në Kolegjet Penale të Gjykatës

së Lartë. Praktika gjyqësore ka treguar se arsytet e veçanta nuk mund të jenë të njëjta për të dënuar të ndryshëm. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë si “arsyete të veçanta” mund të përmenden: “gjendja e vështirë social-ekonomike e familjes së të dënuarit; gjendja e vështirë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit dhe nevoja e tyre për ndihmë dhe asistencë mjekësore; vdekja apo ikja e familjarëve, nga të cilat lihen pa kujdes fëmijët e të dënuarit apo persona të tjerë që ai mund të ketë në ngarkim etj...”.

Element tjetër i kërkuar nga kjo dispozitë është “sjellja e të dënuarit”. Ky parametër duhet parë në dinamikë për gjithë dënimin e vuajtur nga shtetasi i dënuar. Pasi të vlerësohen të gjitha raportet e sjelljes për këtë periudhë, gjykata më pas duhet të çmojë nëse nga konstatimi i gjithë treguesve të sjelljes arrihet qëllimi për edukimin apo risocializimin e këtij të dënuari ose jo. Në praktikë ka lindur për diskutim fakti kur i dënuari gjatë kohës së vuajtjes së dënimit ka marrë disa masa disiplinore dhe të gjitha këto masa janë parashkruar në kuptim të nenit 54/3 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

Në lidhje me vlerësimin e këtij momenti, në praktikën gjyqësore konstatohen dy shkolla mendimi: Nga njëra anë ka prakticienë të së drejtës të cilët ndajnë mendimin se personi i dënuar do e vuajë ndëshkimin disiplinor për një shkelje administrative të kryer për aq kohë sa ajo nuk është parashkruar. Në këtë logjikë, personit të dënuar nuk mund t’i privohen përfitimet ligjore pafundësisht. Kjo pasi fakti që ligjvënësi ka vënë një periudhë 6 muajore për shuarjen e masës disiplinore, tregon qartazi se qëllimi dhe fryma e ligjit është pikërisht rehabilitimi i të gjithë të dënuarve që vuajnë dënimin me kalimin e afateve ligjore, për t’u legjitimuar në gjykatë për të kërkuar lirin me kusht.

Nga ana tjetër, përkrahësit e shkollës së dytë ndajnë mendimin se pavarësisht faktit se me kalimin e 6 muajve masat disiplinore të dhëna ndaj të dënuarit shuhen, gjykata në vlerësimin e saj të raporteve të vlerësimit të sjelljeve ndaj një të dënuari, të para në dinamikën e saj mund të marrë parasysh edhe masat disiplinore të dhëna një të dënuari. Të gjitha këto vlerësime në kompleks, të cilat krijojnë bindjen subjektive për gjykatën në lidhje me qëndrimin ose jo të këtij të dënuari në I.E.V.P. Sipas këtij mendimi edhe pse një shtetas i dënuar mund të përmbushë të gjitha kushtet ligjore të nenit 64 të Kodit Penal, nëse gjatë qëndrimit në vendin e vuajtjes së dënimit ka kryer një shkelje, ky veprim do merret në konsideratë nga gjykata në vlerësimin e sjelljes së tij, pavarësisht nëse është shuar. Kjo mund të ndikojë negativisht në faktin nëse i është arritur qëllimit për riintegrimin e të dënuarit në shoqëri.

Element tjetër i vlerësimit nga gjykata, i cili duhet të merret në konsideratë përveç parametrin të sjelljes është edhe parametri i punës së të dënuarit, e cila gjithashtu si sjellja duhet parë në funksion të arritjes së qëllimit për edukimin e të dënuarit. Ligjvënësi nuk përdor në parashikimin e këtyre dy parametrave, elementin fakultativ, por kërkon si pjesë të vlerësimit të gjykatës, të të dyjave këtyre parametrave njëkohësisht duke parashikuar nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.

Sipas kësaj fraze të këtij parashikimi ligjor është pikërisht gjykata ajo që krahas vlerësimit të sjelljes së një të dënuari duhet të vlerësojë dhe parametrin e punës së kryer nga i dënuari në institucionin e vuajtjes së dënimit. Ky parameter vlerësohet ashtu si dhe sjellja në dinamikën e

gjithë periudhës së vuajtur të dënimit. Vlerësimi i gjykatës mund të bazohet në raportet dhe vlerësimet e punës që ndodhen në dosjen personale të të dënuarit. Ato mund të jenë raporte të veçanta vetëm mbi vlerësimin e punës, por mundet që të jenë rubrika të veçanta brenda raporteve të vlerësimit të sjelljeve. Në funksion të kryerjes së punëve, të dënuarit përfitojnë edhe ulje dënimi, pikërisht për shkak të kryerjes së punëve në institucion, duhet të merren në analizë nga gjykata gjatë vlerësimit të kriterit “punë”.

Në praktikë ka lindur një diskutim në lidhje me vlerësimin e parametrin punë. Kjo pasi nga njëra anë ligji kërkon që të vlerësohet edhe elementi “punë”, kurse nga ana tjetër ka shumë institucione të ekzekutimit të vendimeve penale që nuk kanë mundësi objektive t’iu ofrojnë punë të gjithë të dënuarve. Kështu për ilustrim po sjellim si shembull një Institucion të ri të Ekzekutimit të Vendimeve Penale siç është ai i Korçës, ku vuajnë dënimin në sigurinë e lartë dhe të zakonshme të këtij institucioni mbi 200 të dënuar.

Gjatë shqyrtimit të kërkesave të të dënuarve që vuajnë dënimin në këtë institucion me objekt lirim me kusht konstatohet se pjesa më e madhe e këtyre të dënuarve kanë bërë kërkesa për punë, por vetëm një pjesë të vogël të tyre u ishte ofruar punë nga institucioni. Kjo pasi vetë kushtet e këtij institucioni nuk mundësojnë për shkaqe objektive që të punësohen të gjithë të dënuarit. Në të tilla kushte, ajo që shtrohet për diskutim të qarqet e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve apo studiuesve të së drejtës është pikërisht fakti se si do vlerësohet elementi “punë” i kërkuar nga ligji në kushtet kur vetë institucionet nuk u ofrojnë këtë mundësi të dënuarve që kërkojnë të punojnë.

Ka një grup studiuesish dhe prakticienësh të së drejtës të cilët janë të mendimit që një i dënuar nuk mund të “penalizohet” me vlerësimin negativ të këtij parametri kur i dënuari ka bërë kërkesë për punë, e cila duhet të jetë e dokumentuar dhe institucioni i vuajtjes së dënimit nuk ka mundësi objektive t’i krijojë kushte për të punuar, pasi mundësitë i ka të kufizuara. Kjo pasi edhe pse ligji këkron vlerësimin e këtij parametri, në këtë rast nuk ka mundësi objektive vlerësimi nga gjykata.

Ajo që mund të jetë objekt vlerësimi është rasti kur i dënuari nuk ka depozituar në institucion kërkesë për punë pavarësisht faktit nëse institucioni e ofron ose jo këtë punë. Kjo pasi mosbërja e kërkesës për punë nga i dënuari mund të interpretohet si një mosshfaqje vullneti dhe dëshirë për të punuar.

Gjithsesi, mënyra sesi është formuluar dispozita në lidhje me këto dy parametra, tregon se vlerësimi duhet të jetë në kompleks dhe jo i veçuar. Ajo që kërkohet nga ligji është fakti se mjafton që nga ky vlerësim i këtyre dy parametrave të marra së bashku të vërtetohet se me pjesën e vuajtur të dënimit nga i dënuari i është arritur plotësisht qëllimit për edukimin e tij.

Një kriter tjetër ligjor, i cili kërkohet nga ligji në aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal është pikërisht dhe vuajtja e një periudhe të caktuar të dënimit, i cili duhet të jetë kohë efektive dhe se varian:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në tridhjetë e pesë vjet burgim.

Në praktikë kanë lindur dy grupe mendimesh në lidhje me mënyrën e realizimit të këtij kushti. Njëra shkollë mendimi në analizën e nocionit “masë” i referohet vetëm dënimit të dhënë, p.sh., nëse dënimi është nën 5 vjet do llogaritet 2/3 dhe nëse është mbi 5 vjet do llogaritet me 3/4. Vlen për t’u theksuar se këtë mendim e kanë një pjesë e vogël e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Nga ana tjetër, përkrahësit e shkollës së dytë të mendimit përkrahin idenë se nisur nga interpretimi literal, logjik, por edhe teologjik i kësaj pjese të dispozitës për të përcaktuar se me çfarë kriteri do përllogaritet koha efektive e dënimit të vuajtur, i referohen marzhit të dënimit që parashikon vepra penale për të cilën është akuzuar dhe dënuar shtetasi. Në këtë kuptim, sipas përkrahësve të kësaj ideje, fillimisht shihet marzhi i veprës penale për të përcaktuar më pas nëse përllogaritja do bëhet me 2/3 apo me 3/4. Kështu, nëse personi është dënuar për një vepër penale të përcaktuar si krim, por që ka në maksimum si dënim 5 vjet burgim, shtetasi i dënuar legjitimohet t’i drejtohej gjykatës pasi të kishte vuajtur 2/3 e dënimit të dhënë.

Ajo që mund të jetë objekt diskutimi për përkrahësit e shkollës së parë të mendimit që i referohen nocionit masës së dënimit të dhënë, lind pyetja se sa duhet të ketë vuajtur shtetasi i cili është dënuar për një vepër penale me 5 vjet burgim. Duke qenë se ky kriter është kriteri lidhës, vuajtja e dënimit do llogaritet në këtë rast hipotetik me 2/3 apo me 3/4 e dënimit prej 5 vjetësh.

Problem tjetër i hasur nga praktika gjyqësore është fakti nëse në masën e dënimit të vuajtur nuk do të llogaritet vetëm koha e përfituar me amnisti ose falje, apo edhe koha e fituar për shkak të paraburgimit, të punës ose me vendim gjykate (ulje dënimi sipas nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar). Edhe në lidhje me këtë moment janë shfaqur dy shkolla mendimi.

Përkrahësit e shkollës së parë të mendimit përkrahin idenë se qëllimi i vetë ligjvënësit në parashikimin e kësaj dispozite ka qenë referuar termi “kohë efektive e vuajtur e dënimit”. Si rrjedhim i kësaj, këta përkrahës janë të mendimit se pavarësisht formulimit ligjor, përllogaritja e kohës së dënimit duhet bërë referuar vetëm kohës efektive të vuajtur nga shtetasi duke përjashtuar cdo lloj uljeje apo përfitimi tjetër.

Përkrahësit e shkollës së dytë të mendimit i referohen në mënyrë strikte formulimit ligjor të dispozitës si dhe interpretimit literal të saj. Sipas këtyre përkrahësve nuk do llogaritet në dënimin e vuajtur vetëm koha e përfituar nga i dënuari me amnisti ose falje. Të gjitha uljet e tjera që i dënuari pëëfiton për shkak të ligjit, si llogarotja e paraburgimit, përfitimi i disa ditëve në varësi të kohës së punës, apo uljet që përfitojnë të dënuarit me vendim gjykate të cilat nuk mund të jenë më shumë se 90 ditë në vit për të dënuarit që vuajnë dënimet në burgjet e sigurisë së zakonshme dhe jo më shumë se 45 ditë në vit për të dënuarit që vuajnë dënimet në burgjet e sigurisë së lartë, llogariten në kriterin ligjor të kërkuar për një të dënuar i cili kërkon lirin me kusht.

Po kështu, sipas këtyre përkrahësve edhe pse formulimi i kësaj pjese të dispozitës mund të kishte një mospërputhje me vetë interpretimin logjik të përmbajtjes së dispozitës, pikërisht kjo ka qenë fryma dhe qëllimi i ligjvënësit. Kjo pasi ligjvënësi i kishte pasur të gjitha mundësitë që në

ndryshimet e fundit që i janë bërë kreut mbi alternativat e dënimit me burgim, të kishte përjashtuar nga llogaritja e dënimit edhe përfitimet e tjera të të dënuarve, përveç amnistisë dhe faljes, meqenëse ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 kishte dalë pas parashikimit fillestar të nenit 64 të Kodit Penal.

Në praktikën gjyqësore është shtruar për diskutim gjatë zbatimit të nenit 64 të Kodit Penal nëse gjykatat mund të lirojnë me kusht persona të dënuar më parë për krime të kryera me dashje, por që në momentin e bërjes së kërkesës kanë qenë të rehabilituar. Mënyra sesi është formuluar dispozita tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që të përjashtojë nga ky përfitim ligjor të gjithë të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje, duke ngushtuar sferën e përjashtimit të subjekteve përfitues. Pra, dispozita i referohet nocionit “i dënuar”.

Nga ana tjetër, ligji material penal parashikon në nenin 69 të tij se në cilat raste personat do quhen të padënuar apo të rehabilituar. Në këtë kuptim me kalimin e afateve të përcaktuara në nenin 69 të Kodit Penal, gjendja gjyqësore e personave të dënuar do jetë e bardhë dhe se këta persona humbasin statusin e të dënuarit. Kjo do të thotë se nëse një të dënuari për krime të kryera me dashje:

- I kanë kaluar afatet e rehabilitimit;
- Është duke vuajtur dënimin për një vepër tjetër;
- Plotëson të gjitha kriteret e tjera ligjore të nenit 64 të Kodit Penal;

ai ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për lirimin me kusht.

Nga ana tjetër, ka mendime që për efekt të kësaj dispozite, personat që janë dënuar për krime të kryera me dashje dhe që po vuajnë një dënim për një vepër tjetër edhe pse i përmbushin të gjitha kriteret e tjera ligjore të nenit 64 të Kodit Penal, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo dispozitë.

Nisur nga këto argumente të përkrahësve të këtij mendimi, konstatohet se ligjvënësi nuk bën një ndarje se çfarë dhe kur mund të përfitojë personi i rehabilituar. Kjo pasi e vetmja ndarje ligjore në këndvështrimin penal është në persona të dënuar dhe persona raste të caktuara.

Pra, në këtë këndvështrim vetëm gjatë kohës që do quhen të dënuar për krime të kryera me dashje shtetasit nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga neni 64 i Kodit Penal, kurse për të gjitha rastet e tjera ata nuk kanë asnjë lloj pengese që t’i drejtohen gjykatës dhe të përfitojnë kur plotësohen kur plotësohen dhe kriteret e tjera ligjore.

Neni 64 në emërtimin e tij përdor formulimin “lirimi me kusht”. Nisur nga ky formulim në praktikën gjyqësore ekzistojnë dy grupe studiuesish dhe prakticienësh, të cilët janë të ndarë në mendime në lidhje me faktin se sa do të jetë koha e kushtit. Vetë kjo dispozitë në lidhje me këtë moment nuk bën asnjë parashikim ligjor. Si rrjedhim, janë krijuar dy shkolla mendimi me argumentet përkatëse në lidhje me faktin se sa duhet të jetë kjo kohë kushti.

Referuesit e njëres ide mendojnë se koha e kushtit duhet të jetë sa pjesa e pavuajtur e dënimit për të cilën i dënuari lirohet me vendim gjykate, pra, nëse një person ka vuajtur 3 vjet e gjysmë për një vepër penale për të cilën është dënuar 4 vjet burgim dhe më pas lirohet me kusht, koha e

kushtit sipas këtyre përkrahësve do të jetë vetëm 6 muaj. Pra, përgjithësisht kohëzgjatja e kushtit për këta përkrahës nisur nga kriteri përcaktues që ata përdorin është një kohë relativisht e vogël.

Përkrahësit e idesë së dytë mendojnë dhe mbështesin idenë se koha e kushtit duhet të jetë sa koha (afati) i vënies në provë të personit. Këta përkrahës, duke njehsuar kohën e kushtit me kohën e provës, mendojnë se afati duhet të jetë 18 muaj deri në 5 vjet. Nga ana tjetër, vetë dispozita materiale (neni 64 i Kodit Penal) në asnjë parashikim të përmbajtjes së saj nuk përmend apo referon si kohë kushti kohën e vënies në provë që parashikon neni 59 i Kodit Penal.

Gjithashtu rezulton se ekziston dhe një mendim tjetër doktrinar jo shumë i përhapur sipas të cilit koha e kushtit duhet të jetë sa afati i parashkrimit i veprës penale për të cilën është dënuar shtetasi. Duke qenë se kjo ide i vë të gjithë të dënuarit e liruar me kusht në pozita jo të favorshme, ajo nuk ka gjetur mbështetje në praktikën gjyqësore.

Nga ana tjetër konstatohet se ligjvënësi në nenin 64 të Kodit Penal përdor në formulim termin “gjatë kohës së kushtit”. Duke qenë një parashkrim i tillë, kjo kohë nuk mund të njehsohet me kohën e provës, por do jetë një kohë tjetër. Ky argument përforcohet më tepër edhe nga fakti se dispozita ka pasur ndryshime kohët e fundit dhe nëse ligjvënësi do kishte si qëllim që kjo kohë të ishte e njëjtë me kohën e provës nuk do të kishte asnjë pengesë që ta parashikonte shprehimisht tek kjo dispozitë. Pra, qëllimi i ligjvënësit ka qenë për një kohë tjetër kushti, të ndryshme nga ajo e provës. Ajo që ligjvënësi nuk ka zgjidhur është pikërisht afati i kësaj kohe kushti. Megjithatë, në këtë situatë faktike për oportunitet ligjor, koha e provës do ishte një afat kohe i përshtatshëm që mund të shërbente edhe si afat kushti, deri në një rregullim ligjor të dispozitës.

Një problem tjetër i dalë nga praktika gjyqësore në lidhje me këtë dispozitë është pikërisht fakti nëse personit të liruar me kusht duhet t’i vendosen detyrime apo jo. Nëse i referohemi në mënyrë strikte formulimit të dispozitës, nenit 64 të Kodit Penal, rezulton se ligjvënësi nuk ka parashikuar asnjë lloj detyrimi për gjykatën që t’i caktojë personit të liruar me kusht një ose disa detyrime, ashtu siç parashikon neni 60 dhe 61 i po këtij Kodi, për dënimet e tjera alternative. Nga ana tjetër, ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në nenin 31/6 të tij, konkretisht te tre paragrafët e fundit të tij, ka parashikuar detyrimin e personit të liruar me kusht që t’i raportojë rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirimit me kusht. Ky i dënuar i liruar me kusht ka gjithashtu detyrimin të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës dhe organet vendore të policisë së shtetit në rast se ndryshon vendbanimin, duke dhënë edhe arsyet e këtij ndryshimi. Paragrafi i fundit i kësaj dispozite parashikon dhe të drejtën që ka shërbimi i provës që t’i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht kur ai nuk është në gjendje t’i përmbushë ato. Një parashikim i tillë ligjor tregon se personit të liruar me kusht mund t’i vendosen një ose disa detyrime nga gjykata. Nga ana tjetër, dispozita materiale e Kodit Penal (neni 64) në lidhje me këtë moment është blankete. Po kështu dhe vetë ligji që parashikon nocionin “detyrime ndaj personit të liruar me kusht”, nuk përcakton se cilat janë konkretisht këto detyrime.

Në këtë këndvështrim praktika gjyqësore është shfaqur në dy mënyra. Ka një praktikë gjyqësore ku gjykata në vendimin e saj përcakton dhe një ose disa detyrime që duhet të respektojë personi i liruar me kusht duke argumentuar dhënien e këtyre detyrimeve me faktin se detyrimet e

përcaktuara në nenin 60 dhe 61 të Kodit Penal vlejnë për të gjitha dënimet alternative, përfshirë dhe lirimin me kusht. Po kështu një argument tjetër i përkrahësve të kësaj praktike gjyqësore është dhe fakti që nëse do pranohet si periudhë kushti periudhën e provës, gjykata mund t'i vendosë personit të liruar me kusht një ose disa detyrime sipas rastit, njësoj si personin e vënë në provë, në varësi të rrethanave të çështjes dhe natyrës së veprës së konsumuar.

Nga ana tjetër konstatohet se ka një praktikë të dytë gjyqësore ku gjykatat në aplikimin e lirit me kusht nuk i vënë personit të liruar asnjë detyrim nga ato të parashikuara nga nenet 60 dhe 61 të Kodit Penal. Përkrahësit e kësaj praktike mjaftohen vetëm me urdhërimin e personit të dënuar për lirimin me kusht.

Ka gjithashtu raste nga praktika gjyqësore kur gjykatat në dispozitivin e vendimit përveç faktit që disponojnë në lidhje me lirimin me kusht të personit të dënuar, shprehen edhe për detyrimin që ka personi i dënuar i liruar me kusht që gjatë kohës së kushtit të mos kryejë veprë tjetër penale me dashje.

Nisur nga menyra si është formuluar, por edhe nga interpretimi literal i këtij paragrafi të dispozitës, rezulton se aplikimi i pikërisht këtij paragrafi në praktikë ka hapur diskutime midis juristëve. Kjo pasi ligjvënësi revokon vendimin e lirit me kusht vetëm për të dënuarit e liruar që kanë kryer veprë penale me dashje dhe vetëm kur gjatë kohës së kushtit kryejnë një veprë tjetër penale, po me dashje.

Në këtë këndvështrim ligjvënësi nuk parashikon se si do të veprohet në rastet kur personi i liruar me kusht i dënuar për një veprë me dashje, kryen gjatë kohës së kushtit një veprë penale në pakujdesi apo në rastet kur personi i liruar me kusht për një veprë penale të kryer nga pakujdesia dhe që gjatë kohës së kushtit kryen një veprë penale të kryer me dashje. Duke ju referuar parashikimit ligjor rezulton se në të dyja këto raste, gjykata pasi jep vendim, dënimi ekzekutohet nga i dënuari dhe se pjesa e kushtit për veprën e parë i pushon efektet juridike.

Ajo që konstatohet gjithashtu në lidhje me këtë moment është fakti se dispozita (neni 64) nuk bën ndonjë parashikim ligjor për mënyrën se si veprohet apo për procedurat që duhet të respektojnë subjektet procedurale në rast se janë kushtet për revokimin e dënimit për personin e liruar me kusht, ashtu siç parashikohet për dënimet e tjera alternative në rastet kur shkelen kushtet dhe detyrimet gjatë kohës së provës në nenin 62 të Kodit Penal.

Megjithatë, pavarësisht mungesës së një parashikimi të tillë juristët ndajnë mendimin që procedura e ndjekur duhet të jetë e njëjtë si tek dënimet e tjera alternative. Në këto raste është pikërisht organi i cili merret me mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi, që është shërbimi i provës, i cili në çdo rast njofton organin e prokurorisë, organ i cili kërkon revokimin e vendimit me të cilin është liruar me kusht i dënuari dhe bashkimin e dënimeve midis këtyre dy vendimeve. Nga ana tjetër dhe vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në nenin 31/10 të tij, parashikon procedurat që duhen ndjekur gjatë shqyrtimit të një kërkesë me objekt revokimin e dënimit alternativ.

Ajo që shtrohet për diskutim së pari është fakti se cilat dënime duhet të bashkohen në rastin e revokimit të vendimit të lirit me kusht. Për t'i dhënë një përgjigje kësaj pyetjeje duhet t'u referohemi së pari dispozitave për bashkimin e dënimeve. Referuar përmbajtjes së tyre rezultoi se edhe në rastin objekt studimi gjykata duhet që të bëjë bashkimin e dënimit të mbetur pa vuajtur për të cilin është liruar me kusht personi me dënimin e ri për veprën tjetër penale të kryer pa dashje. Kështu për të ilustruar këtë fakt po paraqesim një shembull për një person që është dënuar për një vepër penale të kryer me dashje dhe lirohet me kusht në momentin që i ka mbetur pa vuajtur dhe 6 muaj burgim dhe gjatë kohës së kushtit kryen po një vepër tjetër me dashje për të cilën dënohet me 5 vjet burgim. Pasi dhe ky vendim të ketë marrë formë të prerë zbatohen dispozitat mbi bashkimin e dënimeve midis 6 muaj burgim dhe 5 vjet burgim, duke iu referuar nenit 56/2 të Kodit Penal.

Ligjvënësi shqiptar, si rregull, lejon lirin me kusht kur përmbushen të gjitha kushtet dhe kriteret e nenit 64 të Kodit Penal, vetëm për të dënuarit me burgim deri në 35 vjet, por nga ana tjetër parashikon edhe përjashtime nga rregulli. Kështu, në nenin 65 të Kodit Penal parashikohet se:

“Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm.

Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur:

Ka vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij”.

Sipas parashikimit ligjor të kësaj dispozite, i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet nga gjykata vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kur plotësohen njëkohësisht tre kushte ligjore, të cilat janë:

- Së pari: Të kishte vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim.
- Së dyti: Gjatë vuajtjes së dënimit të kishte mbajtur sjellje shembullore dhe
- Së treti: Çmohet se në këtë periudhë të vuajtjes së dënimit dhe me këtë sjellje i ishte arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.

Qëllimi i ligjvënësit në këtë rast ka qenë vendosja e kriterëve ligjore tepër të larta për lirin me kusht nisur nga rrezikshmëria e veprës penale dhe e të dënuarve, për shkak të të cilave këta shtetas janë dënuar me burgim të përjetshëm. Përveç faktit që ligjvënësi kërkon vuajtjen e jo më pak se 25 vjet burgim kërkon gjithashtu se gjatë kësaj periudhe dinamika e sjelljes të jetë e vlerësuar shembullore, çka kërkon një disiplinë dhe sjellje tepër pozitive për të dënuarit, të cilat e kategorizojnë rastin si të jashtëzakonshëm. Në këtë këndvështrim, duke qenë kërkesat tepër të larta të ligjit është vështirë praktikisht që të aplikohet një dispozitë e tillë. Kjo pasi do ishte pothuaj hipotetike dhe pothuaj e pamundur që i dënuari të kishte vuajtur mbi 25 vjet burgim dhe se gjatë gjithë periudhës të ishte vlerësuar në mënyrë shembullore.

Në lidhje me aplikimin e nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, e vetmja dispozitë procedurale në Kodin e Procedurës Penale është neni 477 i tij, i cili parashikon se:

“Gjykata e vendit të ekzekutimit vendos për lirimin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirimit me kusht, sipas kriterëve të caktuar në Kodin Penal.

Kërkesa nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë”.

Kjo dispozitë procedurale parashikon si gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesave të lirimit me kusht, gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Po sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, në rast se gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës, një kërkesë e tillë me të njëjtin objekt mund të ngrihet vetëm pasi të kenë kaluar 6 muaj nga dita që vendimi të ketë marrë formë të prerë. Në praktikën gjyqësore është konstatuar fakti se të dënuarit bazuar në të drejtat e tyre, çmojnë se nuk përmbushin për momentin ndonjë kriter ligjor nga ato të nenit 64 të Kodit Penal apo për të ushtruar të drejtën e tyre për të hequr dorë nga gjykimi i kërkesës, duke kërkuar pushimin e gjykimit dhe më pas për ta ushtruar këtë të drejtë në një moment tjetër.

Praktika gjyqësore në lidhje me aplikimin e lirimit me kusht po gjen një përhapje të gjerë. Një gjë e tillë tregon qartë se nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve po kuptohet si duhet qëllimi i kësaj dispozite, duke e bërë të zbatueshme edhe në praktikë. Edhe shtetasit shqiptarë që janë dënuar jashtë shtetit për vepra të ndryshme penale dhe janë transferuar në Shqipëri për të vuajtur dënimin kanë të drejtë të kërkojnë lirimin me kusht nëse plotësojnë kriteret ligjore të nenit 64 të Kodit Penal. Kjo pasi këta shtetas pavarësisht nëse janë dënuar në shtete të ndryshme, nëse e kanë përfunduar procedurën ligjore të njohjes dhe zbatimit të vendimit penal të atij shteti dhe janë transferuar në I.E.V.P-të në Shqipëri, ata përfitojnë njësoj si të gjithë shtetasit e tjerë që vuajnë dënimin në këto institucione, përfshirë dhe lirimin me kusht.

Ajo cka është shtruar për diskutim në praktikën gjyqësore është çështja nëse do të përfitojë lirim me kusht një i dënuar në shtetin shqiptar, por që ka një shtetësi të huaj dhe me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nëse i referohemi Kushtetutës së Shqipërisë, në nenin 16 të saj parashikohet në mënyrë të qartë se personat e huaj që nuk janë shtetas shqiptarë gëzojnë të njëjtat të drejta me shtetasit shqiptarë. Si rrjedhim, ata gëzojnë të njëjtat të drejta si shtetasit shqiptarë, përfshirë dhe të drejtat për të kërkuar aplikimin e dënimeve alternative, qoftë ky dhe lirimi me kusht nëse plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore.

Objekt diskutimi në lidhje me këta shtetas është pikërisht mënyra e mbikëqyrjes së tyre në fazën e ekzekutimit. Rregullimi i mbikëqyrjes së këtyre dënimeve, e veçanërisht i atij të lirimit me kusht, është bërë bazuar në parashikimet e akteve me karakter ndërkombëtar, si edhe VKM nr. 302, datë 25.03.2009. Një akt i tillë ndërkombëtar është dhe Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose liruar me kusht, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000.

Sipas nenit 5 dhe 6 të kësaj Konvente rezulton se shteti që ka dhënë dënimin mund t'i kërkojë shtetit në territorin e të cilit i dënuari ka vendbanimin e tij të zakonshëm që:

- të realizojë vetëm mbikëqyrjen
- të realizojë mbikëqyrjen dhe kur është e nevojshme të bëjë dhe ekzekutimin, dhe
- të realizojë zbatimin e plotë të dënimit.

Në këto raste mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimi i plotë i dënimit përmbushen nga shteti në territorin e të cilit i dënuari (autori i veprës penale) ka caktuar vendbanimin e tij. Si rrjedhim, shteti kërkues dhe shteti i kërkuar informojnë njëri-tjetrin reciprokisht në lidhje me çdo rrethanë që ka të bëjë me përmbushjen e masave të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës në territorin e shtetit të kërkuar.

Sipas përmbajtjes së dispozitave të kësaj Konvente e konkretisht nenit 11/2 të saj, rezulton se masat e mbikëqyrjes që zbatohen nga shteti i kërkuar nuk mundet në asnjë rast të rëndohen nga natyra ose kohëzgjatja e tyre nga çka parashikon shteti kërkues.

Në nenin 27, Konventa parashikon se rruga e zakonshme nëpërmjet së cilës kalon kërkesa por edhe përgjigja e kërkesës është nëpërmjet dy Ministrive të Drejtësisë së shtetit kërkues dhe shtetit të kërkuar. Megjithatë Konventa parashikon që komunikimet e nevojshme mund të bëhen dhe drejtpërdrejt midis autoriteteve të palëve kontraktuese dhe në raste urgjente nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

Po kështu, nga tërësia e dispozitave të kësaj Konvente, e cila është bërë pjesë e rendit juridik të brendshëm të shtetit shqiptar, rezulton në mënyrë të qartë se mbikëqyrja e dënimeve alternative të dhëna nga gjykatat shqiptare për shtetasit e huaj me vendbanim në territorin e një shteti tjetër është plotësisht e realizueshme. Kjo do të thotë që dhënia e dënimeve alternative duhet bërë njësoj jo vetëm për shtetasit shqiptarë por edhe për shtetasit e huaj, mjafton që të plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore të kërkuara nga ligji penal shqiptar.

DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

1. Dënimet kryesore dhe plotësuese

Ligji penal i Kosovës, në nenin 35, parashikon dënimet e mëposhtme:

- Dënimet kryesore:
 - Dënimi me burgim afatgjatë;
 - Dënimi me burgim;
 - Dënimi me gjobë;
- Dënimet alternative:
 - Dënimi me kusht;
 - Gjysmeliria;
- Dënimet plotësuese:
 - Dënimet me të holla;
 - Privimi nga e drejta të jete i zgjedhur;
 - Ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike apo shërbimet publike;
 - Ndalimi i ushtrimit të profesionit, aktivitetit apo detyrave të caktuara;
 - Ndalimi i drejtimit të automjetit motorik;
 - Marrja e patentshoferit;
 - Marrja e sendit;
 - Urdheresa për publikimin e aktgjykimit;
 - Deportimi i të huajve nga territori i Kosovës⁹⁰.

Ligji mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda. Ligji nuk mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një veprë të veçantë penale⁹¹. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetën (21) vjet ose personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore.

Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se tridhjetë (30) ditë e as më tepër se njëzet e pesë (25) vjet. Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe në muaj të plotë, e në rastet kur dënimi është deri në gjashtë (6) muaj, dënimi shqiptohet në ditë të plota⁹².

Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) Euro evropiane (në tekstin e mëtejshëm "EURO"). Dënimi me gjobë nuk mund të tejkalojë njëzet e pesë mijë (25.000) Euro ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë pesëqind mijë (500.000) Euro. Në aktgjykim caktohet afati i pagesës së dënimin me gjobë. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, mirëpo në rrethana të

⁹⁰ Kodi nr. 04/1-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr.19 / 13 korrik 2012, Prishtinë.

⁹¹ Salihu Ismet, "E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme", Prishtinë, 2003.

⁹² Kodi nr. 04/1-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr.19 / 13 korrik 2012, Prishtinë.

arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për një periudhë që nuk tejkalon dy (2) vjet. Aktgjykimi po ashtu duhet të përcaktojë se kur duhet të paguhet këstet dhe duhet të cek se mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3. të këtij neni. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e personit të dënuar, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzet (20) Euro gjobë. Kohëzgjatja e punës në dobi të përgjithshme nuk mund të tejkalojë dyqind e katër dhjetë (240) orë.

Dënimi me gjobë nuk ekzekutohet pas vdekjes së personit të dënuar⁹³.

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar⁹⁴.

Gjykata, me pëlqimin e personit të dënuar, mund të zëvendësojë dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. Nëse e shqipton urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një periudhë të caktuar kohore prej tridhjetë (30) deri në dyqind e katërdhjetë (240) orë pune. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet brenda kohës së caktuar nga gjykata dhe kjo kohë nuk mund të jetë me gjatë se një (1) vit. Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

⁹³ Kodi nr. 04/1-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr.19 / 13 korrik 2012, Prishtinë.

⁹⁴ Salihu Ismet, "E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme", Prishtinë, 2003.

Dënimi plotësues me ndalimin e drejtimit të automjetit ose marrjen e sendit mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht, me vërejtjen gjyqësore ose me lirim nga dënimi.

Gjykata ia heq kryesit të veprës penale të drejtën për tu zgjedhur prej një (1) deri në katër (4) vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku dy (2) vjet burgim.

Kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale. Dëmshpërblimi përfshin vlerën e shpenzimeve që janë të barabarta me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, humbur, dëmtuar apo shkatërruar. Dëmshpërblimi do të urdhërohet gjithashtu edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktima i përjeton si rezultat i veprës penale dhe procedurave hetimore dhe gjyqësore lidhur me atë vepër.

Gjykata ia ndalon kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në pesë (5) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim. Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht.

Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit të veprës penale ushtrimin e profesionit të caktuar, veprimtarisë së pavarur, detyrës menaxhuese apo administrative ose detyrave që janë të lidhura me sistemimin, menaxhimin apo shfrytëzimin e pasurisë në pronësi publike apo mbrojtjen e pasurisë së tillë, nëse ai person e ka keqpërdoruar pozitën e tij, veprimtarinë apo detyrën me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse ka arsye të pritet që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale.

Gjykata e cakton kohëzgjatjen e dënimit të caktuar sipas paragrafit 1. të këtij neni, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se një (1) vit e as më i gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatje të këtij dënimi.

Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të vendosë që ky dënim me kusht të revokohet nëse kryesi nuk e respekton ndalesën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Kryesit të veprës penale, i cili rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia ndalojë drejtimin e automjetit të llojit apo të kategorisë së caktuar. Gjykata cakton kohëzgjatjen e dënimit të urdhëruar sipas paragrafit 1. të këtij neni, kohëzgjatja e të cilit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit e as më e gjatë se pesë (5) vjet, duke llogaritur nga dita kur vendimi merr formën e prerë. Koha e kaluar në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi. Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të vendosë që dënimi i tillë të revokohet nëse kryesi e shkel ndalesën e drejtimit të automjetit. Ky paragraf nuk zbatohet nëse paraqiten rrethana të jashtëzakonshme të cilat kërkojnë nga kryesi që të drejtojë

automjetin. Nëse dënimi nga paragrafi 1. i këtij neni i është shqiptuar personit i cili ka leje të huaj për drejtimin e automjetit, ky dënim do të konsistojë në ndalimin për përdorimin e lejes së huaj në territorin e Republikës së Kosovës.

Kryesit të veprës penale që e rrezikon sigurinë në trafikun publik, gjykata mund t'ia marrë lejen e vozitjes për llojin apo kategorinë e caktuar të automjetit dhe mund t'ia ndalojë kryesit marrjen e lejes së re gjatë periudhës prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Nëse kryesi nuk ka leje të vozitjes, gjykata ia ndalon kryesit marrjen e lejes së vozitjes brenda afatit prej një (1) deri në pesë (5) vjet. Gjykata mund të shqiptojë dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni nëse kryesi ka kryer veprë penale duke shkaktuar lëndim të rëndë trupor apo vdekjen e personit ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e kryesit në trafikun publik është e rrezikshme për sigurinë e trafikut publik për shkak të paaftësisë së tij për drejtimin e sigurt të automjetit.

Leja e vozitjes merret me vendim të formës së prerë të gjykatës. Koha e mbajtur në burg apo në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi. Pas skadimit të afatit të caktuar nga gjykata, kryesi mund ta marrë lejen e re të vozitjes sipas kushteve të përgjithshme të parapara për marrjen e lejes përkatëse të vozitjes.

Sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale do të konfiskohen. Sendet nga paragrafi 1. i këtij neni mund të konfiskohen edhe kur nuk janë pronë e kryesit nëse kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme ose për arsye të moralit, nëse kjo nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë për të marrë nga kryesi kompensimin e çfarëdo dëmi. Me ligj mund të përcaktohet marrja e detyrueshme e sendit.

Gjykata mund të urdhërojë publikimin e aktgjykimit kur çmon se publikimi është në interes të përgjithshëm, të të dëmtuarit ose të personave të tjerë. Urdhri për publikimin e aktgjykimit kërkon që aktgjykimi të publikohet, tërësisht ose pjesërisht, në gazetë apo të transmetohet në radio ose televizion. Publikimi bëhet me shpenzimet e të dënuarit. Data dhe kohëzgjatja e publikimit caktohen nga gjykata. Gazeta, radiostacioni ose stacioni televiziv e publikojnë aktgjykimin të cilin ua ka dërguar gjykata. Publikimi i aktgjykimit nuk urdhërohet nëse publikimi i tillë e rrezikon fshehtësinë zyrtare, privatësinë e personave apo moralin e shoqërisë.

Gjykata mund të urdhërojë dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Kur gjykata vendos për shqiptimin e dënimit nga paragrafi 1. i këtij neni dhe kohëzgjatjen e këtij dënimi, gjykata merr parasysh llojin dhe peshën e veprës penale, motivet e kryerjes së veprës penale dhe lidhjen e kryesit me Republikën e Kosovës. Dënimi nga paragrafi 1. i këtij neni nuk shqiptohet nëse ekzekutimi i dënimit është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Kohëzgjatja e dëbimit llogaritet nga dita kur vendimi gjyqësor merr formën e prerë. Koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

2. Dënimet alternative

Dënimet alternative janë:

- dënimi me kusht;
- gjysmëliria; dhe
- urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:

- urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues; dhe
- urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues⁹⁵.

Qëllimi i **dënimin me kusht** është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimin është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë veprë penale.

Gjykata mund t'ia shqiptojë kryesit dënimin me kusht në përputhje me dispozitat e këtij Kodi. Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar nuk kryen veprë tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit dhe as më e gjatë se pesë (5) vjet. 3. Në dënimin me kusht, gjykata mund të caktojë që dënimi të ekzekutohet, nëse në afatin e caktuar personi i dënuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale, nuk e kompenzon dënimin që e ka shkaktuar me veprë penale ose nuk i përmbush detyrimet e tjera të parapara me dispozitat e këtij Kodi. Gjykata cakton afatin për përmbushjen e këtyre kushteve në kuadër të kohës së verifikimit.

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim ose dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim.

Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet. Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimin. Dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryesit sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni nëse gjykata shqipton dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet, qoftë për një veprë penale ose për disa vepra në bashkim.

Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimin me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimin me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale.

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim ose dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim.

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet.

⁹⁵ Kodi nr. 04/1-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr.19 / 13 korrik 2012, Prishtinë.

Gjykata mund ta revokojë dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim me më pak se dy (2) vjet ose dënimi me gjobë, pasi t'i ketë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera si dhe personit të dënuar dhe sidomos ngjashmëritë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale. Kur revokon dënimin me kusht, gjykata shqipton dënimin unik për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale, në pajtim me nenin 80 të këtij Kodi dhe trajton dënimin e revokuar me kusht si të përcaktuar.

Nëse gjykata nuk e revokon dënimin me kusht, mund ta shqiptojë dënimin me kusht apo dënimin me burgim ose dënimin me gjobë për veprën e re penale. Nëse gjykata shqipton dënim me kusht për veprën e re penale, gjykata zbaton dispozitat e nenit 80 të këtij Kodi për ta shqiptuar dënimin e bashkuar me kusht për veprën penale të kryer më parë dhe për veprën e re penale dhe po ashtu e cakton një periudhë të bashkuar të verifikimit e cila nuk mund të jetë më pak se një (1) vit e as më shumë se pesë (5) vjet, duke filluar prej ditës kur vendimi për dënimin bëhet i plotfuqishëm. Nëse gjykata shqipton dënim me burgim për veprën e re penale, periudha kohore që kalohet në mbajtjen e dënimit me burgim nuk hiqet nga koha e verifikimit e vendosur me dënimin me kusht për veprën penale të kryer më parë.

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me aktgjykim të plotfuqishëm konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër penale tjetër para se të jetë dënuar me kusht dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër penale. Në rastin e këtillë zbatohen dispozitat e paragrafit 3. të nenit 53 të këtij Kodi.

Nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përmbushjen e një apo më shumë kushteve të paraparë me paragrafin 3 të nenit 51 dhe nenin 59 të këtij Kodi dhe personi i dënuar nuk përmbush kushtin apo kushtet brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata mund ta vazhdojë afatin e përmbushjes së kushtit brenda afatit të verifikimit apo mund ta revokojë dënimin me kusht dhe ta ekzekutojë dënimin i cili është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se personi i dënuar nuk ka mund ta përmbushë kushtin për shkaqe të arsyeshme, gjykata e heq përmbushjen e atij kushti ose e zëvendëson atë me një kusht tjetër përkatës të paraparë me ligj.

Dënimi me kusht mund të revokohet gjatë kohës së verifikimit. Nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe kryen vepër penale për të cilën kërkohet revokimi i dënimit me kusht gjatë kohës së verifikimit, mirëpo kjo është konstatuar me aktgjykim të plotfuqishëm vetëm pas skadimit të kohës së verifikimit, dënimi me kusht mund të revokohet jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i kohës së verifikimit. Nëse personi i dënuar brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk e përmbush kushtin e shqiptuar nga gjykata siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 51 dhe nenit 59 të këtij Kodi, gjykata mund të revokojë dënimin me kusht jo më vonë se një (1) vit nga skadimi i kohës për përmbushjen e detyrimit.

Gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata, pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues, konsideron se faktori

kryesor që ka motivuar kryerjen e veprës penale është i lidhur me varësinë e tij nga droga ose alkooli dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale. Gjykata cakton periudhën gjatë së cilës programi për trajtim të detyrueshëm duhet të fillojë dhe të përfundojë. Periudha e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të jetë më pak se tre (3) muaj apo më tepër se dymbëdhjetë (12) muaj.

Programi i trajtimit rehabilitues mbikëqyret nga shërbimi sprovues⁹⁶.

Dënimi konsiderohet se është mbajtur me kryerjen e suksesshme të programit të trajtimit rehabilitues siç kërkohet nga shërbimi sprovues. Nëse personi i dënuar largohet nga programi i trajtimit rehabilitues, nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk i përmbush detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund të zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyj kohëzgjatjen e urdhrin për trajtim ose ta revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimin të caktuar në dënimin me kusht.

Gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e kushteve të shqiptuara nga gjykata arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues.

Kur shqipton dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, gjykata e urdhëron personin e dënuar që të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues. Gjykata, po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e parapara me paragrafin 3. të nenit 51 ose nenit 59 të këtij Kodi. Kohëzgjatja e një kushti të shqiptuar nuk mund të jetë më pak se gjashtë (6) muaj e as më shumë se tre (3) vjet.

Me rastin e zgjedhjes midis detyrimeve të parapara me nenin 59 të këtij Kodi, gjykata në veçanti merr parasysh moshën e personit të dënuar; gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore; mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën; motivet për kryerjen e veprës penale; sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale; sjelljen e tij të kaluar; rrethanat e tij personale dhe ato në lidhje me familjen; dhe rrethanat tjera që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit dhe kohëzgjatjes së mbikëqyrjes.

Nëse personi i dënuar nuk mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 59 të këtij Kodi siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyj kohëzgjatjen e mbikëqyrjes në kuadër të kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.

Dënimi me kusht mund të përfshijë edhe urdhrin për të përmbushur një apo më shumë nga detyrimet e mëposhtme:

- mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor;
- nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;
- vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;

⁹⁶ Ligji Nr. 04/L-149 Për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i Republikës së Kosovës.

- aftësimi profesional në një profesion të caktuar;
- kryerja e aktiviteteve punuese;
- shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave apo pasurisë tjetër për përmbushjen e detyrimeve familjare;
- mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues;
- heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;
- heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara;
- heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar;
- heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve;
- të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;
- të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;
- të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata ose
- të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata.

Gjykata mund t'ia shqiptojë personit të dënuar **dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme** nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dymijepesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar.

Nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë, punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej tridhjetë (30) deri në dyqind e katërdhjetë (240) orë pune. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon një (1) vit. Nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata, po ashtu, mund t'i urdhërojë personit të dënuar të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues ose kryerjen e një apo më shumë prej detyrimeve të parapara me paragrafin 3. të nenit 51 ose me nenin 59 të këtij Kodi. Kohëzgjatja e detyrimit të paraparë me nenin 59 nuk duhet të jetë më e shkurtër se gjashtë (6) muaj ose më e gjatë se sa tri (3) vjet. Neni 58 paragrafi 3. i këtij Kodi zbatohet përshtatshëm për detyrimin e urdhëruar me këtë paragraf. Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, ose e kryen pjesërisht gjykata mund ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin.

Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një (1) ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

Kur shqipton dënimin me burgim deri në një (1) vit, gjykata mund të urdhërojë ekzekutimin e dënimin në **gjysmëliri** për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë esenciale familjare apo nevojën për trajtim mjekësor ose

rehabilitues. Gjatë vuajtjes së dënimit në gjysmëliri, personi i dënuar detyrohet të kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata.

Kur personi i dënuar nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1. i këtij neni, gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg. Kur gjykata urdhëron ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri, ajo po ashtu mund të shqiptojë një apo më shumë nga kushtet e përcaktuara me nenet paragrafin 3. të nenit 51 ose nenin 59 të këtij Kodi.

Konfiskimi është pjesë vitale e procedurës penale bashkëkohore, posaçërisht në kuptim të krimit të organizuar ndërkombëtar, korrupsionit dhe veprave tjera penale të cilat krijojnë pasuri të kundërligjshme për grupe të vogla njerëzish. Neni 69 i Kodit penal urdhëron konfiskimin e “sendeve të përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale”. Kjo është dispozitë e karakterit detyrues, dhe sipas nenit 69 (2) sendet mund të konfiskohen edhe kur nuk janë pronë e kryerësit. Neni 96 përcakton se askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të fituar me vepër penale. Sipas nenit 99, kjo përfshinë personat juridik dhe sipas nenit 97 po ashtu përfshin personat të cilëve iu është transferuar pasuria pa kompensim përkatës. Disa vepra penale, siç është vepra nga neni 215 (dhënia apo marrja e ryshfetit lidhur me votimin) urdhëron konfiskimin e dhuratës apo ryshfetit. Të tjera, siç janë neni 375 (përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm) apo neni 273 (blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e substancave narkotike, psikotropike dhe analogëve) gjithashtu përcaktojnë që sendet të cilat paraqesin rrezik për shoqërinë duhet të konfiskohen.

Kodi i procedurës penale i vë këto masa në praktikë, dhe i jep prokurorit të shtetit mjetet për të identifikuar, sekuestruar dhe konfiskuar sendet dhe dobitë pasurore të fituara në mënyrë të kundërligjshme me vepër penale. Ka tri mënyra për të konfiskuar sendet pas shqyrtimit gjyqësor.

Së pari, nëse ato merren gjatë kontrollit të zbatuar sipas urdhrin të gjykatës, ato i nënshtrohen konfiskimit nëse cekën në aktakuzë. Së dyti, prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjykata që të lëshojë urdhër për sekuestrimin e pasurisë, dhe pastaj nëse ato pasuri cekën në aktakuzë ato mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Së fundmi, prokurori i shtetit mund të ngrijë pasuritë. Ngrirja e pasurive nuk i vë ato pasuri nën kontrollin e shtetit, por vetëm e pengon të pandehurin nga shitja e pasurive apo qasja në llogari bankare. Nëse gjykata pastaj nxjerr urdhër ndalues për pasuritë e ngrira dhe nëse më vonë ato pasuri cekën në aktakuzë, gjithashtu mund të bëhet edhe konfiskimi i tyre. Për më tepër, pasuritë gjithashtu mund të konfiskohen pa gjykim nëse ato cekën në marrëveshjen me shkrim për praninë të fajësisë.

Pas kontrollit të urdhëruar nga gjykata, neni 112 përcakton sendet të cilat mund të konfiskohen, të cilat mund të përfshijnë sende të cilat mund të jenë prova në procedurë penale si dhe sendet të cilat kanë mundësuar kryerjen e veprës penale. Përfshinë edhe pasurinë e cila është dobi pasurore e fituar me vepër penale. Për më tepër, nëse policia gjatë kontrollit mëson për gjësende tjera, sipas nenit 112 (2) prokurori i shtetit mund të urdhërojë që sendet t'i nënshtrohen kufizimit të përkohshëm deri në 5 ditë, derisa gjyqtari i procedurës paraprake të urdhërojë konfiskimin e tyre.

Pasuritë të cilat ngrihen nuk kalojnë në kontrollin e shtetit, por pronari mund të ketë qasje të kufizuar apo mund të mos ketë qasje fare në atë pasuri. Pasuritë të cilat sekuestrohen janë në kontroll të shtetit, por pronari ende nuk ka humbur të drejtat e tij pasurore. Pasuritë e konfiskuara i merren pronarit në mënyrë të përhershme nga gjykata.

Përveç sendeve të gjetura gjatë kontrollit, sipas nenit 112 (3) prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të nxjerr urdhër për sekuestrimin e sendeve, pasurisë, provave apo parave nëse ato sende janë prova të veprës penale, janë përdorur për kryerjen e veprës apo janë dobi pasurore e fituar me vepër penale. Gjësendet vihen nën kontrollin dhe kujdesin e prokurorit të shtetit, i cili këto kompetenca mund t'ia delegojë policisë lidhur me sende të caktuara. Sipas nenit 113, ka disa sende të caktuara të cilat nuk i nënshtrohen sekuestrimit, siç janë komunikimet me shkrim ndërmjet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Sipas nenit 115 dhe 116, procedura për sendet e sekuestruara mund të përfundojë në dy mënyra. Sipas nenit 116 sendet mund t'i kthehen pronarit të tyre, ndërsa sipas nenit 115 sendet mund të konfiskohen në përfundim të shqyrtimit gjyqësor nëse ndërmerren disa procedura të caktuara dhe nëse:

- 1) Sendet janë të cekura në aktakuzë,
- 2) Gjatë shqyrtimit gjyqësor provohet se sendet, pasuria, provat apo paratë janë përdorur në kryerjen e veprës penale apo janë dobi pasurore e fituar me vepër penale; dhe
- 3) Sipas ligjit mund të konfiskohen.

Nëse sendet konfiskohen, ato mund të shfrytëzohen për kompensimin e palëve të dëmtuara apo mund t'i transferohen Qeverisë së Republikës së Kosovës. Disa sende të cilat konsiderohen të rrezikshme mund të shkatërrohen.

Sendet mund të merren gjatë kontrollit apo në pajtim me urdhrin e gjykatës nga neni 112 (3). Sipas neneve 267 deri 273, brenda 60 ditëve nga marrja e sendit prokurori i shtetit mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake urdhërimin e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë. Ky proces rregullohet në nenin 268. Masat e ndryshme për sigurimin e pasurisë përcaktohen në nenin 269 dhe janë në përgjegjësi të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, por gjithashtu mund të përfshijnë mbajtjen në dhoma të dëshmive të policisë. Neni 270 dhe neni 271 i mundësojnë personave të tretë dhe të pandehurit që të kundërshtojnë masën, ndërsa gjykata mund të caktojë shqyrtim sipas nenit 272. Përfundimisht, sipas nenit 273, gjykata mund të urdhëroje masat. Ky proces iu lejon personave të tretë që të mbrojnë të drejtat e tyre pasurore, por pavarësisht nga ajo lejon sekuestrimin e sendit. Brenda 60 ditëve sendet duhet ose t'i kthehen të pandehurit sipas nenit 116 ose të sekuestrohen me masën për sigurimin e pasurisë.

Përveç sekuestrimit, prokurori i shtetit ka mjete të reja për të bërë identifikimin dhe ngrirjen e pasurive. Ndonëse për zbulimin e të dhënave financiare kërkohet urdhër i gjykatës, sipas nenit 91 (3) të Kodit të procedurës penale prokurori i shtetit mund të urdhëroje zbulimin e të dhënave financiare nëse ka dyshim të bazuar se të dhënat financiare do të ishin relevante për procedurën penale e cila zhvillohet për vepër penale nga Kapitulli XXIV, XXV apo XXXIV i Kodit penal. Këta kapituj përfshijnë veprat penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar (Kapitulli XXIV), veprat penale kundër ekonomisë – përfshirë shpëlarjen e parave (Kapitulli XXV) dhe

korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (Kapitulli XXXIV). Gjatë punës së përbashkët me Njësitin e Inteligjencës Financiare, prokurori i shtetit tani ka mjete më fleksibile për sigurimin e shpejtë të të dhënave financiare dhe gjetjen e të gjitha përfitimeve të kundërligjshme.

Me gjetjen e këtyre përfitimeve të kundërligjshme, prokurori i shtetit mund të veprojë shpejtë. Ai jo vetëm që mund të sekuestrojë sendet sipas nenit 115, por në rastet kur prokurori i shtetit është duke hetuar ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 90 ai mund të nxjerr urdhër për ngrirjen e përkohshme të asaj pasurie. Kjo kompetencë buron nga neni 264.

Sipas nenit 264, prokurori i shtetit mund të nxjerr urdhër për ngrirjen e pasurisë me të cilin pengohet shitja, transferimi i pasurisë apo tërheqjeve nga llogaritë bankare. Ky urdhër mund të nxirret vetëm njëherë dhe është i vlefshëm për 72 orë. Sipas nenit 264 (2), prokurori i shtetit duhet të ketë prova me të cilat mbështetet dyshimi i bazuar se pasuria është përdorur në kryerjen e veprës penale, rrjedh nga vepra penale apo është provë e veprës penale. Kjo përfshinë llogaritë apo pasurinë e cila mund t'i takojë apo të mos i takojë të pandehurit. Nëse ka llogari financiare të cilat i takojnë të pandehurit sipas nenit 264 (3), standardi është më i ultë; prokurori i shtetit duhet të provojë vetëm se mund të ketë mjete financiare të cilat janë dobi pasurore e veprës penale apo të cilat janë shfrytëzuar për kryerjen e veprës penale. Në të njëjtën kohë kur prokurori i shtetit nxjerr urdhër për ngrirjen e pasurisë sipas nenit 264, ai duhet t'i paraqesë kërkesë gjyqtares të procedurës paraprake për urdhër ndalues nga neni 265.

Urdhri ndalues është një procedurë ku gjyqtari i procedurës paraprake e shqyrton urdhrin për ngrirje dhe e konfirmon apo e hudh atë. Sipas nenit 265, kërkesa e prokurorit të shtetit duhet të përfshijë:

- Kopjen e urdhrin për ngrirjen e përkohshme të aseteve;
- Përshkrimin e provave të artikulueshme që arsyetojnë urdhrin;
- Përshkrimin e arsyeve që urdhri ndalues të ndalojë shitjen, shkëmbimin apo tërheqjen nga llogaria e asetit të përshkruar; dhe
- Identitetin e të gjithë personave që kanë interes pasuror në asetin e përshkruar, siç përcaktohet në regjistrat kadastral apo regjistrat tjerë qeveritar.

Sipas nenit 265 (3), brenda 72 orëve pas nxjerrjes së urdhrin për ngrirje nga prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake ose e refuzon kërkesën për urdhër ndalues ose nxjerr urdhër ndalues. Urdhri ndalues i nxjerrë nga gjyqtari i procedurës paraprake vlen për 30 ditë dhe duhet të caktojë një shqyrtim brenda 3 javësh. Urdhri ndalues i dërgohet të pandehurit, institucionit përkatës financiar apo palëve, dhe personave tjerë që kanë ndonjë interes në atë pasuri. Sipas nenit 266, në shqyrtimin për konfirmimin e urdhrin ndalues prokurori i shtetit duhet të paraqesë provat apo dëshmitarët në mbështetje të urdhrin ndalues, derisa të tjerët mund të paraqesin argumentet kundër urdhrin ndalues. Sipas nenit 266 (5), gjyqtari i procedurës paraprak nxjerr urdhër për ndalim afatgjatë të pasurisë nëse ka prova të artikulueshme të cilat tregojnë shkak të arsyeshëm për arsyetimin e urdhrin. Gjykata gjithashtu mund të urdhëroje sekuestrimin e pasurisë nëse bindet se urdhri ndalues nuk është i mjaftueshëm për të parandaluar zhvendosjen e pasurisë jashtë Kosovës. Nëse urdhri për ndalim afatgjatë nxirret nga gjyqtari i procedurës paraprake, sipas nenit 266 (10) ky urdhër nuk skadon deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ose deri në

momentin kur gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues urdhëron lirimin e pasurisë për shkak të mospërfshirjes së pasurisë në aktakuzë.

Është me rëndësi jetike që prokurori të cek në aktakuzë çdo ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme apo send i cili i nënshtrohet konfiskimit. Kjo duhet gjithsesi të përfshijë të gjitha sendet e sekuestruara me masat për sigurimin e pasurisë nga neni 273 dhe të gjitha sendet të cilat i janë nënshtuar urdhrimit për ndalim afatgjatë nga neni 266. Nëse sendet nuk ceken në aktakuzë dhe nëse nuk janë subjekt i ndonjë procedure tjetër të konfiskimit, sipas nenit 274 i pandehuri dhe pronarët mund të kërkojnë nga gjykata që të bëjë lirimin e pasurisë. Gjykata mund të refuzojë këtë kërkesë nëse sendet do të shërbejnë si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor apo nëse prokurori i shtetit tregon se sendet do të ceken në aktakuzën që pritet të ngritet.

Pas ngritjes së aktakuzës e cila i cek pasuritë të cilat i nënshtrohen konfiskimit, prokurori i shtetit duhet të paraqesë prova gjatë shqyrtimit gjyqësor për të arsyetuar kërkesën për konfiskim. Me fjalë tjera, ai duhet që të vërtetojë se sendi është përdorur në kryerjen e veprës penale sipas nenit 283 ose që rrjedh si dobi pasurore e fituar me vepër penale. Nenet 275 deri 280 rregullojnë provat dhe procedurat të cilat kërkohen në shqyrtim gjyqësor për të bërë konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Këto përfshijnë nenin 276, i cili përcakton që ndërtesat, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme, sendet dhe mjetet financiare që janë fituar me vepër penale përbëjnë dobi pasurore të veprës penale. Këto gjithashtu përfshijnë edhe ndërtesat, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme apo sendet të cilat janë fituar në mënyrë të tërthortë. Andaj, nëse dobia pasurore e veprës penale përfshinë para të gatshme të përdorura për blerjen e një makine, atëherë makina është dobi pasurore e fituar në mënyrë të tërthortë e cila i nënshtrohet konfiskimit.

Dobia pasurore gjithashtu mund të përfshijë interesit, profitin bruto apo rritjen e vlerës për shkak të këmbimeve të valutës. Neni 277 përcakton që në rast se në llogari bankare ka mjete legjitime të përziera me mjete të cilat janë dobi pasurore e veprës penale, “paratë e pista” gjithnjë shpenzohen të fundit nga llogaria bankare. Pavarësisht nëse kanë mbetur pak para, gjithmonë ka “para të pista” në llogari bankare. Së fundmi, nenet 278-280 mundësojnë konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale e cila gjendet në posedim të palës së tretë.

Sipas nenit 281, nëse aktakuza ngritet për vepër penale të korrupsionit por i pandehuri lirohet nga akuza, ryshfeti nuk mund të kthehet. Nëse gjatë shqyrtimit kryesor prokurori i shtetit provon se dhurata, shpërblym apo dobia është dhënë, gjykata mund të urdhëroje konfiskimin e saj. Po ashtu, disa sende të cilat janë qenësisht të rrezikshme apo të kundërligjshme, siç janë eksplozivët apo narkotikët, automatikisht i nënshtrohen konfiskimit sipas nenit 283. Në fakt, sipas nenit 283 sendi mund të shkatërrohet apo të neutralizohet, por prokurori i shtetit mund të shfrytëzojë fotografitë, testet laboratorike dhe raportet e ekspertimit në shqyrtim gjyqësor. Për disa sende, siç janë narkotikët, një sasi e vogël duhet të ruhet si mostër.

Sipas Kodit të ri të procedurës penale, personi nuk mund të privohet nga posedimi i pasurisë së tij pa pasur prova të mjaftueshme në shqyrtim gjyqësor. Sidoqoftë, nëse në vend të shqyrtimit gjyqësor procedura penale përfundohet me marrëveshje për pranim të fajësisë, marrëveshja me shkrim duhet të përcaktojë në pajtim me nenin 233 (12) përgjegjësinë e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe konfiskimin e pasurive që i nënshtrohen konfiskimit. Andaj, çdo

negocim i marrëveshjes për pranimin e fajësisë duhet të trajtojë çështjen e konfiskimit. Në të ardhmen mund të nxirren edhe ligje për konfiskim të pasurisë në procedurë jashtë asaj penale në rastet kur i pandehuri vdes, arratiset apo ka pasuri të pashpjegueshme.

Në Kodin e ri të procedurës penale ka një procedurë të konfiskimit që është pjesë e rëndësishme e procedurës penale. Sendet që merren gjatë kontrollit apo që merren me urdhër të gjykatës, pas 60 ditësh shqyrtohen nga gjykata dhe më tej kalohet në sekestrim. Në krahasim me Kodin paraprak të procedurës penale, prokurori i shtetit tani ka mjete më të përshtatshme për identifikimin e llogarive bankare në të cilat mund të ketë mjete të paligjshme, dhe ato mjete mund të ngrihen shpejt kur një gjë e tillë është e nevojshme. Nëse aktakuza cek pasuritë, atëherë ka standarde të qarta për të vërtetuar se pasuritë janë përdorur për kryerjen e veprës penale apo janë dobi pasurore e fituar me vepër penale. Gjatë gjithë këtij procesi, duke u nisur nga fakti se prokurori ka mjete më të fuqishme në dispozicionin e tij për të ngrirë, sequestruar dhe konfiskuar pasuritë, ka më shumë mundësi edhe për gjykatën që të shqyrtojë ato kompetenca si dhe për pronarët që të dëgjoen. Megjithatë, në rastet kur prokurori i shtetit ka prova që vërtetojnë lidhjen ndërmjet veprës penale dhe pasurive, Kodi i ri i procedurës penale favorizon konfiskimin e pasurisë së paligjshme.

Në sistemet e mëparshme shqyrtimi kryesor ishte rezultati i pritshëm i çfarëdo hetimi apo aktakuze. Mirëpo, ekzistojnë disa arsye përse prokurori i shtetit apo i pandehuri kërkojnë alternativa, dhe gjykata duhet t'i mbështesë ato *alternativa*. Arsyeja e parë përse prokurori i shtetit kërkon alternativa është avancimi i hetimeve, pasi që marrëveshjet për pranimin e fajësisë mund të rezultojnë në atë që i pandehuri të bëhet dëshmitar bashkëpunues. Në këtë mënyrë, i pandehuri mund të sigurojë prova shtesë kundër personave tjerë të cilët kanë kryer vepra penale dhe në këtë mënyrë të avancojë në hetimet e tij/saj. Ky është mjet i rëndësishëm për hetimet e ndërlikuara, veçanërisht për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Një arsye tjetër për të kërkuar alternativa tjera është mbrojtja e viktimës nga ripërjetimi i asaj nëpër të cilën ka kaluar në gjykatë, gjë që mund të jetë përvojë traumatike dhe e vështirë. Alternativat gjithashtu mund të sigurohen nëse i pandehuri kërkon trajtim në vend të dënimit. Shumë raste mund të përfitojnë nga efikasiteti i gjyqësorit.

Sipas nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale, Prokurori i shtetit fuqizohet për t'i negociuar dhe pranuar marrëveshjet vullnetare me të pandehurin për bashkëpunim apo për pranim të fajësisë. Sipas nenit 229, prokurori i shtetit duhet të marrë në konsideratë dhe të shfrytëzojë alternativat ndaj gjyqimit kurdo që ajo është e duhur dhe në interes të publikut. Këto alternativa përfshijnë diversionin sipas nenit 148, pezullimin e përkohshëm të procedurës sipas nenit 230, dhe negocijimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë sipas nenit 233.

Alternativa e parë, *diversioni*, është vënë në dispozicion me nenin 184 për veprat penale për të cilat dënimi maksimal nuk është më shumë se një vit. Nëse një person nuk ka dënime të mëparshme, prokurori i shtetit dhe gjykata mund të pajtohen që ta pezullojnë procedurën për një vit nëse i pandehuri e bënë kompensim e viktimave, lajmërohet në polici dhe shkon në këshillim, trajtim psikologjik, trajtim nga abuzimi me substanca narkotike, arsimim apo veprime tjera alternative që konsiderohen ë përshtatshme nga gjyqtari i procedurës paraprake. Në një rast të tillë, gjyqtari i procedurës paraprake mund t'i pushojë procedurat penale pas një viti. Kjo alternativë është në dispozicion për personat që mund të kenë më tepër nevojë për intervenim

apo trajtim se sa për ndjekje. Kjo alternativë është përmendur në listën e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit për shkak se është menduar si masë që duhet të përdoret herët në proces si intervenim. Diversioni është i dizajnuar për t'iu dhënë personave që dëshirojnë ta respektojnë ligjin një mundësi për t'i ndihmuar vetës, në vend që ta bartin barrën e të qenit kryerës i veprës penale. Një masë e tillë është në dispozicion për gjyqtarin e procedurës paraprake edhe kur ai intervenim do të kishte efekt pozitiv.

Për veprat penale që janë më të rënda dhe janë të dënueshme me gjobë apo burgim deri tri vite, sipas nenit 230 Prokurori i shtetit e ka mundësinë e **pezullimit të ndjekjes** me pëlqimin e palës së dëmtuar. i pandehuri duhet të zotohet se do të sillt siç është udhëzuar nga prokurori i shtetit dhe se do t'i përmbushë detyrimet e caktuara që pakësojnë ose mënjanojnë pasojat e dëmshme të veprës penale. Kjo alternativë nuk është në dispozicion për rastet e dhunës familjare apo seksuale. Ngjashëm me këtë, sipas nenit 232 prokurori i shtetit mund ta referojë rastin te ndërmjetësuesi i cili mund të bëjë përpjekje për aranzhimin e kompensimit me palën e dëmtuar.

Alternativa më e rëndësishme ndaj gjyqimit është **negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë** sipas nenit 233. Ajo vlen për cilindo të pandehur. i pandehuri mund të bëjë marrëveshje për pranimin e fajësisë në pothuajse cilëndo fazë. Ndryshe nga kodi i mëparshëm, marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të bëhet para ose pas ngritjes së aktakuzës, bile edhe gjatë shqyrtimit kryesor.

Sipas nenit 233(1), i pandehuri dhe prokurori i shtetit mund ta negociojnë marrëveshjen e shkruar mbi pranimin e fajësisë në çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Sipas nenit 233(2) në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë dhe kushtet e pranimit të fajësisë.

Kushtet e pranimit të fajësisë mund të jenë qoftë dënimi më i butë që nuk bie nën minimumin e paraparë me ligj apo minimumet e parapara në nenin 233(7). Ai gjithashtu mund të pajtohet për kushtet tjera që janë në interes të drejtësisë, si lirimi nga dënimi në nenin 234. Neni 233 (3-4) e rregullon procesin kur i pandehuri i fillon negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Neni 233(5) e rregullon procesin kur prokurori i shtetit i fillon negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Neni 233(6) dhe nenet 235-236 e rregullojnë mundësitë për shpalljen e të pandehurit i cili pajtohet që ta pranojë fajësinë si “dëshmitar bashkëpunues”. Në disa raste nuk do të kenë asnjë arsye për ta bërë të pandehurin dëshmitar bashkëpunues, derisa hetimet tjera do të ndihmohen në masë të madhe.

Neni 233(7) nuk e lejon që marrëveshja e shkruar mbi pranimin e fajësisë t'i rekomandojë gjyqtarit dënim më të butë se ajo që parashihet në Kodin Penal. Zbutja e lejuar me ligj varet nga koha e arritjes së marrëveshjes dhe bashkëpunimi i ofruar. Politikat e këtij ligji inkurajojnë që marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të negociohen më herët dhe të rezultojnë në më shumë bashkëpunim.

Nëse i pandehuri dhe prokurori i shtetit lidhin marrëveshje të shkruar mbi pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit kryesor, i pandehuri mund të dënohet më burgim që është i barabartë me 90% e

minimumit të mundshëm të burgimit që parashihet me Kodin Penal. Nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë lidhet para fillimit të shqyrtimit kryesor, i pandehuri mund të dënohet me burgim që është i barabartë me 80% e minimumit të mundshëm të burgimit që parashihet me Kodin Penal.

Mirëpo, nëse i pandehuri është dëshmitar bashkëpunues dhe ofron dëshmi në procedurë penale, ai/ajo mund të dënohet me minimumin prej 60% të burgimit minimal të mundshëm të paraparë me dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Për t'u siguruar që kjo do të ndodhë, palët mund të kërkojnë që t'iu merret dëshmia në mundësinë hetuese të veçantë.

Në marrëveshjet për pranimin e fajësisë ku i pandehuri është dëshmitar bashkëpunues, ndihmojnë në hetimin e fshehtë dhe sigurojnë dëshmi në procedurën penale, i pandehuri mund të dënohet me minimumin prej 40% të minimumit të mundshëm që parashihet me dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Prandaj, nëse i pandehuri pajtohet me rrezikun e pjesëmarrjes në hetimet e fshehta dhe siguron ndihmë të rëndësishme, ai mund të jetë në gjendje që ta zvogëlojë në masë të madhe kohën e burgimit.

Sipas nenit Neni 233 (8 dhe 9), pala e dëmtuar gjithashtu ka të drejtë në kompensim që do të përfshihet në marrëveshjen e shkruar për pranimin e fajësisë dhe të njoftohet për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, përveç kur i pandehuri bëhet dëshmitar bashkëpunues apo merr pjesë në hetim të fshehtë. Gjykata nuk mund të merr pjesë në negociatat mbi pranimin e fajësisë, por sipas nenit 233 (10) mund ta njoftojë të pandehurin dhe prokurorin e shtetit që i kanë deri në tre muaj që ta negociojnë marrëveshjen e shkruar mbi pranimin e fajësisë.

Marrëveshja e shkruar mbi pranimin e fajësisë duhet ta theksojë çdo kusht të marrëveshjes, duhet të nënshkruhet nga kryeprokurori i zyrës përkatëse, avokati mbrojtës dhe i pandehuri, dhe është e detyrueshme për secilën palë. Në mënyrë që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë të pranohet nga gjykata, ajo duhet t'i specifikojë së paku katër gjëra:

- pikat e aktakuzës për të cilat i pandehuri pranon fajësinë;
- nëse i pandehuri pranon të bashkëpunojë;
- të drejtat nga të cilat hiqet dorë;
- (vi) përgjegjësia e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe pasuritë që do të konfiskohen.

Nëse i pandehuri dhe prokurori i shtetit janë pajtuar që gjykatës t'ia propozojnë një minimum dhe maksimum të dënimeve, sipas nenit 233(13), marrëveshja e shkruar mbi pranimin e fajësisë gjithashtu mund të përfshijë një dispozitë që i lejon palët që të ankohen nëse gjykata i shqipton të pandehurit dënim jashtë atij minimumi dhe maksimumi. Në këtë mënyrë, gjykata mund të mos pajtohet me dënimin e përmendur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë, por duhet ta arsyetojë dënimin e shqiptuar në mënyrë që dënimi të mund t'i rezistojë ankimit.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë duhet të paraqitet në gjykatë të hapur, përveç nëse i pandehuri është dëshmitar bashkëpunues dhe janë vendosur masat mbrojtëse. Nëse marrëveshja e shkruar mbi pranimin e fajësisë është negociuar para ngritjes së aktakuzës, aktakuza ngritet së bashku me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar.

Gjykata mund të pranojë apo refuzojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë pas shqyrtimit të mirëfilltë të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe pranimin të saj nga i pandehuri. Sipas nenit 233(18), gjykata duhet ta merr në pyetje të pandehurin, avokatin mbrojtës të tij/saj dhe prokurorin e shtetit, dhe e përcakton nëse:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij;
- pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten
- në aktakuzë, apo me provat materiale për plotësimin e aktakuzës, apo çfarëdo prove tjetër; dhe
- nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253, për hudhjen e aktakuzës.

Nëse i pandehuri bashkëpunon lidhur me marrëveshjen e shkruar mbi pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit duhet të paraqesë kërkesë në gjykatë sipas nenit 236 që i pandehuri të shpallet dëshmitar bashkëpunues. Idealisht, marrëveshja e shkruar mbi pranimin e fajësisë, kërkesa për shpalljen e të pandehurit dëshmitar bashkëpunues, dhe nëse është e përshtatshme edhe aktakuza duhet të parashtrihen në të njëjtën kohë. Gjykata do të mund t'i shqyrtonte që të tria gjatë një shqyrtimi që do të ishte i mbyllur për publikun. Procedurat e atij shqyrtimi do të ishin në bazë të nenit 233, nenit 237 dhe nëse aktakuza nuk është ngritur ende ajo gjithashtu do të shërbente si shqyrtim fillestar. Nëse është e nevojshme gjykata gjithashtu mund ta dëgjojë dëshminë bashkëpunuese sipas mundësisë hetuese të veçantë nga neni 149.

Kodi i ri i Procedurës Penale i ka zgjeruar mundësitë e prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe gjykatës që të merren vesh për zgjidhjen e një rasti penal. Kjo mund të jetë në raste të vogla, ku neni 148 lejon prokurorin e shtetit dhe gjyqtarin që të drejtojnë dikë nga vepra penale në program të trajtimit pa humbur kohë. Kjo është veçanërisht e dobishme sepse Kosova po ekspozohet ndaj përdorimit të drogës gjithnjë e më shumë. Në rastet pak më të mëdha, prokurori i shtetit mund të fillojë pezullimin e përkohshëm të procedurës sipas nenit 230 dhe të kërkojë nga i pandehuri që të bëjë ndërmarrë veprime për kompensimin e dëmit të shkaktuar. Përfundimisht, në të gjitha rastet, i pandehuri dhe prokurori i shtetit mund ta negociojnë marrëveshjen e shkruar për pranimin e fajësisë sipas nenit 233.

Neni 229 e udhëzon prokurorin e shtetit që t'i marrë par sysh dhe t'i shfrytëzojë gjykimet alternative në të gjitha aty raste kur një gjë e tillë është e përshtatshme dhe kur është në interes të përgjithshëm. Gjithashtu, Prokurori i shtetit dhe gjykata duhet t'i marrin parasysh të drejtat e të pandehurit dhe palës së dëmtuar gjatë këtyre gjykimeve alternativave, dhe duhet ta përfshijnë kompensimin dhe konfiskimin e pasurive në rastet kur është nevojshme. Këto gjykime alternative janë të rëndësishme për krijimin e një sistemi të drejtësisë penale që garanton një gjykim të drejtë të rasteve penale, por që e bënë atë me shpejtësinë e duhur për ruajtjen e të drejtave të të gjitha palëve.

DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

1. Dënimet kryesore dhe plotësuese

Përveç dhënies së drejtësië, qëllimi i dënimit penal është:

- Të parandalojë kryerjen e krimeve të tjera nga autori dhe të korrigojë atë;
- Të ushtrojë ndikim edukues, që të mos kryejë krime të tjera⁹⁷.

Dënimet që mund të caktohen kundër personave të deklaruar fajtorë për vepra penale janë:

- Burgim;
- Gjobë,
- Ndalimi për të ushtruar një profesion, aktivitet apo detyrë;
- Ndalimi për të ngarë makina;
- Dëbimi i një të huaji nga vendi;
- Ndalimi për të marrë pjesë në konkurse sportive⁹⁸.

Kodi penal i Maqedonisë nuk e njeh konceptin e dënimit plotësues. Dënimet janë të gjitha kryesore dhe secili prej tyre mund të caktohet më vete ndaj të pandehurit⁹⁹.

Ekzekutimi i sanksioneve penale ka për qëllim risocializimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri dhe përgatitjen e tij për jetë, si dhe për sjellje të përgjegjshme. Ekzekutimi i sanksioneve penale, po ashtu shërben për mbrojtjen e shoqërisë duke parandaluar kryerjen e veprave të tjera penale dhe duke përmbajtur të tjerët nga kryerja e veprave penale.

Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrën e cila siguron trajtimin human dhe respektimin e dinjitetit të secilit individ. Personi i dënuar nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit, apo ndëshkimit çnjerëzor apo degradues. Sanksionet penale ekzekutohen në mënyrë plotësisht të paanshme. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal

⁹⁷ Kambovski.V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje

⁹⁸ Criminal Code (“Official Gazette of the Republic of Macedonia” nos. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 9/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014 and 41/2014). Decisions of the Constitutional Court of the Republic of Macedonia: U. no. 220/2000 dated 30 May 2001, published in the “Official Gazette of the Republic of Macedonia” no. 48/2001; U. no. 210/2001 dated 06 February 2002, published in the “Official Gazette of the Republic of Macedonia” no. 16/2002; U. no. 206/2003 dated 09 June 2004, published in the “Official Gazette of the Republic of Macedonia” no. 40/2004; U. no. 228/2005 dated 05 April 2004, published in the “Official Gazette of the Republic of Macedonia” no. 50/2006. Law on Juvenile Justice (“Official Gazette of the Republic of Macedonia” nos. 87/2007, 103/2008 and 161/2008).

⁹⁹ Criminal Code (“Official Gazette of the Republic of Macedonia” nos. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 9/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014 and 41/2014).

Gjatë ekzekutimit të sanksionit penal gjithmonë respektohen të drejtat e personit të dënuar. Këto të drejta mund të kufizohen vetëm në atë masë që është e domosdoshme për ekzekutimin e sanksionit penal në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ekzekutimi i sanksioneve penale duhet të nxisë sa më shumë që të jetë e mundur pjesëmarrjen e personit të dënuar në risocializimin dhe riintegrimin e tij shoqëror, përmes planifikimit të dënimit dhe planit individual, si dhe bashkëpunimit të shoqërisë në arritjen e qëllimeve të tilla. Qëllimi i risocializimit dhe riintegrit të personit të dënuar në bashkësi, po ashtu duhet të plotësohet përmes nxitjes dhe organizimit të pjesëmarrjes së institucioneve ose të organeve publike dhe private, si dhe të individëve në procesin e riintegrit.

Ekzekutimi i sanksionit penal fillon kur vendimi me të cilin është shqiptuar sanksioni penal e merr formën e prerë dhe nëse për ekzekutimin e tij nuk ka pengesa ligjore. Ekzekutimi i sanksionit penal mund të fillojë edhe para se të marrë formën e prerë vendimi me të cilin shqiptohet sanksioni penal, por vetëm në rastet kur kjo është paraparë shprehimisht me ligj.

Ekzekutimi i sanksionit penal mund të shtyhet dhe të pezullohet sipas kushteve të parapara me ligj.

Personat e dënuar me burgim dhe me burgim të përjetshëm dërgohen në institucione korrektuese për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm, në pajtim me aktin e vendosjes të Ministrit. Përgjithësisht, me lutje të personit të dënuar, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues, për arsye të justifikueshme mund të heq dorë nga akti i vendosjes dhe të ndërroj vendin e ekzekutimit të dënimit. Lidhur me këtë dhe arsyet e ndërrimit duhet të njoftohet me shkrim sa më parë që të jetë e mundur ministri.

Personi i dënuar me burgim, mund të vendoset në qendrën e paraburgimit, nëse kohëzgjatja e burgimit pas llogaritjes së paraburgimit, ose të privimit tjetër nga liria lidhur me veprën penale nuk i kalon tre (3) muaj. Personi i dënuar me burgim vendoset në institucionin korrektues, nëse kohëzgjatja e burgimit pas llogaritjes së paraburgimit, ose të privimit tjetër nga liria lidhur me veprën penale i kalon tre (3) muaj.

Nëse gjykata që ka marrë vendim në shkallë të parë nuk ka kompetencë për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim, ose me burgim të përjetshëm, ajo vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale të personit të dënuar të mbledhura gjatë procedurës penale ia dërgon gjykatës kompetente brenda tri (3) ditëve prej ditës kur vendimi merr formën e prerë. Gjykata kompetente duhet ta fillojë procesin e dërgimit të personit të dënuar në mbajtje të dënimit me burgim, ose burgim të përjetshëm brenda tri (3) ditëve nga pranimi i vendimit.

Gjykata kompetente e urdhëron me shkrim personin e dënuar që në ditën e caktuar të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit me burgim, ose me burgim të përjetshëm. Periudha kohore ndërmjet pranimit të urdhrit dhe ditës së paraqitjes nuk duhet të jetë më e shkurtër se tetë (8) ditë dhe më e gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë. Gjykata kompetente e informon institucionin korrektues për datën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në institucion

dhe ia dorëzon vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale për personin e dënuar të cilat janë mbledhur gjatë procedurës penale.

Institucioni korrektues e informon gjykatën kompetente se a është paraqitur personi I dënuar për mbajtjen e dënimit. Mbajtja e dënimit me burgim ose me burgim të përjetshëm llogaritet prej ditës kur personi i dënuar është paraqitur në institucionin korrektues.

Kur personi i dënuar i cili është thirrur me rregull për mbajtje të dënimit nuk paraqitet në institucionin korrektues, gjykata urdhëron që ai të sjellet me forcë. Nëse personi i dënuar fshehet, ose është në arrati, gjykata urdhëron shpalljen e letër rreshtimit. Ekzekutimi i dënimit me burgim ose me burgim të përjetshëm llogaritet prej ditës kur personi i dënuar është privuar nga liria.

Ekzekutimi i dënimit me burgim mund të shtyhet me lutje të personit të dënuar¹⁰⁰:

- deri në shërimin e sëmundjes, nëse personi i dënuar vuan nga një sëmundje e rëndë akute;
- 1më së largu deri në fund të vitit të tretë të jetës së fëmijës, nëse personi I dënuar femër e ka përfunduar muajin e gjashtë të shtatzënisë, ose e ka fëmijën më të ri se një (1) vit;
- më së largu deri në tre (3) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar, prindi, ose prindi adoptues i personit të dënuar ka vdekur, ose vuan nga ndonjë sëmundje e rëndë;
- më së largu deri në gjashtë (6) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse bashkëshortja e personit të dënuar ka për të lindur edhe tre (3) muaj, ose nëse kanë kaluar më pak se gjashtë (6) muaj prej ditës kur ajo ka lindur dhe nuk ka anëtar tjetër të familjes për t'i ndihmuar asaj;
- më së largu deri në gjashtë (6) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse bashkëshorti, ose ndonjë anëtar tjetër i bashkësisë familjare të personit të dënuar ftohet me personin e dënuar që ta mbajë dënimin me burgim, ose, nëse ndonjëri prej tyre tashmë është në burg;
- më së largu deri në tre (3) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse shtyrjen e kërkon personi i dënuar për kryerjen e punëve bujqësore, ose sezonale që nuk mund të shtyhen, ose për punë si pasojë e ndonjë fatkeqësie dhe familja e personit të dënuar nuk ka fuqi të duhur punëtore;
- më së largu deri në tre (3) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse personi i dënuar është i detyruar të kryejë punën tashmë të filluar dhe moskryerja e saj do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm;
- më së largu deri në gjashtë (6) muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit, nëse personi i dënuar kërkon shtyrjen për përfundimin e shkollimit, ose për t'iu nënshtruar provimit të cilin e ka përgatitur.

I dënuari mund të kërkojë shtyrjen e dënimit më së shumti dy herë për cilën do nga arsyet e parashikuara me këtë nen. Ekzekutimi i dënimit nuk mund të shtyhet, nëse ekzekutimi i dënimit, ose të një pjese të dënimit do të bëhet i pamundur për shkak të parashkrimit

¹⁰⁰ Kambovski.V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje.

Personi i dënuar mund të parashtroj lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i urdhrit për mbajtjen e dënimit me burgim. Nëse urdhri nuk mund t'i dorëzohet të pandehurit ai i dorëzohet ndonjërit nga anëtarët madhorë të familjes, ose i lehet njoftimi për ditën dhe orën e dorëzimit. Nëse i dënuari nuk gjendet në adresën e tij në ditën dhe kohën e caktuar atij i ngjitet urdhri në derë. Dorëzimi i këtillë konsiderohet i rregullt.

Nëse sëmundja e rëndë akute e personit të dënuar, ose vdekja e bashkëshortit të tij, fëmijës, fëmijës së adoptuar, prindit, ose prindit adoptues paraqitet pas kalimit të periudhës prej shtatë (7) ditëve, lutja mund të parashtrohet deri në ditën kur personi i dënuar duhet të paraqitet për mbajtjen e dënimit.

Lutja për shtyrjen e ekzekutimit duhet të përmbajë arsyet e shtyrjes, provat që mbështesin shtyrjen dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet shtyrja.

Personi i dënuar, të cilit i është shtyrë ekzekutimi i dënimit për shkak të sëmundjes së rëndë akute, duhet të dorëzojë raport mbi gjendjen e tij shëndetësore të lëshuar nga institucioni mjekësor ku është duke u trajtuar një herë në tre (3) muaj, ose me kërkesë të gjykatës kompetente, edhe më shpesh.

Kryetari i gjykatës kompetente themelore e revokon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim, nëse ndërkohë konstatohet se arsyet për lejimin e shtyrjes nuk kanë ekzistuar, ose kanë pushuar së ekzistuari, ose personi i dënuar e ka shfrytëzuar periudhën e shtyrjes për qëllime të tjera e jo për ato për të cilat është lejuar. Nëse shtyrja i është lejuar gruas shtatzënë, fëmija i së cilës nuk ka lindur i gjallë, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas lindjes, dhe nëse fëmija vdes pas lindjes, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas vdekjes së fëmijës. Nëse shtyrja i është lejuar nënës së fëmijës më të ri se një (1) vit i cili vdes, shtyrja ndërpritet gjashtë (6) muaj pas vdekjes së fëmijës.

Gjykata që vendos lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës penale të parashtruar në favor të personit të dënuar, mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit me burgim, edhe para hyrjes në fuqi të aktvendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës penale. Gjykata që vendos lidhur me lutjen për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund ta shtyjë ekzekutimin e dënimit, varësisht nga përmbajtja e lutjes.

Me kërkesë të Prokurorit të Shtetit kompetent gjithmonë lejohet shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim, derisa të merret vendimi për shfrytëzimin e mjetit juridik. Vendimi për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim pushon të vlej, nëse prokurori I shtetit nuk e shfrytëzon mjetin juridik brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i vendimit për shtyrjen e ekzekutimit.

Risocializimi në ambientet korrektuese merr parasysh rrethanat dhe nevojat e posaçme të secilit person që kanë të bëjnë me risocializimin e tij. Për caktimin e të gjitha rrethanave dhe faktorëve të rëndësishëm për planifikimin e riedukimit të personit në institucionin korrektues dhe riintegrimin e tij shoqëror pas lirit, vrojtimi i personalitetit bëhet në fillim të ekzekutimit të dënimit dhe vazhdon gjatë tërë kohës së dënimit. Gjatë ekzekutimit të dënimit, programi riedukues përfshihet, ose ndryshohet për t'iu përshtatur përparimit të arritur dhe rrethanave të tjera përkatëse. Për përmbushjen e këtij qëllimi hartohet plan i përshtatshëm kohor për realizimin

e këtij programi. Personi i dënuar inkurajohet që të bashkëpunojë në realizimin e programeve dhe aktiviteteve risocializuese në institucion.

Drejtori i institucionit korrektues e nxjerr program individual për korrektim dhe risocializim të çdo të dënuari në bazë të rekomandimeve të personelit profesional të institucionit korrektues.

Programi risocializues përfshin së paku:

- vendosjen në institucionin, ose në sektorin brenda institucionit;
- pjesëmarrjen në aktivitete arsimore;
- pjesëmarrjen në aktivitete të aftësimi profesional;
- pjesëmarrjen në aktivitete kulturore, edukuese dhe sportive;
- punën dhe përmirësimin e aftësive profesionale;
- lidhjet familjare dhe kontaktet me botën e jashtme;
- kushtet për fitimin e të drejtës për pushim në shtëpi, për lirim me kusht, ose
- lirim të parakohshëm dhe
- masat që synojnë përgatitjen për lirim përfundimtar¹⁰¹.

Qëllimi i riintegrit të personave të dënuar në shoqëri, po ashtu realizohet përmes nxitjes dhe organizimit të pjesëmarrjes së institucioneve, ose të organeve publike dhe private, si dhe të individëve në aktivitetet korrektuese dhe risocializuese.

Gjykata e cila shqipton dënimin me gjobë e urdhëron ekzekutimin e saj. Dispozitat e Ligjit të procedurës përmbarese në fuqi zbatohen për kompetencën dhe procedurën e ekzekutimit të dënimit me gjobë, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe.

Personi i dënuar, dënimi me gjobë i të cilit është zëvendësuar me dënimin me burgim, sipas dispozitave të Kodit Penal, trajtohet si person i cili mban dënimin me burgim për kundërvajtje. Kur shpenzimet e procedurës penale dhe dënimi me gjobë duhet të ekzekutohen njëkohësisht, së pari ekzekutohen shpenzimet e procedurës penale. Nëse pasuria e personit të dënuar është zvogëluar për shkak të pagesës së dënimit me gjobë deri në atë masë sa që kërkesa pasurore-juridike e të dëmtuarit nuk mund të realizohet, kërkesa pasurore-juridike realizohet nga gjoba e paguar, por vetëm deri në masën e vlerës së gjobës.

Personi i dënuar, i paguan shpenzimet e ekzekutimit të dhunshëm të dënimit me gjobë. Mjetet e paguara nga dënimi me gjobë derdhen në buxhetin e shtetit.

Dënimi me burgim i shqiptuar për kundërvajtje, ose me të cilin është zëvendësuar dënimi i shqiptuar me gjobë ekzekutohet sipas dispozitave të këtij ligji, nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe.

Personat e dënuar me burgim për kundërvajtje, e mbajnë dënimin në institucionin korrektues, të ndarë nga personat e paraburgosur. Femrat e dënuara me burgim për kundërvajtje, e mbajnë dënimin në institucionin korrektues për femra, të ndara nga femrat e paraburgosura. Të dënuarit e mitur me burgim për kundërvajtje, e mbajnë dënimin të ndarë nga madhorët.

¹⁰¹ Kambovski.V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje.

Gjykata themelore në vendin e së cilës personi i dënuar ka vendbanimin, ose vendqëndrimin, në kohën kur vendimi për shqiptimin e dënimit merr formën e prerë është kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje. Kur vendbanimi, ose vendqëndrimi i personit të dënuar nuk dihen, kompetente për dërgimin e personit të dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje është gjykata themelore që ka marrë vendim në shkallë të parë. Nëse në procedurën kundërvajtëse është vendosur që dënimi me burgim të ekzekutohet menjëherë pa marrë parasysh ankesën, dërgimin e personit të dënuar për ta mbajtur dënimin e bën gjykata themelore e cila ka marrë vendim në shkallë të parë.

Nëse gjykata themelore e cila ka shqiptuar dënimin me burg, ose e ka zëvendësuar dënimin e shqiptuar me gjobë, me dënimin, me burg, nuk është kompetente për ekzekutim, ajo ka për detyrë që vendimin e ekzekutueshëm t'ia dërgojë gjykatës themelore, jo më vonë se brenda afatit prej tri (3) ditësh, pasi vendimi të ketë marrë formën ekzekutuese. Gjykata themelore e urdhëron me shkrim personin e dënuar të paraqitet ditën e caktuar në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje. Afati ndërmjet pranimit të urdhrit dhe ditës së paraqitjes nuk duhet të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë. Gjykata themelore e informon institucionin korrektues lidhur me datën kur personi i dënuar duhet të paraqitet në institucion, ia dorëzon vendimin e formës së prerë, dhe të dhënat personale për personin e dënuar të cilat janë mbledhur gjatë procedurës kundërvajtëse.

Institucioni korrektues e informon gjykatën themelore se a është paraqitur personi i dënuar për mbajtjen e dënimit me burgim për kundërvajtje. Fillimi i mbajtjes së dënimit me burgim për kundërvajtje llogaritet nga dita kur personi i dënuar është paraqitur për mbajtjen e dënimit në institucionin korrektues.

Nëse i dënuari me burgim për kundërvajtje i cili është thirrur me rregull nuk paraqitet në institucionin korrektues, gjykata kompetente për kundërvajtje urdhëron shoqërimin e tij, e nëse ai fshihet, ose është në arrati, gjykata urdhëron shpalljen urdhër arresti

Ekzekutimi i dënimit me burgim për kundërvajtje mund të shtyhet nga arsyet e njëjta për të cilat mund të shtyhet edhe ekzekutimi i dënimit me burgim të shqiptuar për vepër penale. Shtyrja e fillimit të mbajtjes së dënimit me burgim për kundërvajtje nuk mund të zgjatë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

Personi i dënuar e parashtron lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për kundërvajtje brenda tri (3) ditëve nga pranimi i urdhrit për mbajtjen e dënimit. Lutja për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për kundërvajtje i parashtrohet kryetarit të gjykatës themelore. Kryetari i gjykatës themelore vendos lidhur me lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kërkesës.

Kryetari i gjykatës themelore e hedh poshtë lutjen për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, nëse ajo nuk është parashtruar brenda periudhës së paraparë kohore dhe nëse është paraqitur nga personi i paautorizuar, ose nëse në të nuk janë bashkëngjitur provat që e mbështesin atë brenda periudhës së paraparë kohore.

Lutja për shtyrjen e ekzekutimit e pezullon ekzekutimin e dënimit derisa të merret vendimi i formës prerë lidhur me kërkesën. Kryetari i gjykatës themelore, i cili pas parashtrimit të lutjes së dytë konstaton se e drejta në ankesë është keqpërdorur vendosë që ankesa të mos e shtyjë ekzekutimin e dënimit.

Kryetari i gjykatës themelore e revokon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, nëse më vonë konstatohet se arsyet për lejimin e shtyrjes nuk kanë ekzistuar, ose kanë pushuar së ekzistuari, ose nëse personi i dënuar e ka shfrytëzuar shtyrjen për qëllime të tjera, e jo për ato për të cilat është lejuar.

Me kërkesën e personit të dënuar për kundërvajtje, përjashtimisht në raste të arsyeshme, mund të lejohet ndërprerja e mbajtjes së dënimit me burgim për kundërvajtje, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë. Në raste të jashtëzakonshme me qëllim të mjekimit, ndërprerja mund të vazhdojë derisa të zgjasë mjekimi. Koha e ndërprerjes së lejuar nuk llogaritet në mbajtjen e dënimit.

Dispozitat e këtij ligji që u referohen ekzekutimit të dënimit me gjobë, dhe të dënimeve plotësuese të shqiptuara për vepër penale zbatohen përshtatshëmrisht edhe për ekzekutimin e dënimit me gjobë dhe të masave mbrojtëse të shqiptuara për kundërvajtje, nëse me ligj të posaçëm nuk është paraparë ndryshe.

2. Dënimet alternative

Qëllimi i masave alternative është të mos dënohet i pandehuri për një krim të lehtë, kur kjo nuk është absolutisht e domosdoshme dhe kur mund të pritët që qëllimi i dënimit të arrihet nëpërmjet masash të tjera.

Masat alternative janë:

- 1) dënimi me kusht;
- 2) dënimi me kusht me mbikëqyrje;
- 3) pezullimi me kusht i procedurës penale;
- 4) shërbim në komunitet;
- 5) qortim nga gjykata;
- 6) arrest në shtëpi¹⁰².

Personit të dënuar mund t'i lejohet lirim me kusht në pajtim me dispozitat e Kodit Penal. Personi i dënuar ka të drejtë t'i paraqesë lutje për lirim me kusht panelit të themeluar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal nëpërmjet institucionit korrektues në të cilin ai është duke e mbajtur dënimin. 3. Drejtori i institucionit korrektues mund të paraqesë propozim për lirim me kusht.

¹⁰² Criminal Code ("Official Gazette of the Republic of Macedonia" nos. 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/2011, 135/2011, 185/2011, 142/2012, 166/2012, 55/2013, 82/2013, 14/2014, 27/2014, 28/2014 and 41/2014). Decisions of the Constitutional Court of the Republic of Macedonia: U. no. 220/2000 dated 30 May 2001, published in the "Official Gazette of the Republic of Macedonia" no. 48/2001; U. no. 210/2001 dated 06 February 2002, published in the "Official Gazette of the Republic of Macedonia" no. 16/2002; U. no. 206/2003 dated 09 June 2004, published in the "Official Gazette of the Republic of Macedonia" no. 40/2004; U. no. 228/2005 dated 05 April 2004, published in the "Official Gazette of the Republic of Macedonia" no. 50/2006. Law on Juvenile Justice ("Official Gazette of the Republic of Macedonia" nos. 87/2007, 103/2008 and 161/2008).

Pas paraqitjes së lutjes për lirim me kusht, Drejtori i institucionit korrektues kërkon nga Shërbimi Sprovues që të vizitoj të dënuarin dhe të nënshkruaj marrëveshjen për mbikëqyrjen e tij pas lirimit me kusht.

Pas paraqitjes së lutjes, apo propozimit për lirim me kusht, drejtori i institucionit korrektues, panelit për lirim me kusht menjëherë i dorëzon kopjen e dosjes personale të personit të dënuar dhe raportin mbi personin e dënuar të hartuar nga ekipi profesionist në institucionin korrektues me anë të shkresës përcjellëse të cilën e nënshkruan Drejtori i Institucionit Korrektues. Nëse paneli për lirim me kusht nuk ka të dhëna të mjaftueshme, mund të kërkoj nga institucioni korrektues të dhëna shtesë.

Raporti përfshin:

- llojin e veprës penale të kryer nga personi i dënuar;
- qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së viktimës;
- ndonjë vepër penale të kryer më parë nga ai;
- rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore;
- gjendjen e tij fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vlerësimin e rrezikshmërisë kurdo që konsiderohet e nevojshme nga një psikiatër, apo psikolog;
- sjelljen e tij në institucionin korrektues dhe suksesin e arritur në shmangien e faktorëve të veprës penale;
- planet e tij pas lirimit;
- përkrahja që mund t'i ofrohet pas lirimit dhe
- ndonjë rrethanë që tregon se ai nuk do të kryejë vepër të re penale.

Për lirim me kusht, vendos Paneli për lirim me kusht. Paneli për lirim me kusht përbëhet prej tre (3) anëtarëve: një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, i deleguar nga Kryetari i Gjykatës Supreme; një (1) prokuror i shtetit i deleguar nga Kryeprokurori i Shtetit; një (1) përfaqësues nga MPB/Policia, me njohuri dhe përvojë në fushat relevante profesionale (Juridik, pedagogji, sociologji, psikologji) i deleguar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Këshilli Gjyqësor gjithashtu emëron edhe një (1) përfaqësues të deleguar nga Rektorati/Fakulteti Juridik, si anëtar të katërt, me njohuri dhe përvojë nga fusha përkatëse profesionale, i cili përzgjidhet për të qenë në gatishmëri për të vendosur në rastet kur me ligj parashihet përjashtimi i anëtarit të panelit në një çështje të caktuar apo zëvendësimi në mungesë të ndonjë anëtari tjetër. Paneli për lirim me kusht vendos për të gjitha lutjet dhe propozimet për lirim me kusht.

Këshilli Gjyqësor nxjerr rregulloren për punën e panelit për lirim me kusht. Kundër aktvendimit të panelit për lirim me kusht nuk lejohet ankesa dhe nuk mund të ngritet konflikt administrativ.

Aktvendimi për lirim me kusht i dorëzohet personit të dënuar brenda tri (3) ditëve nga dita e marrjes së tij dhe, po ashtu evidencohet në gjykatën e cila e ka shqiptuar dënimin. Aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht së bashku me dosjen e të liruarit me kusht, duhet t'i dorëzohet shërbimit sprovues brenda afatit tre (3) ditor pas marrjes së vendimit për lirim me kusht. Aktvendimi me të cilin lejohet lirim me kusht mes tjerash përfshin datën kur personi idënuar do të lirohet nga mbajtja e dënimit. Nëse lirim me kusht nuk lejohet aktvendimi mes tjerash përfshin datën kur paneli për lirim me kusht mund të rishqyrtojë kërkesën e personit të dënuar

për lirim me kusht. Data për rishqyrtim nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj dhe jo më e gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

Nëse personit të dënuar i shqiptohet dënimi disiplinor i vetmisë ndërmjet datës së marrjes së aktvendimit për lirim me kusht dhe datës së lirimit me kusht nga mbajtja e dënimit, paneli për lirim me kusht e rishqyrton aktvendimin.

Brenda pesë (5) ditëve nga data e lirimit, personi i liruar me kusht obligohet ta njoftojë policinë dhe shërbimin sprovues për vendqëndrimin e tij gjatë periudhës së lirimit me kusht. Personi i liruar me kusht obligohet që gjatë periudhës së lirimit të tij me kusht t'i raportojë shërbimit sprovues. Nëse personi i liruar me kusht e ndërron vendqëndrimin, ai obligohet ta informojë policinë dhe shërbimin sprovues. Nëse personi i liruar me kusht nuk i përmbush obligimet e parapara, Paneli për Lirim me Kusht mund ta revokoj vendimin për lirim me kusht me propozim të shërbimit sprovues.

Nëse lirim me kusht revokohet, personi i dënuar mban pjesën e mbetur të dënimit. Në rast se brenda njëzetekatër (24) orëve, pas dorëzimit të vendimit me shkrim për revokimin e vendimit për lirim me kusht, personi i liruar nuk kthehet vullnetarisht në mbajtje të dënimit, Policia e Kosovës me forcë e sjell në Institucionin Korrektues për mbajtjen e pjesës së mbetur të dënimit.

Shërbimi sprovues përpilon raporte me shkrim për Panelin për Lirim me Kusht lidhur me ecurinë e mbikëqyrës së personave të liruar me kusht.

Drejtori i institucionit korrektues mund ta lirojë personin e dënuar para përfundimit të mbajtjes së dënimit të tij me burgim nëse ai ka pasur sjellje të mirë, suksese në punë dhe në aktivitete të tjera. Drejtori i institucionit korrektues mund të lejojë lirim të parakohshëm, nëse personi i dënuar ka mbajtur të paktën tri të katërtat (3/4) e dënimit me burgim dhe nëse të njëjtit i kanë mbetur jo më shumë se tre (3) muaj të dënimit. Nëse personit të dënuar i shqiptohet dënimi disiplinor i vetmisë ndërmjet datës së lëshimit të aktvendimit për lirim të parakohshëm dhe datës për lirim të parakohshëm nga mbajtja e dënimit, drejtori i institucionit korrektues e rishqyrton aktvendimin. Aktvendimi për lirim të parakohshëm sipas këtij neni i dorëzohet personit të dënuar brenda tri (3) ditëve nga dita e marrjes së tij dhe evidentohet në gjykatën e cila e ka shqiptuar dënimin.

Personi i dënuar i cili është falur lirohet në të njëjtën ditë kur institucioni korrektues e pranon vendimin për falje dhe jo më vonë se njëzetekatër (24) orë nga pranimi i vendimit.

Para lirimit, institucioni korrektues e njofton gjykatën që e ka shqiptuar dënimin dhe stacionin më të afërt policor me vendbanimin, ose vendqëndrimin e personit të dënuar për lirim e tij. Në rastin kur personi i dënuar është i mitur, institucioni korrektues e njofton familjen e tij shërbimin sprovues dhe Qendrën për Punë Sociale lidhur me lirim e personit të dënuar. 3. Përgatitja për lirim e personit me çrregullime mendore bëhet në konsultim me drejtorin e institucionit korrektues, me psikiatrin i cili e ka trajtuar personin e dënuar në institucionin korrektues, si dhe me autoritetet përkatëse të shëndetit mental në shoqëri.

Nëse pas lirimit personi i dënuar ka nevojë për ndihmë, institucioni korrektues e njofton qendrën për punë sociale, e cila është kompetente sipas vendbanimit, apo vendqëndrimit të personit të dënuar, së paku tre (3) muaj para lirimit. Institucioni korrektues e njofton qendrën për punë sociale lidhur me llojin e ndihmës së kërkuar nga personi i dënuar.

Ekzekutimi i dënimit alternativ fillon pasi vendimi merr formë të prerë. Ndaj personit të dënuar dënimi alternativ ekzekutohet në vendbanimin, apo vendqëndrimin e tij. Ekzekutimin e dënimeve alternative e përgatit, udhëheq dhe mbikqyrë Shërbimi Sprovues.

Dënimi alternativ ekzekutohet në mënyrën e cila siguron respektimin e dinjitetit dhe të drejtat, liritë themelore të personit të dënuar dhe të familjes së tij. Personi i dënuar, dinjiteti, apo të drejtat dhe liritë themelore të të cilit janë shkelur gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ, ka të drejtë në ankesë. Kundër vendimit përfundimtar me të cilët personit të dënuar gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ i është kufizuar, apo i është shkelur ndonjë e drejtë e përcaktuar më këtë ligj, i dënuari ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore.

Para shqiptimit të dënimit alternativ, gjykata mund të kërkojë raport nga shërbimi sprovues. Shërbimi sprovues ia dorëzon raportin gjykatës para shqiptimit të dënimit, brenda tri (3) javësh nga paraqitja e kërkesës së tillë. Raporti i dhënë para shqiptimit të dënimit përcakton dënimin, apo dënimet alternative adekuate për personin e dënuar duke pasur parasysh objektivat e risocializimit dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale në të ardhmen.

Kur gjykata e pranon raportin e Shërbimit Sprovues, i cili përmban të dhënat mbi shkeljen e kushteve të dënimit alternativ, apo mos përmbushjen e ndonjë obligimi, gjykata shqyrton mundësinë e revokimit të dënimit alternativ dhe personin e dënuar e njofton për përmbajtjen e raportit duke i dhënë atij të drejtën që t'i përgjigjet raportit. Personit të dënuar i bëhet me dije se me shpenzime të veta ka të drejtë të angazhojë mbrojtës. Gjatë periudhës së shqyrtimit të revokimit të dënimit alternativ, ekzekutimi i tij pezullohet.

Pasi që gjykata shqyrton raportin e shërbimit sprovues dhe përgjigjet e pranuar nga personi i dënuar, apo mbrojtësi i tij, ajo vendos se a do ta revokojë dënimin alternativ, apo do të ndërmarrë veprime të tjera në pajtim me Kodin Penal. Gjkata merr vendim të arsyetuar me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të raportit nga shërbimi sprovues. Ky vendimi i dërgohet personit të dënuar, mbrojtësit të tij, shërbimit sprovues dhe prokurorit të shtetit.

Kur gjykata shqipton dënimin me kusht, ajo ia dërgon aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon vendimin institucionit të paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i institucionit të paraburgimit e liron personin e dënuar në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Kur gjykata shqipton dënimin me kusht dhe urdhëron përmbushjen e ndonjë obligimi sipas dispozitave të Kodit Penal, shërbimi sprovues mbikëqyr përmbushjen e obligimit. Nëse personi i dënuar nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, sipas paragrafit të këtij neni Shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos përmbushjen e obligimit.

Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor apo në ndonjë institucion tjetër përkatës. Kur gjykata shqipton dënimin me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, ajo aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ia dërgon menjëherë shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit kompetent të kujdesit shëndetësor, apo institucionit përkatës për ekzekutimin e këtij dënimi. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon vendimin institucionit të paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i institucionit të paraburgimit e liron personin e dënuar në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Institucioni kompetent i kujdesit shëndetësor, apo institucioni përkatës, në bashkëpunim me shërbimin sprovues, përcaktojnë programin për trajtim rehabilitues për personin i cili i nënshtrohet dënimit me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues. Shërbimi sprovues në bashkëpunim me institucionin kompetent të kujdesit shëndetësor, apo me institucionin përkatës e mbikëqyrë nëse personi i tillë i përmbahet programit të trajtimit rehabilitues.

Çdo katër (4) muaj shërbimi sprovues ia dërgon gjykatës raportet mbi përparimin e arritur në programin e trajtimit rehabilitues, bazuar në të dhënat e siguruar nga institucioni kompetent i kujdesit shëndetësor, apo nga institucioni tjetër përkatës. Institucioni kompetent i kujdesit shëndetësor, apo institucioni tjetër përkatës e njofton menjëherë shërbimin sprovues për mos përmbushjen e programit të trajtimit rehabilitues nga personi i dënuar. Mos përmbushja e programit të trajtimit rehabilitues nga ana e personit të dënuar vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës. Pas njoftimit nga institucioni kompetent shëndetësor për përfundimin e suksesshëm të programit të trajtimit rehabilitues, raporti i tillë i dërgohet gjykatës nga shërbimi sprovues.

Kur gjykata shqipton dënimin me kusht, me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ia dërgon menjëherë shërbimit sprovues kompetent për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ.

Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon aktgjykimin institucionit korrektues përkatës ku ai mbahet. Drejtori i institucionit korrektues përkatës e liron personin e dënuar me vendim në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Shërbimi sprovues e mbikëqyrë ekzekutimin e dënimit me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues. Nëse personi i dënuar nuk kontakton me shërbimin sprovues, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mosmbajtjen e kontaktit të tillë.

Kur gjykata e shqipton dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues dhe urdhëron përmbushjen e ndonjë obligimi, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, shërbimi sprovues e mbikëqyrë përmbushjen e këtij obligimi. Nëse personi i dënuar nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos përmbushjen e obligimit të tillë.

Përfundimi i suksesshëm i periudhës së verifikimit të ekzekutimit të këtij dënimit alternativ të personave të dënuar i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas pranimit të raportit të tillë, gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e dënimi alternativ.

Kur gjykata shqipton dënimin me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, ajo ia dërgon menjëherë aktgjykimin me të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues kompetent për ekzekutimin e këtij dënim alternativ. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata po ashtu ia dërgon vendimin institucionit të paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i institucionit korrektues përkatës e liron personin e dënuar në mënyrë që të ekzekutohet ky dënim alternativ.

Shërbimi sprovues e zhvillon programin për punë në dobi të përgjithshme për personin e dënuar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal dhe bazuar në aftësitë, shkathtësitë dhe të kaluarën e tij. Shërbimi sprovues e mbikëqyrë ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Shërbimi sprovues, në bashkërendim me organizatën ku duhet kryer puna në dobi të përgjithshme, vendosë rregullat e sigurimit për rastet e lëndimeve në vendin e punës, ose sëmundjes, sjelljen e përgjithshme në vendin e punës dhe çështjet tjera përkatëse para fillimi të punës në dobi të përgjithshme. Akti nënligjor për orarin e punës, pushimet, pushimet javore dhe mbrojtjen në vendin e punës zbatohen gjatë punës në dobi të përgjithshme.

Kur gjykata shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme dhe personin e dënuar e urdhëron që të kontaktojë me shërbimin sprovues, apo të përmbushë një, ose më shumë obligime sipas dispozitave të Kodit Penal, shërbimi sprovues e mbikëqyrë mbajtjen e kontaktit, apo përmbushjen e obligimit.

Nëse personi i dënuar nuk mban kontakt me shërbimin sprovues, ose nuk e përmbush obligimin e urdhëruar nga gjykata, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos mbajtjen e kontaktit, apo mos përmbushjen e obligimit. Organet e administratës të nivelit qendror dhe lokal, institucionet dhe personat e tjerë juridik, si dhe personat fizik janë të obliguar të bashkëpunojnë me shërbimin sprovues dhe zyret regjionale sprovuese në ekzekutimin e dënimit me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

Organizata në të cilën duhet kryer puna në dobi të përgjithshme menjëherë e njofton shërbimin sprovues nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme në nivel të kënaqshëm. Moskryerja në nivel të kënaqshëm e punës në dobi të përgjithshme vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës. Moskryerja në nivel të kënaqshëm e punës në dobi të përgjithshme nënkupton ardhjen e vonuar në punë, mungesat e palejuara nga puna, mosrespektimin e rregullave të punës.

Nëse personi i dënuar është i paaftë për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme për shkak të rrethanave të ndryshuara, shërbimi sprovues mund të korrigjojë programin për punën në dobi të përgjithshme. Ekzekutimi i urdhrin për punë në dobi të përgjithshme me dënim mund të shtyhet, apo pezullohet për shkak të:

- sëmundjes së papritur të personit të dënuar, e cila kërkon trajtim mjekësor dhe atij ia pamundëson kryerjen e punës në dobi të përgjithshme;

- vdekjes së ndonjë anëtarit të familjes, që atë e obligon të merr rolin e kujdestarit kryesor ndaj anëtarëve të tjerë të familjes dhe ia pamundëson kryerjen e punës në dobi të përgjithshme;
- rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë praninë e përhershme të personit të dënuar për arsye humanitare dhe atij ia pamundësojnë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Kërkesa për shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme mund t'i paraqitet gjykatës nga personi i dënuar, mbrojtësi, ose përfaqësuesi i shërbimit sprovues. Parashtrimi i kërkesës pezullon obligimin për kryerjen e punës në dobi të përgjithshme derisa gjykata të vendos lidhur me kërkesën.

Gjykata vendos për shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme të urdhëruar me dënim brenda tri (3) ditëve nga pranimi i kërkesës. Nëse gjykata e miraton shtyrjen, apo pezullimin e ekzekutimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme, ajo me aktin e përcakton periudhën e shtyrjes, apo pezullimit. Shtyrja, apo pezullimi i ekzekutimit të urdhrin për punë në dobi të përgjithshme të urdhëruar mund të zgjasë:

- deri në shërimin e sëmundjes,
- deri në njëzet (20) ditë.

Përfundimi i suksesshëm i punës në dobi të përgjithshme i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas pranimit të raportit të tillë, gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e dënimit alternativ.

Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe urdhëron ekzekutimin e dënimit në gjysmëliri, ajo aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ia dërgon menjëherë shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit korrektues për ekzekutimin e këtij dënimi alternativ. Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues përcakton institucionin korrektues ku do të ekzekutohet urdhri për gjysmëliri, duke marrë parasysh vendin e punës, apo obligimet dhe përgjegjësitë tjera të personit të dënuar dhe faktorët tjerë veprues.

Drejtori i institucionit korrektues e mbikëqyrë personin e dënuar derisa ai është i burgosur, kurse shërbimi sprovues kompetent e mbikëqyrë atë derisa ai është në gjysmëliri. Nëse personi i dënuar nuk kthehet në institucionin korrektues pas kryerjes së obligimeve të tij, drejtori i institucionit korrektues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për moskthim në institucionin korrektues. Nëse personi i dënuar nuk i përmbush obligimet e tij lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin, ose aftësimin profesional, përgjegjësitë familjare, apo nevojën për trajtim, ose rehabilitim mjekësor, shërbimit sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve për mos përmbushjen e obligimeve të tilla.

Kur gjykata vendos që kryerësit t'ia heqë të drejtën për t'u zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Penal, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon stacionit të policisë në territorin e së cilës personi i dënuar ka vendbanimin për ekzekutimin e këtij dënimi plotësues. Njësia administrative e stacionit të policisë e njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisionin Lokal të Zgjedhjeve ku personi i dënuar e ka vendbanimin, se personit të dënuar i

është hequr e drejta për t'u zgjedhur me akt të formës së prerë të gjykatës. Nëse personi i dënuar e ndërton vendbanimin, ai e njofton gjykatën dhe policinë për vendbanimin e tij të ri. Stacioni i policisë në territorin e të cilit personi i dënuar ka pasur vendbanimin e mëhershëm e njofton stacionin e policisë për vendbanimin e ri të personit të dënuar.

Kur gjykata vendos që kryerësit t'ia ndalojë ushtrimin e funksioneve në administratën publike, ose në shërbimin publik, sipas dispozitave të Kodit Penal, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon Ministrisë së Administratës Publike për ekzekutim të këtij dënimi plotësues. Nëse personi i dënuar nuk i përmbahet ndalesës së ushtrimit të funksioneve në administratën publike, ose në shërbimin publik, Ministria e Administratës Publike e njofton gjykatën për mosrespektimin e ndalesës.

Kur gjykata vendos që kryerësit t'ia ndalojë ushtrimin e profesionit, veprimtarisë së pavarur, detyrës udhëheqëse, ose administrative, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ndërmarrjes publike, apo private ku personi i dënuar ka qenë i punësuar, organit të autorizuar për dhënien e lejes për ushtrimin e profesionit, apo veprimtarisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për ekzekutim të këtij dënimi plotësues.

Kur parakusht për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës është leja e dhënë nga organi i autorizuar, ky dënim plotësues ekzekutohet me revokim të lejes, ose me ndalimin e dhënies së lejes gjatë kohës derisa dënim plotësues është në fuqi. Në rastet tjera Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ndërmerr veprime përkatëse që personi i dënuar të parandalohet nga ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës. Ndërmarrja publike, apo private, organi përgjegjës, ose Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e njofton gjykatën, e cila e ka shqiptuar dënimin plotësues kur është ekzekutuar dënim i tillë. Nëse personi i dënuar nuk i përmbahet ndalesës së ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, ose detyrës, ndërmarrja publike, apo private, organi përgjegjës, ose Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e njofton gjykatën për mosrespektim të ndalesës.

Kur gjykata vendos që kryerësit t'ia ndalojë drejtimin e automjetit, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon organit kompetent për dhënien e lejeve të vozitjes në territorin ku personi i dënuar ka vendbanimin, për ekzekutim të këtij dënimi plotësues. Nëse vendbanimi i personit të dënuar nuk dihet, organi kompetent i autorizuar për dhënien e lejeve të vozitjes në territorin ku personi i dënuar ka vendqëndrimin e ekzekuton këtë dënim plotësues. Nëse personi i dënuar nuk ka vendbanim në Kosovë, aktgjykimi i dërgohet organit kompetent të autorizuar për dhënien e lejeve të vozitjes në territorin ku është kryer vepra penale.

Organi kompetent i autorizuar për dhënien e lejeve të vozitjes këtë dënim e ekzekuton me thirrjen e personit të dënuar dhe shënimin në lejen e vozitjes së tij si të pavlefshme gjatë kohës së ekzekutimit të këtij dënimi plotësues për llojin dhe kategorinë e caktuar të automjetit.

Nëse personi i dënuar nuk ka leje të vozitjes, ose ka leje të dhënë nga organi kompetent i shtetit të huaj, ky dënim plotësues ekzekutohet me regjistrimin e dënimit në regjistrin e organit kompetent për dhënien e lejeve të vozitjes. Organi publik kompetent regjistron të dhënat e

personit të dënuar, dënimin e shqiptuar plotësues dhe kohëzgjatjen e tij. Pas përfundimit të dënimit plotësues, personi i dënuar mund të kërkojë dhënien e lejes së re të vozitjes nga organi kompetent. Nëse personi i dënuar nuk i përmbahet ndalimit të drejtimit të automjetit, organi kompetent i autorizuar për dhënien e lejes së vozitjes e njofton gjykatën për mosrespektimin e ndalimit të tillë.

Kur gjykata vendosë që kryerësit t'ia marrë lejen e vozitjes, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë ia dërgon aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon stacionit të policisë në territorin ku personi i dënuar e ka vendbanimin për ekzekutimin e këtij dënimi plotësues. Nëse vendbanimi i personit të dënuar nuk dihet, stacioni i policisë në territorin ku personi i dënuar ka vendqëndrimin e ekzekuton këtë dënim plotësues. Nëse personi i dënuar posedon leje të vozitjes, policia e ekzekuton këtë dënim plotësues me thirrjen e personit të dënuar dhe marrjen e lejes së vozitjes gjatë kohëzgjatjes së dënimit. Nëse personi i dënuar nuk posedon leje të vozitjes, ky dënim plotësues ekzekutohet me regjistrimin e dënimit në regjistrin e organit administrativ kompetent për dhënien e lejes së vozitjes. Organi kompetent e regjistron të dhënat e personit të dënuar, dënimin plotësues të shqiptuar dhe kohëzgjatjen e tij. Ekzekutimi i këtij dënimi plotësues fillon në ditën e marrjes së lejes së vozitjes, ose të regjistrimit të dënimit në regjistrin e organit kompetent për dhënien e lejes së vozitjes.

Dënimi plotësues i marrjes së sendit, sipas dispozitave të Kodit të Penal të Kosovës, ekzekutohet nga gjykata e cila e ka shqiptuar dënimin në shkallë të parë. Gjukata vendos nëse sendi do të shitet sipas dispozitave të ligjit për procedurë përmbarrimore, do t'i dorëzohet organit kompetent, muzeut të kriminalistikës, ose institucionit përkatës, apo nëse do të asgjësohet. Të ardhurat nga shitja e sendit depozitohen në Buxhetin e Kosovës.

Kur gjykata urdhron publikimin e aktgjykimit, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, menjëherë e dërgon aktgjykimin e përmbarrueshëm për publikim në një, ose në më shumë gazeta, ose për transmetim në ndonjë kanal të radios a televizionit.

Kur gjykata vendos për dëbimin e shtetasit të huaj nga territori i Kosovës, sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, ajo aktgjykimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon ia dërgon menjëherë stacionit të policisë në territorin ku personi i dënuar ka vendqëndrimin për ekzekutimin e këtij dënimi plotësues.

Masa e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm për kryerësit e varur nga droga, apo alkooli ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor, apo në institucionin tjetër përkatës. Nëse kjo masë shqiptohet së bashku me dënimin me burgim ajo mbahet në institucionin shëndetësor. Gjukata vendos për institucionin e kujdesit shëndetësor, për institucionin korrektues, apo institucionin tjetër përkatës ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm. Kur gjykata shqipton masën e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm, ajo menjëherë ia dërgon vendimin dhe të gjitha të dhënat tjera që i posedon për shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit të kujdesit shëndetësor, institucionit korrektues, ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata gjithashtu ia dërgon vendimin qendrës së paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i qendrës së paraburgimit e liron personin e dënuar për ekzekutimin e kësaj mase.

Institucioni shëndetësor, institucioni korrektues, apo institucioni përkatës, në bashkëpunim me shërbimin sprovues cakton programin e trajtimit të rehabilitimit për personin që i nënshtrohet masës së trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm. Shërbimi sprovues mbikëqyrë nëse personi vepron në përputhje me programin e trajtimit rehabilitues, në bashkëpunim me institucionin shëndetësor, institucionin korrektues, apo institucionin përkatës. Shërbimi sprovues i dërgon çdo dy (2) muaj raport gjykatës për përparimin e arritur në programin e trajtimit rehabilitues bazuar në informatat e siguruara nga institucioni shëndetësor, i institucionit korrektues, apo i institucionit tjetër përkatës. Institucioni shëndetësor, institucioni korrektues, apo institucioni përkatës menjëherë e informojnë shërbimin sprovues nëse personi i dënuar nuk i përmbahet programit të trajtimit rehabilitues. Mos përmbushja e programit të trajtimit rehabilitues nga personi i dënuar vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës. Përfundimi i suksesshëm i programit të trajtimit rehabilitues i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas marrjes së raportit të tillë gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e masës së tillë.

Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ekzekutohet në institucionin shëndetësor, ose në institucionin tjetër të posaçëm që ndodhet në vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e të pandehurit, ose nëse institucioni i tillë nuk ndodhet në atë vend, në institucionin më të përafërt me vendin ku i pandehuri ka vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin, ose në vendin ku është zbatuar procedura penale. Gjykata vendos për institucionin shëndetësor, ose institucionin tjetër përkatës ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Me rastin e vendosjes për institucionin e kujdesit shëndetësor gjykata merr parasysh rrezikun që i pandehuri paraqet për mjedisin e tij, për vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e tij dhe nevojat e tij për trajtim.

Kur gjykata cakton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, ajo menjëherë ia dërgon vendimin dhe të gjitha të dhënat që i posedon shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit shëndetësor, institucionit korrektues, ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase. Nëse masa është caktuar së bashku me dënimin me burgim, kryerësi i veprës penale së pari dërgohet në institucionin e kujdesit shëndetësor për trajtim

Transferimi i personit të cilit i është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor Nëse personi ndaj të cilit është caktuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, me ndalim ndodhet në liri, gjykata urdhëron transferimin e tij në institucionin e kujdesit shëndetësor, ose urdhëron lëshimin e letër rreshtimit, por nëse personi ndodhet në paraburgim, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës e përcjell në institucionin e kujdesit shëndetësor. Personi ndaj të cilit është caktuar kjo masë, transferohet në institucionin e kujdesit shëndetësor i shoqëruar nga punëtorët e kujdesit shëndetësor. Personi ndaj të cilit ekzekutohet kjo masë ka të drejta dhe detyrime të njëjta sikurse person i cili mban dënimin me burgim, nëse nevojat e trajtimit nuk kërkojnë ndryshe. Me propozimin e institucionit të kujdesit shëndetësor ku ekzekutohet kjo masë, gjykata gjatë kohëzgjatjes së masës, mund të vendosë për transferimin e personit nga një institucion i kujdesit shëndetësor në tjetrin. Gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë monitoron ligjshmërinë e ekzekutimit të saj. Organi publik kompetent për shëndetësi monitoron aftësinë profesionale të trajtimit, i cili ofrohet gjatë ekzekutimit të masës.

Institucioni i kujdesit shëndetësor i dërgon gjykatës që ka caktuar masën në shkallë të parë raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit ekzekutohet masa, së paku një herë në gjashtë (6) muaj dhe më shpesh me kërkesë të gjykatës. Kur institucioni i kujdesit shëndetësor, ose mjeku përgjegjës për shërimin mendor konstaton se, më nuk është e nevojshme ta trajtojë, ose ta ndalojë kryerësin e veprës penale në institucionin e kujdesit shëndetësor, ai menjëherë e informon gjykatën që e ka caktuar masën në shkallë të parë. Çdo gjashtë (6) muaj, gjykata që ka caktuar masën në shkallë të parë, e shqyrton nevojën e vazhimit të masës pas shqyrtimit të institucionit shëndetësor dhe të mendimit të ekspertit të pavarur, i cili nuk është i punësuar në institucionin e kujdesit shëndetësor ku është duke u ekzekutuar masa.

Sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e të pandehurit, mbrojtësit të institucionit të kujdesit shëndetësor, ose të organit të kujdestarisë që është kompetent në bazë të vendbanimit të përkohshëm, ose të përhershëm të personit në kohën kur ka hyrë në fuqi urdhri me anë të cilit është caktuar masa, gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë e pushon masën nëse konstaton se më nuk është e nevojshme që kryerësi të trajtohet, ose ndalohet në atë institucion. Kur pushon masën, gjykata mund ta caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm në liri nëse ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë. Vendimi merret pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe kryerësit të veprës penale nëse gjendja e tij këtë e lejon edhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit. Kur gjykata pushon masën, e informon institucionin e kujdesit shëndetësor, e liron personin ndaj të cilit është caktuar masa menjëherë pas marrjes së vendimit.

Pasi që personi të lirohet nga institucioni shëndetësor, organi kompetent i kujdestarisë është përgjegjës për personin ndaj të cilit është ekzekutuar masa në dhënien e ndihmës pas lirimit nga institucioni shëndetësor. Nëse kryerësi i cili ka kryer veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore lirohet nga institucioni shëndetësor, dhe nëse ai në institucionin shëndetësor ka kaluar kohë më të shkurtër sesa kohëzgjatja e burgimit të caktuar, gjykata e shqyrton lirimin me kusht për atë person.

Me rastin e vendosjes për lirim me kusht, gjykata veçanërisht merr parasysh suksesin e trajtimit të personit të dënuar, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucionin shëndetësor dhe kohën e mbetur të dënimit. Nëse gjykata vendosë për lirimin me kusht, mundet gjithashtu ta caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, nëse ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë. Nëse gjykata vendosë që personi i dënuar të mbajë pjesën e mbetur të dënimit me burgim, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës e përcjellë atë në institucionin korrektues të dënimit.

Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri ekzekutohet në institucionin shëndetësor të caktuar nga gjykata që ka caktuar masën në shkallë të parë. Gjukata e informon institucionin shëndetësor për datën kur personi ndaj të cilit është caktuar masa duhet të paraqitet për trajtim. Personi ndaj të cilit është caktuar masa detyrohet të paraqitet në institucionin shëndetësor për trajtim brenda kohës së caktuar nga gjykata.

Institucioni shëndetësor i dërgon gjykatës që ka caktuar masën në shkallë të parë raport mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit të personit ndaj të cilit është ekzekutuar masa, së paku një (1) herë në gjashtë (6) muaj, dhe më shpesh me kërkesë të gjykatës. Kur institucioni

shëndetësor çmon se më nuk është e nevojshme ta trajtojë personin ndaj të cilit është shqiptuar masa, menjëherë e informon gjykatën e cila ka caktuar masën në shkallë të parë. Gjykata e cila ka caktuar masën në shkallë të parë, sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e të pandehurit, mbrojtësit, institucionit shëndetësor, ose organit kompetent të kujdestarisë, e pushon masën nëse konstaton se më nuk është e nevojshme ta trajtojë personin ndaj të cilit është shqiptuar masa. Vendimi për pushimin e masës merret pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe personit ndaj të cilit është shqiptuar masa, nëse këtë e lejon gjendja e tij dhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit.

Institucioni shëndetësor menjëherë e njofton gjykatën që e ka caktuar masën në shkallë të parë, kur personit ndaj të cilit është shqiptuar masa nuk i është nënshtruar trajtimit në liri nëse ai arbitrarisht e ka ndërprerë trajtimin, ose nëse mendon se trajtimi ka qenë i pasuksesshëm. Gjykata sipas detyrës zyrtare, ose me propozimin e institucionit shëndetësor, në të cilin personi trajtohet, ose duhet të trajtohet, mund të caktojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim nëse:

- kryerësi i veprës penale nuk i është nënshtruar trajtimit në liri, ka ndërprerë trajtimin arbitrarisht, ose kur trajtimi është konsideruar i pasuksesshëm nga institucioni i kujdesit shëndetësor;
- ekzistojnë arsyet për caktimin e masës së tillë.

Vendimi për caktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim merret pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe personit ndaj të cilit është shqiptuar masa, nëse këtë e lejon gjendja e tij dhe pas shqyrtimit të mendimit të ekspertit të pavarur, i cili nuk është i punësuar në institucionin e kujdesit shëndetësor ku ekzekutohet masa. Pasi personi nuk ka më nevojë për trajtim në institucionin shëndetësor, organi kompetent i kujdestarisë është përgjegjës për personin ndaj të cilit është ekzekutuar masa në dhënien e ndihmës pas pushimit të trajtimit të detyrueshëm në liri.

Prona dhe dobia pronësore të siguruara me kryerjen e veprës penale përcaktohen në procedurën penale sipas detyrës zyrtare. Gjykata dhe organet tjera para të cilave mbahet procedura penale, janë të obliguara që gjatë procedurës të grumbullojnë prova dhe t'i hetojnë rrethanat që janë me rëndësi për përcaktimin e pronës dhe dobisë pronësore. Nëse i dëmtuar ka paraqitur kërkesë pronësore-juridike në lidhje me kthimin e sendeve të siguruara me vepër penale, përkatësisht në lidhje me shumën që i përgjigjet vlerës së sendeve, dobia pronësore do të përcaktohet vetëm në atë pjesë që nuk është përfshirë me kërkesën pronësore-juridike.

Gjatë konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore të siguruar me vepër penale personi mbi të cilin është bartur dobia pronësore, si dhe përfaqësuesi i personit juridik, do të thirren për marrje në pyetje në procedurën paraprake dhe në seancën kryesore. Në thirrje do të paralajmërohen se procedura do të zbatohet edhe pa praninë e tyre. Përfaqësuesi i personit juridik do të merret në pyetje në seancën kryesore pas të akuzuarit. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet në lidhje me personin mbi të cilin është bartur dobia pronësore nëse nuk është thirrur si dëshmitar.

Personi mbi të cilin është bartur dobia pronësore si dhe përfaqësuesi i personit juridik, janë të autorizuar që në lidhje me përcaktimin e dobisë pronësore të propozojnë prova edhe pas autorizimit të kryetarit të këshillit t'i parashtrajnë pyetje të akuzuarit, dëshmitarëve dhe

ekspertëve. Përrshtimi i publikut në seancën kryesore nuk ka të bëjë me personin mbi të cilin janë bartur prona dhe dobia pronësore dhe përfaqësuesit të personit juridik. Nëse gjykata edhe gjatë seancës kryesore përcakton se vjen në shprehje konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore, do ta ndërpresë seancën kryesore dhe do ta thirrë personin mbi të cilin janë bartur prona dhe dobia pronësore si dhe përfaqësuesin e personit juridik.

Nëse me prova tjera gjykata nuk mund ta përcaktojë shumën e pronës dhe dobisë pronësore që duhet të konfiskohet, do të përcaktojë ekspertizë. Kur ekziston dyshim se prona gjendet jashtë vendit, gjykata është e obliguar që të lëshojë urdhërrarresti ose shpallje ndërkombëtare. Gjykata në grumbullimin e provave të nevojshme për vërtetimin e lartësisë së shumës së pronës dhe dobisë pronësore të siguruara me veprën penale, mund të kërkojë njoftime të nevojshme nga organet tjera shtetërore, institucionet financiare, persona tjerë juridikë dhe qytetarë të cilët janë të obliguar pa prolongim të njëjtat t'i dorëzojnë.

Gjykata do të shqiptojë masë të konfiskimit të zgjeruar nën kushtet e përcaktuara në Kodin penal, nëse i akuzuari në afat prej një viti nga dita e fillimit të seancës kryesore nuk mund të dëshmojë se prona ose dobia pronësore janë të fituara me ligj. Nëse në afatin më të shkurtër se afati nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata miraton aktgjykim të shkallës së parë për veprën penale, kur ekzistojnë kushte ligjore për shqiptimin e masës konfiskim i zgjeruar, gjykata atë masë do ta shqiptojë me aktgjykim plotësues kundër të cilit lejohet ankesë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Gjykata me aktvendim do të shqiptojë masë konfiskim të zgjeruar me kushtet e përcaktuara në Kodin penal edhe kundër personit të tretë, nëse në afat prej dy vjetësh nga dita e fillimit të procedurës së posaçme për konfiskim, nuk dëshmon se për pronën ose dobinë pronësore ka dhënë kundërkompensim që i përgjigjet vlerës së tyre. Procedura për shqiptimin e masës konfiskim i zgjeruar mbahet sipas propozimit të prokurorit publik. Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, personi ka të drejtë ankesë drejtpërdrejt te gjykata më e lartë në afat prej tetë ditësh.

Kur janë plotësuar kushtet për konfiskim ose konfiskim të zgjeruar të pronës dhe dobisë pronësore, gjykata sipas detyrës zyrtare do të urdhërojë masa të përkohshme të sigurimisë të përcaktuara me nenin 194 të këtij ligji. Masat nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata mundet t'i caktojë kundër personave të tretë për të cilët ekziston dyshim se mbi ta janë bartur prona dhe dobia pronësore, të siguruara me veprën penale pa kompensim adekuat. Kundër aktvendimit me të cilin gjykata cakton masa të përkohshme të sigurisë, mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditëve. Vendimi sipas ankesës gjykata drejtpërdrejt më e lartë do ta miratojë në afat prej tetë ditëve.

Konfiskim të dobisë pronësore gjykata mund të shqiptojë në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, me aktvendimin për vërejtje gjyqësore ose aktvendimin për zbatimin e masës edukative, si dhe aktvendimin me të cilin shqiptohet masa e sigurisë. Në shqiptimin e aktgjykimit ose të aktvendimit gjykata do të theksojë cila pronë ose send, përkatësisht shumë në para konfiskohet. Kopja e vërtetuar e aktgjykimit, përkatësisht e aktvendimit i dorëzohet edhe personit mbi të cilin është bartur dobia pronësore, si edhe përfaqësuesit të personit juridik, nëse

gjykata ka shqiptuar konfiskim të pronës ose dobisë pronësore nga ai person, përkatësisht nga personi juridik.

Personi nga neni 531 të këtij ligji, mund të parashtojë kërkesë për përsëritjen e procedurës penale në pikëpamje të vendimit për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore.

Dispozitat e nenit 412 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji dhe neneve 420 dhe 424 të këtij ligji, në mënyrë përkatëse do të zbatohen në ankesën kundër vendimit për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore.

Kur ekzistojnë pengesa faktike ose juridike për mbajtjen e procedurës penale kundër personit të caktuar, gjykata sipas propozimit të prokurorit publik do të zbatojë procedurë të veçantë për konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve, nëse janë përmbushur kushtet për zbatimin e këtyre masave të veçanta nga Kodi penal. Në procedurën nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata do t'i nxjerrë provat e nevojshme prej të cilave do të përcaktojë se bëhet fjalë për pronë ose dobi pronësore të fituara me veprën penale, ose për sende të cilat janë përdorur ose kanë ndodhur sipas dispozitave të Kodit penal. Nëse me aktvendimin e këtillë preket në të drejtën e personit të tretë, kundër vendimit të gjykatës personi prej të cilit konfiskohet prona ose dobia pronësore ose sendet, ka të drejtë ankese te gjykata drejtpërdrejt më e lartë në afat prej tetë ditëve.

Konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore realizohet në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Urdhër për zbatim e lëshon gjykata që e ka miratuar aktgjykimin e plotfuqishëm. Realizimi zbatohet mbi pronën dhe dobinë pronësore të përcaktuara me vendim gjyqësor, e nëse kjo është pjesërisht ose plotësisht nuk është e mundur, realizimi zbatohet nga prona e mbetur e personit të cilit i është shqiptuar masa e atillë. Kundërshtimi ndaj zbatueshmërisë nuk lejohet, ndërsa realizimi me detyrim do të ndërpritet vetëm nëse personi vullnetarisht e kthen pronën ose e paguan lartësinë e dobisë pronësore në llogari të gjykatës. Bankat dhe institucionet tjera financiare në të cilat është llogaria në të cilën është realizuar kjo masë, janë të obliguara që ta kryejnë pa asnjë prolongim dhe të pengojnë bartjen eventuale ose transaksionet financiare. Veprat juridike të lidhura pas kryerjes së veprës penale, e me qëllim të zvogëlimit të vlerës së pronës që është lëndë e konfiskimit, janë të pavlefshme. Kundërshtimi është i lejuar vetëm për urdhrin me të cilin përcaktohet përmbarimi mbi pronën e mbetur. Kundërshtimi parashtrohet në afat prej tetë ditëve te gjykata drejtpërdrejt më e lartë, i cili vendimin e miraton në afat prej tetë ditëve.

Krahas dobisë pronësore indirekte nga kryerësi do të konfiskohet edhe dobia pronësore indirekte e cila përbëhet nga:

- prona në të cilën është transformuar ose shndërruar dobia e përfituar nga vepra penale;
- prona e fituar nga burime ligjore, në qoftë se dobia e përfituar nga vepra penale është e përzier, në tërësi ose pjesërisht, me pronën e tillë, deri te vlera e vlerësuar nga dobia e përzier e përfituar nga vepra penale dhe
- të hyrat ose dobi tjetër e cila del nga dobia e përfituar nga vepra penale, nga prona në të cilën dobia është përfituar nga vepra penale e transformuar ose shndërruar ose nga prona

në të cilën është përzier dobia e deri në vlerën e vlerësuar nga dobia e përzier e përfituar nga vepra penale.

Nga kryerësi do të konfiskohet dobia e direkte dhe indirekte pronësore e përfituar nga vepra penale e cila përbëhet nga paratë, sendeve të tundshme ose të patundshme me vlerë, si dhe pronësi tjetër, pronë ose aktivë, të drejta materiale dhe jo materiale, ndërsa nëse konfiskimi i tyre nuk është i mundshëm nga kryerësi do të konfiskohet pronë tjetër që i përgjigjet vlerës së dobisë së përfituar. Dobia pronësore e direkte dhe indirekte konfiskohet edhe nga persona të tretë për të cilët është realizuar me kryerjen e veprës penale.

Dobia pronësore nga paragrafi (1) konfiskohet edhe nga anëtarë të familjes së kryerësit të cilëve u është bartur nëse duket sheshazi se nuk kanë dhënë kompensim i cili i përgjigjet vlerës së dobisë së përfituar pronësore ose nga persona të tretë nëse nuk dëshmojnë se sendi ose dobia e fituar pronësore ose nga persona të tretë nëse nuk dëshmojnë se për sendin ose pronën kanë dhënë kompensim kundërligjor që i përgjigjet vlerës së dobisë së fituar pronësore.”

Nga kryerësi i veprës penale në kuadër të shoqërisë kriminale me të cilën realizohet fitim i pasurisë dhe për të cilën është përcaktuar dënim me burg së paku prej katër vjetësh, si dhe veprë penale në lidhje me terrorizmin e neneve 313, 394-a, 394-b dhe 419 për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej pesë vjetësh ose dënim më i rëndë ose është e lidhur me veprën penale pastrim i parave për të cilën është i caktuar dënim me burg së paku prej katër vjetësh, do të konfiskohet pasuria e fituar në periudhën kohore para gjykimit të cilin gjykata e përcakton sipas rrethanave të rastit, por jo më gjatë se pesë vjet para kryerjes së veprës, kur në bazë të të gjitha rrethanave gjykata është e bindur se pasuria i tejkalon të hyrat ligjore të kryerësit dhe rrjedh nga vepra e tillë.

Pasuria do të konfiskohet edhe nga persona të tretë për të cilët është realizuar me zbatimin e veprës penale. Pasuria konfiskohet edhe nga pjesëtarët e familjes së kryerësit të cilëve u është bartur kur është e dukshme se nuk kanë dhënë kundërkompensim i cili i përgjigjet vlerës së tij ose nga personat e tretë nëse nuk dëshmojnë se për mjetin ose pasurinë kanë dhënë kundërkompensim i cili i përgjigjet vlerës së tyre.

Vërejtja gjyqësore shqiptohet me aktvendim. Aktvendimi për vërejtje gjyqësore shpallet menjëherë pas mbarimit të seancës kryesore me arsye thelbësore. Në këtë rast kryetari i këshillit do ta paralajmërojë të akuzuarin se për veprën penale që e ka kryer nuk i shqiptohet dënim, pasi pritet se edhe vërejtja gjyqësore do të ndikojë mjaftueshëm në të, që më tutje të mos kryejë vepra penale. Nëse aktvendimi për vërejtjen gjyqësore shpallet në mungesë të të akuzuarit, gjykata paralajmërimin e atillë do ta shënojë në arsyetimin e aktvendimit. Për heqjen dorë nga e drejta e ankesës ose për përpunimin me shkrim të aktvendimit në mënyrë përkatëse zbatohet dispozita e nenit 486 paragrafi (2) të këtij ligji.

Në shqiptimin e aktvendimit për vërejtje gjyqësore krahas të dhënave personale për të akuzuarin, do të ceket vetëm se të akuzuarit i shqiptohet vërejtja gjyqësore për veprën që është lëndë e akuzës dhe emri ligjor i veprës penale. Shqiptimi i aktvendimit për vërejtje gjyqësore i përfshin edhe të dhënat e nevojshme nga neni 404 paragrafi (1) pikat 5) dhe 7) të këtij ligji. (3) Në

arsyetimin e aktvendimit gjykata do të paraqesë prej cilave shkaqe është udhëhequr gjatë shqiptimit të vërejtjes gjyqësore.

Aktvendimi për vërejtje gjyqësore mund të përgënjeshtrohet për shkak të bazave të cekura në nenin 414 pikat 1), 2) dhe 3) të këtij ligji, si dhe për shkak se nuk kanë ekzistuar rrethana që e arsyetojnë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore. Nëse aktvendimi për vërejtje gjyqësore përmban vendim për masa të sigurisë, konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve, për shpenzime të procedurës penale ose për kërkesat pronësore-juridike, ky vendim mund të përgënjeshtrohet nga shkaku që gjykata me rregull nuk e ka zbatuar masën e sigurisë ose për marrjen e dobisë pronësore, përkatësisht që vendimi për shpenzimet e procedurës penale ose të kërkesës pronësore juridike e ka miratuar në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Shkelja e Kodit penal në rast të shqiptimit të vërejtjes gjyqësore ekziston, vetëm për çështjet e cekura në nenin 416 pikat 1), 2), 3), 4), 5) dhe 6) të këtij ligji, edhe kur me vendim për vërejtje gjyqësore, për masën e sigurisë ose për konfiskimin e pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjen e sendeve është tejkalluar autorizimi që gjykata e ka sipas ligjit.

Nëse ankesën kundër aktvendimit për vërejtje gjyqësore e ka parashtruar paditësi në dëm të të akuzuarit, gjykata e shkallës së dytë mund të miratojë aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor dhe gjykohet me dënim ose me të cilin shqiptohet dënim me kusht, nëse konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të rregullt i ka përcaktuar faktet vendimtare, por që sipas zbatimit të rregullt të ligjit parashihet shqiptimi i dënimit. Me rastin e cilësdo ankese kundër aktvendimit për vërejtje gjyqësore gjykata e shkallës së dytë mund të miratojë aktgjykim me të cilin i akuzuari refuzohet ose i akuzuari lirohet nga akuza, konstaton se gjykata e shkallës së parë i ka përcaktuar me rregull faktet vendimtare dhe se me zbatimin e drejtë të ligjit parashihet shqiptimi i njërit nga këto aktgjykime. Kur ekzistojnë kushtet nga neni 434 të këtij ligji, gjykata e shkallës së dytë do të miratojë aktvendim me të cilin refuzohet ankesa si e pabazë dhe vërtetohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë për vërejtje gjyqësore.

Për vepra penale për të cilët mund të shqiptohen masat alternative: ppunë me dobi të përgjithshme, ndërprerje me kusht e mbajtjes së procedurës penale dhe burg shtëpiak, me propozim të prokurorit publik nëse janë plotësuar kushtet në Kodin penal për zbatimin e këtyre sanksioneve penale, gjykata mund t'i shqiptojë pa mbajtjen e seancës kryesore. Propozimi për shqiptimin e masave alternative mund të parashtrohet edhe paditësi privat.

Para shqiptimit të aktgjykimit, gjykatësi individual i thirr palët. Nëse i akuzuari para gjykatës e kundërshton miratimin e aktgjykimit për shqiptimin e masave alternative, gjykata do të hapë seancë kryesore dhe procedura do të vazhdojë sipas dispozitave për seancën kryesore në pajtim me këtë ligj. Kur i akuzuari pajtohet me propozimin, gjykata do të miratojë aktgjykim me të cilin do ta shqiptojë masën e propozuar alternative. Në aktgjykim me të cilin shqiptohet punë me dobi të përgjithshme si sanksion primar penal, gjykata do të përcaktojë:

- për cilën vepër shpallet fajtor, me shënimin e fakteve dhe rrethanave që supozojnë karakteristikë të veprës penale, si dhe të atyre prej të cilave varet zbatimi i dispozitës së caktuar të Kodit penal.
- emri ligjor i veprës penale dhe cilat dispozita të Kodit penal janë zbatuar;

- numri i përgjithshëm i orëve të punës në dobi të përgjithshme;
- numri i përgjithshëm i orëve që duhet të kryhen gjatë një jave;
- vendi i kryerjes së punës me dobi të përgjithshme dhe pasojat në rast të mospërmbajtjes ndaj masave dhe mënyrës së zëvendësimit të punës me dobi të përgjithshme me dënim me burg.

Nëse me aktgjykimin gjykata ka shqiptuar dënim me para deri në 90 gjoba ditore ose dënim me burg në kohëzgjatje deri tre muajsh kurse i akuzuari ka parashtruar kërkesë për zëvendësim me masën alternative puna me dobi të përgjithshme nga neni 58-a paragrafi (3) të Kodit penal, gjykata miraton aktvendim për mënyrën e zëvendësimit të dënimit me para, përkatësisht dënimit me burg me punë në dobi të përgjithshme.

Krahas masave alternative në aktgjykim sipas paragrafit (4) të këtij neni, gjykata mund të përcaktojë masë të konfiskimit të pronës dhe dobisë pronësore dhe marrjes së sendëve kur janë përmbushur kushtet ligjore për shqiptimin e atyre masave dhe të vendosë për kërkesat pronësore-juridike të të dëmtuarit.

Kur janë plotësuar kushtet ligjore për ndërprerje me kusht të mbajtjes së procedurës penale (neni 58-a i Kodit penal), gjykata me propozim të paditësit të autorizuar do të miratojë aktvendim për ndërprerjen e procedurës në të cilën do ta përcaktojë afatin e ndërprerjes së procedurës dhe obligimin e kryerësit që brenda atij afati të mos kryejë veprë të re penale dhe t'i përmbushë detyrat tjera të parashikuara. Pas skadimit të afatit për ndërprerje, gjykata merr aktvendim për ndërprerjen e procedurës nëse kryerësi i është përmbajtur kushteve dhe detyrave të përcaktuara me aktvendim për ndërprerjen e procedurës.

Nëse i akuzuari ka kryer veprë penale në gjendje të pavetëdijshme, prokurori publik do të parashtojë te gjykata propozim që të shqiptojë masë të sigurisë mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjen e kryerësit në institucionin shëndetësor, përkatësisht propozim për mjekim të detyrueshëm psikiatrik të kryerësit në liri nëse për shqiptimin e masës së atillë ekzistojnë kushtet e parapara me Kodin penal. Në këtë rast të akuzuarit, nëse gjendet në paraburgim, me aktvendim do t'i ndërpritet paraburgimi, por nuk do të lirohet në liri por deri në mbarimin e procedurës për zbatimin e masave të sigurisë përkohësisht do të vendoset në institucion adekuat shëndetësor ose në ndonjë lokal tjetër të përshtatshëm. Me masën nga paragrafi (1) të këtij neni, gjykata mund të përcaktojë ndalim të përkohshme të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës ose ndalim të drejtimit të automjetit. Vendimi i gjykatës dorëzohet te organet kompetente ose organizatat në të cilat kryerësi është punësuar ose e cila është kompetente për kryerjen e mbikëqyrjes mbi zbatimin e ndalimit. Pas parashtrimit të propozimit nga paragrafi (1) të këtij neni, i akuzuari patjetër duhet të ketë mbrojtës.

Për zbatimin e masave të sigurisë mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjen në institucion shëndetësor ose mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri, pas seancës së mbajtur kryesore, vendos gjykata që është kompetente për gjykim në shkallë të parë. Krahas personave që duhet të thirren në seancën kryesore do të thirren si ekspertë edhe mjekë psikiatër nga institucioni shëndetësor të cilit i është ngarkuar ekspertiza në lidhje me vlerësimin e të akuzuarit. I akuzuari do të thirret nëse gjendja e tij është e atillë që të mundet të marrë pjesë në seancën kryesore. Për

seancën kryesore do të njoftohet shoku martesor përkatësisht shoku jashtëmartesor i të akuzuarit dhe prindërit e tij, përkatësisht kujdestari, e sipas rrethanave edhe të afërmit tjerë të afërt.

Nëse gjykata, në bazë të provave të bëra vërteton se i akuzuari ka kryer vepër të caktuar penale dhe se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i vetëdijshëm, do të vendosë nëse të akuzuarin, në bazë të hetimit të personave të thirrur dhe konstatimeve dhe mendimeve të ekspertëve, do t'ia shqiptojë masën e sigurisë mjekim të detyruar psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor, përkatësisht mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri. Gjatë vendosjes se cilën nga masat e sigurisë do ta shqiptojë, gjykata nuk është e lidhur për propozimin e prokurorit publik. Nëse gjykata konstaton se i akuzuari nuk ka qenë i vetëdijshëm, do ta ndërpresë procedurën për zbatimin e masave të sigurisë. Kundër aktvendimit të gjykatës në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, mund të paraqesin ankesë të gjithë personat që kanë të drejtë ankese kundër aktgjykimit (neni 411 të këtij ligji), përveç të dëmtuarit.

Masat e sigurisë nga neni 522 paragrafi (1) të këtij ligji, mund të shqiptohen edhe kur prokurori publik në seancën kryesore do ta ndryshojë aktakuzën përkatësisht propozimkuzën me parashtrimin e propozimit për shqiptimin e atyre masave.

Kur gjykata do t'i shqiptojë dënim personit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të konsiderueshme të ulët të vetëdijes, me aktgjykimin e njëjtë do ta shqiptojë edhe masën e sigurisë të mjekimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjen në institucionin shëndetësor ose mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri ose mjekim detyrueshëm të alkoolistëve ose narkomanëve, nëse vërteton se për këtë ekzistojnë kushte ligjore.

Vendimi i plotfuqishëm me të cilin është shqiptuar masa e sigurisë mjekim i detyruar psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor, përkatësisht mjekim i detyruar psikiatrik në liri në pajtim me nenet 523 dhe 525 të këtij ligji, do të dërgohet te gjykata që është kompetente të vendosë për heqjen e aftësisë për punë. Për vendimin do të njoftohet edhe organi për kujdestari.

Sipas detyrës zyrtare ose me propozim nga institucioni shëndetësor ose nga organi për kujdestari, e sipas hetimit të prokurorit publik, gjykata që në shkallë të parë ka shqiptuar masë të sigurisë mjekim të detyruar psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetësor, do ta ndërpresë këtë masë dhe do të përcaktojë lëshim të kryerësit nga institucioni shëndetësor nëse në bazë të mendimit të mjekut përcakton se është ndërprerë nevoja e mjekimit dhe ruajtjes së kryerësit në atë institucion, e mund të përcaktojë mjekim të detyruar të tij psikiatrik në liri. Kur nga institucioni shëndetësor lëshohet kryerësi vetëdija e të cilit ka qenë tejet e ulët, e në atë institucion ka kaluar më pak kohë se sa që është dënimi me burg në të cilin është dënuar, gjykata me aktvendim për lëshim do të vendosë nëse ai person do ta mbajë mbetjen e dënimit ose do të lëshohet në lëshim me kusht. Kryerësit i cili lëshohet në lëshim me kusht mundet t'i shqiptohet edhe masë e sigurisë mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri nëse për këtë ekzistojnë kushte ligjore.

Sipas detyrës zyrtare ose me propozim nga drejtoria e institucionit shëndetësor në të cilin i akuzuari është mjekuar ose është dashur të mjekohet, ndërsa me hetimin e prokurorit publik, gjykata mundet kryerësit kundër të cilit është zbatuar masa e sigurisë së mjekimit të detyruar psikiatrik në liri t'i shqiptojë masë të sigurisë së mjekimit të detyruar psikiatrik dhe ruajtjes në institucionin shëndetësor, nëse përcakton se kryerësi nuk i është nënshtruar mjekimit ose e ka

lëshuar vullnetarisht ose nëse edhe krahas mjekimit ka mbetur i rrezikshëm për rrethin e tij e është e nevojshme ruajta e tij dhe mjekimi në institucion shëndetësor. Para miratimit të vendimit gjykata sipas nevojës do të sigurojë edhe mendim nga mjeku, ndërsa i akuzuari do të merret në pyetje nëse gjendja e tij këtë e lejon.

Për zbatimin e masës së sigurisë mjekim i detyruar i alkoolistëve dhe narkomanëve, gjykata vendos pasi që të sigurojë konstatim dhe mendim nga eksperti. Eksperti duhet të shprehet edhe për mundësitë për mjekim të të akuzuarit. Nëse gjatë shqiptimit të dënimit me kusht të kryerësit i është urdhëruar mjekim në liri, ndërsa ai nuk i është nënshtruar mjekimit ose me vet dëshirë e ka lëshuar, gjykata mundet sipas detyrës zyrtare ose me propozim të institucionit në të cilin kryerësi është mjekuar ose është dashur të mjekohet, e pas hetimit të prokurorit publik dhe të kryerësit ta përcaktojë revokimin e dënimit me kusht ose kryerjen e detyrueshme të masës së shqiptuar mjekim të detyrueshëm të alkoolistëve ose narkomanëve në institucionin shëndetësor ose në institucion tjetër të specializuar. Para miratimit të vendimit gjykata sipas nevojës do të sigurojë edhe mendim prej mjekut.

Sendet që sipas Kodit penal duhen të merren, do të merren edhe kur procedura penale nuk do të mbarojë me aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor. Aktvendim të posaçëm për këtë miraton organi para të cilit është mbajtur procedura në momentin kur procedura është kryer, përkatësisht kur është ndërprerë. Aktvendimin për marrjen e sendeve nga paragrafi (1) të këtij neni e miraton gjykata edhe kur në aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor, është lëshuar marrja e vendimit të atillë. Kopja e vërtetuar e vendimit për marrjen e sendeve do të dorëzohet te pronari i sendeve nëse pronari është i njohur. Kundër vendimit nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, pronari i sendeve ka të drejtë ankese për shkak të mosekzistimit të bazës ligjore për marrjen e sendeve. Nëse aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e ka miratuar gjykata, për ankesën vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të këtij ligji i gjykatës që ka qenë kompetente për gjykimin në shkallë të parë.

Kur në dënimin me kusht është përcaktuar se dënimi do të zbatohet nëse i dënuari nuk e kthen dobinë pronësore, nuk e kompenson dëmin ose nuk plotëson kushte tjera, e i dënuari në afatin e përcaktuar nuk i përmbush këto kushte, gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë do të zbatojë procedurë për revokimin e akuzës me kusht me propozim nga paditësi i autorizuar, e mundet edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykatësi i cili do të përcaktohet për këtë do ta marrë në pyetje të dënuarin nëse është i kapshëm dhe do t'i zbatojë kontrollet e nevojshme për vërtetimin e fakteve dhe grumbullimin e provave të rëndësishme për vendimin. Pastaj kryetari i këshillit do të caktojë seancë të këshillit për të cilën do t'i njoftojë paditësin, të dënuarin dhe të dëmtuarin. Mosardhja e palëve dhe të dëmtuarit nëse janë të njoftuar me rregull, nuk e pengon mbajtjen e seancës së këshillit. Nëse gjykata vërteton se i dënuari nuk e ka përmbushur obligimin që i është përcaktuar me aktgjykim, do të miratojë aktgjykim me të cilin do ta vazhdojë afatin për përmbushjen e obligimit, do ta lirojë nga përmbushja e atij obligimi ose do ta zëvendësojë me detyrë tjetër adekuate të paraparë me ligj, ose do ta revokojë dënimin me kusht dhe do të përcaktojë dënimi i përcaktuar të zbatohet. Nëse gjykata konstaton se nuk ka bazë për miratimin e ndonjë prej këtyre vendimeve, me aktvendim do ta ndërpresë procedurën për revokimin e dënimit me kusht.

Kur sipas ligjit shlyerja e dënimit paraqitet me kalimin e kohës së caktuar dhe me kusht që i dënuari në atë kohë të mos kryejë veprë të re penale, aktvendim për shlyerjen e dënimit miraton sipas detyrës zyrtare gjykata si organ kompetent për mbajtjen e evidencës ndëshkuese. Para miratimit të aktvendimit për shlyerjen e dënimit do të realizohen kontrollet e nevojshme, e posaçërisht do të grumbullohen të dhëna për atë nëse kundër të dënuarit është në vazhdim procedura penale për ndonjë veprë të re penale, të kryer para skadimit të afatit të paraparë për shlyerjen e akuzës.

Nëse gjykata nuk miraton aktvendim për shlyerjen e dënimit, personi i dënuar mund të kërkojë që të përcaktohet se shlyerja e dënimit ka ndodhur sipas ligjit. Për këtë kërkesë vendos gjykata pas hetimit të prokurorit publik, nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij.

Nëse dënimi me kusht nuk revokohet as pas një viti nga dita e ndërprerjes së kohës për kontroll, gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë do të miratojë aktvendim me të cilin vërtetohet shlyerja e dënimit me kusht. Ky aktvendim do të dorëzohet te i dënuari dhe te prokurori publik, nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij.

Procedurë për shlyerjen e akuzës në bazë të vendimit gjyqësor, ngritet me kërkesë të të dënuarit. Kërkesa parashtrohet te gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë. Gjykatësi i cili do të përcaktohet për këtë, paraprakisht do të hetojë nëse ka kaluar koha e nevojshme sipas ligjit, e pastaj do t'i zbatojë kontrollet e nevojshme, do t'i vërtetojë faktet në të cilat thirrret kërkuesi dhe do të sigurojë prova për të gjitha rrethanat që janë të vlefshme për vendimin. Gjkata mundet për sjelljen e të dënuarit të kërkojë raport nga gjykatat në rajonin e të cilave i dënuari ka qëndruar pas vuajtjes së dënimit, e mundet raport të atillë të kërkojë edhe nga drejtoria e institucionit në të cilin i dënuari e ka vuajtur dënimin. Pas kontrolleve të bëra dhe pas hetimit të prokurorit publik, nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij, gjykatësi do t'i dorëzojë dokumentet me propozimin e arsyetuar te këshilli që ka gjykuar në shkallë të parë. Kundër vendimit të gjykatës pas kërkesës për shlyerjen e akuzës, ankesë mund të parashtrijë lutësi dhe prokurori publik. Nëse gjykata e refuzon kërkesën pasi që i dënuari me sjelljen e tij nuk ka merituar shlyerje të dënimit, i dënuari mundet kërkesën ta përsërisë pas skadimit të dy vjetëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për refuzim të lutjes. Në vërtetimin që i lëshohet qytetarëve për shlyerje të dënimit në bazë të evidencës ndëshkuese, për realizimin e të drejtave të tyre në shtetet tjera, dënimi i shlyer nuk guxon të përmendet.

Kërkesa për kohëzgjatje më të shkurtër të dënimeve për ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ndalim të drejtimit me automjet ose për ndërprerjen e pasojave juridike të dënimit dhe për shlyerjen e dënimit, parashtrohet te gjykata që ka gjykuar në shkallë të parë. Gjykatësi i cili do të përcaktohet për këtë, paraprakisht do të hetojë nëse ka kaluar koha e nevojshme sipas ligjit, ndërsa do t'i realizojë kontrollet e nevojshme, do t'i vërtetojë faktet në të cilat thirrret kërkuesi dhe do të sigurojë prova për të gjitha rrethanat që janë të vlefshme për vendimin. Për sjelljen e të dënuarit gjykatësi mund të kërkojë raport nga gjykatat në rajonin e të cilit i dënuari ka qëndruar pas vuajtjes, faljes ose dënimit të parashkruar kryesor, ndërsa mundet raport të atillë të kërkojë edhe nga institucioni në të cilin i dënuari e ka vuajtur dënimin. Pas kontrolleve të zbatuara, e pas hetimit të prokurorit publik, nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij, gjykatësi do t'i dorëzojë dokumentet me propozim të arsyetuar, te gjykata kompetente për miratimin e aktvendimit për kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni. Gjkata nga

paragrafi (4) të këtij neni, më parë do të sigurojë mendim nga prokurori publik nëse procedura është mbajtur me kërkesë të tij, i cili vepron para asaj gjykate. Në rast të refuzimit të kërkesës, kërkesë e re nuk mund të parashtrohet para skadimit të një viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për refuzimin e kërkesës së mëparshme.

PROCEDURAT ALTERNATIVE NË DISA VENDE TË TJERA

I. Konsiderata të përgjithshme

Terminologjia:

- Procedura alternative
- Procedura konsensuale
- Plea bargaining (fjalë për fjalë “pazar për pranimin e fajësisë”)
- Marrëveshje për pranimin e fajësisë (marrëveshje për pranimin e fajësisë)
- Gjykim i përshpejtuar, i shkurtuar, i drejtpërdrejtë, i menjëhershëm ose i përmbledhur
- Pretrial diversion (devijim i fazës paragjykimore)
- Shtyrje e ndjekjes penale¹⁰³

Arsye të zakonshme për të krijuar procedura alternative:

- Shumica e personave nën hetim janë fajtorë dhe nuk i kundërshtojnë akuzat, që do të thotë se nuk ka fakte që kundërshtohen dhe, për rrjedhojë, nuk ka nevojë për gjykim, në të cilin të sqarohen këto fakte.
- Prokuroritë dhe gjykatat janë zakonisht të mbingarkuara dhe kanë nevojë të gjejnë mënyra për të menxhuar me efektivitet çështjet.
- Tendencat e reja të kriminalitetit kërkojnë dhënien e dënimeve të individualizuara dhe kreative.
- Në vende që aplikojnë gjykimin me juri, gjykimet janë shumë të kushtueshëm dhe kërkojnë shumë kohë e burime për t'u planifikuar.
- Hetimet komplekse kanë nevojë për bashkëpunimin e dëshmitarëve dhe ky bashkëpunim mund të arrihet vetëm nëse dëshmitarëve u jepen përfitime në këmbim të bashkëpunimit¹⁰⁴.

Kategoritë kryesore të procedurave alternative:

Procedurat alternative mund të zhvillohen gjatë hetimit ose gjatë gjykimin. Ato mund të ndahen në disa kategori:

1. Devijim i fazës paragjykimore ose procedura që sjellin pushimin e çështjes
2. Pajtimi mes viktimës dhe autorit
3. Urdhrrat penalë
4. Gjykimet e shkurtuar
5. Marrëveshja për pranimin e fajësisë

¹⁰³ Christie, Nils. (1977), British Journal of Criminology, 17 (1).

¹⁰⁴ Christie, Nils. (1977), British Journal of Criminology, 17 (1); Conklin, J. “Criminology”, Tufts University, USA, 1995; Gottfredson, M. & Hirschi, T. (1990), A general theory of crime, Stanford: Stanford Univ. Press; Haines, K. (2000), Referral Orders and the New Youth Justice, in: Goldson, B. (ed) The New Youth Justice, Lyme Regis: Russell House Publishing; Hirschi, T. (1969) Causes of Delinquency. Berkeley: Univ. of California Press.

Në *devijimin e fazës paragjykimore*, çështja, që si rregull ka të bëjë me një vepër të lehtë, pezullohet për një periudhë kohe dhe të pandehurit i vendosen disa kushte. Nëse i pandehuri i plotëson kushtet, çështja penale kundër tij pushohet. Kushtet mund të përfshijnë pagimin e dëmeve, gjobave, punë në shërbim të komunitetit, trajtim kundër drogave/alkoolit, etj. Gjatë diskutimit të kushteve, zhvillohen negociata ose “pazare” mes palëve. Devijimi i fazës paragjykimore kritikohet sepse viktimat nuk ka ndikim mbi këtë procedurë; dënimi vendoset pa përcaktim të fajësisë dhe nga prokurori e jo nga gjykata dhe sepse procedura sjell një dekriminalizim faktik të veprave penale.

Pajtimi mes viktimës dhe autorit kërkon pjesëmarrje aktive nga të dyja palët, por mund të jetë shumë i kufizuar në zbatimin e tij, për shkak të natyrës së veprës së kryer. Në disa vende, kjo procedurë kryhet nga një ndërmjetës i paanshëm, kurse në vende të tjera përfshihen edhe prokurori e gjyqtari.

Urdhrat penalë përdoren kryesisht për vepra që dënohen me gjobë ose periudhë të shkurtër burgimi. Në këto raste, prokurori paraqet një propozim të shkruar për akuzën dhe dënimin dhe i cakton të pandehurit një kohë të shkurtër për ta pranuar ose refuzuar propozimin. Nëse i pandehuri refuzon, çështja vazhdon në rrugën normale. Zakonisht, zhvillohen negociata në fazat e hershme të kësaj procedure dhe ajo duhet të aprovohet nga gjykata. Ulja në masën e dënimit është e përcaktuar nga ligji. Urdhrat penalë kritikohen sepse i pandehuri humbet të drejtën për t’u dëgjuar; është prokurori ai që vendos pa u zhvilluar gjykim, pa përcaktim të shprehur të fajësisë dhe me kontroll gjyqësor minimal.

Marrëveshja (pazari) për pranimin e fajësisë mund të përkufizohet si një formë negociate, nëpërmjet të cilës prokurori dhe mbrojtja arrijnë një marrëveshje për sqarimin e një ose disa akuzave penale kundër të pandehurit, pa zhvilluar gjykim. Ka tre forma të marrëveshjes për pranimin e fajësisë:

1. Marrëveshje (pazar) për akuzën – prokurori mund të bjerë dakord të pushojë një ose disa akuza apo të mos ngrejë akuzë për vepra të caktuara.
2. Marrëveshje për dënimin – prokurori dhe mbrojtja negociojnë dënimin, pa rënë dakord mbi akuzën e ngritur.
3. Marrëveshje për faktet – i pandehuri pranon disa fakte, duke eliminuar nevojën që prokurori t’i provojë ato, në këmbim të marrëveshjes për të mos përfshirë në objektin e të provuarit disa fakte të tjera.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë përdoret gjerësisht në juridiksione common law, ndërsa në Evropë ekzistojnë disa mekanizma për pranimin e fajësisë që filluan me procedurën e *patteggiamento-s* në Itali. Disa vende në Evropë kanë adoptuar marrëveshje të llojit common law, pavarësisht traditës së tyre civile.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë, vecanërisht ajo e tipit common law, kritikohet në disa drejtime. Kritikata më të shpeshta janë renditur më poshtë¹⁰⁵:

¹⁰⁵ Christie, Nils. (1977), *British Journal of Criminology*, 17 (1); Conklin, J. “Criminology”, Tufts University, USA, 1995; Gottfredson, M. & Hirschi, T. (1990), *A general theory of crime*, Stanford: Stanford Univ. Press; Haines, K.

- Shkel parimin e ligjshmërisë sepse nuk kërkon gjykim dhe gjetje gjyqësore të të vërtetës.
- Detyron të pandehurit të pranojnë fajësinë.
- Inkurajon trajtim të pabarantë të të pandehurve për shkak të qasjeve të ndryshme të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe për shkak të nevojës për avokatë të mirë për të arritur një marrëveshje të mirë ose për të përballuar gjyqin.
- Sjell ulje të shpërpjestuar të dënimeve në krahasim me rëndësinë e veprës.
- Vendimit i mungon pjesa tradicionale e arsytimit, kurse mundësitë për ankim janë të kufizuara.
- Ulja e shpenzimeve dhe shpejtësia bëhen më të rëndësishme se garancitë procedurale për të pandehurin.
- Është prokurori dhe jo gjykata që përcakton akuzën dhe dënimin.
- Prokurorët do të ngrenë akuza të tepërta në mënyrë që t'i bëjnë të pandehurit presion të pranojë fajësinë në këmbim të pushimit të disa prej tyre.
- Inkurajon mashtrimin dhe mungesën e ndershmërisë, sepse indirekt inkurajon kontrolle e pyetje të paligjshme që nuk do të kundërshtohen në gjykim.

Gjykimet e shkurtuara ekzistojnë në forma të ndryshme dhe me emra të ndryshëm. Mund të përkufizohet në mënyrë të përgjithshme si një procedurë e shkurtuar, në të cilën gjyqtari vlerëson provat së bashku me pranimin e fajësisë nga i pandehuri (disa nga procedurat nuk kërkojnë që i pandehuri të pranojë fajësinë) dhe, pasi përcakton fajësinë, i cakton të pandehurit një dënim të ulur sipas përcaktimeve ligjore. Gjykimet e shkurtuar nuk përfshijnë negociata mes prokurorit dhe mbrojtjes dhe ulja e dënimit është e përcaktuar qartë nga ligji.

Pasoja të mundshme të padëshiruara të futjes së procedurave alternative:

- Shkelja e të drejtave të të pandehurit
- Përkeqësimi i perceptimit publik për gjyqësorin
- Inkurajimi i pohimeve të detyruara nga ana e të pandehurve
- Dështimi në importimin e këtyre procedurave në sistemin ligjor

Probleme të mundshme me negociatat mes prokurorit dhe mbrojtjes:

- Publiku i gjerë dyshon tek informaliteti ose shfaqja e informalitetit në këto negociata.
- Nëse prokurori ka pushtet të madh diskrecionar, negociatat mund të kthehen në një formë detyrimi për të pandehurin.
- Negociatat mund të krijojnë pabarazi mes prokurorit dhe mbrojtjes, vecanërisht për të pandehur që nuk kanë mundësi të marrin avokat të mirë.

(2000), Referral Orders and the New Youth Justice, in: Goldson, B. (ed) The New Youth Justice, Lyme Regis: Russell House Publishing; Hirschi, T. (1969) Causes of Delinquency. Berkeley: Univ. of California Press.

II. Procedurat alternative në legjislacionin aktual shqiptar

KPP-ja parashikon vetëm një alternativë ndaj gjyqimit të plotë: gjykimin e shkurtuar. Kërkesa për gjykim të shkurtuar mund të bëhet vetëm nga i pandehuri dhe vetëm pasi çështja të jetë dërguar për gjykim. Kjo do të thotë se prokurori duhet të zhvillojë hetim të plotë dhe të përgatitet për gjyq. Kjo procedurë mund të përdoret për të gjitha veprat penale.

Pasi fillon gjykimi, i pandehuri ka të drejtë të kërkojë që të zhvillohet gjykim i shkurtuar. I pandehuri nuk ka nevojë të pranojë fajësinë, si kusht për pranimin e gjyqimit të shkurtuar; ai mund të deklarohet i pafajshëm. Prokurori mund ta kundërshtojë zhvillimin e gjyqimit të shkurtuar, por kjo ndodh rrallë, ndërkohë që mendimi i tij nuk është detyrues për gjykatën. Standardi që gjykata të pranojë gjykimin e shkurtuar është që çështja mund të zgjidhet me provat e mbledhura gjatë hetimit paraprak dhe se nuk ka nevojë për prova të reja. Kur pranohet kërkesa, gjykimi përfshin vetëm parashtrimin hyrës, marrjen e provave të ndodhura në dosjen hetimore dhe konkluzionet përfundimtare. Dëshmitarët nuk thirren në gjykim, por lexohen deklaratimet e tyre para prokurorit. I pandehuri nuk mund të sjellë prova të reja, por ai mund ta ndërtojë mbrojtjen e tij mbi provat e prokurorit dhe të pretendojë pafajësi. Në përfundim, gjykata mund të japë fajësi, pafajësi apo të pushojë çështjen. Nëse i pandehuri deklarohet fajtor, dënimi i tij caktohet sipas rregullave të përgjithshme dhe pastaj ulet me 1/3. Gjykimi i shkurtuar shpesh nuk përfundon me një seancë e, madje, mund të zgjatet me muaj. KPP-ja dhe një praktikë e qëndrueshme e Gjykatës së Lartë e kanë kushtëzuar pranimin e gjyqimit të shkurtuar me pranimin e provave (akteve), por ka patur raste kur gjykatat kanë deklaruar pavlefshmëri të akteve ose papërdorshmëri të provave gjatë gjyqimit të shkurtuar.

Gjykimi i drejtpërdrejtë është një procedurë tjetër që synon shmangien e një hetimi formal. Gjykimi i drejtpërdrejtë, si rregull, zbatohet kur i dyshuari është arrestuar në flagrancë. Kjo procedurë nuk mund të zbatohet nëse arresti ka qenë i paligjshëm, përveçse nëse i pandehuri pranon që të procedohet me gjykim të drejtpërdrejtë, por ai nuk ka ndonjë përfitim nga ky fakt. Gjykimi i drejtpërdrejtë mund të zbatohet edhe kur i pandehuri është i lirë, por ai ka pohuar veprën e kryer dhe fajësia e tij është e qartë edhe nga prova të tjera. Gjykimi i drejtpërdrejtë nuk është i ndryshëm në asnjë aspekt nga gjykimi i zakonshëm dhe nuk përdoret gjerësisht.

III. Procedurat alternative në disa shtete të tjera

Bosnja dhe Hercegovina¹⁰⁶

Bosnia dhe Hercegovina është një vend i të drejtës civile më një traditë inkuizitore në drejtësinë penale. Indeksi i korrupsionit (TI) ka qenë pak a shumë i qëndrueshëm në vitet e fundit: 3.3 në 2007 dhe 3.2 në 2011. Në 2003, BiH miratoi një KPP të ri, i cili është një hibrid mes modeleve common law dhe të të drejtës civile. Kodi krijoi një sistem kundërshtar dhe gjithashtu parashikoi marrëveshjet për pranimin e fajësisë.

¹⁰⁶ Aertsen, Ivo., Mackey, Robert., Pelikan, Christa., Willemsens, Jolien., Wright, Martin., (2004) Rebuilding Community Connections – Mediation and Restorative Justice in Europe, Council of Europe Publishing.

Termi i përdorur nga Kodi është “*negociata për kushtet e pranimin të fajësisë*”, dhe mekanizmi i krijuar në Bosnje dhe Hercegovinë futet kryesisht në kategorinë e marrëveshjeve për dënimin. Dispozitat e KPP-së nuk lejojnë marrëveshjen mbi akuzën dhe faktet. Prokurori ka pushtet diskrecionar për të mos vazhduar ndjekjen penale vetëm në dy raste, njëri prej të cilëve është kur ai vendos t’i japë imunitet një dëshmitari të rëndësishëm për shkaqe të përcaktuara qartë. Prokurori mund të propozojë një dënim më të ulët se minimumi i parashikuar në ligj.

Gjyqtari, kur e pranon marrëveshjen, urdhëron caktimin e dënimit për të cilin është rënë dakord. Shumica e juristëve mendojnë se gjyqtari nuk ka mundësi që ta pranojë marrëveshjen dhe të caktojë një dënim të ndryshëm nga ai për të cilin është rënë dakord. I pandehuri heq dorë nga e drejta për të ankimuar dënimin e caktuar. Një karakteristikë tjetër e vecantë në BiH është që marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të kërkohet edhe nëpërmjet ankimit, që do të thotë se mund të zhvillohet një gjykim i plotë dhe çështja të mbyllet me një marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Gjykata duhet të njoftojë viktimën për rezultatin e marrëveshjes. Viktima nuk ka të drejta të tjera.

Ky mekanizëm kritikohet sepse krijon pabarazi mes prokurorit dhe mbrojtjes, sepse është vërejtur mosrespektim i të drejtës për mbrojtje edhe gjatë seancave për miratimin e marrëveshjes dhe sepse nuk është arritur të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë në raste të caktuara.

Procedura për lëshimin e urdhrit për caktimin e dënimit zbatohet për krime që dënohen deri në 5 vjet burgim ose me gjobë. Në rastet kur prokurori beson se ka mbledhur mjaftueshëm prova, ai mund të kërkojë në dokumentin e akuzës që dënimi të caktohet pa u zhvilluar gjykim. Nëse gjyqtari bie dakord me kërkesën, cakton një seancë në të cilën sigurohet që i pandehuri e kupton akuzën dhe kërkesën e prokurorit. Nëse i pandehuri deklarohet i pafajshëm ose e kundërshton kërkesën, gjykata vazhdon me gjykim të zakonshëm. Nëse i pandehuri deklarohet fajtor dhe e pranon kërkesën, gjykata përcakton fajësinë e tij dhe cakton dënimin.

Gjeorgjia¹⁰⁷

Gjeorgjia është një vend i traditës së të drejtës civile, por sistemi aktual i drejtësisë penale është një përzierje e sistemeve të të drejtës civile dhe common law me natyrë kundërshtarë. Gjeorgjia aplikon gjykimet me juri. Indeksi i korrupsionit (TI) është përmirësuar nga 1.8 në 2003 në 4.1 në 2011.

Marrëveshjet për pranimin e fajësisë u futën në vitin 2003, si pjesë e një pakete kundër korrupsionit dhe termi i përdorur nga KPP-ja është “*gjykim pa shqyrtim në themel të çështjes*”. KPP-ja lejon si marrëveshjet për akuzën, ashtu edhe ato për dënimin. Përqindja e përdorimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë është rritur nga 12.7% në 2005 në 79.5% në 2010.

Rregullat për pranimin e fajësisë u përmirësuan me KPP-në e ri të vitit 2009 dhe përfshijnë shumë garanci për të pandehurin:

¹⁰⁷ Aertsen, Ivo., Mackey, Robert., Pelikan, Christa., Willemsens, Jolien., Wright, Martin., (2004) Rebuilding Community Connections – Mediation and Restorative Justice in Europe, Council of Europe Publishing.

- Pjesëmarrja personale e mbrojtësit është e domosdoshme që marrëveshja të pranohet.
- I pandehuri ka të drejtë ta refuzojë marrëveshjen në cdo fazë të procedimit penal derisa gjykata nuk ka dhënë ende vendim.
- Nëse marrëveshja refuzohet, është e ndaluar të përdoren të deklaratimet që ka dhënë i pandehuri si pjesë e saj.
- I pandehuri ka të drejtë të ankimojë vendimin e dhënë si pasojë e marrëveshjes, nëse marrëveshja u arrit me mashtrim, shtrëngim, kërcënim apo dhunë.
- Gjatë diskutimit të marrëveshjes, prokurori është i detyruar të marrë në konsideratë interesin publik, ashpërsinë e dënimit, karakteristikat personale të të pandehurit.
- Për të evituar abuzimin me pushtetin, për të arritur marrëveshje apo për ta ndryshuar atë është i nevojshëm miratimi me shkrim i prokurorit më të lartë.
- Marrëveshja është e papranueshme nëse kufizon të drejtën e të pandehurit për të bërë kallëzim penal për torturë.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë nuk ka fuqi ligjore pa u miratuar nga gjykata. Gjykata duhet të bindet që marrëveshja për pranimin e fajësisë është arritur me vullnetin e lirë të të pandehurit, që i pandehuri i kupton plotësisht thelbin dhe pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk mjafton për dhënien e një vendimi fajësie. Gjykata duhet të diskutojë dy çështje të rëndësishme:

- Nëse janë paraqitur prova të pakundërshtueshme që provojnë fajësinë tij përtej cdo dyshimi të arsyeshëm;
- Nëse dënimi i parashikuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë është i ligjshëm.

Gjyqtari nuk mund ta ndryshojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë pa pëlqimin e të dy palëve, por mund të bëjë vetëm rekomandime ose ta refuzojë marrëveshjen.

Prokurori është i detyruar të njoftojë viktimën para se të përfundojë një marrëveshje për pranimin e fajësisë. Prokurori është i detyruar të marrë në konsideratë interesat e viktimës dhe, si rregull, ta përfundojë marrëveshjen për pranimin e fajësisë vetëm pasi janë kompensuar dëmet.

Mekanizmi për pranimin e fajësisë i krijuar në Gjeorgji kritikohet për arsyet e mëposhtme:

- Prokurorët kanë të drejta të pakufizuara në pazarin për dënimin dhe nuk janë të detyruar të tregojnë se çfarë bashkëpunimi fituan si pasojë e marrëveshjes, kurse gjyqtarët kanë autoritet të kufizuar në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë.
- Këto faktorë, të kombinuar me përqindje shumë të larta të vendimeve të fajësisë (98.3% në 2010), një politikë shume të ashpër dënimesh dhe besimin e ulët të publikut tek sistemi i drejtësisë ndikojnë që të pandehurit të pranojnë fajësinë edhe kur janë të pafajshëm, gjë që con në një shtrembërim të drejtësisë.
- Marrëveshjet janë kthyer në një mënyrë për të blerë lirinë. Herë-herë të pandehurit zgjedhin marrëveshjen për pranimin e fajësisë edhe nëse janë të pafajshëm, sepse janë pothuasje të sigurt që nuk do të marrin pafajësinë në gjykim. Roli i mbrojtësit fillon pasi i pandehuri ka pranuar të vetëdeklarohet fajtor.

- Marrëveshja për pranimin e fajësisë përdoret për të shtrënguar të pandehurit të heqin dorë nga kallëzimet për torturë.
- Marrëveshjet kanë patur rol shumë të vogël në sigurimin e dëshmitarëve bashkëpunues.

Franca¹⁰⁸

Gjykimi i menjëhershëm fillon me iniciativën e prokurorit, kur ai cmon se akuzat janë mjaftueshëm të provuara dhe çështja është e gatshme për gjykim. Kjo procedurë zbatohet nëse maksimumi i dënimit të parashikuar për veprën është jo më pak se 2 vjet burgim, si edhe për kundërvajtje në flagrancë që dënohen me jo më pak se 6 muaj burgim. Në rastin e fundit, i pandehuri mbahet në paraburgim deri në momenti që del para gjykatës, gjë që duhet të ndodhë në të njëjtën ditë.

Nëse i pandehuri nuk bie dakord që të gjykohet në atë moment, gjyati e shtyn seancën për një ditë tjetër, jo më pak se dy dhe jo me shumë se gjashtë javë më vonë, përveçse kur i pandehuri heq dorë nga kjo e drejtë.

Procedura e thjeshtuar për kundërvajtje të Kodit Rrugor nuk zbatohet nëse i pandehuri është nën 18 vjec, nëse viktimi ka paraqitur një kërkesë për kthimin e sendit ose pagimin e dëmeve ose nëse kundërvajtja është kryer njëkohësisht më veprën e vrasjes nga pakujdesia apo plagosjes. Prokurori e fillon procedurën kur hetimi ka arritur të përcaktojë veprën e kryer dhe të mbledhë mjaftueshëm informacione për të ardhurat dhe shpenzimet e të pandehurit, të cilat lejojnë aktimin e dënimit. Dosja i dërgohet gjyqtarit, i cili merr vendim nëpërmjet një urdhri penal, pa zhvilluar seancë. Urdhri mund të përmbajë rrëzimin e akuzave ose caktimin e një gjobe dhe, kur është e përshatshme, edhe caktimin e dënimeve të tjera plotësuese. Dënimet plotësuese mund të caktohen edhe në vend të dënimit kryesor. Nëse gjykon se duhet zhvilluar seancë apo se duhet caktuar dënim me burgim, gjyqtari ia kthen dosjen prokurorit. Urdhri mund të ankimohe në gjykatën e korrektimit, e cila mund ta ndryshojë dënimin në dënim me burgim.

Procedura e thjeshtuar për krime të lehta zbatohet për krime të lehta. Prokurori që zgjedh të zbatojë procedurën e thjeshtuar ia dërgon dosjen dhe kërkesën e tij gjyqtarit të gjykatës së policisë. Gjyqtari merr vendim pa zhvilluar seancë, duke nxjerrë një urdhër penal. Ky urdhër përmban rrëzimin e akuzës ose caktimin e një gjobe, së bashku me dënime të tjera plotësuese, kur është e nevojshme. Nëse vlerëson se është i nevojshëm debati kundërshtar, gjyqtari ia kthen dosjen prokurorit për ta ndjekur në rrugën e zakonshme procedurale. Gjyqtari nuk është i detyruar të arsyetojë urdhrin e tij penal.

Për krime të lehta të katër kategorive të para, ndjekja penale shuhet nëpërmjet pagimit të një gjobe fikse. Megjithatë, procedura e gjobës fikse nuk mund të zbatohet nëse i pandehuri ka kryer disa vepra penale dhe të paktën njëra prej tyre nuk dënohet me gjobë fikse.

Për krimet e lehta të katër kategorive të para kundër rregullave të transportit publik hekurudhor dhe shërbimeve të transportit të njerëzve, ndjekja penale shuhet nëpërmjet një transkasioni mes ofruesit të shërbimit dhe autorit. Transaksioni kryhet nëpërmjet pagimit të një kompensimi fikse,

¹⁰⁸ Pallazzo. F, Papa. M “Lezioni di diritto penale comparato”, (2000), Giappichelli editors, Padova.

së bashku me cmimin e biletës, nëse është e nevojshme. Megjithatë, procedura e transaksionit nuk mund të zbatohet nëse i pandehuri ka kryer njëkohësisht disa vepra penale dhe të paktën njëra prej tyre nuk mund të zgjidhet me anë të transaksionit.

Ndërmjetësimi penal lejohet për vepra penale të lehta (plagosje, kërcënime, vjedhje e thjeshtë, mospagimi i detyrimit ushqimor, etj) dhe fillon me iniciativën e prokurorit. Faktet duhet të jenë të thjeshta, të përcaktuara qartë dhe të mjaftueshëm për të treguar se është kryer veprë penale. Autori duhet t'i pranojë faktet. Nëse arrihet marrëveshje mes autorit dhe viktimës, ndërmjetësi harton një marrëveshje me kushtet, e cila nënshkruhet nga të dyja palët. Nëse nuk arrihet marrëveshje ose palët nuk zbatojnë kushtet e saj, ndërmjetësi ia kalon çështjen prokurorit, i cili mund të fillojë një çështje penale ose ta arkivojë rastin.

Formula penale (*composition penale*) është një procedurë që i lejon prokurorit të propozojë një ose më shumë alternativa ndaj ndjekjes penale për disa lloje krimesh. Kjo procedurë mund të zbatohet për të pandehur të rritur dhe të mitur. I pandehuri duhet të pranojë masat e propozuara, si edhe të pranojë faktet sic i ka prezantuar prokurori. Masat që propozon prokurori janë të ndryshme (arsimim, trajtim, shërbim publik, etj) dhe mund të shoqërohen me gjobë. Në cdo rast, nëse është identifikuar viktimë, prokurori duhet t'i kërkojë të pandehurit ta kompensojë atë dhe të njoftojë viktimën për këtë fakt.

Nëse formula pranohet nga i pandehuri, prokurori ia dërgon kërkesën për konfirmim gjyqtarit kompetent. Gjyqtari mund të dëgjojë të pandehurin dhe viktimën. Nëse gjyqtari e konfirmon formulën, masat vihen në ekzekutim. Nëse gjyqtari e refuzon formulën, propozimi humbet fuqinë. Palët nuk kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e gjyqtarit për refuzimin e formulës.

Nëse autori nuk e pranon propozimin ose nuk i zbaton kushtet, prokurori fillon një çështje penale. Në këtë rast, të pandehurit i llogariten pagesat që ka bërë apo puna që ka kryer.

Paraqitja pas pranimit të fajësisë (*comparution sur reconnaissance préalable de culpabilité*, e quajtur ndryshe edhe "*plaider-coupable*" ose vetëdeklarim i fajësisë) i lejon prokurorit të propozojë, drejtpërdrejt dhe pa gjyq, një ose disa dënime kundër personit që i pranon faktet që i atribuohen.

Kjo procedurë zbatohet për persona mbi 18 vjec që pranojnë se e kanë kryer krimin. Procedura nuk zbatohet për disa lloje të krimeve të rënda: sulme, kërcënime dhe dhunë seksuale që dënohen me të pakët 5 vjet burgim; vrasje nga pakujdesia; krime politike, etj.

Procedura fillon me propozimin e gjyqtarit të instruksionit, të prokurorit, të pandehurit ose mbrojtësit të tij. Viktimë duhet të njoftohet pa vonesë për fillimin e procedurës. Viktimë mund të ngrejë një padi civile dhe të dëgjohej gjatë procedurës.

Prokurori mund të propozojë një ose më shumë dënime kryesore ose plotësuese. Ai mund të propozojë ose një dënim me burgim jo më të gjatë se 1 vit (dhe jo më të gjatë se gjysma e dënimit të përcaktuar për veprën) ose një dënim me gjobë në një shumë jo më të madhe se gjoba e parashikuar për veprën. I pandehuri mund të kërkojë 10 ditë për të vlerësuar propozimin, mund ta pranojë ose ta refuzojë atë menjëherë.

Nëse i pandehuri e pranon propozimim, cështja i shkon gjyqtarit. Gjyqtari dëgjon të pandehurin dhe mbrojtësin e tij dhe nxjerr një urdhër të arsyetuar në të njëjtën ditë. Gjyqtari mund ta konfirmojë ose ta refuzojë propozimin, por nuk mund ta ndyshojë ose plotësojë atë. Seanca është publike.

Nëse gjyqtari e pranon propozimin, ai nxjerr një urdhër ratifikimi. Ky urdhër ka të njëjtën fuqi si një vendim gjyqësor përfundimtar dhe është i ekzekutueshëm menjëherë. Palët kanë 10 ditë afat ta ankimojnë atë.

Nëse propozimi refuzohet, prokurori vazhdon me ndjekjen penale.

*Italia*¹⁰⁹

Në seancën paraprake, i pandehuri mund të kërkojë që cështja të përfundohet me aktet e dosjes. Kjo do të thotë se ai heq dorë nga e drejta për të sjellë prova të reja. Gjyqtari urdhëron një gjykim të shkurtuar. Gjykimi i shkurtuar zhvillohet në dhomë këshillimi, përveçse nëse të gjithë të pandehurit kërkojnë gjykim publik.

Gjyqtari mund ta dënojë të pandehurin ose ta deklarojë atë të pafajshëm. I pandehuri nuk është i detyruar të pranojë fajësinë, por ai shpërblehet me uljen e 1/3-s së dënimit, masë që është e përcaktuar në ligj.

Sipas mekanizmit të *patteggiamento-s*, prokurori dhe i pandehuri mund të bien dakord për masën e dënimit dhe t'i kërkojnë gjykatës të caktojë atë dënim. Kjo është një formë e marrëveshjes (pazarit) për dënimin dhe nuk mund të përdoret për të rënë dakord për akuzat. Kështu, i pandehuri i pranon akuzat dhe shpërblehet me një ulje të dënimit dhe avantazhe të tjera (nuk paguan shpenzimet gjyqësore, etj). Ulja e dënimit është e përcaktuar në ligj dhe është deri në 1/3.

KPP-ja italian lejon zbatimin e *patteggiamento-s* edhe nëse prokurori e refuzon këtë lloj marrëveshjeje para gjykimit. Së pari, prokurori që refuzon një marrëveshje duhet të shpjegojë dhe arsyetojë refuzimin. Së dyti, nëse prokurori refuzon uljen e dënimit, i pandehuri mund t'ia përsërisë kërkesën gjyqtarit në fillim të gjykimit dhe, nëse e cmon të përshtatshme, gjyqtari mund të pranojë dhe t'i japë të pandehurit uljen e dënimit. Dhe, së treti, edhe pasi kryen një gjykim të plotë, nëse cmon se refuzimi i prokurorit për të pranuar marrëveshjen ka qenë i gabuar, gjyqtari mund t'i japë të pandehurit uljen e dënimit që lejohet për marrëveshjen e pranimit të fajësisë.

Para se të pranojë një marrëveshje, gjyqtari duhet të shqyrtojë provat dhe të shohë nëse është e mundur të japë një vendim pafajësie për të pandehurin. Nëse është e mundur, gjyqtari duhet të japë atë vendim. Nëse nuk ka mundësi për pafajësi, gjyqtari duhet të sigurohet që akuza e ngritur u përshatet fakteve dhe që dënimi për të cilin është rënë dakord është i përshtatshëm dhe i drejtë për veprën e kryer. Më në fund, gjyqtari mund të marrë në pyetje personalisht të pandehurin, për t'u siguruar që ai ka qenë dakord me marrëveshjen.

¹⁰⁹ Pallazzo. F, Papa. M “Lezioni di diritto penale comparato”, (2000), Giappichelli editors, Padova.

Gjykimi i drejtpërdrejtë është një procedurë që synon shmangien e një hetimi formal. Gjykimi i drejtpërdrejtë, si rregull, zbatohet kur i dyshuari është arrestuar në flagrancë. Ky gjykim nuk mund të kryhet nëse arresti ka qenë i paligjshëm, përveçse nëse i pandehuri bie dakord që ai të zhvillohet. Ky gjykim mund të zbatohet edhe për të pandehur që e pranojnë krimin gjatë hetimeve paraprake. Gjykimi i drejtpërdrejtë ndjek rregullat e gjykimit të zakonshëm dhe i pandehuri mund të kërkojë edhe gjykim të shkurtuar.

Gjykimi i menjëhershëm zbatohet kur është e qartë se i pandehuri e ka kryer krimin dhe zhvillimi i tij nuk e dëmton seriozisht hetimin, por vetëm pasi i pandehuri të jetë pyetur ose të jetë thirrur për pyetje, por të mos jetë paraqitur. Gjykimi i menjëhershëm duhet të kërkojë brenda 90 ditëve nga fillimi i hetimit. Edhe i pandehuri e ka të drejtën për të kërkuar gjykimin e menjëherëshëm. Gjykimi i menjëhershëm ndjek rregullat e gjykimit të zakonshëm dhe i pandehuri mund të kërkojë edhe gjykim të shkurtuar.

Kur prokurori cmon se të pandehurit duhet t'i jepet vetëm një gjobë (edhe në vend të dënimit me burgim), brenda 6 muajve nga fillimi i hetimit ai mund t'i kërkojë gjyqtarit për hetime paraprake lëshimin e një dekreti penal të dënimit.

Kërkesa duhet të tregojë provat e mbledhura deri në atë moment dhe dënimin e menduar si të përshatshëm, i cili mund të jetë deri në gjysmën e dënimit të parashikuar nga ligji. Gjyqtari mund ta deklarojë të pandehurin të pafajshëm ose të caktojë dënimin e kërkuar. Procedimi me dekret lejohet edhe për veprat që ndiqen mbi ankimin e të dëmtuarit, por i dëmtuari mund ta kundërshtojë zhvillimin e kësaj procedure.

Serbi¹¹⁰

Marrëveshja për pranimin e fajësisë arrihet mes prokurorit dhe të pandehurit që nga momenti i fillimit të hetimit deri në gjykim, kur gjykata ta pyesë të pandehurin se si e deklaron veten. I pandehuri duhet të ketë avokat mbrojtës në momentin e arritjes së marrëveshjes. KPP-ja i Serbisë lejon si marrëveshjen për akuzën, ashtu edhe atë për dënimin.

Marrëveshja duhet të konfirmohet nga gjyqtari në një seancë me dyer të mbyllura. Gjyqtari verifikon që ia pandehuri e ka pranuar krimin me dijeni dhe vullnet; që ai është i ndërgjegjshëm për të gjitha pasojat e marrëveshjes së arritur dhe, vecanërisht, që ka hequr dorë nga e drejta për gjykim dhe e drejta për ankim; që provat nuk vijnë në kundërshtim me pohimin e të pandehurit për kryerjen e krimit; që dënimi i propozuar nuk është në kundërshtim me ligjin. Gjykata duhet të arsyetojë pranimin e marrëveshjes. Gjykata mund ta refuzojë marrëveshjen dhe, në këtë rast, marrëveshja dhe të gjithë aktet që lidhen me të shkatërrohen në prani të gjyqtarit dhe procedimi kthehet në fazën ku ishte para se të arrihej marrëveshja.

Marrëveshja e bashkëpunimit arrihet mes prokurorit dhe të pandehurit që nga momenti i fillimit të hetimit deri në gjykim, kur gjykata ta pyesë të pandehurin se si e deklaron veten. Në këtë lloj marrëveshjeje, i pandehuri pranon krejtësisht akuzat dhe pranon të bashkëpunojë me hetimin, në këmbim të uljes së dënimit, lehtësimit ose pushimit të akuzave. Kjo marrëveshje nuk mund të përdoret për të pandehur që dyshohen si organizatorë të grupeve kriminale. Kjo marrëveshje pranohet ose refuzohet nga gjyqtari në kushtet e treguara më lart për marrëveshjen për pranimin

¹¹⁰ Pallazzo. F, Papa. M “Lezioni di diritto penale comparato”, (2000), Giappichelli editors, Padova.

e fajësisë. Nëse i pandehuri i plotëson kushtet, gjykata është e detyruar të zbatojë marrëveshjen. Nëse i pandehuri nuk i zbaton kushtet, gjykata e rrëzon marrëveshjen. Marrëveshja e bashkëpunimit mund të lidhet edhe me të dënuarin që pranon të dëshmojë në këmbim të uljes së dënimit.

Procedura e shkurtuar zbatohet për krime që parashikojnë si dënim kryesor gjobë ose burgim deri në 8 vjet. Për këto lloj krimesh, prokurori mund të kryejë një hetim të shkurtër, nëse mendon se ka mbledhur mjaftueshëm prova. Edhe afatet janë më të shkurtra në këtë procedurë, gjithmonë me qëllimin për të përshpejtuar procedimin. Nëse i pandehuri e pranon fajësinë gjatë gjykimit, ai përfiton një ulje të dënimit.

Kjo procedurë përdoret kur prokurori vlerëson se është e panevojshme të zhvillohet gjykim, për shkak të kompleksitetit të çështjes dhe provave të mbledhura dhe, vecanërisht, sepse i pandehuri është arrestuar gjatë kryerjes së krimit ose e ka pranuar fajësinë. Kjo procedurë zbatohet për krime që parashikojnë gjobë ose burgim deri në 5 vjet si dënim kryesor. Pasi shqyrton kërkesën, gjyqtari cakton gjykim në themel ose një seancë për caktimin e dënimit penal. Nëse cakton seancë, ai thërret prokurorin, të pandehurin dhe mbrojtësin e tij.

Gjyqtari i kërkon të pandehurit të parashtrijë këndvështrimin e tij për faktet dhe e paralajmëron për pasojat e rënies dakord me prokurorin dhe, vecanërisht, për heqjen dorë nga e drejta e ankimit. Nëse i pandehuri bie dakord me prokurorin ose nëse nuk paraqitet për seancën, gjyqtari lëshon një urdhër dënimi. Nëse i pandehuri e kundërshton kërkesën, gjyqtari cakton një gjykim të rregullt. Gjyqtari është i lidhur me kërkesën e prokurorit dhe nuk mund ta ndryshojë masën e dënimit.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës¹¹¹

Devijimi i fazës paragjykimore është një alternativë ndaj ndjekjes penale dhe shfaqet në dy mënyra: marrëveshje për të mos ndjekur penalisht (NPA) dhe marrëveshje për të shtyrë ndjekjen penale (DPA). NPA-të, si rregull, nuk kërkojnë pranim të fajësisë nga i pandehuri, sepse prokurori nuk ngre akuzë penale. NPA-të shpesh janë jo formale dhe kanë formën e një letre të prokurorit, e cila nënshkruhet edhe nga i pandehuri. Nga ana tjetër, DPA-të, të cilat përdoren më shpesh, kërkojnë një procedurë më të komplikuar. Prokurorët ngrenë akuzë penale (pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta për t'u akuzuar nga juria e madhe), por e shtyjnë ndjekjen penale për aq kohë sa i pandehuri zbaton disa kushte të përcaktuara në marrëveshje. Kushtet janë zakonisht më të detajuara e më të vështira për t'u plotësuar se ato të NPA-ve. Për shkak se është ngritur akuza, DPA-të ngjajnë më shumë me marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe janë më formale.

¹¹¹Aos, S., Miller, M. & Drake, E. (2006). Evidence-based public policy options to reduce future prison construction, criminal justice costs, and crime rates. Washington State Institute for Public Policy. Olympia: WA. Austin, J, Fabelo, T, 2006 'The diminishing returns of increased incarceration', viewed November 21, 2006, <<http://www.jfa-ssociates.com/BlueprintFinal.pdf>>. Department of Justice, US, 2002 'Recidivism of prisoners released in 1994', Bureau of Justice Statistics, June, Washington, DC. North Carolina Sentencing and Policy Advisory Commission. (2006).

NPA-të nuk konfirmohen nga gjyqtari, kurse DPA-të duhet të konfirmohen nga gjyqtari. Marrëveshjet janë formularë standard që përmbajnë disa kushte të përgjithshme dhe lejojnë caktimin e kushteve të vecanta. Kushtet e përgjithshme përfshijnë:

- Personi nuk duhet të shkelë asnjë ligj lokal, shtetëror apo federal.
- Personi duhet të ndjekë shkollën apo të punësohet.
- Personi duhet të vazhdojë të banojë në njësinë administrative.
- Personi duhet t'i raportojë agjencisë përkatëse mbikëqyrëse sipas udhëzimeve të caktuara.

Janë pikërisht kushtet e vecanta që i lejojnë prokurorit të strukturojë një program që i përshtatet rrethanave të veprës së kryer. Kushti i vecantë më i përdorur është pagimi i dëmeve, që është vecanërisht i rëndësishëm në veprat e mashtimit. Kushte të tjera të vecanta mund të jenë puna në shërbim të komunitetit apo trajtimi për abuzimin me substancat.

Pjesëmarrësit e suksesshëm nuk akuzohen penalisht ose, nëse janë akuzuar, u pushohen akuzat, kurse për pjesëmarrësit që nuk kanë sukses vazhdohet ndjekja penale.

Një nga karakteristikat më të rëndësishme të sistemit amerikan të drejtësisë penale është pazari për pranimin e fajësisë, që u krijua në vitin 1974 me ndryshimet që iu bënë Rregullave Federale të Procedurës Penale. Kjo procedurë sot mbizotëron në aktivitetin e përditshëm të sistemit amerikan të drejtësisë penale; rreth 90 deri 95% e dënimeve në nivel federal e shtetëror arrihen nëpërmjet vetëdeklarimit të fajësisë.

Rregulli 11 e lejon të pandehurin të vetëdeklarohet fajtor ose thjesht të mos kundërshtojë akuzat (nolo contendere). Në këmbim, prokurori nuk do të ngrejë ose do të pushojë akuza të caktuara; do të rekomandojë ose nu do të kundërshtojë kërkesën e të pandehurit për masën ose marzhin e dënimit; do të bjerë dakord që një masë ose marzh dënimi i caktuar është i përshtatshëm (në këtë rast, gjykata që pranon marrëveshjen e ka të detyrueshëm këtë përcaktim).

Vlefshmëria e marrëveshjes varet nga heqja dorë me dijeni dhe vullnet prej të drejtave dhe nga një bazë faktike që mbështet akuzat, për të cilat pranohet fajësia. Suksesi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë kërkon pjesëmarrjen aktive të tre aktorëve: gjyqtarit, prokurorit dhe mbrojtjes.

Një çështje e rëndësishme është fakti që prokurori nuk ka fuqi të detyrojë gjykatën të pranojë një marrëveshje për pranimin e fajësisë. Prokurorët vetëm mund të rekomandojnë pranimin e marrëveshjes. Gjykata zakonisht do të kërkojë prova për të vërtetuar se janë përmbushur kushtet e mësipërme dhe, si rregull, e pranon rekomandimin e prokurorit.

Një ndër kritikant kryesore që i bëhet praktikave të vetëdeklarimit të fajësisë në Sh.B.A është pushteti i madh diskrecionar që i është dhënë prokurorit. Në të vërtetë, për shkak të parashikimeve të Udhëzimit mbi Dënimet në Sh.B.A, fusha e veprimt të prokurorit është shumë e kufizuar. Për më tepër, shumë vepra federale kanë dënime të detyrueshme që nuk lejojnë pazar mbi masën e dënimit. Së fundi, shumë vepra penale federale nuk lejojnë zbatimin e

marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, kurse për shumë lloj marrëveshjesh kërkohet miratim i niveleve më të larta në prokurori.

DËNIMET PENALE DHE ALTERNATIVAT E TYRE PËR TË PANDEHURIT E MITUR

1. Republika e Shqipërisë

Kriminaliteti si fenomen i demshem dhe i hershem ka qene problem i gjithe shoqerise dhe ne vecanti problem i teorise penalo –juridike i institucioneve shteterore dhe jo shteterore i praktikes gjyqesore, ne zbulimin e ketyre elementeve shkakesore te kesaj dukurie negative, por edhe te paraqitjes se formave dhe mjeteve me te pershtateshme te luftimit te ketij bashkeudhetari te perhershëm te shoqerise njerezore.

Legjislacioni shqiptar ndaj subjekteve te mitur te krimit ka ndjekur dinamiken e zhvillimit te vet shoqerise ne raport me vete zhvillimet ekonomiko-shoqerore, politiko juridike, fetare e kulturore duke qene pjese integrale por ne te njejten kohe edhe produkt i ketyre ndryshimeve ne etapa te caktuara.

Sanksionet e parashikuara ne kodin penal kane per detyre parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit ne pergjithesi dhe krimit te organizuar ne vecanti. Gjithashtu ato kane per detyre mbrojtjen dhe materializimin e raporteve te reja shoqerore forcimin dhe konsolidimin e tyre ne shoqerine shqiptare. Sanksionet penale jane mjete juridike ne te cilat realizohet funksioni mbrojtës i te drejtave penale. Keto tregojne substancën dhe qellimin themelor te vete ekzistences se te drejtes penale.

Ne teorine e te drejtes penale, procedures penale dhe shkencat e tjera qe merren me kriminalitetin perdorim terma te ndryshem te kriminalitetit te te miturve. Lidhur me kete ceshtje ekziston nje panorama e gjere e kuptimit te kriminalitetit te te miturve duke duke perfshire veprimet qe quhen paradeliqence, e deri tek vepra penale ose veprime prej sjelljeve qe quhen mungese e kultures ose miresjellje deri tek krimet e renda ose si te rinjte te lene pas dore, te shfrenuar, moralisht te adoptuar ne rrethin shoqeror, bredhes, lypes, perdorues te droges e deri tek delikuentet e kriminelet e rinj.

Pjesa me e madhe e autoreve qe merren me studimin e kesaj ceshtje jane te mendimit se veprimet e te miturve te drejtuara ne kryerjen e veprave penale te quhen delikuencë e te miturve. Me delikuence te te miturve duhet kuptuar sjelljet shoqerisht te rrezikeshme dhe kundraligjshme, te kryera me faj me anen e te cilave cenohen, preken apo rrezikohen vlerat me vitale te shoqerise nga ana e subjekteve te mitur.

Ne kuadrin e pergjithshem te legjislacionit nje rendesi thelbesore ka edhe trajtimi qe i ben ligji penal te miturve.

Kodi penal Shqiptar i vitit 1928 percaktonte dispozitate vecanta (nenet 54-57) per personat e mitur qe kryenin krime ose kundravajtje penale. Pergjegjesia penale ndaj personave te mitur sipas ketij kodi fillonte prej moshes 10-18 vjecare me sakte thuhet: nuk behet ndjekje penale ndaj atij personi i cili kur ka bere faj nuk ka mbushur moshen 10 vjece (neni 54), por ketu ligjevenesit shqiptar bente nje perjashtim te vecante ne lidhje me pergjegjesine penale ndaj kesaj kategorie. Ne ato raste kur personat nen moshen 10 vjecare kryejne nje krim ose kundravajtje penale per te

cilen parashikohej denimi me vdekje dhe me burgim te perjetshem ose me burgim te rende ose burgim me jo me pak se nje vit gjyq sipas kerkese se prokurorit, mund te urdheronte qe fajtori minoren te mbyllet ne nje institucion edukues permiresues.

Kjo mbyllje mund te zgjase derisa fajtori minoren te mbushte moshen 20 vjec me te drejten ekskluzive te gjykates per evokimin e kesaj mase te mbylljes dhe te mundesohet qe fajtori minoren t'u dorezohej prinderve ose personi qe me ligj ngarkohet. Kujdesi ndaj tij nenit 54\2. Ne te gjitha keto raste kur gjykata me vendim urdheronte qe personi nen moshen 10 vjecare t'u dorezohej prinderve ose kujdestarit, keta kishin detyrimin per rritjen dhe edukimin e shendoshe te kultivonin tek femijet sjelljen e moralshme dhe korrekte me qellim qe ai te behej nje individ i denje per shoqerine. Ne rast te mospermbushjes te ketij detyrimi dhe kur femija kryente ndonje krim te cdo lloji apo kundravajtje penale prindi apo kujdestari do te paguante nje gjobe 100-500 franga.

Vlen per tu theksuar se kur personi ne kohen e kryerjes kishte mbushur moshen 10 vjecare por jo dhe moshen 15 vjecare dhe nuk kishte fuqine vleresuese te veprimeve te tij nuk kishte pergjegjesine penale (neni 55). Ne nenin 52/12 ligjevenesit specifikon pergjegjesine penale te vecante ndaj kesaj kategorie. Ne raste kur per deliktin e caktuar eshte parashikuar nje ndeshkim me vdekje ose me burgim te perjetshem ose me burgim te rende ose me burgim me me teper se nje vit gjykata sipas kerkeses se prokurorit mund te urdheronte qe fajtori e mbyllet ne nje institucion edukues pra zbatohet neni 54/3.

Ne rastet kur personi penalisht i pergjegjshem i moshes 10 – 15 vjecare dhe kur ka patur fuqine vleresuese te veprimeve ose te mosveprimeve te tija ndeshkimi i fajtorit minoren behej sipas rregullave te meposhteme:

- Ne vend te denimit me vdekje ose me burgim te perjetshem caktohej denimi 6-12 vjet.
- Ne vend te denimeve qe kalojne 12 vjet burgim caktohej denimi 1- 5 vjet.
- Ne vend te denimit qe kalonte 6 vjet por jo 12 vjet burgim caktohej denim 1-5 vjet.
- Ne rastet e tjera caktohej denim me pak se gjysma e denimit te caktuar.
- Ndeshkimet ne gjobe zbriteshin me ½ e tyre (neni 55/3).

Ndeshkimi me burgim ndaj te miturve ekzekutohej ne organet e posacme edukuese per te miturit dhe nuk mund te merrej si baze per perseritje (recidivizmi) per delitet ose kundravajtjet e mevoneshme.

Personat e mitur 15-18 vjecare e qe ishin penalisht pergjegjes ne rastin e kryerjes se vepres ose kundravajtjes sipas dispozitave te te kodit mund te ndeshkohen si vijon:

- Ne vend te denimit me vdekje ose burgim te perjetshem caktohej nje denim 12-20 vjet burgim I
- rende.
- Ne vend te ndeshkimit qe kalonte 12 vjet denim caktohej nje denim 6-12 vjet .
- Ne raste te tjera ndeshkimi zbritet ne ½ e tij.
- Ndeshkimet me gjobe zbriteshin ne ne 1/3 e tyre (neni 55).

Ne qoftese ne kohen e denimit fajtori nuk ka mbushur moshen 18 vjecare gjykata mund te urdheronte qe ndeshkimet kunder lirise se personit te ekzekutoheshin ne nje institucion edukues-permiresues.

Kodi Penal i vitit 1928 kishte percaktuar dispozita te vecanta lidhur me pergjegjesine penale per kategorine e te denuarve shurdh- memecë. Ky kod kishte percaktuar edhe lirimin para kohe me kusht vetem per arsye te vecante, kur i denuari kishte treguar sjellje te mire gjate vuajtjes se denimit e njekohësisht gjykata kishte krijuar bindjen se i denuari ishte permiresuar dhe se denimi ndaj tij e kishte rritur qellimin e tij dhe se ne te ardhmen nuk do te kryente me delikte te njejta ose te tjera. Me kerkesen e tij lirohej nga ekzekutimi i metejshe i denimit me kusht qe I denuari me burgim te rende ose me burgim me teper se tre vjet, po qe se kisht evuajtur $\frac{1}{4}$ e denimit, por jo me pak se 3 vjet, kur ndeshkimi ishte burgim i rende, ose gjysmen e kohes se kushtit, kur kryen nje krim te rende ose nuk permbushte detyrimet e vendosura nga gjykata¹¹².

Kur analizojme permbajtjen e dispozitave te kodit penal te vitit 1928 mund te arrijme disa konkluzione :

- Ky kod ishte nje ekstrakt i kodeve penale me te mira te popujve me te perparuar te Europes.
- Percaktonte lloje te ndryshme denimesh penale per subjekte te mitura autore te veprave penale.
- Sistemi relative i sanksioneve penale lejonte gjykatën qe ne pershtatje me rrezikshmerine shoqerore te vepres, personalitetin e minorenit te percaktonte llojin dhe masen e denimit.
- Ky kod kishte karakter demokratik jo vetem per faktin qe bazohej ne nje game te madhe dhe te shumellojshme te ndeshkimeve penale por edhe per faktin se ky kod mbeshtetej ne parimet me demokratike te se frejtes penale si : parimin e ligjshmerise ,parimin e pergjegjesise penale individuale dhe parimi i barazise se qytetareve para ligjit¹¹³.

Pas perfundimit te luftes u vendos shteti i ri socialist i diktatures se proletariatit. Me krijimin e ketij shteti te ri u krijua edhe e drejta penale e re e cila kishte per detyre te mbronte frytet e luftes dhe luftimin e kriminalitetit ne teresi. Aprovimi i kushtetutes se vitit 1946 ishte burim kryesor i te drejtes penale dhe ne mbeshtetje te saj Kuvendi Populloor i Shqiperise aprovoi Ligjin nr. 382 dt. 24.12.1946 mbi dispozitat e pergjithshme penale. Ne nenin 16 te ketij ligji ishin parashikuar edhe denimet penale per te rritur kryesisht ato me karakter edukues.

1. Dorezimi i te mitureve prinderve ose personave te tjere te ngarkuar prej ligjit me edukimin e tyre
2. Gjykata mund te vendose mbylljen ne nje institucion edukimi per nje periudhe te caktuar nga vete ajo. Kjo periudhe nuk duhet te kalonte me shume se koha qe i duhej minorenit per te mbushur moshen 18 vjecare¹¹⁴.

¹¹² Elezi Ismet, "Normat e së drejtës penale zakonore të mbledhura në KLD dhe kanune / vendime / të veçanta, " Referate e kumtesa " mbajtur në sesionin shkencor të Fakultetit të Drejtësisë, kushtuar 50 vjetorit të pavarësisë / I, Tiranë, 1965.

¹¹³ Elezi Ismet. "E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme I dhe II, Tiranë 1999.

¹¹⁴ E drejta penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1973, fq. 2010.

Ne nenin 39 te ketij ligji parashikohej dhe denimi per te miturit. Sipas kesaj dispozite te miturit perjashtohen nga denimi me vdekje dhe pune te detyruar. Denimi me burg per pune te detyruar, denimi me burg dhe me pune te detyruar nuk mund te jene me shume sa 1/2 e maksimumit te caktuar per subjektet e rritura ne raste te tjera mund te perjashtoje te miturit nga cdo lloj denimi dhe mund te vendose dergimin e te miturit ne nje institucion edukimi.

Ligji mbi dispozitat penale paraqet perparesi ne percaktimin e sistemeve te denimeve sepse parimet e politikës penale, caktimi dhe individualizimi i denimit ishin ngritur ne nje shkalle me te larte duke percaktuar denimin me kusht dhe zbritjen e denimit deri ne minimumin e pergjithshem te pecaktuar per ate denim.

Kodet e viteve 1952-1977 kishin parapare mundësinë e caktimit të dënimeve penale të vécanta (denime dhe masa edukuese) te te miturve te cilet kishin kryer vepra penale. Keto kode denimet penale nuk i kane vendosur ne kapituj te vecante por ishin te inkorporuar se bashku me denimin ose se bashku me masat mjekesore. Keto kode pergjegjesine penale per te mitur e kishin rregulluar ne menyre te vecante pa i ndare te miturit ne kategori te caktuara sic i ndajne kodet penale te vendeve te tjera ne te mitur te rinj (14-16 vjec) dhe ne te rritur te mitur (16-18 vjec). Sipas dispozitave penale te ketyre viteve, te miturit konsideroheshin personat te cilet ne kohen e kryerjes se vepres penale kane kryer moshen 14 vjec por jo moshen 18 vjecare.

Personat qe ne kohen e kryerjes se vepres penale kishin mbushur moshen 14-18 vjec dhe ishin penalisht te pergjegjshem ndaj tyre mund te merreshin masa edukuese ose denimet. Ndersa personat e tjere 14-18 vjecare por qe ishin penalisht te pergjegjshem gjykata mund t'u caktonte vetem masa edukuese.

Percaktimi nga ligjveneri i sanksioneve penale ndaj te miturve ishte i nje natyre te vecante. Kjo vecanti ishte rezultat i personalitetit qe kane te miturit. Jane pikerisht keto karakteristika te vecanta te personalitetit te te miturve qe keto kode te materlizojne qarte dhe dukshem qellimin e denimit.

Qellimi i ketyre denimeve nuk eshte percaktuar ne menyre te vecante por ne mund ta percaktojme dhe nga permbajtja e pergjitheshme e te qellimit te denimeve.

- Denimi i fajtorit ndaj veprimit ose mosveprimit shoqerisht te rrezikshem e te kundraligjshem dhe
- ndalimet e veprimtareise se metejshme antiligjore te subjekteve.
- Permiresimi i sjelljes se kundraligjeshme ,shoqerizimi dhe edukimi i subjektit me qellim per t'u bere i denje dhe i dobishem per shoqerine shqiptare.
- Parandalimi i kriminalitetit nepermjet influencimit ndaj te miturve te tjere me frymen e korektesise, respektimit te ligjit dhe zhvillimit te pergjegjesise se tyre personale¹¹⁵.

Pra, qellimi final i denimit eshte: edukimi, zhvillimi i shendoshe psikosocial, riedukimi per te ardhmen, ndikimi tek minorenet e tjere qe at ate mos kryejne veprimie antiligjore me objektivin madhor qe ata te behen persona te nderuar dhe shoqerisht te dobishem.

¹¹⁵ E drejta penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1973, fq. 2010.

Sipas dispozitave te kodit te vitit 1952 (neni 46/2) dhe kodit te vitit 1977 (neni 21/2) i mituri i cili ne kohen e kryerjes se vepres penale nuk kishte mbushur moshen 18 vjec dhe qe ishte penalisht i pergjegjshem mund te denohej me burgim me jo me shume se 1/2 e denimit te parashikuar ne pjesen e posacme te kodit per vepren penale konkrete. Maksimumi i denimit me heqje te lirise ishte percaktuar 12.5 vjet. Persa i perket minimumit nuk parashikohej por, duke u nisur nga interpretimi i dispozitave ne praktike, ishte pranuar qe dhe minimumi mund te ulej ne gjysmen e tij.

Ne caktimin dhe individualizimin e denimit ndaj te miturve nga gjykata merrej per baze sanksioni i percaktuar ne dispozite per vepren penale konkrete, shkalla e rrezikshmerise se vepres dhe e subjektit, personi, shkalla e fajesise se minorenit, pasoja e vepres, mjeti me te cilin ishin kryer vepra penale, vendi dhe koha e kryerjes, rrethanat lehtesuese dhe renduese, si dhe ndergjegjja juridike sociale. Pra, edhe denimi me heqje te lirise per te mitur kishte kishte premisa politike dhe ideologjike sepse edhe ky kishte per qellim ruajtjen dhe forcimin e diktatures te udhehequr nga partia komuniste si forca e vetme e jetes shoqerore dhe politike te vendit. Ne baze te nenit 46 te vitit 1952 dhe neni 34 te vitit 1977 gjykata kishte mundesi te dhe tager te perjashtonte te miturit te cilet ne kohen e kryerjes se vepres penale nuk kishin mbushur moshen 18 vjec. Ky perjashtim behej ne keto raste :

1. Kur i mituri per shkaqe te asyeshme, nuk ishte ne gjendje te kuptonte se vepra e tij ishte qartazi e rrezikshme.
2. Kur ka kryer nje veper penale te parendesishme per shkak te nje fatkeqesie personale ose familjare ose i ndikuar dhe I influencuar nga rrethana rastesore.
3. Kur i mituri ka kryer nje veper penale ne tronditje psikike ose nen influencen e nje personi tjeter, por gjithmone duke u nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres .
4. Kur gjykohet se masat edukuese qe caktohen ndaj subjektit te mitur ia arrijne plotesisht qellimit te denimit.

Ne nenin 28/1 te kodit te vitit 1977 perdoret shprehja: “Per shkak te moshes nuk ka pergjegjesi penale”. Keta nuk duhen identifikuar me persona penalisht te pergjegjshem. Personat e mitur nuk mund te konsideroheshin te pergjegjshem sepse pjekuria e tyre bioseptike eshte ne formim e siper dhe si pasoje e kesaj, ata nuk jane ne gjendje te kuptojne veprimet e veta, pasoje e vepres penale dhe as per te kontrolluar veprimet e tyre. Pikerisht per keto arsye objektive dhe te provuara shkencerisht, pergjegjesia penale e te miturve duhet konsideruar si nje pergjegjesi e vecante. Pikerisht per keto arsye legjislacioni ka percaktuar masat edukuese si sanksione penale te vecanta. Gjykata keto masa I cakton, kur e cmon se denimi nuk eshte I pershtatshem per te materializuar qellimin e tij dhe se masa edukuese e realizon me mire qelimin e denimit ne pergjithesi. Ne nenin 39 te kodit te vitit 1952 masat edukuese ndaheshin:

- Dorezimi i te miturve nen kujdestarine e prinderit, te adoptuesve, te kujdestareve, te te afermeve, ne qofte se keta kane mundesi ta mbajne, ose nen kujdestarine e personave te tjere ose te institucioneve.
- Mbyllja ne nje institucion te posacem edukimi dhe mjekimi.

Ne kodin penal te vitit 1977 ne nenin 28/3 masat edukuese ndaheshin ne:

- Vendosja e te miturit ne nje institucion edukimi ose mjekimi
- Lenia e personit te mitur per edukim kolektiv ose organizatave shoqerore.

Kur i mituri kryente nje veper penale si rezultat i neglizhences dhe moskujdesjes te nevojshem te prinderve dhe kur gjykata nga teresia e rrethanave dhe kushteve konkrete vleresonte se prinderit apo personat e tjere te pecaktuar me ligj ishin ne gjendje te kontrollonin te miturit dhe te ndikonin ne edukimin e tyre, gjykata caktonte masen edukuese te variantit te pare. Ne qofte se prinderit nuk ishin ne gjendje te ushtronin kete mbikqyrje per arsye te ndryshme si: kur prinderit ishin penalisht te papergjegjshem, ishin te denuar, ushtronin ndonje veprimtari te jashteligjeshme ose kishin vdekur, atehere gjykata kete mase ia ngarkonte kujdestarit, adoptuesit ose te afermve te te miturit. Ne rastet kur keta persona mungonin ose keta persona nuk kishin mundesi ta ushtronin kete mbikqyrje, atehere gjykata kete person ua caktonte institucioneve. Nga permbajtja e dispozites 39 nuk percaktohet kohezgjatja e saj, por kuptohet qe kjo mase vazhdonte derisa i mituri te mbushe moshen 18 vjec.

Kur i mituri ne kryerjen e vepres penale ishte kushtezuar nga prania e nje semundje te caktuar dhe kur nga rrethana konkrete gjykata cmonte se i mituri duhej te menjanohej e te vecohej per nje fare kohe nga rrethi social, gjykata mund te caktonte nje mase tjeter reduktuese, pra mbylljen ne nje institucion edukimi dhe mjekimi.

Vendosja e te miturit ne nje institucion edukimi, si mase edukuese nga ana e gjykates u caktohej te miturve qe kishin kryer nje veper te rende, por qe ne kohe e kryerjes se saj nuk kishin qene te vetedijshem sa duhej per pasojen e vepres penale te kryer dhe kur gjykata vleresonte se rrethanat ne te cilat ishte kryer kjo veper penale, sjelljet e mepareshme te te miturit, rrethi familjar dhe ambjenti ku jetonte i mituri, e bindte gjykatën se minoreni duhej vendosur ne kushte te tjera dhe ne nje kontroll te rrepte.

Mbyllja ne nje institucion te posacem mjekimi dhe edukimi ishte nje mase qe gjykata ua caktonte te miturve te cilet ne kohen e kryerjes se vepres penale ishin 14 vjec, por s'kishin mbushur moshen 18 vjec. Dhe kete mase edukuese ku e caktonte gjykata ne dispozite ligjore nuk ishte pecaktuar kohezgjatja e saj, pra gjykata percaktonte mbylljen ne nje institucion edukimi dhe mjekimi pa afat te caktuar nga ana e saj. Kjo natyrisht nuk percaktohej nga ana e gjykates por nga vete institucioni i posacem per edukimin ose sherimin e te miturit dhe nga vete i mituri, nese ky do te riedukohej shpejt ose jo. Kjo mase edukuese (neni 39/1) u caktohej te miturve te cilet krimin e kishin kryer si rezultat i ndonje semundje te caktuar dhe per kete mbylleshin ne nje institucion te posacem edukimi dhe mjekohej nga semundja e cila kishte kushtezuar kryerjen e vepres penale. Masat edukuese u caktoheshin te miturve me rrezikshmeri shoqerore te vogel dhe kur gjykata bindej se riedukimi dhe qellimi i denimit do te arrihej dhe me caktimin e mases edukuese pa caktuar ndonje denim tjeter .

Ne praktiken gjyqesore te Shqiperise, organizatave shoqerore dhe kolektivave punonjese u besohej edukimi dhe riedukimi i personave te mitur te denuar. Kete mase e caktonte gjykata duke pecaktuar me vendimin e saj detyrimin e organizates shoqerore ose kolektivit perkates qe ta edukonte dhe riedukonte te miturin e denuar me frymen e respektimit te ligjit dhe rregullave te bashkejeteses socialiste. Koha qe qendronte i mituri i mituri per edukim varej nga personaliteti i

te miturit. Kjo mase hiqet nga gjykata kur organet perkatese te organizates shoqerore e bejne me dije gjykatën se mbajtja e metejshe e te miturit ishte e panevojshme per shkak se ishte arritur riedukimi i personit te mitur.

Legjislacioni aktual shqiptar, bazuar edhe ne aktet e ndryshme nderkombetare, merr ne mbrojtje dhe ne kujdes te vecante te miturit. Kushtetuta e Republikës se Shqiperise si ligj themeltar, kodet e ndryshem dhe aktet e tjera ligjore ne permbajtjen e tyre pranojne edhe parimet e normat e akteve nderkombetare për mbrojtjen e femijeve dhe te miturve.

Neni 12 i Kodit Penal parashikon se ka pergjegjesi penale personi qe ne kohen e kryerjes se nje krimi ka mbushur moshen 14 vjec. Personi qe kryen nje kundravajtje penale ka pergjegjes kur ka mbushur moshen 16 vjec. Te miturit qe nuk kane mbushur moshen 14 vjec nuk mund te procedohen penalisht, as edhe per krime, kurse ata qe nuk kane mbushur moshen 16 vjec nuk mund te procedohen as edhe per kundravajtje.

Sipas nenit 41 ite Kodit te Procedures Penale, ne cdo gjendje dhe shkalle te procedimit, kur ka arsye per te besuar se i pandehuri eshte i mitur, organi i procedures ben verifikimet e nevojshme dhe, kur eshte rasti, urdheron ekspertimin. Kur edhe pas verifikimeve edhe ekspertimit mbeten dyshime per moshen e te pandehurit, prezumohet se ai eshte i mitur. Verifikimi i moshes duhet te behet nga policia gjyqesore, prokurori apo gjykata sa here lind dyshimi per shkak qe duket apo pretendohet nga i mituri ose prindrit e tij. Kur eshte rasti mund te caktohen edhe eksperte qe te vleresojne moshen e te miturit. Ne qofte se nga verifikimet e bera moshja nuk mund te percaktohet dhe ka dyshime qe ai eshte i mitur, atehere ai konsiderohet i tille nga vete ligji¹¹⁶.

Neni 290 i KPP-së parashikon se procedimi penal nuk mund te filloje dhe, ne qoftese ka filluar, duhet te pushoje kur personi nuk ka mbushur moshen per pergjegjesine penale.

Ne keto tre dispozita te kodit penal dhe te Kodit te Procedures Penale shprehet kujdesi per te perjashtuar te miturit nga pergjegjesia penale, ne varesi te rëndesise se vepres penale qe kane kryer. Deri ne moshen 14 vjec ata nuk mund te procedohen penalisht per asnje lloj vepre penale, kur mbushin moshen 14 vjec ata pergjigjen vetem per krime dhe kur behen 16 vjec pergjigjen edhe per kundravajtje penale.

Organet e procedimit penal (Policia Gjyqesore, Prokuroria dhe gjykata) duhet te verifikojne me me kujdes moshen e te miturit, duke u bazuar ne dokumentet e gjendjes civile dhe kur nuk ka te tilla, duhet te bejne verifikimet e nevojshme dhe te caktojne eksperte per percaktimin e moshes. Kur ky percaktim nuk mund te behet i sakte dhe mbetet e dyshimte nese i mituri e ka mbushur moshen ose jo per vepren qe akuzohet, ai do te konsiderohet i mitur dhe procedimi penal nuk do te fillohet. Ne qofte se konstatimi i moshes behet pas fillimit te procedimit penal, ceshtja duhete te pushohet ne baze te nenit 328 te K .Pr.Penale.

Te pandehurit te mitur i sigurohet ndihme juridike dhe psikologjikene cdo gjendje dhe shkalle te

¹¹⁶ Mandro. A The juvenile justice system in Albania, an analysis of the juvenile justice system and of the situation of juveniles in conflict with the law in Albania, a publication of the Center for Protection of Child Rights in Albania, (2007), Visi Design, Tirana.

procedimit, me pranine e prindit ose te personave te tjere te kerkuar nga i mituri dhe dhe te pranuar nga organi qe procedon. Organi procedures mund te kryeje veprime dhe te perpiloje akte, per te cilat kerkohej pjesemarrja e te miturit pa pranine e personave te treguar ne paragrafin e pare vetem kur nje gje e tille eshte ne interes te te miturit ose kur vonesa mund te demtojte rende procedimin, por gjithmone ne pranine e mbrojtjesit.

Kur i pandehuri eshte ne moshen 18 vjec ndihma nga nje mbrojtës eshte e detyrueshme. Për te miturit caktimi i avokatit eshte i detyrueshem ne ndryshim nga te rriturit, te cileve u caktohet avokat vetem kur e kerkojne. Organi qe procedon penalisht duhet t'i caktojte avokat te pandehurit te mitur edhe kur ai nuk e kerkon ate.

Si gjate hetimeve paraprake, ashtu edhe ne gjykim te miturit duhet t'i sigurohet ndihma psikologjike gjate pyetjes se tij. Kjo gje behet mire kur ne pyetjen e te miturit asiston nje psikolog ose sociolog, i cili ka aftesine e nevojshme per komunikim me te miturin dhe krijon kushtet e pershtatshme qe i mituri te shprehet lirshem dhe te shpjegoje saktesisht faktin per te cilin akuzohet¹¹⁷.

Organi i procedues merr te dhena per kushtet e jeteses personale, familjare dhe shoqerore te te pandehurit te mitur me qellim qe te sqaroje pergjegjshmerine dhe shkallen e pergjegjesise, te vleresoje rendesine shoqerore te faktit dhe te caktojte masa te pershtatshme penale. Organi procedues mbledh informacione nga personat qe kane pasur marredhenie me te miturin dhe degjon mendimin e eksperteve. Keto te dhena jane shume te nevojshme per vleresimin e denimit qe mund 'ti jepet te miturit. Nepermjet ketyre gjykata informohet per kushtet e jeteses personale, familjare dhe shoqerore te te miturit dhe mbi kete baze percakton qendrimin qe duhet te mbajtur ndaj tye miturit, sipas rastit, duke e perjashtuar nga denimi, duke dhene denimin me kusht, duke e mbyllur ne nje institucion edukimi apo duke e denuar me burgim.

Denimi i te miturve eshte nje nga ceshtjet me delikate te procedimit penal te te miturve te te miturve. Vendimi gjyqesor, i cili cakton nje denim, duhet ne cdo rast te kete ekzaminuar dhe ta kete marre ne konsiderate interesin me te larte te femijes. Per caktimin e denimit ndaj te miturit caktohen te njejtat norma si dhe ndaj te rriturve. Por jane disa dispozitate Kodit Penal dhe te K.Pr. Penale te cilat parshikojne rregulla te vecanta lidhur me caktimin e llojit dhe te mases se denimit per te mitur, tye cilat synojne diferencimin favorizues per ta.

Gjykata, nisur nisur nga rrezikshmeria e paket e vepres penale, nga rrethanat konkrete te kryerjes se saj, nga sjellja e mepareshme e te miturit, mund ta perjashtojte ate nga denimi. Ne kete rast gjykata mund te vendose dergimin e te miturit ne nje institucion edukimi¹¹⁸. Per zbatimin e kesaj dispozite kerkohej te ekzistojne njeheresh te gjitha kushtet e parashikuara ne paragrafin e pare dhe jo vetem njeri prej tyre. I mituri nuk mund te perjashtohet nga denimi ne qofte se ka kryer nje krim te rende apo per motive te dobeta ose kur nuk ka sjellje te mira.

Masat edukuese mund te jepen ndaj te miturve qe perjashtohen nga denimi ose qe per shkak te moshes ,nuk kane per gjegjesi penale. Masa edukuese eshte vendosja e te miturit ne nje

¹¹⁷ Albanian Helsinki Committee, Criminal justice system for juveniles in Albania, (2005) PEGI, Tirana.

¹¹⁸ Foundation "Conflict Resolution and Reconciliation of Disputes", Restorative justice and mediation in resolving criminal despotism, Manual for judges and prosecutors, UNICEF, (2007), Tirana.

institucion edukimi. Vendimi gjyqesor per masat edukuese eshte I revokueshem ne cdo kohe kur zhduken rrethanat per te cilat ai eshte dhene, por ne cdo rast, gjykata kryesisht eshte e detyruar qe pas kalimit te nje viti te marre ne shqyrtim vendimin e saj. Nga kjo dispozite del se vendosja e te miturit ne institucion edukimi mund te behet vetem me vendim te gjykates ne dy raste:

- kur ne perfundim te gjykimit te tij, gjykata vendos ta perjashtoje nga denimi, ne baze te nenit 52 te kodit penal,
- kur i mituri nuk mund te gjykohej penalisht per nje akt qe perben veper penale, per shkak te moshes.

Ne kete rast me kerkese te prokurorit gjykata vendos masen edukuese te vendosjes se te miturit ne nje institucion edukimi. Kete kerkese prokurori e ben duke u bazuar ne te dhenat e Policise ose edhe kryesisht. Prandaj kerkohet nje bashkepunim i vazhdueshem midis tyre.

Masat edukuese me vendosjen e te miturit ne nje institucion riedukimi duhet te behet ne rastet kur vepra e kryer eshte e lehte dhe nga shqyrtimi i gjithë kuadrit te provave dhe vecanerisht zhvillimit psikoemocional te te miurit shihet si i domosdoshem dhe i mundshem korrigjimi i sjelljeve te tij coroditese, te cilat kane qene percaktuese per kryerjen e vepres penale¹¹⁹.

Keto lloj institucionesh nuk ekzistojne ende ne Shqiperi, por edhe ne qoftese ato do te ekzistonin, programi ne to duhet te jete i tille qe te ndikojë pikerisht ne korrigjimin e coroditjeve te ndodhura ne personalitetin e te miturit. Ato ne asnje rast nuk duhen te konsiderohen si nje lloj burgu femijesh. Keta femije qe do te detyrohen te ndjekin programet e institucioneve te edukimit nuk do te konsiderohen te denuar por te marre ne kujdes¹²⁰.

Per te miturit ,qe ne kohen e kryerjes se vepres penale nuk kane mbushur moshen 18 vjec denimi me burg nuk mund te jete me shume se gjysma e denimit qe parshikon ligji per vepren penale te kryer. Ky rregull favorizues per te miturit do te thote qe, kur nje i mitur gjykohej per nje veper penale qe denohet nga 10 deri 20 vjet burgim, ai nuk mund te denohet me shume se 5 deri 10 vjet burgim.

Denimi me burgim te per jetshem nuk jepen ndaj personave qe ne kohen e kryerjes se krimit nuk kane mbushur moshen 18 vjec.

2. Republika e Kosovës

Në Republikën e Kosovës, përmes sanksioneve penale i tërheqet vërejtja të miturit për faktin e kryerjes së veprës penale si dhe synohet të ushtrohet trajtimi ndaj tyre me qëllim të edukimit, rehabilitimit dhe zhvillimit të drejtë. Së bashku me disa prej sanksioneve penale të mituve u caktohen edhe detyrime të veçanta të cilat ata janë të obliguar t'i përmbushin. Në Kodin e Drejtësisë për të Mitur janë paraparë masat që mund të shqiptohen ndaj të miturit. Të tilla janë:

¹¹⁹ Albanian Helsinki Committee, Observance of the Rights of Juvenile Offenders in Criminal Proceedings, (2007) PEGI, Tirana.

¹²⁰ Center of services and integrated legal practices, Albanian legislation and the Convention of Child Rights, (2008), Tirana.

- a) Masat e diversitetit dhe
- b) Masat edukative¹²¹.

Krahas kësaj ky Kod ka parashikuar dënimet që mundë të shqiptohen ndaj të miturve. Të tilla janë:

- a) Gjoba,
- b) Urdhëri për punë në dobi të përgjithshme, dhe
- c) Burgimi për të mitur.

Përvec masave dhe dënimeve kryerësve të mitur të veprave penale mund tu shqiptohen edhe masat e trajtimit të detyrueshëm dhe dënimet plotësuese. E rëndësishme është që ndaj të miturve që nuk kanë mbushur moshën 16 vjec pra të miturve të rinj mund të shqiptohen vetëm masat e diversitetit dhe masat edukative.

Masat e diversitetit

Masat e diversitetit janë masa të cilat i parashohin dhe zbatojnë shtetet bashkëkohore në legjislacionet e tyre penale,¹³ për të mitur. Duhet theksuar faktin se edhe edhe legjislacioni jonë penal i parasheh këto masa.

Këto masa sipas rekomandimit të akteve respektive ndërkomnëtare (Rregullat e Tokios dhe rregullat e Pekinit) i parasheh Kodi i drejtësisë për të Mitur. Këto janë masat më të lehta të cilat u shqiptohen të miturve. Gjatë shqiptimit të këtyre masave gjykatat marrin parasysh nevojën e të miturit për shkollim ose aftësim profesional.

Qëllimi i masave të diversitetit është përcaktuar në Kodin Penal. Së këndejmi, “qëllimi i masave të diversitetit është të parandalojë, kur është e mundur, fillimin e procedurës ndaj kryerësit të mitur, të ndihmoj në rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin e të miturit në bashkësinë e tij me qëllim të parandalimit të sjelljes recidiviste”.

Këto masa e mundësojnë rehabilitimin e të miturit, pa e maltretuar nëpër procedura të gjykatës dhe duke mos e shkëputur kontinuitetin e tij nga shkollimi dhe nevojat tjera të tij. Këto masa burimin e kanë edhe nga dokumente ndërkombëtare veqanrisht në **Rregullat e Pekinit**, të cilat rekomadojnë që të zbatohen si masa penale për të mitur.

Kushtet për shqiptimin e masave të diversitetit kanë të bëjnë me dy lloj kritere; lloji i parëndërlidhet me veprën e kryer, kurse lloji i dytë-me kryerësin e mitur. Gjithashtu janë paraparë edhe kushtet që duhet të plotësohen për shqiptimin e këtyre masave të diversitetit, e që ndërlidhen me veprën e kryer. Së këndejmi masa e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me gjobë apo dënimi me burgim deri 3 vjet, ose për veprën penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në 5 vjet burgim, me përjashtim të atyre të cilat si pasojë sjellin vdekjen.

Në Kodin e Drejtësisë për të Mitur janë paraparë gjithësejt tetë lloje të masave të diversitetit të cilat të cilat mund të shqiptohen ndaj kryerësve të mitur. Të tilla janë;

¹²¹ Hajdari Azem, “Kriminaliteti i të miturve në Kosovë 2001-2003”, Prishtinë 2004.

1. Pajtimi ndërmjet kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkimfaljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;
2. Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;
3. Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar përmes marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet viktimës, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
4. Vijimi i rregullt në shkollë;
5. Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij;
6. Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë;
7. Edukimi në rregullat e trafikut; dhe
8. Këshillimi psikologjik¹²².

Kur gjykatësi për të mitur ose prokurori i shtetit shqipton masën e diversitetit, shërbimit sprovues kompetent ia dërgon aktvendimin për ekzekutimin e masës adekuate. Sipas autorizimit ligjor gjykata e cila e ka shqiptuar masën e diversitetit, e mbikqyrë ekzekutimin e saj.

Të miturit duhet të trajtohen si viktima e jo si kriminelë sado që sjelljet e tyre të jenë të rrezikshme, por nuk do të thotë se duhet të fallen për sjelljet e tyre, por duhet të trajtohen më mirë gjatë rrjedhës së procedurës, dhe të zgjedhën masat më adekuate që duhen të aplikohen ndaj tyre.

Masat edukative – përmirësuese janë sanksione kryesore të veçanta penale kanë për qëllim në radhë të parë pengimin e veprimit kriminal të të miturve por edhe riedukimin risocializimin dhe përgaditëjen për jetë të miturve pas ekzekutimit të tyre.

Pra qëllimi i masave edukative është që të kontribuojnë në rehabilitimin dhe Zhvillimin adekuat të kryerësve të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë personale, duke i ndaluar nga sjelljet recidiviste”.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur i ka paraparë tetë lloje të masave edukative. Masat edukative janë:

I. Masat disiplinore:

1. Qortimi gjyqësor, dhe
2. Dërgimi i të miturit në qendrën disiplinore.

II. Masat e mbikqyrjes së shtuar:

1. Masat e mbikqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adaptues ose
 1. kujdestarit të të miturit,
 2. Mbikqyrja e shtuar nga ana e familjes tjetër, dhe
 3. Mbikqyrja e shtuar nga ana e organit të kujdestarisë.

III. Masat institucionale-edukative:

1. Dërgimi i të miturit në institucionin edukativ;

¹²² Hajdari Azem, “E drejta e procedurës penale e të miturve” (me ligjin penal për të mitur, Prishtinë 2005).

2. Dërgimi i të miturit në institucion edukues-korrektues, dhe
3. Dërgimi i të miturit në institucionin e kujdesit të posaqëm¹²³.

Masat edukative konsiderohen masat themelore në kuadrin e masave dhe dënimeve të zbatueshme ndaj të miturve.

Rrjedhimisht vend të rëndësishëm duhet kushtuar edhe gjetjes së masës adekuate me qëllim të mbrojtjes sa më të mirë të miturve, dhe duke i aftësuar ata gjatë qëndrimit nëpër institucione të veçanta, si dhe duke zhvilluar përgjegjësinë personale në mënyrë që në të ardhmen të bëhen qytetar të disiplinuar dhe respektojnë ligjin dhe normat morale të shoqërisë e jo recidivistë¹²⁴.

Masat disiplinore

Masat disiplinore ndaj të miturve konsiderohen masat më të lehta edukative që mund të shqiptohen ndaj kryesve të mitur të veprave penale. Këto masa kryesisht shqiptohen për vepra të lehta penale, dhe nga pakujdesia. Këto masa janë; qortimi gjyqësor dhe dërgimi në qendrën disiplinore.

a) Qortimi gjyqësor, – Kur i mituri kryen vepër penale të lehtë dhe gjykata mendon se është e mjaftueshme si masë për t’ia tërhequr vërejtjen të miturit në të ardhmen të mos përsëris veprat e tilla ajo ia shqipton këtë masë disiplinore.

b) Dërgimi në qendrën disiplinore – Edhe dërgimi në qendrën disiplinore përfaqëson masë insitucionale të lehtë që shqiptohet, për vepra penale të lehta. Në këto raste i mituri dhe dërgohen në qendër disiplinore për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin e tij dhe në evitimin e sjelljeve negative.

Masat e mbikqyrjes së shtuar

Masat e mbikqyrjes së shtuar janë masa të karakterit jasht institucional, që kanë rëndësi të madhe në pengimin dhe luftimin e kriminalitetit të të miturve pa e privuar atë nga liria dhe pa e izoluar nga mjedisi i tij, këto përfaqësojnë llojin më të shpeshtë të masave edukative që u shqiptohen kryerësve të mitur të veprave penale.

a) Mbikqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të të miturit – Për shqiptimin e masës së mbikqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të të miturit duhet të plotësohen dy kushte: Kushti i parë është që vepra penale të jetë kryer për shkak të mos shtrimit të mbikqyrjes dhe edukimit nga ana e prindërve, adoptuesit, apo kujdestarit. Kushti i dytë është se kjo masë edukative mund të shqiptohet nëse konstatohet se prindërit, prindi adoptues apo kujdestari i të miturit kanë mundësi dhe aftësi ta ushtrojnë mbikqyrjen dhe edukimin e tij. Qëllimi i mbikqyrjes është të zvogëlojë sjelljet e paligjshme të sërishme dhe t’i ndihmoj integritet të të miturit në shoqëri në një mënyrë që e minimizon dëshirën për t’iu kthyer krimin.

¹²³ Hajdari Azem, “E drejta e procedurave penale e të miturve” (me ligjin penal për të mitur, Prishtinë 2005).

¹²⁴ Latifi Vesel, “Fenomenologjia dhe struktura e delikuencës së të miturve dhe luftimi i saj në KSA të Kosovës”, “Përparimi” nr 4, Prishtinë, 1988.

b) Mbikqyrja e shtuar nga ana e familjes tjetër – Masa e mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër zakonisht shqiptohet në rastet kur në familjen e personit të mitur nuk ka kushte për zbatimin e masës së mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit. Kjo ndodh në rastet kur për shkaqe objektive prindërit, adoptuesi apo kujdestari nuk janë në gjendje ta ushtrojnë zbatimin e kësaj mase dhe atë për shkak të pa aftësisë fizike dhe psikike, si p. sh. për shkak të sëmundjeve të ndryshme, kur gjenden jashtë shtetit, janë duke mbajtur dënimin me burgim etj, ose edhe për shkak të rrethanave personale të tyre (janë alkoolist, narkoman etj). Me vendimet e saj familjes tjetër, gjykata i cakton obligime të cilat obligohet ajo t'i përmbushë. Ato obligime kanë të bëjnë me edukimin, shkollimin, dhe mbikëqyrjen e personit të mitur etj. Kjo masë edukuese nuk mund të zgjasë më pak se tre muaj dhe më gjatë dy vjet. Sipas të dhënave statistikore të përdorura nuk është shqiptuar në asnjë rast nga gjykatat e Rajonit të Gjilanit

c) Mbikqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë – sipas nenit 25 të kodit të drejtësisë për të mitur, masa e mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë shqiptohet nga gjykata pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues apo kujdestarit, kur ajo konstaton se personat e përmendur nuk janë në gjendje të ushtrojnë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit dhe kur një masë e tillë është në interesin më të mirë të miturit. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase i mituri edhe më tej mbetet në mjedisin e familjes së vetë. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase, gjykata i cakton detyra të caktuara organit të kujdestarisë të cilat kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e ekzekutimit të kësaj mase nga i mituri, lehtësimin e qasjes në arsimimin profesional dhe punësimin; sigurimin e largimit të miturit nga çfarëdo ndikimi negativ; lehtësimin e qasjes në kujdes shëndetësor; ofrimin e zgjidhjeve të mundshme lidhur me problemet që mund të shfaqen te i mituri dhe detyra të tjera që mund të caktoj gjykata me interes për të miturin. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase është obligim i gjykatave, zyrave të prokurorive, shkollave dhe institucioneve të tjera që të ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me organin e kujdestarisë gjatë ekzekutimit të kësaj mase edukative.

Masat institucionale

Masat edukative institucionale shqiptohen ndaj kryerësve të mitur të veprave penale ndaj të cilëve duhet ndërmarr masa afatgjate të edukimit, rehabilitimit dhe trajtimit¹²⁵.

Zakonisht masat institucionale aplikohen ndaj personave të mitur që kanë kryer vepra penale të rrezikshme, e nga ana tjetër, personaliteti i tyre me qëllim përmirësimi kërkon të ndërmerren disa metoda dhe mjete të posaçme të riedukimit dhe risocializimit.

Vendosja e personave të mitur në ente dhe institucione të veçanta arsyetohet edhe me faktin se ambienti jetësor i deritanishëm ndaj tyre ka kultivuar ndikim negativ dhe vlerësohet se është e domosdoshme që ata të largohen edhe në mënyrë fizike për një kohë të caktuar nga ai ambient, me qëllim të eliminimit të ndikimeve të tilla dhe krijimit të shprehive e vetive të reja konstruktive.

a) Dërgimi në institucionin edukativ – Sipas nenit 27 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, kjo masë edukative u shqiptohet atyre të miturve të cilve u nevojitet mbikëqyrje e plotë nga edukatori

¹²⁵ Latifi Vesel, “Disa vrojtme mbi sjelljet delikuede të të miturve dhe fëmijëve” E drejta, Prishtinë, nr.1 / 1997.

adekuat dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të miturit. Lidhur me kohëzgjatjen e kësaj mase, gjykata nuk vendos gjatë marrjes së vendimit, por më vonë kuptohet kjo, varet nga procesi i riedukimit dhe përmirësimit të personave të mitur. Kjo masë ekzekutohet nën mbikëqyrjen e Shërbimit Sprovues kompetent.

b) Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues – Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues është masë më e rëndë institucionale, e cila mund t'i shqiptohet të miturit. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase, veçmas theksohet se personave të mitur duhet t'u sigurohen kushte për riedukim, arsimim dhe trajtim të specializuar. Programi individual i trajtimit të të miturit duhet të jetë rezultat i një pune të përbashkët të ekipit multidisiplinar¹²⁶, në të cilën janë të përshirë ekspertë të ndryshëm të institucionit korrektues. Kjo masë institucionale mund të zgjatë prej një viti deri në pesë vjet (neni 28 paragrafi 3).

c) Dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm – Masa edukative e dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm i shqiptohet personit të mitur i cili ka kryer vepra penale për shkak të çrregullimeve dhe ngecjeve të tij bisopsikike dhe kur kjo është në interesin më të mirë të të miturit. Çdo i mitur i cili vuan nga sëmundjet mendore, duhet të shërohet në një institucion të specializuar, dhe të pavarur mjekësor. Në këto raste duhet të ndërmerren masa në marrëveshje me agjencitë përkatëse, për të siguruar çdo vazhdim të nevojshëm të përkujdesjes shëndetësore, mendore pas lirimimit. Mirëpo, në pajtim me nenin 29 të Kodit Penal për të Mitur, gjykata që e ka shqiptuar këtë masë, është e obliguar që çdo gjashtë muaj ta rishikoj nevojën për qëndrimin e mëtejshëm të të miturit në institucionin e kujdesit të posaçëm, e veçmas kur i mituri arrin moshën tetëmbëdhjetë vjeçare.

Dënimi me burgim për të mitur

Ky dënim me burgim është lloji më i rëndë i dënimeve që mund tu shqiptohet të miturve, ky dënim shqiptohet vetëm përjashtimisht dhe atë vetëm për rastet e kryerjes së veprave penale shumë të rënda dhe vetëm atëherë kur plotësohen të gjitha kushtet të parapara me ligj për shqiptimin e tij.

Në nenin 34 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, në krahasim me ligjin e aplikuar deri më tash, kohëzgjatja e burgut për të mitur është paraparë në dy variante dhe atë:

a) Gjykata mund të shqiptoj dënimin me burgim për të mitur, ndaj kryerësit të mitur i cili ka arritur moshën 16 vjeçare, për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me burgim mbi 5 vjet, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuat për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjrgjesisë penale, si dhe

b) Maksimumi i burgimit për të mitur është 10 vjet për veprat të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur i mituri ka kryer së paku dy vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se 10 vjet.

Të miturit mund t'i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj deri në 10 vjet. Shqiptimi i dënit bëhet në muaj dhe vite të plota. Me rastin e vendosjes për kohëzgjatjen e

¹²⁶ Latifi Vesel, "Kriminalistika e delikuencës së të miturve", Prishtinë, 1882.

burgimit për të mitur gjykata, merr parasyshë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 33 parag.3 të këtij Kodi të drejtësisë për të mitur¹²⁷.

3. Republika e Maqedonisë

Ligji për të Drejtën e të Miturve rregullon veprimin me fëmijët në rrezik dhe me kryerësit e mitur të veprimeve që me ligj janë përcaktuar si vepra penale dhe kundërvajtje, përcaktohen kushtet për zbatimin e masave të ndihmës, të kujdesit dhe mbrojtjes, masave edukative dhe alternative dhe për ndëshkimin e të miturve; pozita, roli dhe kompetencat e organeve që marrin pjesë në veprimin me fëmijët në rrezik dhe me kryerësit e mitur të veprimeve që me ligj janë përcaktuar si vepra penale dhe kundërvajtje dhe aplikimi i masave dhe i ndëshkimeve edukative dhe alternative. Me këtë ligj rregullohen masat për mbrojtjen e të miturit, viktimë e veprave penale dhe masat për parandalimin e devijimit të të miturve¹²⁸.

Qëllimet e ligjit dhe të zbatimit të tij janë realizimi i interesit prioritar dhe mbrojtja e të miturve nga kriminaliteti, dhuna dhe nga çfarëdo qoftë forme e rrezikimit të të drejtave dhe lirive të tyre dhe zhvillimin e tyre të drejtë; mbrojtjen e të miturve kryerës të veprave që me ligj janë cilësuar si vepra penale dhe kundërvajtje të përsëritura, socializmin e tyre, edukimin dhe riedukimin, ndihmën dhe përkujdesjen e të miturve dhe mbrojtjen në procedurë para gjyqit dhe para organeve të tjera të të drejtave dhe lirive të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Konventën e të drejtave të fëmijës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare për pozitën e të miturve në sistemin e drejtësisë, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Parimet themelore të ligji¹²⁹:

- Të miturit nuk mund t'i shqiptohet sanksion i paraparë me këtë ligj, për veprim që para se të kryhej nuk ka qenë me ligj i cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje dhe për të cilin nuk ka qenë i përcaktuar sanksion me ligj.
- Të miturit në procedim joformal të organeve dhe shërbimeve kompetente, si dhe në procedurën gjyqësore, i garantohen të gjitha të drejtat që i kanë personat e mitur të akuzuar në procedurën penale, respektivisht për kundërvajtje si dhe të drejtat e veçanta, të pranuar me Konventën për të drejtat e fëmijës dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara, në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqiptimin dhe zbatimin e cilitdo sanksion ose masë të përcaktuar me ligj.
- Zbatimi i masave dhe sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj dhe veprimi me të miturin janë subordinuar në interes të tij për mbrojtje, edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë.
- Gjatë zbatimit të masave dhe sanksioneve edhe në procedurat e përcaktuara me këtë ligj të miturit mund t'i merren ose t'i kufizohen të drejtat e caktuara vetëm në masë që

¹²⁷ Latifi Vesel, "Kryesit e mitur të veprave penale dhe pozita e tyre në legjislacionin penal", E Drejta, nr. 3, Prishtinë, 1996.

¹²⁸ Kambovski.V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje.

¹²⁹ Kambovski.V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje.

përgjigjet me shkallën e arritur të zhvillimit të personalitetit të tij dhe të nevojës së tij për mënjanimin e gjendjeve që ndikojnë që ai të bëjë vepra penale ose kundërvajtje.

- Nga masat dhe sanksionet e përcaktuara me këtë ligj, çdo herë iu jepet përparësi masave preventive, mbrojtëse dhe edukuese. Sanksionet që përbëjnë me privim nga liria të të miturit, do të zbatohen në raste të veçanta, si mjet i fundit, nëse ndryshe nuk mund të arrihet qëllimi i zbatimit të masave dhe sanksioneve për veprën e kryer penale.
- Masa ose sanksioni që i shqiptohet të miturit duhet t'i përgjigjet personalitetit të tij, peshës së veprës që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje dhe pasojat e saj, nevojën e edukimit të tij, riedukimin, arsimimin dhe zhvillimin, me qëllim të sigurimit dhe mbrojtjes së interesit më të mirë për të miturin.
- Për veprimin e të miturit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, organet kompetente dhe shërbimet sipas rregullit nuk ndërmarrin procedurë gjyqësore, që të mënjanohet ndikimi i dëmshëm ndaj të miturit, përveç nëse cilësitë personale të të miturit dhe rrethanat në të cilat është kryer veprimi nuk tregojnë për nevojën e mbajtjes së procedurës gjyqësore. Procedura gjyqësore sipas rregullit, zbatohet vetëm në rastet e parapara me këtë ligj, nëse i mituri ka kryer vepër që me ligj është përcaktuar si vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg prej tre vjet ose dënim më i rëndë, ose në rast kur qëllimi i masave ose sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj nuk mund të arrihet pa procedurën e tillë.
- I mituri ka të drejtën e mbrojtjes në gjykatën kompetente kundër aktvendimeve të marra në procedurën administrative.
- E drejtë themelore e të miturit është që procedurën ndaj tij ta mbajë dhe sanksionet e përcaktuara me këtë ligj t'i shqiptojë vetëm gjykata kompetente për kriminalitetin e të miturve. Masat e tjera të përcaktuara me këtë ligj mund t'i shqiptojnë edhe organet tjera të specializuara.

Ndaj të miturit i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, që nuk i ka mbushur katërmbëdhjetë vjet - fëmijë në rrezik nuk mund të zbatohet sanksioni i paraparë me këtë ligj. Ndaj fëmijës në rrezik zbatohen masat e ndihmës dhe të mbrojtjes.

Ndaj fëmijës në rrezik zbatohen masat e ndihmës dhe të mbrojtjes vetëm kur Qendra për punë sociale do të vlerësojë se gjendja e rrezikut shprehet në zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe edukimin e tij të drejtë dhe ajo mund të ndikojë që në të ardhmen të bëjë vepra penale ose kundërvajtje.

Masat nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zbatohen edhe ndaj anëtarëve të familjes nëse e kanë lënë pas dore ose keqpërdorur kryerjen e të drejtave të tyre ose detyrave në drejtim të mbrojtjes së personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës.

Masat e ndihmës dhe të mbrojtjes janë masa të përcaktuara me ligj në sferën e arsimit, mbrojtjes shëndetësore, sociale, familjare dhe formave tjera të mbrojtjes.

Për veprim të fëmijës, që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, si dhe për veprimin e të miturit të vogël ose të madh në rrezik që është cilësuar si vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg deri në tri vjet ose kundërvajtje, si dhe për gjendje tjera në rrezik, informohet Qendra për punë sociale (në tekstin e mëtejme: qendra) kompetente sipas vendit të banimit të të miturit. Qendra vepron sipas informimit të Ministrisë për Punë të Brendshme, shkollës ose nga institucioni tjetër në të cilin i mituri është vënë në përkujdesje dhe edukohet, si dhe nga familja, i mituri, i dëmtuari dhe nga personi tjetër.

Në afat jo më të gjatë se shtatë ditë nga pranimi i informimit ose njohurisë tjetër, e në raste urgjente jo më vonë se njëzetë e katër orë, qendra e thërret fëmijën respektivisht të miturin e vogël ose të madh në rrezik dhe familjen e tij dhe ngre procedurën me karakter të besueshëm për shkak të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të ngjarjes konkrete ose gjendjes në rrezik. Bisedën e mban përfaqësuesi nga ekipi profesional ose ekipi profesional i përbërë nga pedagogu, punëtori social, psikologu dhe juristi i diplomuar. Në bisedë, detyrimisht marrin pjesë avokati i cili i mbron të drejtat dhe interesat e fëmijës, respektivisht të miturit të vogël ose të madh në rrezik. Familja e zgjedh avokatin, e nëse nuk zgjedh avokat, atë e cakton Qendra sipas detyrës zyrtare nga lista e përpiluar nga Oda e avokatëve. Ndhima juridike për fëmijën, respektivisht të miturin e vogël ose të madh është pa pagesë. Të gjithë pjesëmarrësit gjatë procedimit me fëmijën, respektivisht me të miturin e vogël ose të madh në rrezik janë të detyruar që të dhënat, tek të cilat kanë arritur, t'i ruajnë në pajtim me dispozitat për informatat e klasifikuara, respektivisht dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Avokati është i detyruar të japë mendim juridik për rastin në formë të shkruar në afat prej shtatë ditësh nga biseda me ekipin profesional. Nëse ekipi profesional nuk e pranon mendimin e avokatit ose avokati nuk e jep mendimin në afatin e përcaktuar nga paragrafi 1 i këtij neni, Qendra është e detyruar në afat prej shtatë ditësh nga dorëzimi i tij të kërkojë nga gjykata kompetente për të mitur që të marrë aktvendim për veprimin e mëtejme të qendrës. Në rast kur, avokati nuk e jep mendimin në afatin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, gjykata për atë do ta informojë Odën e avokatëve. Aktvendimi i gjyqit për të mitur se nuk ka vend për procedim të mëtejme të Qendrës nuk është pengesë, gjatë përcaktimit të rrethanave të reja në lidhje me veprimin tjetër që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose si kundërvajtje ose gjendje në rrezik, ai të vazhdojë me zbatimin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes së të miturit në pajtim me dispozitat nga neni 16 i këtij ligji.

Në bazë të informatave të grumbulluara dhe të dhënave tjera me të cilat disponon qendra, si dhe bisedën e zhvilluar me familjen dhe fëmijën, respektivisht të miturin e madh ose të vogël në rrezik, ekipi profesional nga neni 19 paragrafi 2 i këtij ligji, në afat prej 30 ditëve, përgatit program për masat dhe aktivitetet (në tekstin e mëtejme: program) dhe e zbaton. Në përpilimin dhe zbatimin e programit marrin pjesë edhe organet ose personat e tjerë specialistë.

Më së voni, në afat prej dhjetë ditë pas dorëzimit të programit, ekipi profesional nga neni 19 paragrafi 2 i këtij ligji, bisedon për të dytën herë me familjen në të cilën jeton fëmija respektivisht i mituri i vogël ose i madh në rrezik me qëllim që në mënyrë direkte të bindet nëse

prindi ose kujdestari mund të përkujdesen për të dhe nëse mund t'i mënjanojnë shkaqet për sjelljen e tij dhe gjendjen e rrezikut. Ekipi profesional i njofton prindit, respektivisht kujdestarin me programin, me qëllim të pjesëmarrjes së tyre aktive në zbatimin e masave të ndihmës dhe mbrojtjes dhe njëkohësisht i paralajmëron për pasojat e mëtejme nga mosbashkëpunimi me qendrën. Ekipi profesional takohet me prindërit, respektivisht me kujdestarin së paku një herë në muaj.

Ndryshimet e programit bëhen në pajtim me suksesin e masave të ndërmarra ose rrethanave të reja. Masat e ndihmës dhe të mbrojtjes mund të zgjasin deri në arritjen e të miturit në moshë tetëmbëdhjetë vjeçe. Mbikëqyrjen e zbatimit të programit e bën Enti për veprimtari sociale.

Nëse familja ose kujdestari nuk e zbaton programin e qendrës, në afat prej shtatë ditëve nga përcaktimi i rrethanës së tillë, qendra e informon gjykatësin kompetent për të mitur i cili në afat prej tre ditëve merr aktvendim për zbatimin e masave të përfshira në program, duke i dhënë udhëzime të caktuara qendrës. Aktvendim nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të marrë edhe gjykatësi për të mitur me propozim të avokatit të fëmijës, respektivisht të miturit të vogël ose të madh në rrezik ose familjes së tij ose kujdestarit. Nëse familja nuk vepron sipas aktvendimit të gjykatës, do të zbatohen masat e përcaktuara me ligj.

Nëse me veprimin që me ligj është cilësuar si vepër penale ose si kundërvajtje, fëmija respektivisht i mituri i ri ose i vjetër në rrezik ka përfituar interes material ose i ka shkaktuar dëm dikujt tjetër, qendra ndërmjetëson midis familjes ose kujdestarit, respektivisht fëmijës, të miturit të vogël ose të madh në rrezik dhe familjes së tij ose kujdestarit dhe të dëmtuarin për shkak të kthimit të interesit material ose kompensimin e dëmit. Procedura e ndërmjetësimit mund të zgjasë më së shumti tridhjetë ditë pas marrjes së aktvendimit për ngritjen e procedurës për ndërmjetësim. Për pëlqimin, përpilohet marrëveshje që ka rëndësinë e barazimit jashtë procesit gjyqësor. Nëse ndërmjetësimi nuk ka sukses, i dëmtuari mundet në afat prej tridhjetë ditëve pasi që të konstatojë mossakses në ndërmjetësim, t'i paraqesë propozim

Sanksionet që u shqiptohen të miturve

Për veprim që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje të kryera nga të miturit, në formë të njëjtë zbatohen dispozitat e Kodit penal, si dhe dispozitat e Ligjit për kundërvajtje dhe ligjet tjera në të cilat janë përcaktuar kundërvajtjet. Dispozitat e veçanta që vlejné për kryerësit e mitur të veprave penale zbatohen nën kushte të përcaktuara në dispozitat e këtij kapitulli dhe ndaj personave të moshës madhore kur u gjykohet për vepra penale që i kanë kryer si të mitur, e me përjashtim edhe ndaj personave që kanë kryer vepër penale si të moshës madhore të vogël¹³⁰.

Ndaj të miturit të vogël për veprim që me ligj është përcaktuar si vepër penale mund të shqiptohen vetëm masa edukuese. Ndaj të miturit të madh për veprim që me ligj është përcaktuar si vepër penale mund të shqiptohen masa edukuese, e me përjashtim mund t'i shqiptohet dënim ose masë alternative. I mituri i madh mund të lirohet nga dënimi nën kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Kodin penal.

¹³⁰ Kambovski.V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje.

Ndaj të miturit për veprim që me ligj është përcaktuar si kundërvajtje mund të shqiptohen sanksione për kundërvajtje të përcaktuara me këtë ligj. Të miturit i shqiptohen masat e sigurisë sipas kushteve të përcaktuara me Kodin penal dhe me këtë ligj. Konfiskimi i pronës dhe i dobisë pronësore dhe sendeve të përfituara me vepra penale dhe kundërvajtje të të miturve, bëhet në pajtim me kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Kodin penal.

Qëllimi i masave edukative, i dënimit, masave alternative dhe sanksioneve për kundërvajtje përbëhet në sigurimin e mbrojtjes dhe ndihmës së të miturve, që të sigurohet edukimi i tyre dhe riedukimi. Qëllimi i dënimit përbëhet në ushtrimin e ndikimit të përforcuar ndaj të miturve që në të ardhmen të mos bëjnë vepra penale, si dhe ndaj të miturve të tjerë që të mos kryejnë vepra penale.

Sanksioni që i shqiptohet të miturit duhet t'i përgjigjet personalitetit të tij, peshës së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje dhe pasojave të tij, nevojave të edukimit të tij, riedukimit, arsimimit dhe zhvillimit, për shkak të sigurimit dhe mbrojtjes së interesit më të mirë të të miturit. Kur janë plotësuar kushtet ligjore, gjykata kompetente shqipton dënim vetëm nëse është i arsyeshëm shqiptimi i masës së edukimit ose masës alternative.

Dënimi që ka të bëjë me privimin nga liria, gjykata kompetente mund ta shqiptojë kur qëllimi i masave edukative, dënimi ose masat alternative nuk mund të arrihen me masat e ndihmës dhe mbrojtjes. Nëse është shqiptuar sanksion më i rëndë ose sanksion që ka të bëjë në privimin nga liria, gjykata kompetente në mënyrë të veçantë i arsyeton shkaqet e shqiptimit të tij.

Kryerësit të mitur të veprës penale mund t'i shqiptohen këto masa edukative:

- masa disiplinore: qortim ose udhëzim në qendrën disiplinuese për të mitur,
- masat e mbikëqyrjes së përforcuar: nga ana e prindërve ose kujdestarit, familjes që përkujdeset ose nga ana e qendrës.

Gjatë zgjedhjes së masës edukative gjykata do ta marrë parasysh moshën e të miturit, shkallën e zhvillimit të tij shpirtëror, cilësitë psikike të tij, prirjet, motivet nga të cilat e ka bërë veprën, edukimin e deritanishëm, mjedisin dhe rrethanat në të cilat ka jetuar, peshën e veprës, a është shqiptuar ndaj tij më parë masa edukative ose dënim me burg për të miturit dhe të gjitha rrethanat që ndikojnë ndaj përcaktimit të llojit të masës me qëllim të arritjes së qëllimit të saj të përcaktuar me ligj¹³¹.

Qortimi shqiptohet nëse mjafton vetëm qortimi i të miturit për veprën e kryer penale. Gjatë shqiptimit të qortimit, të miturit do t'i bëhet me dije për dëmin nga veprimi i tij dhe do t'i tërhiqet vërejtja se në rast të përsëritjes së veprës penale ndaj tij mund të shqiptohet sanksion tjetër penal.

Gjyqi do ta shqiptojë masën e dërgimit në qendrën disiplinuese për të mitur kur është e nevojshme me masa adekuate afatshkurta të bëhet ndikim ndaj personalitetit dhe sjelljes së të miturit. Të miturin, të cilit i është shqiptuar kjo masë, gjykata mund ta dërgojë në qendrën disiplinore:

¹³¹ Kambovski.V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje.

- në një numër të caktuar orësh gjatë ditës, në ditë feste, edhe atë më së shumti në katër ditë feste të njëpasnjëshme,
- në një numër të caktuar orësh gjatë ditës, por më së shumti një muaj ose
- në qëndrim të pandërprerë për një numër të caktuar ditësh, por jo më shumë se njëzet ditë.

Gjatë shqiptimit të kësaj mase, gjykata do të mbajë llogari për atë se me zbatimin e saj i mituri të mos mungojë nga mësimi i rregullt ose nga puna. Në qendrën disiplinore i mituri do të bëjë punë që i përgjigjet gjendjes së tij psikofizike. Kur do të shqiptojë dërgim në qendër disiplinore, gjykata mund të përcaktojë që gjatë kohës dhe pas zbatimit të kësaj mase i mituri të vihet nën mbikëqyrje të përforcuar të qendrës, për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj.

Gjykata do të shqiptojë masën e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e prindërve ose e kujdestarit nëse prindërit ose kujdestari kanë bërë lëshim, ndërsa kanë mundësi që të bëjnë mbikëqyrje ndaj të miturit. Kur gjykata do ta shqiptojë këtë masë do t'i ngarkojë prindërit ose kujdestarin me disa detyra të caktuara në drejtim të masave që duhet të ndërmerren për edukimin e të miturit, për shërimin e tij dhe për mënjanimin e ndikimeve të dëmshme ndaj tij, kurse mund t'u japë edhe udhëzime të duhura. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata mund të caktojë që qendra ta kontrollojë zbatimin e saj dhe t'i ofrojë ndihmë prindit ose kujdestarit. Gjykata në mënyrë plotësuese do të vendosë për përfundimin e këtij kontrolli me atë që nuk mund të zgjasë më pak se një vit as më gjatë se tre vjet.

Nëse prindërit ose kujdestari i të miturit nuk kanë mundësi të bëjnë mbikëqyrje ndaj tij ose nëse ajo me arsye nuk mund të pritët nga ata, i mituri do t'i dorëzohet familjes për përkujdesje e cili dëshiron ta pranojë dhe që ka mundësi të bëjë mbikëqyrje të përforcuar ndaj tij. Zbatimi i kësaj mase do të ndërpritet kur prindërit ose kujdestari i të miturit do të fitojnë mundësinë që të bëjnë mbikëqyrje të përforcuar ndaj tij ose kur sipas rezultateve të edukimit dhe riedukimit nuk do të ketë nevojë për mbikëqyrje të përforcuar. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata do të caktojë që qendra ta kontrollojë kohëzgjatjen e zbatimit të saj dhe t'i ofrojë ndihmë të duhur familjes të cilës i është dhënë i mituri.

Nëse prindërit ose kujdestari nuk kanë mundësi të bëjnë mbikëqyrje të përforcuar ndaj të miturit, kurse nuk ekzistojnë kushte për dorëzimin e të miturit në familje për përkujdesje për shkak të kryerjes së mbikëqyrjes së këtyllë, i mituri do të vihet nën mbikëqyrjen e qendrës. Gjykata në mënyrë plotësuese do të vendosë që masa të përfundojë, me atë që kohëzgjatja nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit, as më e gjatë se tre vjet. Për kohëzgjatjen e masave i mituri edhe më tej ngel që të jetojë te prindërit e vet ose te personat e tjerë që e mbajnë, ndërsa mbikëqyrjen përforcuese ndaj tij e bën qendra. Nëse i mituri nuk mund të ngelë në familje në të cilën ka jetuar, qendra do ta vendosë në institucion edukues dhe do të kujdeset për shkollimin e tij ose për punësimin, për ndarjen nga mjedisi që ndikon dëmshëm ndaj tij, për shërimin e duhur dhe për përmirësimin e rrethanave në të cilat jeton.

Gjatë shqiptimit të ndonjëres nga masat edukuese të mbikëqyrjes së përforcuar, gjykata mundet të miturit t'i caktojë një ose më shumë obligime të veçanta nëse ajo është e duhur për zbatimin më të suksesshëm të masës së shqiptuar.

Gjykata mundet të miturit t'ia caktojë veçanërisht këto obligime:

- t'i kërkojë falje personalisht personit të dëmtuar,
- ta korrigjojë ose kompensojë dëmin e shkaktuar me veprën penale,
- rregullisht ta ndjekë shkollën,
- të mos mungojë nga vendi i punës,
- të aftësohet për punë që u përgjigjet aftësive, prirjeve dhe forcës fizike të tij,
- të pranojë punë,
- t'ia ndalojë përdorimin e pijeve alkoolike, drogës dhe substancave të tjera psikotrope,
- të dërgohet në entin shëndetësor adekuat ose në këshillimore,
- në mënyrë produktive ta shfrytëzojë kohën e lirë,
- të mos kontaktojë me persona që ndikojnë dëmshëm në personalitetin e tij,
- t'i nënshtrohet ngritjes profesionale dhe rikualifikimit me qëllim të mbajtjes së vendit të punës që e ka marrë ose për krijimin e parakushteve për punësim,
- të mundësojë shikim dhe të pranojë këshilla në lidhje me organizimin dhe shpenzimin e rrogës dhe të ardhurave të tjera që i realizon,
- të kyçet në punën e organizatave humanitare, organizatave komunale, ekologjike ose joqeveritare dhe
- të inkuadrohet në organizatë të caktuara sportive, kulturore-argëtuese ose në shoqata me obligim që t'i ndjekë provat dhe trajnimet e rregullta.

Gjykata mundet, me propozim të qendrës, t'i ndryshojë ose t'i heqë obligimet e veçanta që i ka caktuar. Gjatë përcaktimit të obligimeve nga paragrafi 2 i këtij neni, gjykata veçanërisht do t'u bëjë me dije të miturit dhe prindërve të tij, të birësuesit, respektivisht kujdestarit, se në rast se i mituri nuk i përmbush obligimet, masa mund të zëvendësohet me dërgim në qendrën disiplinore ose me masë të entit. Qendra bën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe e ndihmon të miturin në plotësimin e obligimeve të caktuara, bashkëpunon me prindërit, respektivisht kujdestarin dhe e informon gjykatën, së paku një herë në gjashtë muaj për suksesin e arritur në realizimin e obligimeve të veçanta.

Gjykata mund ta dërgojë të miturin në entin edukues ndaj të cilit duhet të ushtrohet mbikëqyrje e vazhdueshme nga ana e personave profesionalë (me përgatitjen profesionale dhe shkollore për edukatorë) me qëllim të edukimit, riedukimit dhe zhvillimit të drejtë. Në entin edukues i mituri ngel së paku gjashtë muaj, e më së shumti tre vjet. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e përcakton kohëzgjatjen e saj por për atë vendos në mënyrë plotësuese (neni 41 paragrafi 2 i këtij ligji).

Të miturin ndaj të cilit duhet të zbatohen masat e vazhdueshme dhe të përforcuara për edukim dhe riedukim dhe veçimin e tij të plotë nga mjedisi i deriatëhershëm, gjykata mund ta dërgojë në shtëpinë edukuese-korrektuese. Gjatë marrjes së vendimit nëse do ta shqiptojë këtë masë, gjykata veçanërisht do ta marrë parasysh peshën dhe natyrën e veprës së kryer dhe rrethanën nëse ndaj të miturit më herët janë shqiptuar masa edukuese ose dënimi me burg për të mitur.

Në shtëpinë edukuese-korrektuese i mituri qëndron së paku një vit, e më së shumti pesë vjet, respektivisht deri në mbushjen e njëzet e tre vjetëve. Gjatë shqiptimit të kësaj mase gjykata nuk e përcakton kohëzgjatjen e saj por për atë vendos në mënyrë plotësuese. Gjykata e rishqyrton

nevojën e qëndrimit në shtëpinë edukuese-korrektuese çdo vit.

Kur, pas marrjes së vendimit me të cilin shqiptohet masa e mbikëqyrjes së përforcuar ose masa e entit, do të paraqiten rrethanat që nuk kanë ekzistuar gjatë kohës së marrjes së vendimit ose për ato nuk është ditur, ndërsa kanë ndikim në marrjen e vendimit, zbatimi i masës së shqiptuar, mund të pezullohet ose të zëvendësohet me masë tjetër të mbikëqyrjes së përforcuar ose me masë enti. Me përjashtim të rasteve nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse për masa të caktuara nuk është paraparë ndryshe, zbatimi i masës mbikëqyrje e përforcuar ose e masës së entit, duke marrë parasysh suksesin e arritur në edukimin dhe riedukimin, mund të pezullohet, por mund të zëvendësohet edhe me masë tjetër të tillë, me kufizimet si vijon:

- masa dërgim në entin edukues nuk mund të ndërpritet nga zbatimi para skadimit të afatit prej gjashtë muajsh, kurse deri në skadimin e këtij afati mund të zëvendësohet vetëm me dërgimin e të miturit në shtëpinë edukuese-korrektuese dhe
- masa dërgim në shtëpinë edukuese-korrektuese nuk mund të pezullohet nga zbatimi para skadimit të afatit prej një viti.

Nëse nga plotfuqishmëria e vendimit me të cilin është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së përforcuar ose masa e entit ka kaluar më shumë se një vit, kurse zbatimi nuk ka filluar, gjykata sërish do të vendosë për nevojën e zbatimit të tij. Me këtë rast, gjykata mund të vendosë që masa e shqiptuar më herët të zbatohet, të mos zbatohet ose të zëvendësohet me ndonjë masë tjetër. Masa, dërgim në qendrën disiplinore për të mitur nuk do të zbatohet nëse nga plotfuqishmëria e vendimit me të cilin është shqiptuar kjo masë kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj, ndërsa zbatimi i tij nuk ka filluar.

Mund të dënohet vetëm i mituri i madh me përgjegjësi penale nëse për shkak të pasojave të rënda nga vepra penale dhe shkallës së lartë të përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohej masa edukative. Nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj, të miturit të madh mund t'i shqiptohen dënimet si vijojnë:

- burg për të miturit,
- dënim me para,
- ndalesa për drejtim me automjet të llojit të caktuar ose kategorisë së caktuar dhe
- dëbimi i të huajit nga vendi.

Burg për të miturit mund të shqiptohet vetëm si ndëshkim kryesor.

Dënim me para mund të shqiptohet si dënim kryesor. Me përjashtim, për vepra penale të kryera me interes përfitimi, dënimi me para mund të shqiptohet si dënim dytësor së bashku me dënimin me burg për të mitur ose me dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse kur është përcaktuar dënim me burg për të mitur. Ndalimi për drejtim me automjet të llojit të caktuar ose të kategorisë dhe dëbimi i të huajit nga vendi mund të shqiptohen si dënim kryesor ose si dënim dytësor me dënim me para.

Burg për të mitur mund t'i shqiptohet të miturit të madh për përgjegjësi penale, që ka kryer vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej pesë vjetësh ose dënim më të rëndë, nëse

vepra është kryer në rrethana veçanërisht të rënda dhe gjatë shkallës së lartë të përgjegjësisë penale të kryerësit dhe me ç'rast nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohej masa edukative. Vuajtja e burgut për të miturit nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit as më e gjatë se dhjetë vjet, kurse shqiptohet në vite të plota ose në gjysmën e vitit. Gjatë llogaritjes së dënimit të miturit të madh për vepër të përcaktuar penale, gjykata nuk mund t'i shqiptojë burg për të mitur në kohëzgjatje më gjatë se dënimi i përcaktuar me burg për atë vepër, por gjykata nuk është e lidhur për masën më të vogël të përcaktuar për atë dënim.

Gjatë llogaritjes së dënimit burg për të mitur, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i madh ose më i vogël, të përcaktuar në Kodin penal, veçanërisht duke mbajtur llogari për shkallën e zhvillimit shpirtëror të të miturit dhe për kohën e duhur për edukimin e tij, riedukimin dhe aftësimin profesional.

I mituri i cili është në vuajtje të dënimit burg për të mitur mund të lëshohet në lirim me kusht nëse ka vuajtur gjashtë muaj nga dënimi i shqiptuar nëse riedukimi është i suksesshëm. Gjatë kohës së lirimimit me kusht gjykata i përcakton masën e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e qendrës në kohëzgjatje të caktuar, e cila mund të jetë edhe më e shkurtër se pjesa e dënimit të pavuajtur. Gjkata mund ta vazhdojë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes së përforcuar prej një viti pas kohëzgjatjes së dënimit, por më së shumti deri në arritjen e moshës njëzetë e një vjeç të të dënuarit.

Gjkata do ta heqë lirimin me kusht nëse i dënuari i mitur nuk i plotëson obligimet e përcaktuara me mbikëqyrjen e përforcuar ose nëse bën një ose më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi burg për të mitur mbi dy vjet, deri sa është i liruar me kusht. Nëse i mituri ka bërë vepër penale për të cilën i është shqiptuar dënim deri në dy vjet burg për të mitur ose dënim me para, gjykata mund ta heqë lirimin me kusht, duke marrë parasysh ngjashmërinë e veprave penale të kryera, rëndësinë e tyre, motivet për shkak të të cilave janë bërë dhe rrethanat e tjera që tregojnë në arsyen e heqjes së lirimimit me kusht.

Kur gjykata do ta heqë lirimin me kusht, do të shqiptojë një dënim me zbatimin e dispozitave nga neni 53 i këtij ligji, duke marrë dënimin e shqiptuar më herët tani si të përcaktuar. Kur gjykata nuk do ta heqë lirimin me kusht, ai vazhdohet për kohën të cilën i mituri i dënuar e ka kaluar në vuajtjen e dënimit burg për të mitur të shqiptuar për veprën e re.

Dënimi me para mund t'i shqiptohet të miturit të madh me përgjegjësi penale, i cili për interes të përfitimit ka kryer vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej së paku tre vjet.

Dënimi me para shqiptohet në gjoba ditore. Numri i gjobave ditore nuk mund të jetë më i vogël se një, as më i madh se 120 gjoba ditore. Në lidhje me llogaritjen dhe zbatimin e dënimit me para në formë të njëjtë zbatohen dispozitat e Kodit penal.

Dënimin të papaguar me para gjykata mund ta zëvendësojë me masën punë me interes të përgjithshëm. Një gjobë ditore zëvendësohet me tre orë pune me interes të përgjithshëm, me ç'rast numri i përgjithshëm i orëve pune me interes të përgjithshme nuk mund të jetë më i madh se 100 orë.

Dënimin të papaguar me para dhe punën me interes të përgjithshëm të pazbatuar dhe pjesërisht të zbatuar si zëvendësim të saj, gjykata mund ta zëvendësojë edhe me masë disiplinore, dërgim në qendër disiplinore për të mitur, ose me masë të mbikëqyrjes së përforcuar.

Ndalimi i drejtimit me automjet, me lloj të caktuar ose kategori të caktuar dhe dëbimi i të huajit nga vendi, shqiptohen në kushtet e shqiptimit të tyre të përcaktuara në Kodin penal.

Kur gjykata sipas dispozitave të përgjithshme në Kodin penal do ta shpallë të miturin për fajtor dhe do ta lirojë nga dënimi, mund t'i shqiptojë edhe masë edukuese.

Për vepra penale në varg gjykata i kumton të miturit vetëm një masë edukuese ose vetëm dënim me burgim për të mitur ose dënim me para kur ekzistojnë kushte ligjore për kumtimin e atij dënimi dhe kur gjykata do të konstatojë se duhet të kumtohet.

Gjykata do të veprojë sipas paragrafit 1 të këtij neni edhe kur pas kumtimit të masës edukuese, gjegjësisht burgimit për të mitur ose dënimin me para do të përcaktojë se i mituri para ose pas kumtimit të tyre ka bërë ndonjë vepër penale. Nëse i mituri i madh bën më tepër vepra penale në varg, ndërsa gjykata konstaton se për çdo vepër të veçantë penale duhet t'i kumtohet dënim me burgim për të mitur ose dënim me para, dënimin do t'ia masë sipas vlerësimit të lirë në suaza të masës më të madhe ligjore të saj. Gjykata do të veprojë sipas paragrafit 3 të këtij neni edhe në rast se pas kumtimit të dënimin përcakton se i mituri para ose pas kumtimit të saj ka bërë vepër penale.

Nëse gjatë kohëzgjatjes së masës edukuese gjykata kumton dënim me burg për të mitur, masa edukuese pushon me fillimin e mbajtjes së këtij dënimi. Nëse gjatë kohëzgjatjes së masës edukuese gjykata i kumton personit të moshës së re madhore dënimin me burg për të mitur ose burgimi së paku një vit, masa edukuese pushon me fillimin e mbajtjes së dënimin. Nëse dënimi i kumtuar është në kohëzgjatje më e shkurtër nga masa edukuese, gjykata në aktgjykimin do të vendosë nëse pas mbajtjes së dënimin do të vazhdojë zbatimin e masës edukuese ose do ta ndërpresë.

Të miturit të madh përgjegjës penal për vepër penale të kryer mund t'i kumtohen masat alternative në vijim:

- gjykim i kushtëzuar me mbikëqyrje të mbrojtur,
- ndërprerje e kushtëzuar e mbajtjes së procedurës ndaj të miturit, dhe
- punë me dobi të përgjithshme.

Dispozitat e Kodit penal për masat alternative ka të bëjnë edhe në kumtimin e tyre të miturve të mëdhenj, në qoftë se me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Qëllim i masave alternative është që ndaj të miturit të madh përgjegjës penal që të mos zbatohet dënim kur kjo nuk është e domosdoshme për shkak të pengimit të kryerjes së veprave penale dhe kur mund të pritët se paralajmërimi me kërcënimin e dënimin dhe zbatimin të masave të ndihmës, mbrojtjes dhe mbikëqyrjes së lirisë në mënyrë të mjaftueshme do të ndikojë ndaj edukimit, riedukimit dhe zhvillimit të rregullt të tij.

Dënimi i kushtëzuar me mbikëqyrje të mbrojtur mund të kumtohet kur të miturit i është përcaktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre vjet ose dënim me para. Nëse të miturit i është përcaktuar edhe dënim me burg për të mitur dhe dënim me para, dënimin e kushtëzuar gjykata mund të kumtojë për të dy dënimet ose vetëm për dënimin me burg për të mitur. Kohën për kontrollim gjykata e përcakton në kohëzgjatje e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një e as më e gjatë se tre vjet. Mbikëqyrja e mbrojtur përbëhet në një ose më tepër obligime të përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji për të cilat i mituri është i obliguar që t'i përmbahet kohës për kontroll.

Ndihmë dhe kujdes, mbikëqyrje dhe mbrojtje të përmbushjes së obligimeve nga ana e të miturit kryen qendra, e cila është e obliguar që me këshilla praktike ta nxisë dhe ta ndihmojë në përmbushjen e tyre, të bashkëpunojë me prindërit, adoptuesin ose tutorin dhe kohë pas kohe, e së paku një herë në tre muaj, ta njoftojnë gjykatën për gjendjet me përmbushjen e obligimeve të përcaktuara. Gjukata do ta revokojë dënimin me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur nëse i mituri gjatë kohës për kontroll nuk i plotëson obligimet e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji ose bën një ose më tepër vepra penale, për të cilat është e përcaktuar dënim me burg për të mitur në kohëzgjatje më shumë se tre vjet, ose nëse pas kumtimit të dënimin me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur përcakton se i mituri ka kryer vepër penale para se të jetë dënuar me kusht dhe se është i domosdoshëm dënimi për veprat penale të kryera paraprakisht.

Gjukata mund të vendosë që me kusht ta ndërpresë procedurën ndaj të miturit të madh për vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose dënim me burg deri në pesë vjet, nëse i mituri ka shprehur pendim për veprën e kryer, nëse i ka shmangur pasojat e veprës, nëse e ka kompensuar dënimin dhe nëse është pajtuar me të dëmtuarin, i cili pajtohet me ndërprerjen e procedurës, me kusht që në afat prej dy vjetësh i mituri të mos bëjë vepër tjetër penale.

Gjukata të miturit të madh përgjegjës penal i cili ka kryer vepër penale për të cilën është përcaktuar dënim me para ose dënim me burgim prej tre vjetësh mund t'i kumtojë masë pune me dobi të përgjithshëm në kohëzgjatje prej pesë deri njëqind orë kur është e nevojshme që me këtë masë të bëhet ndikim edukues ndaj personit dhe sjelljes së të miturit.

Mbikëqyrjen mbi plotësimin e obligimeve të punës së të miturit e kryen qendra, e cila është e obliguar që kohë pas kohe, e më së paku një herë në muaj, ta njoftojë gjykatën për zbatimin e masës. Nëse i mituri nuk i plotëson ose në mënyrë të parregullt i plotëson obligimet e urdhëruara të punës, gjykata do ta zëvendësojë këtë masë me masën dërgim në qendër disiplinore për të mitur ose me masën e mbikëqyrjes së përforcuar, me kushtet e parashikuara për kumtimin e tyre, duke marrë parasysh pjesën e obligimeve të cilat janë plotësuar.

SHËRBIMI I PROVËS

1. Çfarë është shërbimi i provës?

Shërbimi i provës ekziston në shumë vende të ndryshme në mbarë botën, në çfarëdo regjimi politik apo kulturë. Edhe vetë fjala shërbim i provës po përdoret si term ndërkombëtar duke kapërcyer çdo gjuhë dhe ndryshime ligjore. Megjithatë nuk ka për përkufizim të vetëm të saj apo një strukturë unike me funksione të njëjta që të jetë marrë nga të gjithë venedet.

Në Evropë shërbimi i provës njih një larmi të gjerë formash organizative, p.sh., në Holandë shërbimi i provës sigurohet nga një organizatë kombëtare joqeveritare. Në shumë nga vendet e Evropës Perëndimore ky shërbim është pjesë e strukturave të Ministrisë së Drejtësisë dhe Finlandë shërbimi i provës kryhet nga organizata private kombëtare. Personeli i organizatave të shërbimit të provës është gjithashtu një fushë e larmishme.

Disa nga këto shërbime përdorin gjerësisht punën vullnetare, megjithatë shumica e shërbimeve të provës punësojnë personel të specializuar që u janë nënshtruar trajnimeve të posaçme.

Shërbimi i provës ndryshon nga një vend në një tjetër edhe në lidhje me aktivitetin që kryen. Në disa vende shërbimet e provës janë të kompletuara, d.m.th., që mbulojnë të gjitha fushat e “punëve të shërbimit të provës”. Në vende të tjera ky shërbim ka funksion më të kufizuar, që mjaftohet me paraqitjen e raporteve në gjykata. Edhe grupet kryesore të synuara të shërbimit të provës variojnë. Në Angli dhe Uells, Irlandë dhe Norvegji shërbimi i provës ka në fokus autorët e veprave penale të cilët paraqesin shkallë të lartë rrezikshmërie, në Holandë fokusi vendoset mbi ata autorë të veprave penale të cilët janë ose mund të motivohen për të ndryshuar, ndërsa në Skoci dhe Spanjë fokusi përqendrohet mbi autorët e rinj në moshë. Edhe niveli i punës me të rinjtë ndryshon nga njëri vend në tjetrin. Edhe pse zakonisht sistemet e shërbimit të provës merren me autorët e mitur të veprave penale, në shumicën e vendeve sistemi i drejtësisë për të mitur ndryshon shumë nga ai për të rritur dhe ekzistojnë organizma të veçantë, përgjegjësia kryesore e të cilave është të punojnë me të dënuarit e mitur¹³².

Këto ndryshime në fushën e shërbimit të provës komplikohen edhe më tej për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme që pëson ky shërbim. Ristrukturimi organizativ është një tipar konstant i shërbimit të provës, megjithatë ky shërbim ka kaluar edhe në një proces zhvillimi (ndonjëherë edhe me ndryshime radikale) në lidhje me orientimin profesional. Kohët e fundit shërbimi i provës është vënë në qendër të vëmendjes të politikës dhe si rrjedhojë ndikohet më tepër nga ndryshimet e politikave dhe ideologjive politike.

Këto tipare të fushës së shërbimit të provës e shtojnë vështirësinë e të gjeturit të një kuptimi të vetëm për “shërbimin e provës”. Kombet e Bashkuara deklarojnë se vënia në provë është një ndëshkim, një metodë për të trajtuar të dënuar të veçantë dhe që konsiston në pezullimin me kusht të dënimit penal dhe i dënuari vihet nën mbikëqyrje dhe merr udhëzime ose trajtim individual¹³³. Shërbimi i provës është përkufizuar si:

¹³² Mehlbye & Walgrave, 1998.

¹³³ UNICRI 1998.

“Një mënyrë ndëshkimi me bazë sociale-pedagogjike që karakterizohet nga një kombinim i mbikëqyrjes dhe ndihmës. Aplikohet falas për ata të dënuar të përzgjedhur në bazë të personalitetit të tyre kriminal, llojit të krimit dhe pranimet nga ana e tyre, në raport me një sistem, qëllimi i të cilit është t’i japë të dënuarit mundësinë për të ndryshuar përjasjen ndaj jetës në shoqëri dhe të bëhet pjesë e mjedisit social të zgjedhjeve pa rrezik se mund të shkelë përsëri ndonjë normë penale shoqërore.”¹³⁴

Ky përkufizim nuk e përmend faktin se vënia në provë është një lloj “lirie e mbikëqyrur”, me fjalë të tjera “vënia në provë” është një aktivitet që kryhet në komunitet dhe pa qenë nevoja që personat e mbikëqyrur të kufizohen fizikisht. Po kështu, ai nuk përfshin të gjithë gamën e aktiviteteve të shërbimit të provës, si p.sh., strategjitë e skemave alternative, alternativa të paraburgimit (arrest parandalues), etj.

Në përpjekjet e fundit për të gjetur një perspektive evropiane gjithëpërfshirëse mbi shërbimin e provës (duke përfshirë edhe përkrimet e sistemeve të shërbimit të provës në 19 vende të Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore) Conference Permanente Europeenne de la Probation (Konferenca e Përhershme Evropiane e Shërbimit të Provës - CEP) deklaroi:

“Në këtë volum, koncepti i “shërbimit të provës” përdoret njësoj si ajo që në sociologji quhet “koncept sensibilizues”: një koncept i gjerë apo i hapur i cili merr kuptim në kontekstin ku përdoret. Këtu shërbimi i provës nënkupton të gjitha aktivitetet në fushën e drejtësisë penale (raportet për vlerësimin e rrethanave shoqërore, puna e ndërhyrjes së hershme, aktivitetet në fushën e sanksioneve dhe masave komunitare, aktivitetet në institucione të vuajtjes së dënimit (institucione penitenciare), mbikëqyrja, vënia në provë si sanksion penal, aktivitete të parandalimit të krimit, etj.)”¹³⁵.

2. Çfarë është vënia në provë?

Çdo përpjekje për të treguar se çfarë është vënia në provë duhet të vërë theksin në kontekstin social të krimit dhe në rolin e shërbimit të provës. Kjo përjasje të çon në mënyrë të paevitueshme drejt një analize sociale, politike dhe ekonomike të krimit dhe shkaqeve të tij. Një analizë e tillë e detajuar shtrihet përtej qëllimit të këtij kapitulli, megjithatë, mund të nxjerrim disa konkluzione të përgjithshme. Pikë së pari, duhet të pranojmë se në mbarë botën, këto dy shekujt e fundit, zhvillimi i kapitalizmit dhe ekonomisë së tregut është shoqëruar nga një rritje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e krimit. Ndryshimet social-ekonomike në lidhje me zhvillimin e ekonomive moderne të tregut (që mund të përmbledhen si: produktiviteti ekonomik në rritje, hyrja dhe zgjerimi i ekonomive të tregut të lirë, rritja e prosperitetit në përgjithësi dhe si rrjedhojë, rritja e konsumit, thellimi i pabarazisë sociale dhe i përjashtimeve sociale, rritja e urbanizimit dhe çrregullimit social) janë faktorë që çojnë në rritjen e krimit. Për më tepër, mund të themi se sa më shumë të zhvillohen këto procese aq më tepër do të rritet numri i krimeve. Për shembull, në Angli dhe Uells gjatë periudhës 1963 – 1983 pati një rritje prej 232% të numrit të krimeve të regjistruara nga policia.

¹³⁴ Cartledge 1995.

¹³⁵ Van Kalmthout & Derks 2000.

Ndërsa duhet të pranojmë që shkaqet e krimeve janë komplekse dhe subjekt i debateve të shumta, mund të dalim në një përfundim të rëndësishëm: zhvillimi dhe ekzistenca e vënies në provë nuk ka ndikim të dukshëm në numrin e krimeve/nivelin e kriminalitetit. Vënia në provë nuk është faktor që ndikon në rritjen e krimit por as nuk ka ndikim madhor në uljen e tij. Ndryshimet sociale, politike dhe ekonomike që ndikojnë në shkallën/nivelin e krimeve janë përtej arritjes së praktikës së vënies në provë. Pra, vënia në provë nuk është një mekanizëm që kontrollon krimin. Këto aktivitete shkojnë përtej aftësive të vënies në provë dhe shtrihen diku gjatë në strukturën sociale të shoqërisë. Nocioni që shërbimi i provës nuk është një organ për kontrollin e krimit na bën të kuptojmë që ai është një organizëm dedikuar drejtësisë penale. Me fjalë të tjera, shërbimi i provës është pjesë e sistemit të drejtësisë penale dhe si i tillë, është një nga institutet e shumta që merren me autorë të caktuar të veprave penale.

Çdo institucion brenda sistemit të drejtësisë penale ka rolin e vet: Policia është përgjegjëse për arrestimin e autorëve të veprave penale, prokurorët janë përgjegjës për ndjekjen dhe procedimin penal të tyre, gjykatat për dënimin e autorëve dhe burgjet për të mbajtur të dënuarit e dërguar nga gjykatat. Megjithatë, roli i shërbimit të provës brenda sistemit të drejtësisë penale ndryshon nga roli i institucioneve të tjera të drejtësisë penale, sepse ky Shërbim luan rol në të gjitha stadet e procesit të drejtësisë penale. Pra, shërbimi i provës ka një rol të veçantë në sistemin e drejtësisë penale; ai kryen një sërë funksionesh të specializuara, të domosdoshme për funksionimin e sistemeve moderne të drejtësisë penale. Megjithatë, një tipar kryesor i rolit të këtij shërbimi është që kryen shumicën e aktiviteteve në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me pjesë të tjera të sistemit të drejtësisë penale. Për më tepër, nëpërmjet këtij bashkëpunimi, shërbimi i provës po përpiqet të sjellë ndryshim në mënyrën sesi institucionet e drejtësisë penale marrin vendime në lidhje me shkelës/autorë të veprave penale.

Ku e gjen të drejtën ky shërbim për të sjellë këto ndryshime? Pa dyshim, që është përgjegjësi e policisë, prokurorisë dhe përfundimisht e gjykatave që të vendosin ndëshkimin e autorëve të veprave penale. Atëherë, mbi ç'baza e mbështet shërbimi i provës rolin legjitim të tij brenda sistemit të drejtësisë penale? Kjo është një pyetje komplekse dhe përgjigjja gjendet në identitetin e shërbimit të provës¹³⁶.

Shërbimi i provës mund të përkufizohet në bazë të mënyrës si i kryen këto funksione, d.m.th., në bazë të vlerave të këtij shërbimi. Edhe pse nuk është artikuluar, argumenti mbi vlerat e shërbimit të provës është që nëse vlerat e shërbimit janë të rëndësishme, atëherë vetë shërbimi mund të konsiderohet një organizatë me vlerë. Cilado qofshin meritat e këtij argumenti, është treguar se këto vlera janë:

- Respekt për individët, vlerën bazë të njerëzimit, integritetin dhe jetën private
- Drejtësi, sinjeritet dhe përgjegjësi
- Respekt për dinjitetin njerëzor dhe drejtësinë
- Parimi i ndërhyrjes minimale – d.m.th., që të mos përdoret më shumë forcë nga sa është e nevojshme
- Parimi i normalizimit – që kushtet për të dënuarit duhet t'i korrespondojnë atyre jashtë sistemit të drejtësisë penale

¹³⁶ Benson, J. (2001) Working More Creatively with Groups, 2nd ed. London: Routledge.

- Parimi i ndërhyrjes në kohë – për të siguruar një reagim të efektshëm ndaj veprës, shërbimi i provës duhet të ketë akses te të dënuarit në çdo fazë të procesit të drejtësisë penale.
- Parimi i ndërhyrjes së vazhdueshme
- Gatishmëria për të bashkëpunuar me organizata të tjera¹³⁷.

Por vetëm vlerat nuk mjaftojnë, sepse ato nuk na tregojnë shumë rreth asaj se çfarë bën shërbimi i provës dhe përse e bën ky shërbim. Përgjigja ndaj pyetjes “çfarë është shërbimi i provës?” duhet të përfshijë diçka rreth rolit të shërbimit të provës, vetëm të këtij shërbimi në sistemin e drejtësisë penale. Kjo çështje është në qendër të debateve bashkëkohore kriminologjike dhe i referohet lidhjes midis drejtësisë ndëshkuese dhe asaj shpërndarëse. Drejtësia ndëshkuese ka të bëjë me mënyrën sesi shkelësit ndëshkohen dhe me shpërndarjen e masës së duhur të ndëshkimit sipas dëmit të shkaktuar nga i dënuari¹³⁸.

Kështu, një shoqëri është e padrejtë nëse ndëshkon lehtë një të dënuar të rrezikshëm dhe nëse ndëshkon më rëndë një të dënuar më pak të rrezikshëm, apo nëse ndëshkon autorë veprash penale me rrezikshmëri të njëjtë në mënyra të ndryshme.

Nga ana tjetër, drejtësia shpërndarëse ka të bëjë me shpërndarjen më të gjerë të shpërblimeve në shoqëri. Me fjalë të tjera, mënyra sesi punët, paraja, të mirat materiale, shtëpitë, mallrat e konsumit, etj., shpërndahen në shoqëri. Pra, një shoqëri e drejtë është ajo shoqëri ku këto “shpërblime” ndahen në mënyrë të barabartë, dhe është e padrejtë nëse vetëm një pakicë i zotëron këto shpërblime ndërsa shumë të tjerë kanë pak ose aspak.

3. Historia dhe zhvillimi i shërbimit të provës

Origjina e shërbimit të provës gjendet te Kisha dhe në lëvizjet fetare të saj. Në vitin 1876 Shoqata anti-alkoolike e Kishës së Anglisë (Church of England Temperance Society) caktoi Misionarin e parë të gjykatës së shkallës së ulët¹³⁹ (pararendësi i Punonjësit të Shërbimit të Provës sot). Gjashtë vjet më vonë kishte 146 Misionarë në gjykatat e shkallës së ulët. Puna e misionarëve të gjykatës së shkallës së ulët kishte të bënte kryesisht me “këshillimin e shkelësve që të linin pijen, shpërndarjen e trakteve fetare dhe marrjen e zotimeve për të hequr dorë (nga pija)”¹⁴⁰. Këta misionarë e zgjeruan shumë shpejt rolin e tyre dhe u përpoqën të ndihmonin në grindjet midis fqinjëve, duke ndihmuar prindërit që s’i kontrollonin dot fëmijët e tyre dhe në vlerësimin e kandidatëve për “kutinë e të varfërve” (një lloj bamirësie).

Ashpërsia e ndëshkimit ndaj shumë autorëve të veprave penale, jetët e të cilëve karakterizoheshin nga vështirësitë dhe varfëria e skajshme ishte shqetësues. Sistemi i drejtësisë penale lindi nën presionin e publikut dhe, si rrjedhojë, gjykatat filluan t’i linin shkelësit, në rrugë joformale, nën mbikëqyrjen e Misionarëve të Gjykatës së shkallës së ulët.

¹³⁷ CEP 2000.

¹³⁸ Blumstein, A. “Criminal Carriers and Career Criminals”, Washington D.C: National Academy Press, 1986.

¹³⁹ Në versionin anglisht Police Court Missionary. Police Court – sot Magistrates’ Court është shkalla më e ulët e gjykatave në Angli, Uells dhe në shumë vende të tjera të sistemit Common Law.

¹⁴⁰ McWilliams 1983.

Shumë shpejt u përvetësua nga numri në rritje i Misionarëve të Gjykatës së shkallës së ulët. Sipas McËilliams, mëshira është çelësi për të kuptuar rolin e këtyre Misionarëve në gjykatë: “Mëshira ndodhej midis shkelësit, misionarit dhe gjyqtarit, dhe kjo i jepte kuptim marrëdhënies së tyre” (McËilliams 1983). Kështu, Misionarët e Gjykatës së shkallës së ulët. Nuk kemi shumë informacion se cili u zgjodh nga misionarët e gjykatës së shkallës së ulët për një kërkesë faljeje apo përse (dhe mbi ç’baza) u bënë këto zgjedhje – që pa dyshim ishin pak ideosinkretike – por, kur dilnin me sukses, i jepte misionarëve një mundësi për të drejtuar reformimin e shkelësve duke krijuar kështu termin “këshillo, ndihmo dhe trego miqësi” si parimi kryesor i shërbimit të provës.

Në fillim të viteve 1900 dolën një sërë aktesh, që në kombinim me njëra-tjetrën, themeluan Shërbimin e Provës pothuajse në të njëjtën formë që ai ekziston dhe në ditët e sotme. Në vitin 1907 u miratua Akti mbi Shërbimin e Provës të Autorëve të Veprave Penale, i cili u dha gjykatave të rrethit autoritetin për të punësuar dhe emëruar në shërbim. Gjithsesi, Urdhrat e Shërbimit të Provës nuk ishin dënime, por urdhra të dhëna në vend të një dënimi, duke ndjekur parimin e mëshirës¹⁴¹.

CJA 1925 e bëri të detyrueshme për të gjitha gjykatat e shkallës së ulët që të caktonin Punonjës të Shërbimit të Provës me pagesë dhe të krijonin njësi më të zgjeruara administrative ose të quajtura ndryshe “Shërbime të Provës”. CJA 1925 bëri të detyrueshme edhe krijimin e Komiteteve të Shërbimit të Provës. Këto komitete përfshinin edhe gjyqtarët e gjykatave të shkallës së ulët të cilët kishin për detyrë të caktonin dhe paguanin Punonjësit e Shërbimit të Provës. Në çdo gjykatë të shkallës së ulët u krijuan Komitete të Çështjeve (gjyqësore) për mbikëqyrjen e punës së Punonjësve të Shërbimit të Provës nga gjyqtarët e gjykatave të shkallës së ulët.

Në vitin 1936, me krijimin e Sektorit të Shërbimit të Provës, Inspektoratit dhe Bordit Trajnues të Shërbimit të Provës u formua edhe baza e përgjegjësive të Ministrisë së Brendshme.

Në kontekstin organizativ mbi të cilin u zhvillua Shërbimi i Provës në Angli dhe Uells, ne mund të kuptojmë natyrën ndryshuese të praktikës së shërbimit të provës ose filozofinë e tij, që us hfaq në katër faza:

- Ideali misionar
- Ideali rehabilitues
- Rënia e idealit rehabilitues
- Shfaqja e menaxherializmit

Siç përmendet më sipër, origjina e Misionarëve të Gjykatës së Shkallës së Ulët gjendet te kisha dhe “vënia në provë” e autorëve të veprave penale ishte një zgjerim i rolit të kishës dhe të idealit të saj misionar, d.m.th., ideja e të shpëtuarit të shpirtit të autorit të veprës penale nëpërmjet hirit hyjnor. Ekzistonte besimi se nëse kishe Perëndinë dhe kishën në jetën tënde, atëherë de facto, nuk do të kryeje vepra penale, do të ishe një person i mirë që nuk pinte apo rrihte fëmijët, etj. Theksi, siç përmendet dhe më lart, ishte në marrjen e zotimeve.

¹⁴¹ Bondenson, U.V. (1989). Prisoners in Prison Societies. Transaction Publishers. New Brunswick and New Jersey.

Ky ideal misionar nuk mund t'i mbijetonte kritikave dhe pushtetit në rritje të idealit rehabilitues me bazë shkencore i cili u zhvillua rreth shkencave sociale që po lulëzonin, por ishte edhe tepër selektiv, aq sa “vënia në provë” u ofrohej vetëm atyre shkelësve që mendohej se mund të reformoheshin¹⁴².

Paradigma shkencore që mbështeti vizionin diagnostik të idealit rehabilitues ishte shumë më tërheqëse dhe e zbatueshme. Vizioni diagnostik bazohej në shkencë, kështu që besohej se: i) kryerja e veprave penale ishte simptomë e një lloj sëmundjeje, ii) duke aplikuar teknikat shkencore mund të identifikojmë shkaku dhe kryerjes së veprës penale, dhe iii) nëpërmjet zhvillimit të trajtimeve shkencore mund të “shërojmë” nga veprimtaria kriminale - të gjithë njerëzit (të paktën potencialisht).

Paradigma e trajtimit dhe ideali diagnostik arritën kulmin gjatë periudhës së pas luftës (në vitet 1950 dhe 60). “Në bazë të këtij modeli, sjellja kriminale shihet si shfaqje e një sëmundjeje psikologjike ose psiko-sociale, dhe si e tillë mund të diagnostikohet dhe të marrë trajtim profesional; dhe themelore për të gjithë procesin ishte diagnoza e saktë bazuar në një vlerësim objektiv, faktiv të shkelësit, rrethanave të tij dhe reagimit të mundshëm të tij ndaj repertorit/programit të trajtimit. Mjeti i zgjedhur për diagnostikimin dhe trajtimin e shkelësve të ligjit nga Punonjësit e Shërbimit të Provës eventualisht u shndërruan në ato teori dhe metoda që u avancuan nga shkollat e ndryshme të rasteve sociale¹⁴³”. Fuqia dhe ndikimi i këtij lloji mendimi nuk duhet nënvlerësuar. Në atë kohë ekzistonte besimi i përhapur gjerësisht se kriminaliteti dhe sjellja kriminale mund të kuroheshin.

Ideali rehabilitues u rrëzua nga evidencat e shumta, që ne as nuk mund të dallojmë shkaqet e kryerjes së veprave penale dhe as nuk mund të gjejmë metoda për të trajtuar autorët e këtyre veprave. Nga fundi i viteve 70 kjo ide u hodh plotësisht poshtë. “Asgjë nuk funksionon” u bë slogani që karakterizonte punën me autorët e veprave penale dhe gjatë një periudhe prej 30 vitesh kaluam nga besimi maksimal në aftësitë e shërbimit të provës, në bindjen totale se ai nuk po jepte ndonjë kontribut në uljen e numrit të veprave penale nëpërmjet punës së tyre me autorët e veprave penale, dhe dukej se shërbimi i provës nuk po jepte ndonjë kontribut të rëndësishëm në funksionimin “efektiv” të sistemit të drejtësisë penale (në terma të politikave publike, shërbimi i provës nuk po funksiononte në mënyrë efektive për të reduktuar numrin e të dënuarve).

Kështu, një pjesë e mirë e praktikës së shërbimit të provës në vitet '90 u zhvillua në një kontekst të politikës përshkruese të Ministrisë së Brendshme. Prandaj, temat kryesore të kësaj praktike në vitet '90 ishin: mbrojtja e publikut, shërbimet do të përdoren aty ku kanë më shumë ndikim në përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale, shtimi i kontrollit ndaj të dënuarve me punë në komunitet dhe reduktimi i recidivizmit. Në vitin 2001 shërbimi i provës në Angli dhe Uells u ristrukturua në mënyrë radikale, duke u kthyer në një sistem kombëtar i financuar nga njësitë e qeverisë vendore. Ky hap ishte faza përfundimtare në një proces ku qeveria ka bërë përpjekje të shumta për të kontrolluar qëllimin e shërbimit të provës dhe natyrën e aktiviteteve të këtij shërbimi.

¹⁴² Canton, R. , Hancock, D. (2007) Dictionary of Probation and Offender Management, Cullompton: Willan

¹⁴³ McWilliams, 1985.

4. Çështjet e të miturve, si shtysë e zhvillimit të shërbimit të provës

Që nga themelimi i saj në Angli dhe Uells në vitin 1908, gjykata e të miturve kishte si juridiksionin penal dhe atë civil mbi fëmijët. Diferencimi midis çështjeve penale dhe civile brenda gjykatës së të miturve ka ndryshuar me kalimin e kohës; ndonjëherë më i dallueshëm dhe ndonjëherë më pak i dallueshëm. Shkelësi/i dënuari i mitur dhe i mituri “në nevojë” nuk janë trajtuar gjithmonë si entitete të ndara dhe nuk ka pasur gjithmonë dallim midis masave të marra për ata që kanë kryer krime dhe për ata që kanë nevojë për ndihmë ose mbrojtje¹⁴⁴. Megjithatë, në praktikë gjykata e të miturve ka trajtuar kryesisht të rinj të cilët kanë kryer vepra penale ndërsa numri i rasteve civile ka mbetur relativisht i vogël. Por gjithsesi, gjykata e të miturve duhet të kishte parasysh nevojat e të rinjve kur jepte vendimin/dënimin.

“Çdo gjykatë që trajton çështjen e një fëmije ose të riu, qoftë si autor i veprës ose ndryshe, duhet të mbajë parasysh mirëqenien e fëmijës ose të të riut...” (Akti/Ligji për Fëmijët dhe të Rinjtë i vitit 1933 i ndryshuar me Aktin/Ligjin për Fëmijët dhe të Rinjtë të 1969).”

Vitet ‘60 ishin një dekadë turbulente për sa i përket politikave të drejtësisë për të mitur. Megjithatë, nga fundi i dekadës, në bazë të besimit se kishte shumë ngjashmëri midis fëmijëve që kryejnë vepra penale dhe atyre në nevojë, qeveria formuloi një politikë që u pasqyrua nga Ligji për Fëmijët dhe të Rinjtë 1969 (CYPA2 1969). Në praktikë CYPA u zbatua vetëm pjesërisht (për shkak të një ndryshimi në qeveri në vitin 1970), u prezantuan ndëshkime të reja të bazuara në mirëqenien sociale (Urdhra Kujdesi dhe Mbikëqyrjeje – si për të miturit që kanë kryer vepra penale edhe për ata në nevojë), por ndëshkimet e vjetra me burgim nuk u shfuqizuan.

Prezantimi i ndëshkimeve të bazuara në mirëqenien sociale në gjykatat e të miturve u shoqërua nga një lëvizje e punonjësve socialë në sistemin e drejtësisë për të miturit, të punësuar nga departamentet e shërbimeve sociale në qeverisjen vendore, përgjegjësia e të cilëve ishte të zbatonin këto masa të reja. Mjeti kryesor i këtij zhvillimi ishte ajo që quhej Trajtim i Ndërmjetëm (TN). Në terma ligjorë, një kërkesë për TN ishte një kusht që gjykatat mund të vendosnin për të dhënë një Urdhër Mbikëqyrjeje, por qëllimi ishte që TN duhej të jetë një shërbim i bazuar mbi nevojat dhe i përdorshëm për një numër të madh të rinjsh – jo vetëm për ata që kanë kryer vepra penale dhe po gjykohen.

Koncepti i TN-së u prezantua në CYPA 1969 dhe nënkuptonte punën me fëmijët “në rrezik” që shërbente si “ndërmjetësim” midis punës në familje (puna me fëmijën në ambientin familjar dhe fokusimi te familja si njësi ndërhyrjeje) dhe dërgimit të fëmijës në një institucion. TN do të thoshte punë e drejtpërdrejt me të rinjtë, por natyra e kësaj pune nuk u përcaktua apo nuk u kuptua asnjëherë qartë.

Jo vetëm që natyra e aktivitetit të TN-së ishte e shumëllojshme dhe jo e qartë, por edhe grupi i synuar nuk ishte i përcaktuar mirë dhe si rrjedhojë i ndryshëm. Meqë burgimi nuk ishte shfuqizuar, shumë prej këtyre klientëve të synuar të TN-së burgoseshin. Në praktikë, në një

¹⁴⁴ Cartledge (1995) in: Harris, R. et al Probation Round the World, Coles, B. (1995) Youth and Social Policy, London: UCL Press.

mënyrë disi kaotike dhe konfuze, vitet '70 dëshmuar si degëzimin e dënimit (ku dënimi ndahet sipas disa pikave arbitrare dhe ku disa prej autorëve marrin ndëshkim të rëndë ndërsa të tjerë ndihmë) ashtu edhe praktika jo të qarta ndëshkimi ku si ata që kanë kryer vepra penale edhe të rinjtë në nevojë marrin të njëjtin lloj dënimi.

Punonjësit social besonin se ndërhyrja zyrtare ishte e mirë dhe vendosën të punonin me sa më shumë fëmijë, shpesh duke rekomanduar ndëshkime intervencioniste për fëmijët që kishin kryer vepra penale me rrezikshmëri të ulët ose që po përjetonin vështirësi të vogla në familje, zhvillimi apo adoleshentësh. Kushtet formale të TN-së ndaj Urdhrave të Mbikëqyrjes ishin thjesht një mekanizëm për të “futur fëmijët në grupe TN”¹⁴⁵.

Nëse trajtimi ishte i dobishëm, dhe punonjësit social në vitet '70 mendonin se po, atëherë duhej të ishte i përdorshëm për çdo të ri në nevojë. Zelli për trajtime dhe i të rinjve për të mbushur programet e trajtimit ishte një karakteristikë kryesore e kohës. Por gjithashtu, ishte e zakonshme që punonjësit social mund edhe të rekomandonin dënim me burgim për të miturit që dilnin para gjykatës së të miturve; ndonjëherë sepse mendonin se trajtimi kishte dështuar, sepse kishin pasur vështirësi të integronin të rinjtë në grupe trajtimi dhe ndonjëherë sepse mendonin se ishte më mirë për të riun të merrte një dozë të shkurtër por të prerë disiplinë.

Në vitet '70, gjykata e të miturve u kthye në dy sisteme paralele – një sistem për dënim me burgim dhe tjetri bazuar në mirëqenien sociale – dhe u zgjeruan llojet e ndëshkimeve. Si rrjedhojë, gjatë kësaj kohe një numër i madh fëmijësh u futën në sistem dhe shumë të rinj që kishin kryer vepra penale me rrezikshmëri tepër të ulët, u ndëshkuan me burgim ose me punë në komunitet. Një analizë e zhvillimeve të viteve '70 tregoi se në vend që të krijohej një sistem i ri i bazuar në mirëqenien e fëmijëve që do të zëvendësonte sistemin e bazuar në ndëshkim, sistemi i ri thjesht iu shtua atij të vjetër duke krijuar kështu një sistem të ri dhe më të madh që kërkonte sa më shumë të rinj për të plotësuar ndëshkimet e mundshme (Thorpe et al 1980). Ky argument ishte një kritikë e sjelljes së sistemit – sistemi dhe punonjësit individualë brenda tij (policët, punonjësit social dhe gjyqtarët), merrnin vendime të gabuara për fëmijët e gabuar në kohën e gabuar.

Argumenti ligjor për përjasjen e bazuar në drejtësi të procedimit dhe dënimit të një autori veprash penale bazohet në besimin se drejtësia është një gjë e mirë. Të argumentosh kundër drejtësisë është njësoj sikur mbron padrejtësinë – që është qartësisht e padëshirueshme: nuk është e mundur të kemi shumë drejtësi. Kjo lëvizje në Angli dhe Uells besonte në vlerën e drejtësisë, por mbështetja që i jepnin drejtësisë ishte pjesërisht një qëndrim reaksionar kundër mirëqenies sociale.

Në këtë kontekst u miratua Ligji i Drejtësisë Penale 1982, i cili konsolidoi burgimin në qendër të sistemit të drejtësisë për të mitur, duke kërkuar që dënimi të jetë në të mirë të të rinjve. Ky ligj përfshinte edhe një sërë paragrafesh të ndryshëm të bazuar në drejtësi, si për shembull:

- Të gjithë të rinjtë që dilnin para një gjykate për të mitur kishin të drejtën e
- përfaqësimit ligjor falas.

¹⁴⁵ Chapman, T. & Hough, M. (1998) Evidence Based Practice – a Guide for Practitioners.

- Gjykatat duhet të parashtronin arsyet për vendimet që merrnin.

Në mënyrën më domethënëse, Ligji prezantoi tre kritere nga të cilat të paktën një duhej plotësuar para se gjykata të merrte një vendim për dënim me burgim:

- I pandehuri nuk është i gatshëm apo në gjendje të kryejë një dënim të ndryshëm nga burgimi, ose
- Dënimi me burgim është i nevojshëm për mbrojtjen e publikut, ose
- Vepra penale është aq e rëndë, sa që një dënim jo me burgim nuk mund të ishte i dëmshëm.

Për më tepër, para se të jepet një dënim me burgim, ligji kërkon që të përgatitet një raport për vlerësimin e rrethanave shoqërore që të vlerësojnë, inter alia, nëse një sanksion komunitar ishte i përshtatshëm apo jo. Edhe pse u treguan të ngadalshëm

Një sërë konkluzionesh të nxjerra nga studimet formuan besimet që përforconin zhvillimin e praktikës së punës së punonjësve social me të miturit që kryenin vepra penale¹⁴⁶:

- Realiteti i parëndësishëm – shumica e veprave penale të kryera nga të miturit nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë dhe madje janë të parëndësishme.
- Zhvillimi i arsytimit të krimit – që shumica e të rinjve kryejnë vepra penale në një kohë të caktuar gjatë adoleshencës dhe se pjesa më e madhe nuk do të kryejnë më vepra penale për shkak se në mënyrë natyrore do të rriten/maturohen (e thënë ndryshe – kriminaliteti i të miturve nuk është produkt i patologjisë sociale apo personale dhe si rrjedhojë, nuk duhet të trajtohet).
- Teoria e etiketimit – përfshirja zyrtare në sistemin e drejtësisë penale mund të ketë pasoja negative të rinjtë, aq sa të etiketohen si kriminelë dhe si rrjedhojë, të sillen si të tillë.
- Efekti i kostos në rritje – nëse të rinjtë sillen para drejtësisë penale që në moshë fare të re dhe për vepra penale me rrezikshmëri të ulët, atëherë do tëshpejtojnë dënimin me burgim në të ardhmen nëse do të kryejnë vepra të tjera penale.
- Argumenti i shkollave të krimit – burgimi është një përvojë brutale dhe e dëmshme që i ekspozon të rinjtë ndaj shkelësve më të mëdhenj në moshë dhe më profesionistë të cilët shërbejnë vetëm si modele negative.
- Parimi i zgjerimit të rrjetit – përjasjet e bazuara në ndihmën sociale sjellin më shumë të rinj para sistemit të drejtësisë penale.
- Teza radikale e mos-ndërhyrjes – më e mira që mund të bëjnë punonjësit e drejtësisë për të mitur është që të shmangin dëmin e mundshëm që mund të shkaktohet nga sistemi i drejtësisë penale dhe sistemi i tij i sanksioneve; për të rinjtë është më mirë të mos bëjnë asgjë sesa të përfshihen në sistemin e drejtësisë penale.

¹⁴⁶ Christie, Nils. (1977), *British Journal of Criminology*, 17 (1); Conklin, J. "Criminology", Tufts University, USA, 1995; Gottfredson, M. & Hirschi, T. (1990), *A general theory of crime*, Stanford: Stanford Univ. Press; Haines, K. (2000), *Referral Orders and the New Youth Justice*, in: Goldson, B. (ed) *The New Youth Justice*, Lyme Regis: Russell House Publishing.

Këto ide ishin shumë të rëndësishme për krijimin e besimeve profesionale të specialistëve të drejtësisë penale për të mitur të cilët punonin në departamentet e shërbimeve sociale, kështu që u zhvillua një tipar dominues i fuqishëm kundër burgosjes, si dhe një qëndrim pro-diversitetit/skemave alternative. Por këto besime nuk do të kishin qenë aq të fuqishme në praktikë nëse nuk do të ishin shoqëruar nga teknikat e menaxhimit të sistemeve.

Punonjësit e drejtësisë penale për të mitur në vitet '80 përdorën gjerësisht teknika agresive të menaxhimit të sistemeve për të rritur numrin e vendimeve të marra për të larguar të rinjtë nga sistemi i drejtësisë penale dhe për të zvogëluar numrin e dënimeve me burgim të dhëna nga gjykatat. Këto teknika kanë qenë shumë efektive në praktikë.

5. Shërbimi i provës në Shqipëri

Qëllimi kryesor i paketës ligjore mbi dënimet alternative, krahas reformimit të alternativave të dënimit me burgim, është edhe krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për mbikëqyrjen e alternativave nëpërmjet prezantimit të institucionit shtetëror të Shërbimit të Provës¹⁴⁷. Ligji nr. 10 024/2008 bën një prezantim të përgjithshëm të Shërbimit të Provës, duke deleguar rregullat e detajuara për organizimin dhe unksionimin e tij në akte nënligjore në përputhje me standardet e nenit 118 të Kushtetutës. Në bazë dhe zbatim të ligjit nr. 10 024/2008, janë miratuar dy akte nënligjore me karakter normativ:

- (Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.200944 “Për miratimin e Rregullores ‘Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative’”. Sikundër parashikohet që në nenin 1 të saj, objekti i rregullores është përcaktimi i rregullave lidhur me:
 - b) organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës;
 - ç) standardet dhe procedurat e mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative;
 - d) mënyrën e realizimit të të drejtave të të dënuarve.
- Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 6325, datë 31.07.200945 “Për miratimin e rregullores ‘Për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit’”. Ky akt nënligjor përcakton rregullat e bashkëpunimit të Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit, për të siguruar mbikëqyrjen e të dënuarve me masa alternative; asistimin e të dënuarve për t’u riedukuar dhe integruar në shoqëri, si dhe reduktimin dhe parandalimin e kriminalitetit.

Kuadri normativ mbi dënimet alternative dhe Shërbimin e Provës vendos nga njëra anë rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës, mbi standardet dhe 42 Ligji nr. 10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar” dhe ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale””.

¹⁴⁷ Foundation “Conflict Resolution and Reconciliation of Disputes”, Restorative justice and mediation in resolving criminal despotes, Manual for judges and prosecutors, UNICEF, (2007), Tirana.

Mbikëqyrja e dënimeve/masave alternative është konceptuar si një proces që përfshin shumë aktorë bashkëpunues me njëri-tjetrin, por gjithsesi me role dhe përgjegjësi të ndara (prokurorin, gjykatën, Shërbimin e Provës, të dënuarin, mbrojtësin, të dëmtuarin, etj).

Shërbimi i Provës ngarkohet jo vetëm të mbikëqyrë zbatimin e alternativave të dënimit me burgim, por edhe të ndihmojë organin procedues (gjykatën dhe prokurorinë) për shpjegime të specializuara në drejtim të thelbit të alternativave të dënimit me burgim¹⁴⁸. Ky institucion u emërtua “Shërbimi i Provës” nisur nga modelet evropiane të legjisllacionit. Emërtesa lidhet me funksionin bazë të këtij Shërbimi “mbikëqyrjen e plotësisht të masave apo detyrimeve të të dënuarit në kohën e provës si alternativa më e mirë ndaj dënimit me burgim për arritjen e qëllimit edukues dhe risocializues ndaj të dënuarit”. Ligji nr. 10 024/2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331/1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’” prezanton Shërbimin e Provës si organin shtetëror të ngarkuar me këto funksione gjatë procedimit penal:

- Mbikëqyrjen e zbatimit të dënimeve alternative;
- dhënien e ndihmës në ekzekutimin e dënimit alternativ, duke ndihmuar veçanërisht personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin në shoqëri;
- dhënien e ndihmës për organin e prokurorisë për marrjen e vendimeve gjatë fazës së hetimeve paraprake;
- dhënien e ndihmës për gjykatën për vlerësimin e duhur të dënimit alternativ.

Nga ana tjetër, në nenin 6 të VKM-së nr. 302/2009 është përcaktuar në mënyrë parimore se:

“1. Shërbimi i Provës mbikëqyr dhe mbështet zbatimin e dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e ersonit të dënuar gjatë kryerjes së dënimit alternativ në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror.

2. Shërbimi i Provës bashkëpunon dhe paraqet informacion dhe raporte para prokurorisë dhe gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

3. Shërbimi i Provës përcakton metodat e zbatimit të dënimit alternativ në përputhje me parashikimet ligjore. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione shtetërore, qendrore apo lokale, me komunitetin lokal, si dhe me institucione të tjera si dhe me organizata jo fitimprurëse për zbatimin e dënimeve alternative”.

Duke analizuar këtë kuadër ligjor arrihet në përfundimin që qëllimi i ligjvënësit ka qenë atribuiimi i funksioneve të Shërbimit të Provës përgjatë të gjitha fazave të procedimit penal: (i) gjatë hetimit paraprak; (ii) gjatë gjykimit; dhe (iii) gjatë ekzekutimit të vendimit. Ky qëllim është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë në nenet 31/7 dhe 31/8 të ligjit nr. 10 024/2008:

“Shërbimi i provës është organi shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës”; dhe “Raporti mbështetet në fakte, duhet të jetë i paanshëm dhe objektiv, si dhe dërgohet brenda kohës së caktuar nga gjykata”.

Po ashtu, në nenin 31 të VKM-së nr. 302/2009, që parashikon detyrimin e këtij Shërbimi për të

¹⁴⁸ Foundation “Conflict Resolution and Reconciliation of Disputes”, Restorative justice and mediation in resolving criminal despotes, Manual for judges and prosecutors, UNICEF, (2007), Tirana.

hartuar dhe paraqitur raportet:

“Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit ose gjykatës, paraqet një raport vlerësues për personin nën hetim, për të pandehurin ose për të dënuarin në këto raste:

- a) gjatë fazës së hetimeve paraprake;
- b) gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit penal;
- c) gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal:
 - i) në rastin e mbikëqyrjes së personit të dënuar;
 - ii) në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;
 - iii) në përfundimin para kohe të periudhës së vënies në provë;
 - iv) në përfundim të dënimit alternativ apo në përfundim të përmbushjes së detyrimeve të caktuara”.

Padyshim, funksioni më thelbësor është ai i fazës së ekzekutimit të vendimit penal për mbikëqyrjen e zbatimit të alternativave dhe ndihmën e të dënuarit për t’u riintegruar në shoqëri.

Shërbimi i Provës është organ shtetëror i centralizuar, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ky koncept organizimi përshkon të gjitha rregullat normative (mënyra e emërimit të Drejtorit, centralizimi; kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm, etj.). Ligjvënësi ka zgjedhur këtë model organizimi për shkak të funksionit bazë që kryen Shërbimi i Provës, mbikëqyrja e dënimeve alternative. Mbikëqyrja e dënimeve alternative është pjesë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale dhe rrjedhimisht u ndoq i njëjti model ligjor për varësinë institucionale të strukturave me funksione të kësaj natyre si: shërbimi gjyqësor përmbarrimor apo sistemi penitenciar. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë agjenci në varësi të Ministrisë së Drejtësisë sepse fokusi i veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë është sistemi i drejtësisë, ku ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një prej aspekteve më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, ky model organizimi e ka bazën edhe në përgjegjësinë e pushtetit ekzekutiv, nëpërmjet Këshillit të Ministrave për hartimin dhe zhvillimin e politikave, përfshirë edhe atë penale.

Shërbimi i Provës është i organizuar në dy nivele: qendror (Drejtoria e Përgjithshme) dhe vendor (zyrat vendore). Ligji parashikon që pranë çdo gjykate të rrethit gjyqësor të ketë zyrë vendore të Shërbimit të Provës, mirëpo aktualisht ka një rregullim tranzitor me urdhër⁴⁸ të Ministrisë së Drejtësisë, në bazë të të cilit funksionojnë vetëm katër zyra vendore me vendndodhje në qytetet Tiranë, Durrës, Fier dhe Shkodër. Me këtë organizim tranzitor, veprimtaria e Shërbimit të Provës përmbushet nga një staf prej 50 punonjësish (12 në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 38 në zyrat vendore).

Secila nga zyrat vendore të Shërbimit të Provës i shtrin kompetencat tokësore në disa rrethe gjyqësore, duke bërë të mundur mbulimin e të gjithë territorit të vendit. Konkretisht, sipas urdhrit 5331/1 të Ministrisë së Drejtësisë, Zyra Vendore Tiranë ushtron veprimtarinë në rrethet gjyqësore Dibër, Kavajë, Krujë, Kurbin dhe Tiranë; Zyra Vendore Durrës ushtron veprimtarinë në rrethet gjyqësore Durrës, Elbasan, Korçë dhe Pogradec; Zyra Vendore Shkodër ushtron veprimtarinë në rrethet gjyqësore Kukës, Lezhë, Mat, Shkodër dhe Tropojë; dhe Zyra Vendore Fier ushtron veprimtarinë në rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Lushnjë, Përmet, Sarandë dhe Vlorë.

Kompetencat tokësore sipas urdhrorit të Ministrit janë të lidhura dhe i referohen konceptit të rrethit gjyqësor meqë zyrat vendore ushtrjnë veprimtarinë e tyre në funksion të procedimeve penale të ndjekura nga gjykatat dhe prokuroritë. Për zbërthimin e ndarjeve administrative-territoriale që ato mbulojnë (lidhur me vendbanimet e të pandehurit/të dënuarit) është e nevojshme referenca tek Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 6201, datë 08.06.2009 “Për përcaktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë të secilës prej tyre”. Ky dekret jep shtrirjen territoriale të çdo rrethi gjyqësor sipas ndarjeve administrativo-territoriale (rreth, bashki apo qytet) të njohura me ligjin nr. 8653, datë 31.07.2000 “Për ndarjen administrativoterritoriale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Shërbimi i Provës në ushtrimin e veprimtarisë së tij bazohet mbi parimin e ligjshmërisë, të objektivitetit, të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në mungesën e diskriminimit, të respektimit të dinjitetit të të pandehurit/dënuarit. Në veprimtarinë e tij, Shërbimi i Provës përpiqet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështesë e inkurajojë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social. Pikërisht në funksion të këtyre parimeve janë rregullat për rekrutimin e punonjësve të Shërbimit të Provës: kushti për arsimin e lartë arsimin e lartë në degët psikologji, punë sociale, sociologji ose juridik, si dhe procedura e rekrutimit me konkurs të hapur bazuar në meritat.

Gjithashtu, në funksion të këtyre parimeve dhe si një premisë që siguron efektivitetin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës është trajnimi. Shërbimi i Provës organizon kurse trajnimi të detyrueshme për punonjësit, me qëllim aftësimin profesional dhe përsosjen e njohurive në drejtim të kryerjes së detyrave me efektivitet dhe profesionalizëm. Për realizimin e trajnimeve Shërbimi i Provës krijon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione lokale, kombëtare e ndërkombëtare.

Për përmbushjen e funksioneve të tij, Shërbimi i Provës, nëpërmjet punonjësve të tij, vendos kontakte me të dënuarin, zhvillon takime me të dhe me të afërm të tij, si dhe merr të gjitha të dhënat mbi kontekstin shoqëror të të dënuarit. Shërbimi i Provës dokumenton veprimtarinë e tij nëpërmjet krijimit të dosjes personale të të dënuarit, mban regjistra të veprimtarisë, për të konkluduar me hartimin dhe paraqitjen e raporteve të vlerësimit.

Dosja personale krijohet në momentin e kontaktit të parë me të dënuarin dhe vazhdon deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit. Aktet që përfshihen në të janë të renditura në nenin 25 pika 2 e VKM-së nr. 302/2009. Lista e akteve nuk është shteruese sepse në të përfshihet çdo dokument që lidhet me të dënuarin, i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes së dënimit alternativ (shkronja l e pikës 2 të nenit 25), por në të përfshihen:

1. vendimi penal gjyqësor që cakton dënimin alternativ;
2. urdhri i ekzekutimit të vendimit gjyqësor të lëshuar nga prokurori;
3. raportin i vlerësimit të përgatitur gjatë fazës së hetimeve paraprake për caktimin e dënimit alternativ, nëse ka;
4. një fotokopje e dokumentit identifikues;
5. raporti mjekësor për vlerësimin e kushteve shëndetësore, kur është e nevojshme;
6. procesverbali i kontakteve me të dënuarin;

7. programi i mbikëqyrjes;
8. raportet e përpiluara nga Shërbimi i Provës dhe të dërguara në gjykatë ose prokurori gjatë periudhës së mbikëqyrjes;
9. çdo paralajmërim të dhënë nga prokurori për shkelje të detyrimeve të vendosura nga gjykata gjatë periudhës së mbikëqyrjes;
10. një ekstrakt të paralajmërimit të bërë nga prokurori në rastin e shkeljeve të lehta dhe të kryera për herë të parë, nëse ka;
11. raporti përfundimtar të hartuar nga Shërbimi i Provës në përfundim të mbikëqyrjes;
12. të dhëna mbi përparimin e të dënuarit gjatë periudhës së mbikëqyrjes, duke përfshirë arsyet për përfundimin e parakohshëm të saj;
13. kopje të ankesave të të dënuarit mbi Shërbimin e Provës dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;
14. kopje të ankesës së të dënuarit mbi të dhënat dhe përmbajtjen e dosjes personale;
15. urdhrin e caktimit të institucionit të ekzekutimit të masës alternative;
16. çdo dokument tjetër në lidhje me të dënuarin që është i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes”.

Vlen rregulli që informacioni i përfshirë në dosjen personale duhet të jetë i besueshëm, objektiv dhe të ketë të bëjë vetëm me çështjet që lidhen me masën apo llojin e dënimit dhe ekzekutimin e tij.

Pikë kyçe e veprimtarisë së Shërbimit të Provës është ndërtimi i programit individual të të dënuarit në përputhje me dënimin alternativ konkret të caktuar. Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e të dënuarit, me qëllim qartësimin e nevojave, vullnetin për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale të tij. Programi individual miratohet nga drejtori i zyrës përkatëse vendore. Programi individual hartohet në përshtatje me alternativën konkrete të caktuar dhe me nevojat konkrete të të dënuarit. Gjithsesi, elementët e domosdoshëm të një programi individual të përcaktuara në nenin 28, pika 4 e VKM-së nr. 302/2009 janë:

“a) pjesa hyrëse, në të cilën tregohen gjeneralitetet, adresa e vendbanimit, vepra penale e kryer, numri i vendimit gjyqësor, dënimi i dhënë, periudha e provës, emri i punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar;

b) masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata, si dhe mënyrat e përdorura nga punonjësi i Shërbimit të Provës për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe masave.

c) nevojat kriminogjene dhe sociale të personit nën mbikëqyrje, si dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre;

ç) rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit;

d) metodat e propozuara për të plotësuar nevojat e identifikuar dhe për të reduktuar rrezikun;

dh) data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të dënuarit që do të mbahen gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes të përcaktuar nga gjykata”.

Programi individual i shërben funksionit të Shërbimit të Provës për dhënien ndihmë të të dënuarit për kapërcimin e vështirësive dhe riintegrimin social, duke synuar reduktimin/ eliminimin e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit. Nëpërmjet këtij programi, Shërbimi i Provës përpiket të

ndërgjegjësojë të dënuarin për veprën penale të kryer, për rëndësinë e saj duke e orientuar të dënuarin drejt sjelljeve vetëdisiplinuese. Gjithashtu, Shërbimi i Provës e mbështet të dënuarin që ai të përmbushë nevojat sociale që lidhen me edukimin, trajnimin, punësimin, strehimin apo çdo nevojë tjetër të ngjashme të kësaj natyre. Realizimi i kësaj veprimtarie kryhet duke respektuar të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të të dënuarve, si dhe duke garantuar respektimin e dinjitetit personal të tyre. Për të realizuar programin individual, Shërbimi i Provës kontakton me familjen e të dënuarit, persona të tjerë të afërt me të, kryen vëzhgim të mjedisit social të të dënuarit, bashkëpunon me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit me qëllim reduktimin dhe eliminimin e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit dhe rehabilitimin e tij. Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton, në çdo takim, se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit të mbikëqyrjes. Ky plan mund të rishikohet nëpërmjet anekseve që i shtohen atij.

Shërbimi i Provës ka një rol qendror në procesin e caktimit dhe të mbikëqyrjes së dënimeve alternative dhe për përmbushjen e funksioneve të tij ai bashkëpunon me prokurorin, me gjykatën, me të pandehurin/të dënuarin dhe mbrojtësin e tij, me të dëmtuarin, me organet shtetërore dhe, në ndonjë rast të veçantë edhe me subjektin pranë të cilit kryhet puna në interes publik.

Megjithatë, kuadri ligjor parashikon përgjegjësi dhe detyra të ndara për secilin nga këta aktorë.

Lidhja e Shërbimit të Provës me prokurorin. Përgjithësisht, roli i prokurorit në procesin e dënimeve alternative është shqyrtimi i rrethanave të rastit konkret për të vlerësuar nëse është e përshtatshme të caktohen masa alternative, si dhe për të siguruar provat e mjaftueshme për këtë qëllim. Prokurori i kërkon Shërbimit të Provës hartimin e raportit përkatës, në të cilin jepen edhe rekomandimet konkrete. Gjithashtu, prokurori luan rol edhe në fazën e mbikëqyrjes së masës alternative të caktuar, ku në raste të caktuara mund të ndërhyjë, duke dhënë paralajmërime ndaj të dënuarit për shkeljet e detyrimeve gjatë kohës së provës ose duke paraqitur kërkesa në gjykatë për përfundimin e parakohshëm të masës, për zëvendësimin/ revokimin e saj apo për shtimin/ndryshimin e detyrimeve gjatë kohës së provës.

Lidhja e Shërbimit të Provës me gjykatën. Gjykata është organi me kompetencën ekskluzive për caktimin e masave alternative dhe llojin e detyrimeve për t'u përmbushur nga i dënuari. Gjithashtu, gjykata është organi që vendos mbi kërkesat e palëve në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, të cilat përfshijnë përfundimin e parakohshëm të dënimit alternativ, zëvendësimin apo revokimin e tij. Në këtë proces vendimmarrës, gjykata padyshim që mbështetet në raportet e hartuara nga Shërbimi i Provës në të cilin krahas përshtimit të rrethanave konkrete të rastit për gjykim, jepen edhe rekomandimet konkrete.

Lidhja e Shërbimit të Provës me mbrojtësin. Roli i mbrojtësit në mbështetje të nenit 6 të Kodit të Procedurës Penale është të ndihmojë të pandehurin që atij t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat ligjore. Nën këtë këndvështrim, roli i mbrojtësit është t'i shpjegojë të pandehurit thelbin e alternativave të dënimit me burgim, mundësinë e përfshirjes së tij në këtë proces dhe gjatë ekzekutimit të dënimeve alternative, të asistojë të pandehurin si me dhënie e pëlqimit në ato raste ku ky pëlqim nevojitet, ashtu edhe për të paraqitur kërkesat e nevojshme procedurale përpara prokurorit/gjykatës. Për ilustrim, në rastin e alternativës së parashikuar nga neni 62 i Kodit Penal "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen

e një pune në interes publik”, dhënia e pëlqimit të të dënuarit është kusht i domosdoshëm për caktimin e kësaj alternative nga gjykata.

Lidhja e Shërbimit të Provës me organet shtetërore. Organet shtetërore qendrore dhe organet e njësive të qeverisjes vendore i japin Shërbimit të Provës ndihmën e nevojshme për përmbushjen e detyrave ligjore. Shërbimi i Provës mund të paraqesë kërkesë pranë tyre, madje edhe tek Policia e Shtetit nëse e çmon të nevojshme ndihmën e tyre.

Lidhja e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe ndërmjetësit. Shërbimi i Provës bashkëpunon me këto organizata për të siguruar mbikëqyrjen e të dënuarit në përputhje me programin individual të trajtimit; asistencën dhe mbështetjen e të dënuarit për kapërcimin e vështirësive në lidhje me riintegrimin social dhe për përmbushjen e nevojave shoqërore të edukimit, arsimimit, punësimit, strehimit dhe nevojave të tjera të ngjashme; hartimin dhe realizimin e programeve në qendra ditore, si dhe të ndërhyrjeve të tjera me ndikim potencial në rehabilitimin e të dënuarit; vlerësimin e të dënuarve, kur për hartimin e raportit nevojiten analiza të specializuara mbi shëndetin e tyre mendor, abuzimin me substanca alkoolike, narkotike apo psikotrope ose analiza të tjera të cilat mund të kryhen nga OJF-ja; sistemimin e të dënuarve të liruar me kusht duke përgatitur dhe ofruar programe të lirimit, mundësi strehimi, arsimit, trajnimit dhe punësimi, veprimtari në qendra ditore, programe terapeutike apo të kujdesit dhe çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme për rehabilitimin e ish të dënuarve; zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të dëmtuarve nga vepra penale dhe të dënuarve; si dhe reduktimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet nënshkrimit të memorandumëve të bashkëpunimit.

Lidhja e Shërbimit të Provës me të dëmtuarin. Megjithëse pjesëmarrja e të dëmtuarit nuk është kusht për caktimin e masave alternative ndaj të dënuarit, roli i tij merr ndonjëherë peshë domethënëse. Rasti më tipik mbetet kur gjykata i ka caktuar të dënuarit me masë alternative detyrimin për të riparuar dëmin civil të parashikuar nga neni 60 pika 3 të Kodit Penal. Nga ana tjetër, normalizimi i marrëdhënieve me të dëmtuarin përbën një premisë për riintegrimin social të të dënuarit dhe për këtë shkak, kuadri ligjor ka parashikuar edhe bashkëpunimin e Shërbimit të Ndërmjetësit me Shërbimin e Provës me funksionin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të dëmtuarve nga vepra penale dhe të dënuarve.

Lidhja e Shërbimit të Provës me subjektin pranë të cilit kryhet puna në interes publik. Në alternativën e parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal parashikohet bashkëpunimi i Shërbimit të Provës me subjektin pranë të cilit kryhet kjo punë. Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me subjektet në të cilin do të kryhet puna me interes publik për përmbushjen e programit. Marrëveshja përcakton programin, punën që do të kryhet, personin përgjegjës të caktuar nga subjektet për të mbikëqyrur realizimin e punës nga i dënuari, si dhe detyrimin e subjekteve për të njoftuar menjëherë Shërbimin e Provës në rastet e mospërmbushjes të detyrimeve nga i dënuari. Shërbimi i Provës i shpjegon personit përgjegjës të caktuar për mbikëqyrjen se është e nevojshme të evidentohen orët e punës, si dhe për të informuar rregullisht Shërbimin e Provës mbi nivelin e performancës në punë të të dënuarit. Në bashkëpunim me subjektin pranë të cilit kryhet puna, Shërbimi i Provës i bën të ditur të dënuarit rregullat e sigurimit teknik në punë. Gjithashtu, subjekti pranë të cilit kryhet puna informon Shërbimin e Provës mbi mënyrën e përmbushjes së punës nga i dënuari pranë tyre. Për të realizuar këtë bashkëpunim, Shërbimi i

Provës ka detyrimin të përcaktojë një listë të institucioneve/shoqërive, publike apo private, ku mund të kryhet puna me interes publik.

Modelet e standardizuara të Shërbimit të Provës

Ministri i Drejtësisë, në zbatim të kuadrit ligjor, me urdhrin nr. 4583/1, datë 11.06.2009 “Për miratimin e modelit të regjistrave të Shërbimit të Provës, raportit të vlerësimit dhe raportit përfundimtar” ka modeluar aktet e mëposhtme:

- regjistrin themeltar të personave të dënuar;
- regjistrin e kërkesë-ankesave;
- regjistrin e shkeljeve të planit individual të trajtimit;
- regjistrin e ngjarjeve të rënda;
- regjistrin e OJF-ve dhe institucioneve të tjera që ofrojnë këshillim dhe asistencë ose vende pune për të dënuarit me dënim alternativ.

Gjithashtu, janë miratuar edhe modelet e raporteve të vlerësimit (për të dënuarin/të pandehurin/personin nën hetim), si dhe të raportit përfundimtar të periudhës së mbikëqyrjes. Në dokumentet e përshkruar më lart gjenden të pasqyruara të dhënat personale të të dënuarit, përshkrimi dhe analiza e veprës penale të kryer, qëndrimin e autorit të veprës penale ndaj veprës së kryer prej tij, përshkrimi dhe analiza e autorit të veprës penale përfshirë jetën dhe historinë personale të autorit që ka lidhje me veprën penale, analiza dhe vlerësimi i rrezikut që nënkupton rrezikun e përsëritjes së veprave penale prej autorit; përshkrimi dhe analiza e ekzekutimit të vendimit të gjykatës përfshirë sipas rastit informacionin në lidhje me programin e mbikëqyrjes dhe masat e marra për të adresuar nevojat kriminogjene të të dënuarit; sjelljen dhe progresin e bërë nga i dënuari gjatë ekzekutimit të dënimit; qëndrimin e të dënuarit ndaj viktimës; gjendjen familjare, rrethanat sociale të të dënuarit dhe planet konkrete për riintegrimin e tij social pas lirimit të tij me kusht.

Nga ana tjetër, Drejtori i Përgjithshëm në zbatim të dispozitave përkatëse ligjore ka nxjerrë urdhra, udhëzime, metodika, marrëveshje bashkëpunimi, si më poshtë vijon:

1. Marrëveshjen e Bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
2. Marrëveshjen e Bashkëpunimit me OJF-të;
3. Marrëveshjen e Bashkëpunimit me pushtetin vendor;
4. Modelin e standardizuar të Programit individual të trajtimit të të dënuarve;
5. Modelet e standardizuara të raporteve të vlerësimit;
6. Modelin e standardizuar të letër referencave për OJF-të;
7. Modelet e standardizuara të formularëve statistikorë për zyrat vendore me të dhëna mbi të dënuarit (e mitur dhe të rritur);
8. Urdhra dhe udhëzime të ndryshme për efekt të mirëfunksionimit dhe organizimit të zyrave vendore.

Më në detaje, aktet e miratuara për Shërbimin e Provës, deri në fund të majit 2010, janë si më poshtë vijon:

- Vendime të Këshillit të Ministrave
 - VKM nr. 302, datë 25.03.2009 Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.
- Urdhra të Ministrit të Drejtësisë
 - Urdhër nr. 4583/1, datë 11.06.2009 “Për miratimin e modelit të regjistrave të shërbimit të provës, raportit të vlerësimit dhe raportit përfundimtar”.
 - Urdhër nr. 5331/1, datë 06.07.2009, “Për përcaktimin e vendndodhjes dhe kompetencave të zyrave vendore të shërbimit të provës”.
 - Urdhër nr. 6325, datë 31.07.2009, “ Për bashkëpunimin e shërbimit të provës me OJF-të dhe shërbimin e ndërmjetësimit”.
- Urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm
 - Urdhër nr. 283, datë 21.08.2009, “Për miratimin e formularëve statistikorë dhe mënyrën e plotësimit të tyre”.
 - Urdhër nr. 189, datë 03.07.2009, “Për miratimin e modelit të dokumentit, “Programi individual i trajtimit të të dënuarve me dënime alternative”.
 - Urdhër nr. 245, datë 31.7.2009 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Shërbimin e Provës”.
- Udhëzime të Drejtorit të Përgjithshëm
 - Udhëzim nr. 319, datë 18.09.2009 “Për trajtimin e rasteve të mbikëqyrjes të të dënuarve me dënim alternative me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.
 - Udhëzim nr. 353, datë 30.09.2009 “Për llogaritjen e fillimit dhe përfundimit të periudhës së provës për të dënuarin; Për trajtimin e rastit kur i dënuari në provë ndryshon vendqëndrimin e tij, etj;
 - Udhëzim nr. 616, datë 21.05.2010 “Për mënyrën e përdorimit të modelit të standardizuar të letër referencave, për të dënuarit me dënime alternative, për të cilët Shërbimi Provës bashkëpunon me OJF-të e specializuara dhe me subjektet që ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit”.
- Marrëveshje dhe Memorandume bashkëpunimi
 - Marrëveshje bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe OJF te ndryshme.
 - 4 memorandume te nënshkruara
 - Memorandum bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe bashkive e komunave te vendit.
 - 27 memorandume të nënshkruara.

Të gjitha sa më sipër janë pjesë përbërëse e bazës ligjore të zbatueshme nga Shërbimi i Provës. Ato synojnë jo vetëm dhe rritjen e transparencës dhe të mirëfunksionimit të Shërbimit të Provës, por edhe standardizimit të praktikave të këtij Shërbimi dhe krijimin e traditës. Modelet e standardizuara të raporteve të përgatitura nga Shërbimi i Provës për fazat para dhënies së dënimit dhe pas dhënies së dënimit janë në Shtojcën II, faqe 274. Sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, si dhe parashikimeve të reja që sollën aktet e tjera nënligjore, të dala në bazë e për zbatimin e tij, kusht i nevojshëm, për të mos thënë i domosdoshëm i

vendimmarrjes së gjykatës, në rastet e aplikimit të alternativave me burgim është edhe raporti i përpiluar nga Shërbimi i Provës. Ky organ ka detyrim jo vetëm të përpilojë këtë raport, por edhe të mbikëqyrë dhe ndihmojë zbatimin e dënimeve alternative, si dhe të ndihmojë personin e liruar nga vuajtja e mëtejshme e dënimit me burgim, për kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social.

Sa më sipër, në bazë të ligjit nr. 10 023, datë 27.11.2008, këtij Shërbimi iu ngarkua detyra për përgatitjen e raportit përkatës, i cili do të vlerësonte qëndrimin e të dënuarit ndaj veprës dhe pasojave të saj; gjendjen gjyqësore të të dënuarit; sjelljen e të dënuarit në raport me personat e tjerë; gjendjen psiko-sociale të të dënuarit; gjendjen familjare si dhe planet e tij konkrete, të cilat do ta ndihmojnë në riintegrimin e tij të plotës nëse gjykata do të vendosë lirimin e të pandehurit/ të dënuarit nga burgimi.

Për realizimin e detyrave të mësipërme, Shërbimit të Provës i është dhënë e drejta për të realizuar intervistimin e të gjithë subjekteve të përmendura nga i dënuari në kërkesën e tij për lirimin me kusht apo të përmendura nga prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij gjatë hetimeve paraprake. Bazuar në përfundimet e arritura gjatë intervistimit të subjekteve të përmendura më lart, në raportin e përgatitur nga Shërbimi i Provës i rekomandohet gjykatës (apo dhe prokurorit gjatë hetimeve paraprake) se cila do të jetë perspektiva e riintegrimit të të dënuarit apo të pandehurit në shoqëri e për pasojë, cili do të jetë detyrimi më i përshtatshëm për t'u përmbushur nga i pandehuri/i dënuari, nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal. Ky rekomandim përgjithësisht orientohet në tre plane:

1. Bashkëpunimi me Shërbimin e Provës;
2. Situata familjare dhe shoqërore nëse, i dënuari apo i pandehuri ka mbështetjen e rrethit familjar e shoqëror për përballimin e vështirësive pas lirimit;
3. Në fushën e punësimit apo të arsimimit.

Parashikimi pas ndryshimeve në Kodin Penal, si ligj material, në ligjin nr. 10 024, datë 27.12.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, miratuar me vendimin nr. 302, datë 25.03.2009 të Këshillit të Ministrave, dalë në zbatim të ligjit, padyshim është një risi për kuadrin ligjor shqiptar. Kjo pasi krijimi i një institucioni të tillë, i cili deri dje nuk ishte i parashikuar, përbën njëherazi një ndihmesë të madhe për organin e hetimit, por edhe për gjykatën në aplikimin e formave të dënimeve alternative. Për më tepër një organ i tillë i bën realisht të zbatueshme në praktikë dënimet alternative, të cilat deri dje për sa i përket fazës së ekzekutimit mbeteshin vetëm një formalitet në letër dhe që vareshin në ndërgjegjen e personave për t'u zbatuar. Kjo vinte pikërisht si rezultat i mungesës së një organi të specializuar. Nga ana tjetër, konstatohet se implementimi i Shërbimit të Provës në legjislacionet me karakter material nuk është bashkëshoqëruar me ndryshime të karakterit procedural, e cila ka sjellë vështirësi në lidhje me pozitën procedurale të Shërbimit të Provës, sidomos në fazën e hetimit dhe gjykimit. Në lidhje me rolin që duhej të luajë ky organ në fazën e ekzekutimit, parashikimet ligjore janë dhe më të qarta.

Neni 31/7 i ligjit nr. 10 024, datë 27.12.2008 parashikon se:

“Shërbimi i provës është organi shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, sipas këtij ligji dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social”.

Nga formulimi ligjor i kësaj dispozite rezulton se Shërbimi i Provës, me cilësinë e organit shtetëror, ka detyrimin që të paraqesë informacione dhe raporte para prokurorit ose gjykatës. Sipas ligjit të sipërcituar rezulton se që në fazën e hetimit organi i prokurorisë me kërkesë ka të drejtë të kërkojë nga Shërbimi i Provës një raport në të cilin të vlerësohen rrethanat shoqërore për ta ndihmuar prokurorinë në marrjen e vendimeve gjatë fazës së hetimeve paraprake. SKëto të dhëna jepen në raport me qëllim që të ndihmojnë gjykatën në vlerësimin e duhur të dënimit alternativ.

Raporti përmban edhe rekomandimin e Shërbimit të Provës për dënimin e përshtatshëm alternativ për personin, integrimin e tij në shoqëri dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

Në praktikën gjyqësore ka lindur për diskutim çështja se për çfarë vendimmarrjesh në fazën e hetimeve paraprake ka pasur qëllim ligjvënësi dhe me çfarë cilësie procedurale paraqitet ky raport i Shërbimit të Provës në fazën e hetimeve paraprake. Për të analizuar këto dy çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me rolin e Shërbimit të Provës, duhet parë roli që merr organi i prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake.

- Së pari: Ky organ i drejtohet gjykatës për marrjen e masës së sigurimit personal për personin në hetim të një vepre penale, duke kërkuar dhe llojin e masës konkrete.
- Së dyti, vendos mosfillimin e procedimit penal, konform nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale.
- Së treti: Vendos pushimin e çështjes penale ose të akuzës nëse janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale.
- Së katërti: Merr vendim për përfundimin e hetimeve dhe dërgimin e çështjes për gjykim.

Në rastin e dytë dhe të tretë, konstatohet se të dyja këto lloj vendimmarrjesh, duke qenë se kanë të bëjnë me mungesën e elementëve të veprës penale apo të personit që dyshohet, nuk kanë asnjë lidhje me dënimet alternative. Si rrjedhim, nuk ka mundësi që në të dyja këto raste, Shërbimi i Provës të ndihmojë organin e hetimit për marrjen e vendimeve të tilla.

Për sa i përket fazës së marrjes së vendimit kur organi i prokurorisë ka kërkuar në gjykatë një masë sigurimi personal, rezulton se ky organ përcakton në kërkesën e drejtuar gjykatës analizën lidhur me llojin e masës. Në përfundim të kësaj analize prokurori çmon nëse duhet të kërkojë në gjykatë masë sigurimi personal arrest në burg, ose masa të tjera alternative të përcaktuara nga nenet 232 dhe 240 të Kodit Penal.

Nëse organi i prokurorisë do kishte mundësinë që para se të bënte kërkesën në gjykatë për caktim mase sigurimi të kishte një raport nga Shërbimi i Provës, me të gjitha të dhënat që përcakton ligji e kryesisht për personalitetin e shkelësit të ligjit, ky Shërbim do e ndihmonte së tepërmi organin

e hetimit para një vendimmarrje të tillë. Edhe pse një gjë e tillë do ndikonte pozitivisht në përcaktimin e një mase alternative sigurimi nga organi i prokurorisë, kjo gjë aktualisht ende është e pamundur objektivisht. Kjo pasi e gjithë koha e nevojshme e vënë në dispozicion të organit të prokurorisë deri në marrjen e vendimit për bërjen e kërkesës në gjykatë për masë sigurimi është vetëm 48 orë (në rastet e arrestimit apo ndalimit), ndërkohë që aktualisht Zyrat e Shërbimit të Provës nuk funksionojnë pranë çdo gjykate të rretheve gjyqësore sipas parashikimit ligjor të nenit 31/12 të ligjit nr. 10 024, datë 27.12.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. P.sh., nëse një raport i tillë kërkohet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë para bërjes së kërkesës në gjykatë, i kërkon një raport Shërbimit të Provës, Zyra Vendore e Shërbimit të Provës që mbulon në juridiksionin e vet këtë prokurori, që është Zyra Vendore e Durrësit, e ka pothuaj të pamundur që t’i vërë në dispozicion raportin e saj brenda 48 orëve organit të prokurorisë. Kjo pasi largësia e madhe, mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe profesionale e bëjnë të pamundur procesin e intervistimit gjatë kësaj periudhe dhe arrijten në konkluzione përfundimtare dhe më pas përpilimin e një raporti të tillë.

Situata është më e thjeshtë në rastet kur prokuroria depoziton në gjykatë një kërkesë vetëm për caktim mase sigurimi. Në të tilla raste organi i prokurorisë i ka të gjitha mundësitë, por edhe kohën e mjaftueshme që para se të bëjë kërkesën në gjykatë, t’i kërkojë Shërbimit të Provës një raport që i përkiste të dyshuarit. Nëse raporti i Shërbimit të Provës do jetë pozitiv, kjo gjë mund t’i shërbejë organit të prokurorisë për t’i kërkuar gjykatës një caktim mase sigurimi alternative nga ajo e arrestit në burg.

Për sa i përket vendimit për përfundimin e hetimeve dhe bërjen e kërkesës për dorëzimin e çështjes në gjykatë, konstatohet se organi i prokurorisë gjatë gjykimit, pjesë të kësaj vendimmarrje ka dhe kërkesën për marrjen e provave, deri dhe në bërjen e konkluzioneve përfundimtare, ku kërkohet jo vetëm fajësia, por dhe lloji dhe masa e dënimit. Në këtë kuptim organi i prokurorisë gjatë fazës së hetimeve ka të drejtë t’i kërkojë Shërbimit të Provës një raport dhe më pas këtë raport e bën pjesë të akteve të depozituara në gjykatë, duke kërkuar administrimin e tij si provë. Mbi bazën e rekomandimeve të këtij raporti, organi i prokurorisë mund të arrijë në një konkluzion nëse duhet të kërkojë ose jo që gjykata të aplikojë ndaj të pandehurit një dënim alternativ. Ajo që është e rëndësishme është fakti se prokuroria nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga raporti i Shërbimit të Provës, i cili është rekomandues në çdo rast dhe jo detyrues për organin e prokurorisë. Ajo që vihet re në praktikën gjyqësore është fakti se nga disa prokurori ose nga disa prokurorë është hapur një praktikë ku pothuaj në çdo rast i drejtohen në fazën e hetimeve Shërbimit të Provës, ku i kërkojnë një raport në lidhje me personalitetin e të pandehurit, punësimin e mëparshëm të tij, sjelljen dhe nivelin arsimor të tij, etj. Nga ana tjetër ka ende prokurorë të cilët e shohin me skepticizëm administrimin e një raporti të tillë. Kjo nisur nga dy arsye:

- Së pari, ligji nuk është i qartë kundrejt prokurorisë që ta detyrojë në çdo rast t’i drejtohet Shërbimit të Provës për të marrë një raport të tillë. Si rrjedhim, ligji ka nevojë për një ndryshim me qëllim që të jetë më i qartë në këtë drejtim, duke parashikuar se kur dhe për çfarë rastesh organi i prokurorisë mund t’i drejtohet Shërbimit të Provës.
- Së dyti: Për shkak të mungesës jo vetëm të burimeve njerëzore që kanë Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, por edhe për shkak të faktit se në Shqipëri funksionojnë aktualisht

vetëm 4 Zyra Vendore të Shërbimit të Provës, jo siç e parashikon vetë ligji. Për pasojë, pritja e një raporti të tillë nga prokuroria apo prokurori të ndryshme, mund të passjellë dhe zvarritje të padobishme të hetimit, çka do çonte dhe në zgjatje të afateve të hetimit, e cila do të mund të cenonte dhe interesat apo të drejtat e të pandehurve të paraburgosur.

Ajo që konstatohet gjatë praktikës gjyqësore është dhe fakti se ka pasur raste kur gjykatat nuk kanë pranuar gjykimin e shkurtuar ndaj të pandehurve për shkak se dosjes gjyqësore i mungonte raporti i Shërbimit të Provës, i cili duhej të merrej në fazën e hetimeve. Nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje, gjykatat kanë pasur rëndësinë e këtij raporti në fazën e hetimeve paraprake që më pas i shërben dhe gjykimin të çështjes. Ajo që lë vend për interpretime në këtë drejtim është fakti se me çfarë vlere procedurale duhet të administrohet nga organi i prokurorisë një raport i tillë. Për shkak të mungesës së përshtatjes së ndryshimeve ligjore në ligjin procedural, pozita e Shërbimit të Provës është ende e paqartë jo vetëm në fazën e hetimit, por edhe në fazën e gjykimin. Për pasojë, kjo gjë ka sjellë vështirësi dhe në llojin apo produktin ligjor që “prodhon” ky Shërbim, se çfarë cilësie do ketë raporti i përgatitur nga Shërbimi i Provës në fazën e hetimit. Legjislacione të ndryshme këtë situatë e kanë zgjidhur me parashikime të sakta ligjore.

Sistemi ynë ligjor duke mos parashikuar në mënyrë të qartë pozicionin procedural të Shërbimit të Provës në hetim dhe gjykim, ka sjellë më pas vështirësi në natyrën e provës që ka produkti i tij. Në këtë kuptim, nëse i referohemi nocionit “Provat” të përcaktuara në Titullin IV, në Kreun I të Kodit të Procedurës Penale, nuk rezulton që raporti i përgatitur nga Shërbimi i Provës të jetë përcaktuar në ndonjë nga llojet e provave tek ky organ. Po kështu edhe ligji nr. 10 024, datë 27.12.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” nuk bën ndonjë parashikim të tillë në lidhje me raportin e Shërbimit të Provës si lloj prove. Nga ana tjetër, Rregullorja e Shërbimit të Provës përcakton në nenin 32 të saj rregulla të hollësishme për raportin e Shërbimit të Provës duke përcaktuar dhe faktin që një raport i tillë paraqitet edhe në fazën e hetimeve paraprake, madje specialisti që përpilon raportin në këtë fazë ka të drejtë të paraqesë mendim për llojin dhe masën e dënimit që ai e quan të përshtatshme.

Konkretisht neni 32 i kësaj rregullore, në paragrafët 1–5 të tij parashikon se:

“1. Shërbimi i provës harton raportin vlerësues duke analizuar rrethanat sociale që lidhen me personin nën hetim, të pandehurin apo të dënuarin. Ky raport paraqet një ekspertim të personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit brenda kompetencave të Shërbimit të Provës.

2. Në rastin e fazës së hetimeve paraprake dhe të gjykimin, ky raport hartohet nga një punonjës i caktuar nga drejtori i zyrës vendore për këtë qëllim. Në rastet e fazës së ekzekutimit të dënimit penal, raporti hartohet nga punonjësi i caktuar me mbikëqyrjen e të dënuarit.

3. Raporti i vlerësimit paraqet të dhëna që i vijnë në ndihmë prokurorit ose gjykatës në marrjen e vendimit në çdo fazë të procedimit penal, bazuar në informacione të detajuara dhe në analizën e rrethanave, shkaqeve të kryerjes së veprës penale dhe qëndrimeve të tij të paraqitura nga Shërbimi i Provës në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme.

4. Shërbimi i Provës paraqet në raport mendimin e tij për llojin apo masën dënimit të përshtatshme që duhet marrë në çdo rast individual. Ky mendim jepet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht qëndrimeve të prokurorisë apo të mbrojtësit.

5. Raporti i vlerësimit paraqitet në formë të përmbledhur, duke shmangur termat e specializuar apo shprehjet që do ta vështirësonin kuptimin e tij”.

Nëse i referohemi paragrafëve të dispozitës rezulton se raporti paraqet një ekspertim të personit. Në këtë prizëm, në mungesë të një parashikimi ligjor të shprehur, raporti mund të përbëjë në një farë mënyre një akt ekspertimi. Si i tillë, organi i prokurorisë në administrimin e tij në fazën e hetimeve paraprake mund të respektojë rregullat procedurale të parashikuara në nenet 178–185 të Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me ekspertimet.

Sipas përmbajtjes aktuale që kanë sot dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe Kodi i Procedurës Penale na rezulton se Shërbimi i Provës nuk është ndër subjektet procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale. Në pjesën e parë të këtij Kodi parashikohet se “subjekte të procedimit penal” janë të gjithë pjesëmarrësit e procedimit penal, të cilët luajnë role të rëndësishme në realizimin e detyrave të procedimit penal, duke vepruar në përputhje me të drejtat, detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Kodi nuk lë hapësira që pjesëmarrës të tjerë në procesin penal të përfshihen në rrethin e “subjekteve të procedimit penal”. Të tillë pjesëmarrës janë p.sh.: dëshmitarët dhe ekspertët. Në të njëjtën situatë juridike gjendet sot edhe Shërbimi i Provës. Shërbimi i Provës nuk është subjekt i procedimit penal por merr pjesë në këtë procedim në rolin e “ekspertit” për të ndihmuar subjektet e procedimit penal në kryerjen e detyrave të tyre, me qëllim dhënien e një vendimi sa më të drejtë e të përshtatshëm jo vetëm për të pandehurin por edhe për të dëmtuarin nga vepra penale si dhe shoqërinë.

Ky përfundim bazohet edhe në përmbajtjen e dispozitave të VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009, të cilat e trajtojnë raportin e përpiluar nga Shërbimi i Provës si “...ekspertim të personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit brenda kompetencave të Shërbimit të Provës”.

Për të përcaktuar masën dhe llojin e dënimit, sipas nenit 47/2 të Kodit Penal parashikohet se: “Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”. Ndërsa, në nenin 380 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: “Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në seancë gjyqësore”. Nga interpretimi i këtyre dispozitave të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën rezulton se për të marrë një vendim përfundimtar e për pasojë, për të dhënë edhe një dënim gjykata mund të përdorë vetëm prova që janë marrë ose janë verifikuar në seancë gjyqësore. Ky është një rregullim absolut, i cili nuk lejon përjashtime. Pra, në kuptimin negativ të këtij rregulli rezulton se: Gjykata nuk mund të japë një vendim të bazuar në akte të cilat nuk kanë marrë cilësinë e “provës”.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se edhe Shërbimi i Provës do të prodhojë një “provë” gjatë procesit penal, e cila e shqyrtuar në harmoni me provat e tjera, do t’i shërbejë gjykatës për të marrë një vendim përfundimtar dhe për pasojë për të dhënë një dënim ndaj autorit të veprës penale.

Nisur nga analiza e mësipërme nxirret si përfundimin se raporti i Shërbimit të Provës i paraqitur para gjykatës (qoftë edhe i kryer gjatë hetimeve paraprake me kërkesë të prokurorit përbën “provë” në kuptimin e ligjit procedural penal. Ndërsa, specialisti i Shërbimit të Provës është në

cilësinë e “ekspertit” në procesin penal. Për pasojë, ai duhet t’i nënshtrohet rregullave për caktimin e ekspertit të parashikuara nga nenet 178 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Nisur nga analiza e mësipërme në lidhje me subjektet e procedimit penal, provat në këtë procedim, rolin e Shërbimit të Provës, si dhe natyrën e raportit të përpiluar nga ky Shërbim, rezulton se në rastet e gjykimit të shkurtuar të parashikuar nga neni 403 e vijues i Kodit të Procedurës Penale, i cili bazohet vetëm mbi aktet e paraqitura nga prokuroria, aplikimi i dënimeve alternative, pa patur në fashikullin për gjykim të raportit të Shërbimit të Provës do të jetë jo i mirë bazuar në prova dhe në ligj. Ky përfundim bazohet në faktin se në gjykimin e shkurtuar gjykata e ka proceduralisht të pamundur të marrë prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, qoftë këto edhe për të përcaktuar vetëm llojin dhe masën e dënimit. Më saktë, mungesa e këtij raporti, do ta vendosë në vështirësi gjykatën për të përcaktuar se:

- cili nga dënimet alternative do të jetë më i përshtatshëm në rastin konkret;
- cili nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal do të jetë më i përshtatshëm në rastin konkret, kur gjykata ka vendosur aplikimin e një dënimi alternativ.

Në përfundim të analizës së bërë më lart për rolin dhe pozitën procedurale të Shërbimit të Provës në Shqipëri është me vend që ligjvënësi të bëjë ndryshimet përkatëse në ligjin procedural penal për të saktësuar qartë pozitën procedurale të Shërbimit të Provës dhe të raportit të përgatitur nga ky Shërbim gjatë gjykimit penal.

Shërbimi i Provës parashikohet si organ shtetëror që ka kompetencë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të dënimeve alternative.

Vetë dispozitat e Kodit Penal, të ndryshuar, mbi dënimet alternative, parashikojnë në përmbajtjen e tyre rolin mbikëqyrës të Shërbimit të Provës. Kështu vetë neni 59 i Kodit parashikon:

“Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës, apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit”.

Sipas këtij parashikimi ligjor, gjykata ka të drejtë që nëse i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi siç ka urdhëruar gjykata, atëherë kjo e fundit ka tre opsione vendimmarrjeje:

- Së pari: Zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër
- Së dyti: Zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes brenda periudhës së provës
- Së treti: Revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

Mbetet i paqartë fakti se çfarë ka pasur qëllim ligjvënësi në parashikimin e opsionit të dytë për gjykatën, ku parashikon zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes brenda periudhës së provës, në një kohë që e gjithë periudha e provës karakterizohet nga një periudhë mbikëqyrjeje, e cila realizohet nga Shërbimi i Provës. Në këtë kuptim, nëse gjykata do zgjatë periudhën e mbikëqyrjes, ajo ka

zgjatur njëherazi periudhën e provës. Praktika gjyqësore në këtë drejtim ende nuk ka pasur një zhvillim.

Po kështu edhe në aplikimin e alternativës tjetër të dënimit të parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, i emërtuar “Qëndrimi në shtëpi,” ligjvënësi parashikon rolin mbikëqyrës të Shërbimit të Provës në fazën ekzekutive të këtij dënimi. Kështu, nëse gjykata lejon personin e dënuar me “qëndrim në shtëpi” që të largohet nga vendbanimi për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, ajo duhet që të marrë pëlqimin e Shërbimit të Provës sipas parashikimit ligjor të nenit 59/a të Kodit Penal.

Më pas është gjykata që në vendimin e saj përcakton dhe masat që duhet të marrë Shërbimi i Provës. Nocioni “masë” i parashikuar në këtë dispozitë nuk gjen ndonjë parashikim të veçantë në dispozitat e kreut të “Alternativave të dënimit me burgim”. Megjithatë, këto masa mund të konsistojnë kryesisht në veprimet konkrete që duhet të kryejë Shërbimi i Provës me qëllim monitorimin apo mbikëqyrjen e kësaj vendimmarrjeje të gjykatës.

Kjo pasi largimi i personit të dënuar nga vendbanimi të jetë vetëm për plotësimin e atyre nevojave që gjykata ka përcaktuar në vendimin e saj.

Gjykata zbaton edhe nenin 62 të këtij Kodi. Kjo dispozitë parashikon në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt, në mënyrë të qartë mënyrën, procedurën dhe rolin që ka Shërbimi i Provës në rast se gjatë afatit të provës i dënuari shkel kushtet dhe detyrimet që ka vendosur gjykata.

Detyrimet e të dënuarit të vënë në provë, të cilat parashikohen dhe nga neni 62 i Kodit Penal janë përcaktuar në mënyrë të shprehur dhe në nenet 60 dhe 61 të Kodit Penal. Nga ana tjetër, kusht ligjor sipas nenit 62 të Kodit Penal mund të përbëjë edhe çdo lloj detyrimi tjetër i ndryshëm nga ato të përcaktuara në këto dy dispozita, por i përcaktuar në vendimin e gjykatës si p.sh., urdhërohet i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, etj. Në të tilla raste, Shërbimi i Provës ngarkohet me detyrimin që t’i raportojë në mënyrë të menjëhershme prokurorit sapo të konstatojë një fakt të tillë. Më pas është prokurori i cili disponon në këtë mënyrë sipas procedurave ligjore:

“Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit.

Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës:

- a) ndryshimin e detyrimit të vendosur,
- b) shtimin e detyrimeve të tjera,
- c) zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose
- ç) revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg”.

Edhe dënimi tjetër alternativ i parashikuar në nenin 63 të Kodit Penal i emërtuar “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik,” parashikon rolin që duhet të kryejë Shërbimi i Provës. Risia që sjell parashikimi i një dënimi të tillë alternativ pas ndryshimeve është pikërisht fakti që në ndryshim nga e njëjta dispozitë, por

para ndryshimeve, llojin e punës që do kryhet, vendin e punës, si dhe ditët kur do të kryhet e përcakton vetëm Shërbimi i Provës.

Pikërisht këto parashikime i bën neni 63 i Kodit Penal kur shprehet në mënyrë eksplicite se:

“Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbaje kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë”.

Duke qenë një organ mbikëqyrës në ekzekutimin e një dënimi alternativ të tillë, është Shërbimi i Provës ai që konstaton dhe më pas informon prokurorin që i dënuari nuk kryen punën në interes publik, nuk mban kontakte të rregullta dhe periodike me vetë Shërbimin e Provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera të vendosura nga gjykata. Më pas është prokurori i cili informon menjëherë gjykatën dhe kjo e fundit në këtë rast vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi.

Ajo që konstatohet në këto dispozita të Kodit Penal është fakti se ligjvënësi nuk ka bërë ndonjë parashikim specifik lidhur me rolin e Shërbimit gjatë “gjysmëmlirisë”, parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal apo te “lirimi me kusht” parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal. Gjithsesi, një parashikim më të hollësishëm në lidhje me rolin dhe detyrat që ka Shërbimi i Provës në fazën e ekzekutimit të dënimeve alternative e parashikon vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Në nenin 29 të tij, ky ligj parashikon se:

“Kur gjykata vendos ekzekutimin e vendimit me burgim në gjysmëliri, parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë vendimin prokurorit për ekzekutim. Administrata e burgjeve dhe shërbimi i provës, në bazë të vendit të kryerjes së detyrimeve nga personi i dënuar, përcakton institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri, bazuar në detyrimet që ai duhet të përmbushë. Shërbimi i provës harton programin ditor, që duhet të zbatojë personi i dënuar për periudhën kohore, që ai ndodhet jashtë institucionit”.

Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, gjykata e cila aplikon vendimin alternativ me “gjysmëliri” parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal, ia dërgon menjëherë vendimin prokurorisë pranë asaj gjykate me qëllim ekzekutimin e tij. Më pas, bazuar në detyrimet që i dënuari duhet të përmbushë, të përcaktuara në vendimin e gjykatës, është administrata e burgjeve por dhe Shërbimi i Provës si organ mbikëqyrës që përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri.

Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ të “gjysmëmlirisë”, parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal

Mënyra e mbikëqyrjes së këtij dënimi parashikohet në nenin 7 të ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Kjo dispozitë në përmbajtjen e saj parashikon se:

“Shërbimi i provës mbikëqyr personin e dënuar me gjysmëliri, kur ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit dhe, kur është e nevojshme, edhe drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush kushtet ose detyrimet e tij për qëllimin e këtij dënimi.

Kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk kthehet në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, drejtori i institucionit, në bashkëpunim me shërbimin e provës, pasi të kenë verifikuar faktet dhe rrethanat, informojnë menjëherë prokurorin”.

Sipas kësaj dispozite përcaktohet qartë momenti apo roli se kur Shërbimi i Provës kryen detyrat e veta funksionale në dënimet alternative të “gjysmëlisë”.

Në këtë këndvështrim rezulton se Shërbimi i Provës mbikëqyr të dënuarin me “gjysmëliri” në momentin që ai ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për shkak të përmbushjes së detyrimeve për të cilat është aplikuar kjo alternativë dënimi. Nëse gjatë kësaj periudhe Shërbimi i Provës konstaton se personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush kushtet ose detyrimet e tij për qëllimin e këtij dënimi, pasi mban një procesverbal përkatës për dokumentimin e këtij fakti i raporton menjëherë prokurorit të caktuar, i cili merret me ekzekutimin e vendimeve penale dhe në rast se e çmon të nevojshme, mund të vërë në dijeni dhe drejtorin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Ligjvënësi ka zgjidhur ligjërisht edhe situatën faktike kur i dënuari me “gjysmëliri” nuk kthehet në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale. Në këto raste, është drejtori dhe punonjësi që verifikojnë rrethanat për moskthimin e këtij të dënuari në institucion, informojnë menjëherë prokurorin, i cili më pas vë në lëvizje gjykatën.

Nga ana tjetër, Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative,” miratuar me vendimin nr. 302, datë 25.03.2009 të Këshillit të Ministrave, dalë në zbatim të ligjit, në kreun VII të saj, në nenet 35 dhe 36, parashikon mënyrën e mbikëqyrjes së të dënuarve me “gjysmëliri”.

Në nenin 35 të saj, kjo rregullore parashikon se:

“1. Shërbimi i Provës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me urdhër të përbashkët përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri. Në këtë përcaktim, mbahen parasysh shkakut për të cilin gjykata ka caktuar masën alternative të gjysmëlisë dhe vendin ku duhet të përmbushë detyrimet personale jashtë burgut.

2. Modeli i urdhrit miratohet nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorëve të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës”.

Në zbatim të vetë ligjit, nenit 6 të tij, Rregullorja përcakton se institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale për të dënuarin me “gjysmëliri” bëhet me urdhër të përbashkët të Shërbimit të

Provës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, model i së cilit miratohet nga Ministria e linjës, nga e cila varen këto dy institucione, e cila është Ministria e Drejtësisë. Në përcaktimin e vendit ku do të vuhet dënimi këto dy institucione (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës) mbajnë parasysh dy kritere thelbësore.

Nga ana tjetër, në nenin 36 të kësaj Rregulloreje, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar se Shërbimi i Provës, mbikëqyrjen e personit të dënuar me “gjysmëliri,” duhet ta bëjë në bazë të një programi. Në lidhje me këtë moment kjo dispozitë parashikon se:

“Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program ditor individual për ekzekutimin e dënimit me gjysmëliri, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje. Ky program përmban detyrimet e të dënuarit gjatë kohës që ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duke përcaktuar:

- a) oraret e hyrjes dhe daljes në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;
- b) personat me të cilët i dënuari lejohet ose ndalohet të mbajë kontakte gjatë kohës së qëndrimit jashtë institucionit;
- c) ambientet e lejuara dhe ato të ndaluara për frekuentim;
- d) kushte të tjera”.

Kjo do të thotë që mbikëqyrja duhet të jetë e monitoruar me veprime konkrete dhe e dokumentuar bazuar në programin e hartuar. Ky program duhet të jetë në përputhje me parashikimet që bën neni 28 i kësaj Rregulloreje.

Vetë kjo dispozitë referuese në përmbajtjen e saj parashikon në mënyrë të detajuar se:

“1. Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e të dënuarit, me qëllim qartësimin e nevojave të të dënuarit për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale të tij. Shërbimi bazuar në këtë vlerësim, si dhe në të dhënat personale, familjare e shoqërore, masën e dënimit, ndërton programin individual të trajtimit të të dënuarit në përputhje me dënimin alternativ përkatës. Ky program duhet të miratohet nga drejtori i zyrës përkatëse vendore.

2. Në takimin e dytë me të dënuarin, punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar i paraqet dhe shpjegon të dënuarit përmbajtjen e programit individual. Programi individual i trajtimit të të dënuarit, diskutohet me të dënuarin. Ky program mund të ndryshohet në varësi të ecurisë së të dënuarit.

3. Programi individual nënshkruhet nga punonjësi i Shërbimit të Provës dhe i dënuari dhe, kur i dënuari është i mitur, edhe nga mbrojtësi i tij. Një kopje e programit individual i dorëzohet të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

4. Programi individual përmban elementët e mëposhtme:

a) pjesa hyrëse, në të cilën tregohen gjeneralitetet, adresa e vendbanimit, vepra penale e kryer, numri i vendimit gjyqësor, dënimi i dhënë, periudha e provës dhe emri dhe mbiemri i punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar;

b) masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata, si dhe mënyrat e përdorura nga punonjësi i Shërbimit të Provës për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe masave;

c) nevojat kriminogjene dhe sociale të personit nën mbikëqyrje, si dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre.

ç) rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit;

d) metodat e propozuara të ndërhyrjes për të reduktuar rrezikun;

dh) data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të dënuarit që do të mbahen gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes të përcaktuar nga gjykata.

5. Kur gjykata vendos detyrimin e të dënuarit për të marrë pjesë në një program rehabilitimi, programi individual shkurtimisht përshkruan përmbajtjen, kohëzgjatjen dhe mënyrën e kryerjes së tij.

6. Kur gjykata vendos detyrimin e kryerjes së një pune të papaguar në interes publik, plani i mbikëqyrjes përmban përshkrimin e veprimtarive, vendin e punës dhe oraret e saj.

7. Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton, në çdo takim, se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit të mbikëqyrjes.

8. Kur ndodhin ndryshime që mund të ndikojnë tek nevojat dhe rreziqet, pani ndryshohet me anekset që i shtohen atij”.

Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, Shërbimi i Provës edhe në fazën e ekzekutimit të vendimit ka detyrimin që të vlerësojë personalitetin e të dënuarit. Si rrjedhim, bazuar në këtë vlerësim si dhe në të dhënat personale familjare e shoqërore, masën e dënimit, ai harton programin individual të trajtimit të dënuarit në përputhje me dënimin alternativ përkatës. Një program i tillë duhet t'i bëhet i njohur të dënuarit në takimin e dytë që zhvillon specialisti i Shërbimit të Provës me të. Si rezultat i diskutimit të zhvilluar në këtë takim, programi dhe mund të ndryshohet në varësi të ecuresë së të dënuarit. Një kopje e këtij programi nënshkruhet nga i dënuari dhe kur i dënuari është i mitur, dhe nga mbrojtësi i tij, të cilëve iu dorëzohet dhe një kopje e këtij programi. Sipas pikës 4 të kësaj dispozite, programi duhet të përmbajë një sërë elementesh të detyrueshme në përmbajtjen e tij. Ajo që mund të haset me vështirësi në praktikë nga Shërbimi i Provës është fakti që mundësitë objektive të këtij organi për të hartuar programe individuale ditore për çdo të dënuar me kërkesa të hollësishme, e bëjnë pothuaj të vështirë hartimin e tij. Kjo vështirësohet dhe më tej kur dënimet alternative po gjejnë një përhapje gjithmonë dhe më të gjerë.

Programi përcakton:

- rastet kur do hyjë dhe dalë personi i dënuar në institucion;
- personat me të cilët i dënuari lejohet të takohet;
- personat me të cilët ndalohet që të mbajë kontakte gjatë kohës së qëndrimit jashtë
- institucionit;
- ambientet që lejohet të frekuentojë;
- ambientet që ndalohet të frekuentojë;
- por edhe kushte të tjera në varësi të rrethanave të rastit konkret.

Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të “pezullimit të ekzekutimit të dënimeve me burgim dhe vënia në provë”, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal

Në nenin 31/5 të ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” parashikohet pezullimin e

ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë. Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite rezulton se: “Kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë, parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal, ia dërgon vendimin prokurorit dhe institucioneve të ekzekutimit të vendimit penal.

I dënuari i vënë në provë, gjatë kohës së provës, duhet të raportojë rregullisht te shërbimi i provës, i cili duhet të informojë rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit. Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk mban kontakte me këtë shërbim apo nuk përmbush detyrimin e vendosur”.

Nga interpretimi literal i dispozitës rezulton se vendimi i gjykatës mbi dënimin alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë e personit të dënuar, ekzekutohet apo mbikëqyret nga Shërbimi i Provës. Për çdo problem të lindur ky Shërbim i raporton menjëherë prokurorit si subjekt procedural, i cili legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykatën.

Po sipas kësaj dispozite, të dënuarit e vënë në provë, gjatë gjithë periudhës së provës kanë detyrim të raportojnë rregullisht tek Shërbimi i Provës dhe ky i fundit duhet të informojë rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit. Nisur nga mënyra sesi është formuluar dispozita, rezulton se Shërbimi i Provës duhet të informojë jo vetëm prokurorin, por dhe policinë. Mbetet ende jo i qartë fakti në të cilin ligjvënësi ka parashikuar me ligj që Shërbimi i Provës duhet të informojë edhe organet vendore të policisë së shtetit, ndërkohë që këto organe ligji i mëparshëm nuk i ka ngarkuar dhe më pas dhe ndryshimet ligjore nuk kanë parashikuar se mbikëqyrjen e këtyre dënimeve alternative ta bënin pikërisht këto organe.

Në zbatim të këtij ligji, Rregullorja e Shërbimit të Provës në kreun e VIII, nenet 37 – 44 të saj, parashikon procedurat dhe mënyrën e mbikëqyrjes së të dënuarve për të cilët gjykata ka vendosur “pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të personit”. Në nenin 37 të saj, Rregullorja, ashtu si tek mbikëqyrja e dënimit alternativ me “gjysmëliri”, parashikon dhe në këtë dispozitë hartimin e një lloj programi individual. Me këtë program përcaktohen në mënyrë sa më të qartë dhe të saktë të drejtat dhe detyrimet e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit dhe se të gjitha këto duhen të jenë në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 28 të kësaj Rregulloreje.

Si organ mbikëqyrës, Shërbimi i Provës në këndvështrim të nenit 38 të Rregullores, ka detyrimin të informojë të dënuarin mbi detyrimin e vetë këtij të dënuari që të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë zbatimit të këtij dënimi alternativ.

Në paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 kjo dispozitë e Rregullores parashikon në mënyrë të detajuar mënyrën se si veprohet kur i dënuari i vënë në provë nuk paraqitet për shkaqe objektive. Për një mbikëqyrje sa më efektive të kësaj alternative dënimi, në zbatim edhe të parashikimeve ligjore të nenit 61 të Kodit Penal, Rregullorja e Shërbimit të Provës në nenin 39 të saj parashikon në mënyrë të qartë detyrimet që ka i dënuari i vënë në provë në rast se ndryshon vendbanimin apo vendqëndrimin.

Kjo dispozitë e Rregullores parashikon gjithashtu procedura strikte për të dënuarin e vënë në provë në lidhje me mënyrën se si duhet të njoftojë Shërbimin e Provës në rast të këtij ndryshimi. Një gjë e tillë bëhet nga i dënuari sipas nenit 39/4 të Rregullores edhe kur i dënuari ndryshon vendin e punës. Parashikimi i një dispozite të tillë nga ligjvënësi është bërë me qëllim që Shërbimi i Provës të jetë sa më pranë këtij procesi mbikëqyrjeje, duke mos u shkëputur i dënuari i vënë në provë për asnjë moment nga kontakti me këtë shërbim. Në rast se vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i të dënuarit të vënë në provë është jashtë kompetencës, kjo e fundit i dërgon brenda 3 ditëve Zyres Vendore kompetente të Shërbimit të Provës dosjen personale të të dënuarit të vënë në provë si dhe njofton menjëherë gjykatën që ka dhënë vendimin. Ajo që mund të shtrohet për diskutim në këtë moment është pikërisht fakti se për çfarë arsyesh gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet nga Shërbimi i Provës në këto raste. Mos do të ishte më e drejtë parashikimi i një lloj informacioni nga Shërbimi i Provës si organ mbikëqyrës tek prokurori, i cili ka vënë në ekzekutim një dënim penal të formës së prerë, por i një natyre të tillë?

Në lidhje me njoftimin që i dënuari i bën Shërbimit të Provës për ndryshimin e vendit të punës, rezulton se kjo ka një logjikë juridike, pasi i jep mundësinë Shërbimit të Provës që të përshtatë programin individual për këtë të dënuar në varësi dhe të llojit të punës që kryen i dënuari.

Ligjvënësi në një dispozitë tjetër të Rregullores, e konkretisht në nenin 40 të saj, detyron specialistin e Shërbimit të Provës që të përmbushin detyrimet e tyre funksionale që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e këtij dënimi alternativ, në rast se gjykata ka caktuar për të dënuarin e vënë në provë një ose më shumë se një nga detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal.

Shërbimi i Provës ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo organizata të ndryshme, si p.sh. deri në datën 18 qershor 2010, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe OJF-ve janë nënshkruar 4 marrëveshje bashkëpunimi dhe 27 marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar me bashkitë dhe komunat në vend. Nga ana tjetër, ka pasur raste kur gjykata të veçanta kanë lidhur marrëveshje me fondacione të ndryshme dhe në vendimet gjyqësore në vendosjen e detyrimeve kanë përcaktuar dhe fondacionin ku do përmbushet një detyrim i tillë

Vetë Rregullorja e Shërbimit të Provës në nenet 41 – 44 të saj përcakton rregulla të hollësishme në lidhje me mbikëqyrjen e realizuar nga Shërbimi i Provës në lidhje me detyrimin për të ushtruar një veprimtari profesionale ose për të marrë një formim, të detyrimit për mjekim ose rehabilitim.

Kështu, vetë neni 41 i Rregullores në pikën 4 të tij përcakton në mënyrë të shprehur që nëse gjykata në vendimin e saj nuk ka përcaktuar llojin e veprimtarisë që do të ndiqet nga i dënuari, është Shërbimi i Provës organi i cili ka detyrimin për të përcaktuar llojin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit të tij. Pra, nga ky parashikim ligjor rezulton se përveç gjykatës, këtë të drejtë e ka dhe Shërbimi i Provës, i cili përveç se mbështet të dënuarin në përmbushjen e detyrimeve të vëna nga gjykata, ka njëherazi detyrimin të kontrollojë në mënyrë periodike nëse përmbushen rregullisht këto detyrime ose jo. P.sh., nëse i dënuari shkon rregullisht për të ndjekur kursin e formimit profesional ose jo. Në varësi të përmbushjes së këtyre detyrimeve Shërbimi i Provës ka detyrime më pas nëse duhet ose jo të informojë prokurorin.

Ajo që duhet theksuar në këtë drejtim është fakti se Shërbimi i Provës ka detyrim për të përcaktuar vetëm llojin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit të tij, dhe jo të përcaktojë vendosjen si detyrim kryerjen e një aktiviteti profesional apo aktiviteti tjetër. Kjo pasi këtë të drejtë e ka vetëm gjykata për t'i caktuar detyrime personit të vënë në provë.

Për sa i përket përmbushjes së detyrimeve të tjera të parashikuara në nenet 60/4; 60/5; 60/6; 60/7; 60/8; 60/9; 60/10 dhe 60/11 të Rregullores së Shërbimit të Provës, rezulton se Shërbimi i Provës si detyrim kryesor që është në funksion të mbikëqyrjes së këtyre lloj detyrimeve, ka bashkëpunimin tepër të ngushtë me institucionet lokale apo me entet e tjerë publikë ose privatë, të cilët mund të orientojnë në mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtyre detyrimeve.

Për çdo lloj detyrimi të përcaktuar nga dispozitat e sipërcituara, Shërbimi i Provës brenda 3 ditëve nga kontakti i parë me të dënuarin, ka detyrimin që t'i dërgojë Policisë së Shtetit dhe çdo organizatë tjetër ose institucioni që mund të asistojë mbikëqyrjen, informacionin mbi të dënuarin në provë, duke iu kërkuar njëherazi këtyre subjekteve që të njoftohet menjëherë në rast se i dënuari nuk i përmbush detyrimet.

E ndërsa dispozitat penale materiale të përcaktuara në nenin 62 të Kodit Penal i jepnin të drejtë prokurorit që t'i bënte paralajmërim të dënuarit, neni 43 i Rregullores në pikën 4 të tij ia njeh këtë të drejtë edhe Shërbimit të Provës.

Në nenin 44 të saj, Rregullorja përcakton procedurën dhe mënyrën e mbikëqyrjes si të detyrimit për mjekim apo rehabilitimin të vendosur nga gjykata personit të vënë në provë. Qendrat mund të jenë shëndetësore, organizatë, institucion apo që realizon programe rehabilitimi për substancat narkotike, alkoolin apo lloje të tjerash programi rehabilitimi. Më pas për vendosjen në këto qendra është përsëri specialisti i Shërbimit të Provës i cili kontrollon nëse i dënuari ndjek programet e trajtimit.

Në këtë kuptim, me qëllim lehtësimin e përmbushjes së detyrimeve, Shërbimi i Provës ka të drejtë të lidhë marrëveshje me qendrat mjekësore, institucionet, organizatat dhe specialistët për rregullimin e procedurave të bashkëpunimit. Ligjvënësi ka zgjidhur edhe situatën kur ky detyrim konsiderohet i papërmbushur. Një detajim i tillë sipas kësaj dispozite të Rregullores konsiderohet i papërmbushur kur i dënuari i vënë në provë. Aktualisht nuk konstatohen ende raste nga praktika gjyqësore kur të dënuarit e vënë në provë nuk kanë përmbushur detyrimet e dhëna nga gjykata.

Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ të “qëndrimit në shtëpi”, parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal

Për sa i përket mbikëqyrjes së dënimit alternativ të “qëndrimit në shtëpi”, parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në nenin 31/4 të tij parashikon mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së tij.

Në përmbajtjen e saj, kjo dispozitë parashikon se:

“Kur gjykata vendos vuajtjen e dënimit të dhënë, me qëndrim në shtëpi, parashikuar në shkronjën “a” të nenit 59 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë për ekzekutim vendimin prokurorit dhe, në rast se ai mbahet në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, edhe drejtorisë së këtij institucioni.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit me qëndrim në shtëpi dhe bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera, private dhe shtetërore. Shërbimi i provës siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për personin e dënuar nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimit me qëndrim në shtëpi. Shërbimi i provës harton programe për personin, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi. Kur personi i dënuar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata, për shkak të ndryshimit të rrethanave, shërbimi i provës i rishikon këto detyrime, për të cilat i raporton menjëherë prokurorit”.

Nëse personi, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi, nuk respekton detyrimet e vendosura, i drejtohet prokurorit dhe, sipas rastit, i propozon atij kërkesën për ndryshimin e detyrimit”.

Sipas këtij parashikimi ligjor në rast se gjykata aplikon këtë dënim alternativ, ajo ka detyrimin që një kopje të këtij vendimi t’ia dërgojë për ekzekutim prokurorit edhe nëse personi ndaj të cilit aplikohet një dënim i tillë është duke u mbajtur në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale edhe drejtorisë së këtij institucioni. Një parashikim i tillë është bërë nisur nga fakti se aplikimi i një dënimi të tillë alternativ, bëhet jo vetëm në fazën e ekzekutimit të dënimit, por edhe në fazën e dhënies së dënimit, kur shtetasi ende ka qenë i pandehur, i paraburgosur, por jo me statusin e të dënuarit. Sipas rasteve konkrete, Shërbimi i Provës bashkëpunon me autoritetet e pushtetit vendor, me shërbimet sociale, me organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera private dhe shtetërore me qëllim ekzekutimin e vendimit. Në këtë kuadër, Shërbimi i Provës jo vetëm harton programe për personin që vuan dënimin me “qëndrimin në shtëpi”, por dhe siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për personat e dënuar nga institucionet që bashkëpunojnë me të në zbatimin e vendimit.

Ligjvënësi i ka dhënë të drejtë Shërbimit të Provës se nëse i dënuari nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata për shkak të ndryshimit të rrethanave, që t’i rishikojë këto detyrime për të cilat i raporton menjëherë prokurorit. Mbetet e paqartë në praktikë mënyra se si i rishikon këto detyrime Shërbimi i Provës apo se çfarë kërkesash i bën prokurorit. Kjo pasi një detyrim i përcaktuar për t’u përmbushur në vendimin e gjykatës nuk mund të ndryshohet nga prokurori, dhe për më tepër nga ky Shërbim. Situata është e ndryshme dhe në rastin tjetër kur nuk kanë ndryshuar rrethanat, por personi i cili vuan dënimin me “qëndrim në shtëpi” nuk respekton detyrimet e vendosura nga gjykata. Shërbimi verifikon faktet dhe rrethanat dhe më pas sipas parashikimit ligjor i raporton prokurorit, ku sipas rastit i propozon atij kërkesën për ndryshimin e detyrimit.

Ligji në këtë pjesë të dispozitës i jep të drejtën edhe Shërbimit të Provës për të propozuar për ndryshimin e detyrimit, ndërkohë që këtë detyrim nuk e ka të drejtë ta ndryshojë prokurori, i cili informohet nga Shërbimi i Provës. Jo vetëm kaq, por ka dy shkolla mendimi në lidhje me këtë moment.

Përkrahësit e njëres ide mendojnë se detyrimet e dhëna nga gjykata nuk mund të ndryshojnë gjatë periudhës që personi po vuan dënimin në shtëpi. Përkrahësit e idesë tjetër mendojnë se kur janë rastet e parashikimeve në dispozitën e sipërcituar, prokurori mund t'i drejtohet gjykatës mbi bazën e informacionit të marrë nga Shërbimi i Provës duke kërkuar ndryshimin e detyrimit.

Edhe Rregullorja e Shërbimit të Provës në kreun IX, në nenet 45 – 47 të saj, përcakton mënyrën dhe procedurat e mbikëqyrjes të të dënuarve, për të cilët gjykata ka vendosur “qëndrimin në shtëpi”. Edhe në këto raste, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për çdo të dënuar që vuan “qëndrimin në shtëpi”. Në funksion të mbikëqyrjes, Shërbimi i Provës kontakton institucionet lokale apo çdo lloj organi ose enti privat dhe publik, të cilët mund të asistojnë në ekzekutimin e dënimit me “qëndrim në shtëpi”, duke lidhur dhe marrëveshje për këtë qëllim.

Shërbimi i Provës harton një program duke mbikëqyrur mënyrën e respektimit nga i dënuari të plotësisht të nevojave të domosdoshme familjare të lejuara nga gjykata. Në rast se Shërbimi i Provës si organ mbikëqyrës konstaton se nuk ekzistojnë kushtet për të cilat gjykata ka caktuar masën alternative, ai i raporton menjëherë prokuror me qëllim që ky i fundit t'i drejtohet gjykatës për revokimin e masës alternative dhe zëvendësimin e saj me një tjetër. Raporti i Shërbimit të Provës, përveç se duhet të jetë informues në këtë rast, duhet të përmbajë dhe një propozim konkret për dënimin zëvendësues.

Të njëjtin raportim Shërbimi i Provës e bën dhe në rastet kur i dënuari nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga dënimin me “qëndrim në shtëpi”. Më pas është prokurori, i cili zbaton të gjitha procedurat dhe detyrimet e nenit 62 të Kodit Penal.

Situata është e ndryshme në rastin kur Shërbimi i Provës çmon se mospërmbushja e detyrimeve të të dënuarit ka ardhur si rezultat i pamundësisë objektive. Në të tilla raste, ky shërbim, duke qene organi që monitoron përmbushjen e këtyre detyrimeve, i propozon prokurorit ndryshimin e këtyre detyrimeve në përputhje me mundësitë konkrete dhe nevojat e vetë të dënuarit.

Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ “punë në interes publik”, parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal

Ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, parashikon në nenet 31–31/3 mënyrën e ekzekutimit të një vendimi penal me punë në interes publik.

Fillimisht gjykata, pasi vendos ndaj një personi të dënuar, me pëlqimin e këtij personi, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, ia dërgon menjëherë për ekzekutim një kopje të vendimit prokurorit, i cili merret me ekzekutimin e dënimit.

Nga ana tjetër, pasi vihet në dijeni për një dënim të tillë alternativ, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program për kryerjen e punës në interes publik. Në hartimin e këtij programi, Shërbimi i Provës bazohet në aftësitë e personit si dhe në formimin profesional të personit të dënuar me këtë dënim alternativ.

Në lidhje me këtë moment ka dy praktika gjyqësore. Ka gjyqtarë të cilët duke e konsideruar një detyrim të përcaktuar në ligj, nuk e shprehin në dispozitivin e vendimit këtë urdhërim, duke e çmuar se kjo do përbënte thjesht si një përsëritje të një detyrimi ligjor. Nga ana tjetër, ka një praktikë tjetër gjyqësore ku gjyqtarët përcaktojnë në mënyrë të shprehur këtë urdhërim ligjor, duke e bërë atë pjesë të vendimit. Një veprim i tillë është në unitet me faktin që është Shërbimi i Provës organi i cili mbikëqyr të dënuarin që kryen një punë në interes publik. Në funksion të mbikëqyrjes është ky Shërbim, organ i cili i raporton menjëherë prokurorit kur personi i dënuar shkel kushtet e dënimit.

Nga ana tjetër, Shërbimi i Provës vihet në dijeni menjëherë nga subjekti pranë të cilit kryhet puna në interes publik kur i dënuari nuk e kryen punën në mënyrë të rregullt. Ligjvënësi ka parashikuar rastet që konsiderohen moskryerje në mënyrë të rregullt të punës:

- paraqitja me vonesë duhet të jetë e përsëritur, pasi nuk do kishte logjikë të konsiderohej moskryerje e rregullt e punës paraqitja me vonesë e të dënuarit vetëm në një rast sporadik.
- mosrespektimi p.sh., i rregullave të sigurimit teknik.
- mosrespektimi i rregullave që kanë të bëjnë me etikën, disiplinën në punë etj.
- raste kur personi i dënuar nuk kryen normën e lejuar të punës, nuk e kryen në sasinë e duhur apo me cilësinë e duhur, etj.

Neni 31/3 i këtij ligji përcakton si risi pezullimin e vendimit për punë në interes publik. Sipas kësaj dispozite tre janë rastet kur gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me punë në interes publik. Ato janë:

- a) për shkak të sëmundjes së papritur të personit të dënuar, për të cilën është i nevojshëm trajtimi mjekësor dhe e pengon atë të kryejë punën;
- b) për shkak të vdekjes së një anëtarit të familjes, si pasojë e së cilës personi i dënuar duhet të veprojë si kujdestar për anëtarët e tjerë të familjes dhe e pengon atë në kryerjen e punës;
- c) për shkak të rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë praninë e vazhdueshme të të dënuarit dhe e pengojnë atë të kryejë punën.

Mënyra se si është formuluar dispozita rezulton se gjykata duhet në çdo rast të vendosë pezullimin e vendimit për punë në interes publik, çka nuk përputhet me vetë rolin dhe pozicionin që ka vetë gjykata në gjykime. Duke qenë një dispozitë e parashikuar rishtazi në ligj, ajo ende nuk është shoqëruar me një praktikë gjyqësore në këtë drejtim.

Përveç këtyre dispozitave ligjore edhe Rregullorja e Shërbimit të Provës, e dalë në bazë dhe për zbatim të detyrimeve ligjore, parashikon në Kreun X të saj, në nenet 48 – 55, një grup dispozitash në lidhje me mënyrën dhe procedurat e mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit të Provës së të dënuarve për të cilët gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim në detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik. Sipas nenit 48 të Rregullores, i cili në përmbajtjen e vet është në unitet me nenin 63 të Kodit Penal, është pikërisht Shërbimi i Provës organi i cili vendos.

Nëse gjykata ka vendosur kryerjen e punës në favor të interesit të një shoqate, Shërbimi i Provës në këtë rast ka autoritetin të përcaktojë llojin e punës, ditët e punës, si dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo. Në përcaktimin e këtyre elementeve Shërbimi i Provës ka autoritetin të vlerësojë objektivist një sërë rrethanash.

Nga ana tjetër, Shërbimi i Provës, kur përcakton vendin ku do të kryhet puna në interes publik, merr në konsideratë dhe vendbanimin e të dënuarit. Nëse konstaton se në këtë vendbanim nuk ka një institucion të përshatshëm për kryerjen e punës në interes publik, Shërbimi i Provës cakton një institucion tjetër, i së njëjtës natyre, i cili ndodhet në rrethin më të afërt me vendbanimin e të dënuarit.

Menjëherë pas përcaktimit të institucionit ku do të kryhet puna, Shërbimi i Provës harton për të dënuarin një program individual për kryerjen e punës në interes publik.

Për të analizuar elementë të tillë, Shërbimi i Provës ka të drejtë që të konsultohet me prindërit, kujdestarin, mbrojtësin e tij, i cili mund të jetë ai i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nga gjykata, ose persona të tjerë të kërkuar nga i mituri, të cilët mund të jenë të afërm ose jo të familjes.

Lidhja e marrëveshjeve bëhet në funksion të realizimit të programit, duke e përcaktuar si pjesë të marrëveshjes dhe këtë program. Ajo mund të përcaktojë gjithashtu personin përgjegjës të caktuar nga subjektet për të mbikëqyrur realizimin e punës nga i dënuari, si dhe detyrimin e subjekteve për të njoftuar menjëherë Shërbimin e Provës në rast se i dënuari nuk përmbush detyrimet. Po kështu, Shërbimi i Provës ka detyrimin që t'i shpjegojë personit përgjegjës që është caktuar nga subjekti për mbikëqyrjen që të evidentojë orët e punës, si dhe për të informuar rregullisht Shërbimin e Provës mbi nivelin e performancës në punë të të dënuarit.

Nëse ky Shërbim njoftohet nga subjekti pranë të cilit kryhet puna, për mospërmbushje të detyrimeve nga i dënuari, atëherë Shërbimi kryen dy detyra kryesore në këto raste.

- Së pari, verifikon nëse i dënuari po kryen punën, dhe
- Së dyti: i raporton në mënyrë të menjëhershme prokurorit.

Terminologjia e përdorur pothuaj në të gjitha dispozitat “raporton në mënyrë të menjëhershme”, presupozon faktin se ky raportim duhet bërë në kohën më të parë të mundshme nga Shërbimi i Provës tek prokurori.

Në rastet kur i dënuari i ka paraqitur prokurorit një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me punë në interes publik, ky i dënuar ka gjithashtu detyrimin që të njëjtën kërkesë t'ia paraqesë dhe Shërbimit të Provës. Kjo bëhet me qëllim që Shërbimi i Provës të informojë personin përgjegjës të caktuar me mbikëqyrjen e punës. Ajo që konstatohet në këtë pjesë është fakti se dispozitat e rregullores që parashikojnë mbikëqyrjen e personit që kryen një punë në interes publik, parashikojnë caktimin e një personi përgjegjës ose personi të caktuar nga subjekti ku i dënuari kryen punën, me qëllim që jo vetëm të mbikëqyrë në detaje punën, por edhe të jetë në rolin e një ndërmjetësi midis të dënuarit që kryen punë në interes publik dhe vetë Shërbimit të Provës.

Nëse i dënuari gjatë gjithë kohës së caktuar për kryerjen e punës në interes publik ose në interes të një shoqate, përmbush të gjitha detyrimet e caktuara, vetë subjekti pranë të cilit është kryer puna, në përfundim të kohës së punës pajis të dënuarin me një vërtetim mbi orët e punës dhe datat e kryerjes së saj. Ajo që konstatohet në lidhje me këtë moment është arsyeja përse kërkohet një vërtetim i tillë. Nisur nga interpretimi logjik i dispozitës (neni 55 i Rregullores) rezulton se një vërtetim i tillë mund t'i shërbejë të dënuarit për ta bërë pjesë të dosjes së tij të ekzekutimit të vendimit penal që mbahet nga prokurori, por edhe të mbikëqyrjes, me qëllim që i dënuari më pas të quhet i padënuar për efekt të gjendjes gjyqësore.

Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të “lirimit me kusht”, parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal

Për sa i përket mënyrës së mbikëqyrjes së dënimit alternativ të “lirimit me kusht”, i parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’”, në nenin 31/6 të tij parashikon shprehimisht se:

“I dënuari me burgim, në përputhje me nenin 64 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Kërkesa shqyrtohet nga një gjyqtar, i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin e dënimit me burgim.

Pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të. Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës...”

Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit.

Kur gjykata vendos lirimin me kusht të personit të dënuar, ia dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor, ku do të jetojë i dënuari pas lirimit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal.

Personi i liruar me kusht duhet t'i raportoje rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirimit me kusht.

Kur personi i liruar me kusht synon të ndryshojë vendbanimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht shërbimin e provës dhe organet vendore të Policisë së Shtetit, duke dhënë motivet përkatëse.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe ato të Policisë së Shtetit.

Shërbimi i provës mund t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht, kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato”.

Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite rezulton se gjykata kompetente për gjykimin e kërkesave të tilla është gjykata e vendit ku i dënuari po vuan dënimin, parashikim i cili është në unitet të plotë me nenin 477 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana tjetër, me qëllim mosparagjykimin e vendimmarrjes gjyqësore, në rastet kur është e njëjta gjykatë, si ajo që ka dhënë vendimin dhe ajo e vendit ku ekzekutohet dënimi i dhënë, ligjvënësi ka ndaluar që të dyja këto gjykime t'i zhvillojë i njëjti gjyqtar. Praktika gjyqësore në këtë drejtim është e konsoliduar. Ka pasur mjaft raste në praktikën gjyqësore ku gjyqtarë të ndryshëm të cilët kanë qenë në trupin gjykues që kanë

dhënë vendimin e dënimit, u ka rënë me anë të shortit gjykimi i kërkesës së të njëjtit shtetas, me objekt lirim me kusht. Në këtë rast, ata kanë dhënë dorëheqjen, dorëheqje të cilat janë pranuar nga titullarët e gjykatës.

Ligjvënësi ka parashikuar në dispozitë se pasi i dënuari paraqet në gjykatë një kërkesë për “lirim me kusht”, drejtori i institucionit përveç detyrimit për paraqitjen në gjykatë të një kopje të dosjes personale të të dënuarit, ka dhe detyrimin për paraqitjen e një raporti përmbledhës.

Praktika gjyqësore e deritanishme në lidhje me këtë moment ka treguar se në të gjitha gjykimet me objekt “lirim me kusht”, gjykatat kanë administruar si provë edhe raportin e drejtorit të I.E.V.P.-së. Ajo që konstatohet është fakti se ky raport paraqitet në mënyrë të përmbledhur për të gjitha kërkesat ligjore të sipërcituara, në një formular standard, duke vënë kryqe në lidhje me opsionet e paraqitura në raport. Ajo çka përbën një shqetësim nga qarqet e praktikienëve të së drejtës është pikërisht fakti se këto raporte duhet të jenë për çdo rast në mënyrë të detajuar dhe jo në formularë standarde, me qëllim që të krijohet një tablo sa më e saktë në lidhje me të gjitha elementet ligjore të kërkuara.

Tek shqyrtimi i kërkesave të tilla, Shërbimi i Provës është gjithmonë prezent, duke paraqitur dhe raportin përkatës për këtë qëllim. Ajo që konstatohet është fakti se raportet nuk përmbajnë planet konkrete në lidhje me punësimin e personit që kërkohet të lirohet me kusht, i cili do mundësojë riintegrimin e tij të plotë në shoqëri. Kjo vjen si rezultat i mungesave të marrëveshjeve me subjekte të ndryshme për këtë qëllim. Për të krijuar një tablo sa më të qartë në lidhje me këtë moment po paraqesim në mënyrë të përmbledhur një përmbajtje të një raport shërbimi të zgjedhur në mënyrë rastësore, i cili përmban:

- Pjesën hyrëse që përmban të dhëna për të dënuarin, për vendimin e dënimit, periudhën e dënimit të vuajtur, qëllimin e raportit, datën e raportit dhe emrin e specialistit të Shërbimit të Provës që ka përgatitur raportin.
- Përcaktimi i burimeve të informacionit të përdorura për hartimin e raportit ku përfshihet i gjithë dokumentacioni i ndodhur në dosjen gjyqësore si dhe dy intervistat e kryera nga specialisti i Shërbimit të Provës.
- Pjesën përshkuese dhe analizuese të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, ku përfshihet vepra për të cilën është deklaruar fajtor i dënuari, masa e dënimit, ecuria e çështjes, nëse është ushtruar ankimi, I.E.V.P.-ja ku vuan dënimin i dënuari, dhe treguesit e sjelljes.
- Pjesën analizuese dhe vlerësimin e rrezikut, ku analizohen në mënyrë të detajuar se çfarë rreziku/rreziqesh ka nëse i dënuari lirohet me kusht. Çfarë faktorësh apo arsyesh e bëjnë që një kërkesë e tillë të jetë e përligjur, nëse ka të tilla, etj.
- Pjesën e konkluzioneve dhe të rekomandimeve. Në këtë pjesë specialisti i Shërbimit të Provës, në mënyrë të përmbledhur, paraqet se sa dënim i ka mbetur të dënuarit, dhe se me dënimin e vuajtur a i është arritur qëllimit për edukimin e tij dhe riintegrimin e tij, çfarë arsyesh të veçanta ka paraqitur, a ka treguar interes për të bashkëpunuar me Shërbimin e Provës me qëllim që të përballojë vështirësitë që mund të hasë në integrimin social të tij, planet e punësimit, nëse ka të tilla dhe nëse Shërbimi i Provës e shikon të mundshme llojin e këtij dënimi alternativ ose jo. Gjithsesi një parashikim i tillë ka karakter sugjerues, pasi në çdo rast është gjykata organi i cili në bazë të analizës së provave ka të drejtë të vendosë nëse i dënuari duhet ose jo të lirohet me kusht.

Pasi gjykata liron me kusht një të dënuar, ajo ka detyrimin që një kopje të vendimit t'ia dërgojë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku do jetojë i dënuari pas lirimit me kusht, si dhe një kopje tjetër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimit Penal.

Nga ana tjetër, personi i cili është liruar me kusht, ka detyrimin t'i raportojë rregullisht Shërbimit të Provës gjatë gjithë kohës së kushtit. Në këtë kuptim, kur personi i liruar me kusht, synon të ndryshojë vendbanimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht duke dhënë dhe motivet përkatëse, Shërbimin e Provës dhe organet vendore të Policisë së Shtetit.

Shërbimi i Provës pas dhënies së vendimit të lirimit me kusht ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ekzekutimin e një vendimi të tillë penal. Në këtë prizëm, nëse Shërbimi i Provës e konsideron të nevojshme, mund të bashkëpunojë me organet e pushtetit vendor, si dhe me ato të policisë së shtetit. Nëse personi i liruar me kusht ka vështirësi objektive në përmbushjen e një ose disa detyrimeve, duke mos qenë në gjendje t'i përmbushë ato, është përsëri Shërbimi i Provës i cili ka të drejtë që t'i drejtohet prokurorit, duke i kërkuar dhe ndryshimin e një ose disa nga këto detyrimeve të personit të liruar me kusht.

Nga ana tjetër, Rregullorja e Shërbimit të Provës, në kreun XI, parashikon rregulla mbi mënyrën e mbikëqyrjes së të dënuarve, për të cilët gjykata ka vendosur "lirimin me kusht", të përcaktuara në nenet 56–59 të kësaj Rregulloreje. Sipas këtyre dispozitave, Shërbimi i Provës ka detyrimin që të hartojë dhe zhvillojë një program i cili duhet të jetë individual me qëllim ekzekutimin e vendimit të "lirimit me kusht". Në kuadrin e mbikëqyrjes së ekzekutimit të një vendimi penal të kësaj natyre, Shërbimi i Provës sa herë që e çmon të nevojshme, ka tagrin që të bashkëpunojë me organet e pushtetit vendor, si dhe me Policinë e Shtetit. Ky Shërbim njëherazi ka detyrimin që të informojë personin e dënuar në lidhje me detyrimin ligjor që ka ky person për të raportuar rregullisht pranë këtij Shërbimi lidhur me kryerjen e dënimit.

Pasi njoftohet paraprakisht mbi ndryshimin e vendbanimit dhe mbi arsyet e këtij ndryshimi, Shërbimi i Provës ka detyrimin që të njoftojë menjëherë prokurorin, si dhe Shërbimin e Provës në juridiksionin e së cilit përfshihet banesa e të liruarit me kusht. Dispozita nuk përcakton se cilin prokuror duhet të njoftojë Shërbimi i Provës, por nga kuptimi teologjik i saj rezulton që është prokurori i cili ka ekzekutuar këtë vendim penal dhe jo prokurori i vendit ku ka adresën e re të banimit i liruarit me kusht.

Ashtu si tek ligji, neni 31/6, dhe Rregullorja në nenin 59 të saj, përcakton procedurën që duhet të ndjekë Shërbimi i Provës në rastin kur i dënuari nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet që rridhnin nga lirimi me kusht. Në këto raste, Shërbimi i Provës duhet të konkludojë nëse kjo mospërmbushje kishte ardhur për shkaqe objektive ose subjektive.

Dispozita e ligjit jep një pasqyrim më të saktë se sa dispozita e Rregullores që rregullon këtë moment. Kjo pasi edhe pse Rregullorja nuk e parashikon se sa detyrime duhet të mospërmbushë personi i liruar me kusht për t'u ndodhur përpara këtij rasti, këtë e përcakton ligji. Konstatohet gjithashtu se nuk parashikohet më pas se si vepron prokurori në ndryshimin e këtyre detyrimeve. Referuar logjikës juridike, prokurori duhet që në raste të tilla të drejtohet tek organi që ka vendosur këto detyrime, dhe më pas po ky organ ai që ka të drejtë që të ndryshojë këto detyrime.

Praktika gjyqësore në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të tilla është ende e pakonsoliduar, çka përbën një tendencë të së ardhmes në këtë zhvillim që ka sot aplikimi i dënimeve alternative.

Mënyra se si ekzekutohet dhe mbikëqyret një dënim alternativ përcaktohet nga neni 31/9 i ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’”.

Në përmbajtjen e saj kjo dispozitë parashikon se:

“Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, ia dërgon menjëherë vendimin prokurorit, për ekzekutimin e dënimit alternativ. Në qoftë se personi i dënuar është i burgosur, gjykata ia dërgon një kopje të vendimit edhe institucionit të ekzekutimeve të vendimeve penale, ku mbahet i dënuari, për lirimin e tij.

Në ekzekutimin e dënimit alternativ, shërbimi i provës mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, asiston dhe këshillon të dënuarin në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe jep ndihmë në integrimin social të tij. Me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit, shërbimi i provës përgatit një raport për zbatimin e vendimit të gjykatës dhe të programit të mbikëqyrjes. Kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, shërbimi i provës paraqet raport para prokurorit, i cili përmban informacion për rrethanat e shkeljes, shpjegimet e dhëna nga i dënuari, vlerësimin e punonjësit të shërbimit të provës dhe propozimin, së bashku me arsyet përkatëse, për të caktuar detyrime shtesë, për të zgatur afatin e mbikëqyrjes apo për të ndryshuar kushtet e detyrimet për ekzekutimin e dënimit”.

Sipas kësaj dispozite nëse gjykata vendos aplikimin e një dënimi alternativ, një kopje të vendimit ia dërgon prokurorit dhe në rast se personi i dënuar është i burgosur, një kopje tjetër të këtij vendimi ia dërgon I.E.V.P.-së ku mbahet i dënuari.

Ligjvënësi në të njëjtën dispozitë, neni 31/9 i ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’”, ka parashikuar dhe rolin e Shërbimit të Provës kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata. Në këto raste Shërbimi i Provës ka detyrimin që të paraqesë para prokurorit një raport i cili duhet të përmbajë propozimi që punonjësi i Shërbimit të Provës mund të japë në këto raste.

Ajo çka mund të shtrohet për diskutim në lidhje me këtë moment është fakti nëse prokuroria duhet të respektojë apo jo në çdo rast propozimin e Shërbimit të Provës. Juristët ndajnë dy mendime në këtë drejtim. Një grup juristësh mbështesin idenë se prokurori në kërkesën drejtuar gjykatës në të tilla raste nuk është i ndërvarur nga propozimi i Shërbimit të Provës, pasi ai është i pavarur në llojin e kërimit. Nga ana tjetër ekziston dhe një grup tjetër juristësh që mbështesin idenë se prokurori duhet që të kërkojë në gjykatë propozimin që ka bërë Shërbimi i Provës. Kjo pasi është ky Shërbim i cili ndjek nga afër duke mbikëqyrur ekzekutimin e dënimit alternativ, duke njohur dhe problematiken e vetë çështjes. Prokurori në këto raste është vetëm subjekti procedural që i jep formën ligjore kërkesës në gjykatë, pasi vetëm ai mund të legjitimohet si subjekt në gjykim dhe jo Shërbimi i Provës.

Ligjvënësi në nenin 31/10 të ligjit parashikon procedurën që ndiqet për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit që ka të bëjë me shkeljen nga i dënuari të kushteve të dënimit alternativ apo mospërbushjes së detyrimit të dhënë. Sipas kësaj dispozitë, gjykimi në këto raste bëhet i zakonshëm duke respektuar gjitha rregullat procedurale të vendosura për këtë qëllim, përfshirë dhe ato që kanë të bëjnë me ankimet. Kërkesa e prokurorit shqyrtohet nga gjykata brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe se gjatë periudhës së shqyrtimit gjykata ka të drejtë në varësi të rrethanave të pezullojë ekzekutimin e dënimit alternativ dhe të urdhërojë që personi i dënuar të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale.

Në përfundim të shqyrtimit të një kërkesë të tillë gjykata në varësi të mënyrës së shkallës së mospërbushjes së detyrimeve nga i dënuari, mund të vendosë në disa mënyra. Në te gjitha rastet, nëse gjykata jep dënimin me burgim kjo do të thotë që çdo dënim tjetër alternativ është i papërshtatshëm.

Ligjvënësi ka rregulluar gjithashtu me parashikimet ligjore edhe procedurën që duhet të kryejë Shërbimi i Provës në rast se i dënuari kryen dënimin alternativ apo përbush detyrimin e dhënë. Kështu, sipas parashikimit ligjor të nenit 31/11 të ligjit, Shërbimi i Provës në këto raste ka detyrimin që të paraqesë para prokurorit raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Më pas është prokurori i cili ka detyrimin që të nxjerrë një vendim të veçantë për kryerjen e dënimit alternativ, vendim i cili bëhet pjesë e akteve të dosjes së ekzekutimit të vendimit që disponon prokurori, pse jo dhe e dosjes së mbikëqyrjes së ekzekutimit që disponon shërbimi i provës.

Kjo dispozitë (neni 31/11 i ligjit) ka parashikuar se gjykata ka të drejtë që mbi bazën e kërkimit të prokurorit të vendosë përfundimin para afatit të dënimit alternativ. Në kërkesën e tij drejtuar gjykatës në të tilla raste, prokurori vërteton se i dënuari ka kryer të gjitha detyrimet dhe vlerësohet se nuk është më e nevojshme për t'i zbatuar më tej ato, për të arritur qëllimin e dënimit alternativ.

Ligji parashikon gjithashtu se një kërkesë e tillë paraqitet nga prokurori në gjykatë pasi plotësohen dy kritere ligjore:

- Së pari: I dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore të dënimit alternativ, dhe
- Së dyti: I dënuari nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, rendin publik apo palët e treta.

Praktika gjyqësore në lidhje me ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, apo përfundimin para afatit të dënimit alternativ nuk është e konsoliduar. Ajo përbën aktualisht një prirje që i takon së ardhmes duke pasur parasysh faktin e zhvillimeve të reja që po pësojnë në praktikën gjyqësore shqiptare aplikimi i dënimeve alternative.

6. Shërbimi i provës në Kosovë

Shërbimi Korrektues i Kosovës (më tej: Shërbimi Korrektues) është organ qendror i administratës shtetërore, profesional i pavarur, i uniformuar me grada dhe pjesërisht i armatosur në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë (më tej: Ministria). Shërbimi Korrektues është përgjegjës për kryerjen e këtyre punëve:

- organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe me burgim të përjetëshëm;
- organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese, përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe;
- organizimin e programeve që i kontribuojnë korrektimit, përgatitjes për lirim dhe mbikëqyrjes afatgjatë të personave të dënuar me burgim dhe me burgim të përjetëshëm;
- Vlerësimin e rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryerësve të veprave penale;
- udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;
- ndërmarrjen e masave me qëllim të arsimimit dhe aftësimin profesional të personelit civil dhe të zyrtarëve korrektues të punësuar;
- për realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, shoqatat dhe organizatat të cilat merren me problemet e ekzekutimit të sanksioneve penale.

Shërbimi korrektues ka statusin e personit juridik. Shërbimi Korrektues ka shenjën e vet identifikuese dhe ka selinë në Prishtinë.

Për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetenca e Shërbimit Korrektues themelohen këto njësi themelore organizative:

- Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues me seli në Prishtinë; dhe
- institucionet korrektuese.

Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Shërbimit Korrektues, dhe i institucioneve korrektuese rregullohet me akt të veçantë, të cilin e miraton Ministri, dhe që përfshihet si kre i veçantë në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë.

Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues, e përcjell, e mbikëqyr ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njësisve organizative të Shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese. Në Zyrën Qendrore të Shërbimit Korrektues, themelohen drejtoritë dhe sektoret. Me drejtorinë udhëheqin, udhëheqësit të cilët emrohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues njëherit është edhe udhëheqës i Zyrës Qendrore të Shërbimit Korrektues.

Në Shërbimin Korrektues ekzistojnë këto lloje të institucioneve korrektuese:

- burgjet, për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetëshëm;

- qendrat e paraburgimit, për ekzekutimin e paraburgimit dhe dënimeve me burgim deri në tre (3) muaj;
- burgjet për femra, për ekzekutimin e dënimit me burgim, burgimit për të mitur të shqiptuar ndaj femrave;
- burgjet për të mitur, për ekzekutimin e burgimit të të miturve;
- institucionet edukative-korrektuese, për ekzekutimin e masave edukative të dërgimit të kryerësit të mitur në institucionin edukativo-korrektues;
- spitali dhe ambulancat e burgjeve, për trajtimin e personave të paraburgosur dhe personave të dënuar.

Në bazë të shkallës së sigurisë dhe mënyrës së trajtimit të personave të dënuar, institucionet korrektuese mund të jenë të tipit të mbyllur, gjysmë të hapur dhe të hapur. Institucionet korrektuese të tipit të mbyllur kanë elemente të sigurisë fizike dhe materiale, siç janë zyrtaret korrektues të armatosur, muret rrethuese apo rrethoja, pajimet teknike dhe masat tjera të sigurisë që pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Në kuadër të tipit të mbyllur bënë pjesë edhe burgu i sigurisë së lartë, për ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj personave të klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë, personave të paraburgosur të klasifikuar me rrezikshmëri shumë të lartë dhe atyre të dënuar me burgim të përjetshëm. Institucionet korrektuese të tipit gjysmë të hapur nuk kanë elemente të sigurisë fizike në formë të mbikëqyrjes së lëvizjeve dhe punës së personit të dënuar, por kanë elemente të sigurisë materiale që e pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Institucionet korrektuese të tipit të hapur nuk kanë elemente të sigurisë fizike as materiale që e pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Sjellja ndaj personave të dënuar bazohet në vetë disiplinën e tyre dhe përgjegjësinë personale, kurse personeli korrektues mbikëqyrë lëvizjen dhe punën e personave të dënuar. Në institucionet korrektuese të tipit të mbyllur mbahet së paku një e treta (1/3) e dënimit me burgim të përjetshëm.

Në institucionet korrektuese themelohen një apo më shumë njësi ekonomike për punë të personave të dënuar. Njësia ekonomike themelohet me vendim të Ministrisë së Drejtësisë Njësia ekonomike ka statusin e personit juridik dhe në qarkullim paraqitet në emrin e vet dhe për llogari të tijë. Njësia ekonomike krijon të hyra të dedikuara për nevoja të Shërbimit Korrektues.

Me Shërbimin Korrektues udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues (më tej: Drejtori i Përgjithshëm). Drejtori i Përgjithshëm emërohet në bazë të konkursit të hapur nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dipozitat për Shërbimin Civil për emërimin, për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga profesionist përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimi Korrektues, gjyqëtar i Gjykatës së Apelit, prokuror i shtetit dhe profesor i fakultetit të drejtësisë i drejtimit penal juridik.

Drejtori i Përgjithshëm udhëheqë, drejton dhe kontrollon Shërbimin Korrektues dhe të gjitha çështjet lidhur me Shërbimin Korrektues. Drejtori i Përgjithshëm zgjidhet për periudhë kohore pesë (5) vjeçare, e me mundësi rizgjedhje.

Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen me konkurs të hapur nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dipozitat për Shërbimin Civil, për emërimin, për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen

përshtatshmërisht me dispozitat për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm. 3. Drejtorët e institucioneve korrektuese emërohen për periudhë kohore pesë (5) vjeçare me mundësi vazhdimi.

Në institucionet korrektuese, varësisht nga madhësia dhe nga përmbajtja e punëve të institucionit korrektues mund të themelohen drejtorate dhe sektore. Drejtoritë mundën me qenë: për sigurim, trajtim dhe administrative. Në kuadër të shërbimeve mund të organizohen edhe sektore, pavijone apo struktura tjera të veçanta. Me aktin nënligjor për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Shërbimit Korrektues përcaktohet organizimi i brendshëm, pozitat dhe vendet e punës në institucionet korrektuese.

Personelin e Shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese e përbëjnë nëpunësit civil në pajtim me dispozitat për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe zyrtarët korrektues të shërbimit Korrektues dhe të institucioneve korrektuese në pajtim me këtë ligj. Marrëdhënia e punës për zyrtarët korrektues rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri. Shërbimi Korrektues e harton ndërsa Ministri miraton Kodin e Etikës Profesionale për zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues.

Zyrtarët korrektues i emëron dhe shkarkon Drejtori i Përgjithshëm në bazë të konkursit publik dhe në pajtim me këtë ligj. Personat të cilët themelojnë marrëdhënie pune si zyrtar korrektues në Shërbimin Korrektues në punët e drejtorateve të sigurimit, në punët e trajtimit si edukues dhe në punët e instruktorit, duhet t'i plotësojnë edhe aftësitë shëndetësore dhe psikofizike të nevojshme për kryerjen e atyre punëve. Zyrtarët korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave.

Me vendimin e Drejtorit të institucionit korrektues, në interes të shërbimit, sipas nevojës së krijuar, personi i punësuar është i detyruar të punojë edhe më gjatë se koha e punës së plotë, dhe mund t'i ndërpritet apo t'i shtyhet shfrytëzimi i pushimit vjetor.

Për të punësuarit si zyrtar korrektues në institucionet korrektuese të cilët punojnë në punët e ekzekutimit të sanksioneve penale, është i detyrueshëm arsimimi dhe aftësimi profesional permanent në pajtim me planin dhe programin e trajnimit të arsimimit dhe aftësimi profesional. . Për arsimimin dhe aftësimin profesional të punësuarve, shërbimi korrektues mundet në mënyrë të pavarur, apo nëpërmjet të organizatës profesionale vendore, apo të jashtme, me projekte të organizojë seminare, këshillime dhe forma tjera të aftësimi profesional.

Vërtetimi i aftësive shëndetësore dhe psikofizike të punësuarve si zyrtar korrektues të cilët punojnë në punët e sigurimit kryhet njëherë gjatë dy (2) viteve, ndërsa sipas nevojës së paraparë mund të dërgohen edhe në periudhat më të shkurta kohore, për çka vendosë drejtori i përgjithshëm. Vërtetimi i aftësive shëndetësore të punësuarve të cilët punojnë në punët e tjera për të cilat stazhi i punës llogaritet në kohëzgjatje të rritur, kryhet një herë në tre vjet, ndërsa sipas nevojës së paraqitur mund të dërgohen edhe në periudhat kohore më të shkurta, për çka vendosë drejtori i institucionit korrektues.

Shërbimi Sprovues është organ qendror i administratës shtetërore në vartësi të Ministrisë. Shërbimi Sprovues është përgjegjës për kryerjen e punëve lidhur me:

- organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të riintegritit shqëror të personave të dënuar (punët sprovuese);
- përgatitjen e anketës sociale dhe raportet parandëshkuese për kryerësit e veprave penale;
- vlerësimin e rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryesve të veprave penale;
- Ekzekutimin e masave të diversitetit dhe masave edukative për të mitur;
- mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimeve alternative;
- mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj kryerësve të varur nga droga, ose alkooli të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues i cili mbahet në liri;
- mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar të liruar me kusht;
- Zhvillimi i programeve individuale të mbikëqyrjes;
- Hartimin e raporteve për ekzekutimin e dënimeve alternative dhe personave të liruar me kusht nga burgu për Prokurorit, Gjykatat dhe Panelin për Lirim me Kusht;
- udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre;
- mbajtjen e evidencave dhe regjistrave për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative në sistemin elektronik për menaxhimin e të dhenave;
- ndonjë detyrë tjetër të përcaktuar nga Ministri.

Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Sprovues në zbatimin e punëve sprovuese bashkëpunon me organet e pushtetit shtetëror, me institucionet shkencore dhe institucionet e tjera, me organet e pushtetit lokal dhe institucionet e tjera, personat juridik dhe shkëmben informata relevante.

Shërbimi Sprovues ka statusin e personit juridik. Shërbimi Sprovues ka shenjën e vet identifikuese dhe ka selinë në Prishtinë. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Shërbimit Sprovues dhe i zyret rajonale sprovuese rregullohet me akt të veçantë të cilin e miraton Ministri. Ky akt përfshihet si kre i veçantë në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë.

Shërbimin Sprovues e udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit sprovues. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues emërohet me konkurs të hapur nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dipozitat për Shërbimin Civil për emërimin për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga profesionist përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Sprovues, Gjykatës së Apelit, Prokurorit të Shtetit dhe Fakultetit të Drejtësisë, drejtimi penalo juridik. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues emërohet për periudhë kohore pesë (5) vjeçare e me mundësi rizgjedhje. Për punën e tij Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues i përgjigjet drejtpërdrejtë Ministrit. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues udhëheqë, drejton dhe kontrollon Shërbimin Sprovues dhe të gjitha çështjet lidhur me Shërbimin Sprovues.

Për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetenca e Shërbimit Sprovues themelohen këto njësi themelore organizative:

- Zyra Qëndrore e Shërbimit Sprovues me seli në Prishtinë; dhe
- Zyret rajonale sprovuese.

Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Shërbimit Sprovues dhe të zyreve rajonale sprovues rregullohet me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Shërbimit Sprovues të cilën e miraton Ministri dhe përfshihet në kre të veçantë të Rregullores së Ministrisë për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë.

Zyra Qendrore e Shërbimit Sprovues e përcjell dhe mbikqyrë ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njësive organizative të Shërbimit Sprovues dhe të zyreve rajonale sprovuese. Në Zyrën Qendrore të Shërbimit Sprovues, themelohen drejtoritë dhe sektoret. Me drejtorinë udhëheqin udhëheqësit, të cilët emrohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues njëherit është edhe udhëheqës i Zyrës Qendrore të Shërbimit Sprovues.

Zyret regjionale sprovuese, të cilët kryejnë punët sprovuese në kuadër të përgjegjësive të Shërbimit Sprovues, themelohen me vendim të ministrit për territorin e gjykatave themelore. Zyrën rajonale sprovuese e udhëheqë udhëheqësi i zyrës i cili emërohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues me konkurs të hapur në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil.

Personeli i shërbimit Sprovues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave.

Mbikëqyrjen administrative të punës së institucioneve korrektuese e kryen Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në pajtim me dispozitat ligjore. Në zbatimin e mbikëqyrjes administrative, mbikëqyret në veçanti ligjshmëria e punës dhe e veprimit, ligjshmëria e akteve nga kompetenca e drejtorit të institucionit korrektues, efikasiteti dhe përshtatshmëria e punës në kryerjen e punëve nga fushëveprimi i institucioneve korrektuese. Mbikëqyrjen lidhur me ofrimin e mbrojtjes shëndetësore të personave të burgosur e kryen ministria e kompetente për punët e shëndetësisë, ndërsa ndaj programeve të arsimit të personave të dënuar dhe për zbatimin e tyre ministria kompetente për punët e arsimit.

Me qëllim të përcjelljes, hulumtimit dhe përparimit të sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale do të themelojë këshillin profesional nga radhët e institucioneve shkencore, gjykatave, organeve të administratës, shoqatave profesionale, shoqërisë civile dhe të institucioneve tjera të cilat merren me çështjet e kriminalitetit dhe të edukimit të personave të dënuar.

KONKLUZIONE E REKOMANDIME

1. Dënimet alternative ndaj dënimit me burgim janë pjesë e reformave më të mëdha që u referohen standardeve të trajtimit të të dënuarve me burgim. Keto reforma nuk janë vetëm një kërkesë e Këshillit të Evropës, Komitetit kundër Torturës, por janë edhe nevojë e domosdoshme dhe e vonuar tashmë. Janë tri pika në të cilat kjo reformë ligjore referon. E para është komponenti social, pra, si do të trajtohen dhe konsiderohen të dënuarit – ata nuk do të jenë më si kategoria që duhen të ndëshkohen nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe shoqëria duhet t'i risocializojë. Komponenti i dytë është ai ligjor – ndryshimet bëjnë të mundur që të gjitha këto ndryshime që ofrojnë alternativa të jenë të aplikueshme nga sistemi gjyqësor, prokuroria, si dhe nga ata që do të merrem me ekzekutimin. Komponenti i tretë është një komponent praktik, financiar. Nga të gjitha përlllogaritjet, kostoja që të dënuarit mbahen në burgje shkon deri në 3000 lekë në ditë. Vendosija e këtyre alternativave do të sjellë uljen e kostos, por dhe përfitime të mëdha shoqërore. Gjithashtu, këto ndryshime sjellin lehtësi në zbatimin e ligjit, ulin marzhin e diskrecionit që mund të ketë sistemi i drejtësisë, japin siguri juridike, parashikueshmëri juridike.
2. Do të ishte e kotë të propagandojmë aplikim më të gjerë të alternativave, përderisa nuk kemi infrastrukturën e nevojshme institucionale për të mbikëqyrur ekzekutimin e tyre. Madje, çdo përmirësim legjislativ në funksion të futjes së instituteve të reja do të rezultonte thjesht me një përmirësim legjislativ pa asnjë vlerë në praktikë në qoftë se nuk ngrihet një strukturë e tillë, e cila, përveç mbikëqyrjes së personave ndaj të cilëve janë zbatuar alternativat, do të kujdesej edhe për një trajtim të përshtatshëm të të dënuarve pas daljes nga burgu, në funksion të rehabilitimit dhe të kthimit të tyre në gjirin e shoqërisë.
3. Përkufizimi më i përshtatshëm për dispozitat e Kodit Penal që përcaktohen si “Alternativat e dënimit me burgim”, do të ishte “Alternativat e ekzekutimit të dënimit me burgim”, pasi në të gjitha dispozitat e këtij kreu nuk parashikohen lloje dënimi të tjera, por jepet një mundësi, që disa dënime me burgim të mos ekzekutohen në mënyrën tradicionale, por të ekzekutohen në një mënyrë të ndryshme që do t'i shërbente më mirë qëllimit të dënimit. Në favor të kësaj teze shkon edhe fakti që alternativat zbatohen vetëm në rastin kur jepen dënime me burgim. Është i veçantë për legjislativin shqiptar ky fakt, në një kohë kur në legjislativ të tjera këto alternative aplikohen edhe ndaj dënimeve me gjobë. Megjithatë Kodi Penal nuk e njeh konceptin e sanksioneve penale, mund të themi se alternativat e dënimit me burgim mund të përkufizohen si: “Sanksione penale të vendosura nga shteti, që konsistojnë në vuajtjen e dënimit me burgim në një mënyrë të ndryshme nga sistemi tradicional i qelisë, duke pasur parasysh që për autorë dhe vepra me rrezikshmëri të ulët shoqërore, riedukimi dhe Risocializimi i tyre do të ishte më efektiv në gjirin e bashkësisë.
4. Një çështje e diskutueshme që ka dalë në praktikën gjyqësore është çështja nëse do të aplikohet neni 59 i Kodit Penal edhe për të pandehurit me shtetësi të huaj dhe që kanë vendbanimin e tyre jashtë territorit të Shqipërisë. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, personat e huaj të cilët nuk janë nënshtruar shqiptarë gëzojnë të njëjtat të drejta me shtetasit shqiptarë. Për pasojë, ata duhet të gëzojnë edhe të drejtën për të kërkuar dhe

përfituar nga nenet 58, 59, 59/a, 63 apo 64 të Kodit Penal. Mbikëqyrja e këtyre dënimeve do të realizohet nga Shërbimi i Provës, mbi bazën e përcaktimeve dhe rregulimeve të parashikuara nga Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht”, nga akte të tjera ndërkombëtare dhe neni 60 I VKM nr. 302, datë 25.03.2009.

5. Gjithashtu, është për t’u diskutuar çështja nëse gjykata është e detyruar që të vendosë ndaj të pandehurit një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal në rastet kur vendos aplikimin e nenit 59 të tij. Një mendim është se duke u bazuar edhe në frymën e përgjithshme që përshkon dispozitat aktuale mbi alternativat me burgim si dhe frymën që përcjell ligjbërësi në ndryshimet e fundit të Kodit Penal dhe ligjeve të tjera të cilat parashikojnë dhe rregullojnë ekzekutimin e dënimit me burgim me qëllim riintegrimin social të të dënuarit, në çdo rast gjykata, kur aplikon nenin 59 të Kodit Penal, si rregull, duhet të urdhërojë të pandehurin të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit (varet nga rrethanat e çështjes). Ky përfundim bazohet në paragrafin e dytë të nenit 59 të Kodit Penal. Megjithatë, sikundër do ta theksojmë edhe më poshtë, duke qenë se sistemi ynë është një sistem i përzier me prirje akuzatore, ka edhe raste përjashtimore kur gjykata nuk ka përse të urdhërojë të pandehurin të përmbushë një nga detyrimet e nenit 60 të Kodit Penal. Për shembull, nëse një i pandehur i moshës mbi 70 vjeç deklarohet fajtor dhe dënohet me kusht për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve”, është e vështirë të gjendet një detyrim të përshtatshëm për t’u përmbushur nga ky i pandehur gjatë kohës së provës.
6. Thirrja e Shërbimit të Provës dhe caktimi i detyrës për përgatitjen e raportit nga ky shërbim janë veprime që mund të kryhen nga gjykata në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor, qoftë edhe pas paraqitjes së pretendimeve të fundit nga palët. Një veprim i tillë është në përputhje të plotë me nenet 378/5 dhe 367 të Kodit të Procedurës Penale. Nisur nga formulimi i nenit 59/a arrihet në përfundimin se në qoftë se këto kushte kanë ekzistuar edhe përpara dhënies së vendimit me burgim dhe gjykata nuk ka aplikuar nenin 59/a të Kodit për këtë të pandehur kur ky i fundit apo prokurori e ka kërkuar një dënim të tillë, atëherë ky i pandehur kur merr statusin e të dënuarit nuk mund të përfirojë “qëndrimin në shtëpi” sipas nenit 59/a të Kodit Penal. Pra, nëse i dënuari paraqet një kërkesë për aplikimin ndaj tij të nenit 59/a, gjykata duhet të vendosë rrëzimin e kërkesës. Në praktikë haset edhe një qëndrim tjetër nga ai i shpjeguar më sipër për zbatimin e nenit 59/a të Kodit Penal. Sipas mbështetësve të këtij qëndrimi, rezulton se neni 59/a i Kodit Penal do të aplikohet vetëm në rastet kur gjykata vendos ta deklarojë fajtor të pandehurin dhe ta dënojë atë me burgim deri në dy vjet, ose më shumë se dy vjet por për shkak të vuajtjes së paraburgimit të pandehurit i kanë mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur nga ky dënim i dhënë nga gjykata. Ky qëndrim përjashton aplikimin e nenit 59/a të Kodit Penal për të dënuarit me vendim të formës së prerë, të cilëve u ka mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur dhe që plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara nga neni 59/a i Kodit Penal. Argumenti kryesor ku bazohet ky qëndrim është vendosja e nenit 59/a menjëherë pas nenit 59 të Kodit Penal, pra, një interpretim sistematik i nenit 59/a të Kodit Penal në raport me nenet e tjera që parashikojnë dënimet alternative. Por një qëndrim i tillë është i gabuar dhe bie ndesh me formulimin e nenit 59/a të Kodit Penal. Si përfundim, neni 59/a do të aplikohet edhe për të dënuarit me vendim të formës së prerë,

të cilëve u ka mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur dhe që plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara nga neni 59/a i Kodit Penal.

7. Një çështje tjetër e diskutueshme është ngjashmëria e “qëndrimit në shtëpi” me “lirimin me kusht” e parashikuar nga neni 64 i këtij Kodi. Nisur nga përmbajtja e këtyre dy dispozitave na rezulton se ka ndryshime të mëdha të cilat konsistojnë në: a) Mospërputhjen e masës së dënimit të vuajtur nga përfituesit e “qëndrimit në shtëpi” nga përfituesit e “lirimit me kusht”; b) Arsyet të cilat duhet të paraqesë dhe plotësojë përfituesi i “qëndrimit në shtëpi”; fc) aktin e të qenit ose jo përsëritës në krim. Prandaj, nisur edhe nga këto ndryshime thelbësore përforcohet mendimi se “qëndrimi në shtëpi” përfitohet si nga të pandehurit, ashtu edhe nga të dënuarit, ndërkohë që lirimi me kusht” përfitohet vetëm nga të dënuarit.
8. Nga formulimi gramatikor i neneve 59, 60 dhe 62 të Kodit Penal kanë lindur interpretime të ndryshme sa i përket çështjes nëse gjykata në rastet kur aplikon një “dënim me kusht” apo një “qëndrim në shtëpi” është ose jo e detyruar të urdhërojë të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës apo gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal. Në praktikë po hasen tre qëndrime lidhur me këtë çështje:
 - a. Gjkata nuk është e detyruar të urdhërojë të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe as të përmbushë një ndër detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal;
 - b. Gjkata urdhëron të pandehurin që gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa detyrime të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal, por nuk mund të urdhërojë të pandehurin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës;
 - c. Gjkata urdhëron të pandehurin që gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa detyrime të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal, si dhe urdhëron të pandehurin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës.

Nga sa shihet sistemi ynë i dënimeve alternative me burgim është një përzierje e dy sistemeve botërore të këtyre dënimeve: a) sistemit kontinental, i cili ka parasysh vetëm pezullimin e dënimit me burgim duke i vënë si kusht të vetëm të dënuarit moskryerjen e veprave të tjera penale dhe b) sistemit të mbikëqyrjes, ose i quajtur ndryshe “Probacioni”. Ky sistem ka në thelb të tij nevojën për t’i vendosur të dënuarit një detyrim, i cili do të mbikëqyret edhe nga një person i specializuar, që sipas ligjit penal shqiptar është Shërbimi i Provës. Nga analiza që i bëhet në tërësi neneve të Kodit Penal që parashikojnë alternativat e dënimeve me burgim dhe ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” na rezulton se sistemi ynë i dënimeve alternative është më shumë i prirur drejt sistemit të mbikëqyrjes (Probacionit – vënie në provë; latinisht - probatio), duke iu larguar sistemit kontinental, por jo të shkëputet tërësisht prej tij. Ky argument bëhet edhe më i besueshëm nga përdorimi i fjalës “mund” në nenin 60 të Kodit Penal (i cili parashikon detyrimet konkrete) si dhe në nenin 59 të këtij Kodi.

9. Sipas formulimit të nenit 470 të Kodit të Procedurës Penal dhe ligjit nr. 8331, datë 16.04.1998, i ndryshuar, “Për ekzekutimin e dënimeve penale”, shqyrtimi i kërkesave për revokim apo zëvendësim do të bëhet nga gjykata e vendit ku është duke u ekzekutuar

vendimi, me përjashtim të rastit kur, vendimi ekzekutohet në një shtet të huaj. Në këtë rast kompetente do të jetë gjykata që ka dhënë vendimin. Kjo mënyrë do të sjellë një ndjekje më të mirë të ekzekutimit të dënimit alternativ, si një kosto të ulët të proceseve gjyqësore.

10. Përkufizimi i “arsyes së veçantë” nuk jepet nga Kodi Penal, por është lënë në çmim të gjykatës. Është gjykata dhe asnjë organ tjetër që vlerëson arsyet e paraqitura nga i dënuari nëse janë apo jo arsye të veçanta, në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal, por në çdo rast sipas formulimit ligjor duhet të ekzistojë një arsye e veçantë. Sipas formulimit të ri të nenit 64 të Kodit Penal janë dhënë në mënyrë indikative dhe jo shteruese, disa raste të cilat konsiderohen si “arsye të veçanta”. Këto raste janë zhvilluar më tej nga praktika gjyqësore shqiptare deri në Kolegjet Penale të Gjykatës së Lartë. Praktika gjyqësore ka treguar se arsyet e veçanta nuk mund të jenë të njëjta për të dënuar të ndryshëm. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë si “arsye të veçanta” mund të përmenden: “gjendja e vështirë social-ekonomike e familjes së të dënuarit; gjendja e vështirë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit dhe nevoja e tyre për ndihmë dhe asistencë mjekësore; vdekja apo ikja e familjarëve, nga të cilat lihen pa kujdes fëmijët e të dënuarit apo persona të tjerë që ai mund të ketë në ngarkim etj...”.
11. Element tjetër i kërkuar nga kjo dispozitë është “sjellja e të dënuarit”. Ky parametër duhet parë në dinamikë për gjithë dënimin e vuajtur nga shtetasi i dënuar. Pasi të vlerësohen të gjitha raportet e sjelljes për këtë periudhë, gjykata më pas duhet të çmojë nëse nga konstatimi i gjithë treguesve të sjelljes arrihet qëllimi për edukimin apo risocializimin e këtij të dënuari ose jo. Në praktikë ka lindur për diskutim fakti kur i dënuari gjatë kohës së vuajtjes së dënimit ka marrë disa masa disiplinore dhe të gjitha këto masa janë parashkruar në kuptim të nenit 54/3 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Mënyra sesi është formuluar dispozita në lidhje me këto dy parametra, tregon se vlerësimi duhet të jetë në kompleks dhe jo i veçuar. Ajo që kërkohet nga ligji është fakti se mjafton që nga ky vlerësim i këtyre dy parametrave të marra së bashku të vërtetohet se me pjesën e vuajtur të dënimit nga i dënuari i është arritur plotësisht qëllimit për edukimin e tij.
12. Në praktikën gjyqësore është shtruar për diskutim gjatë zbatimit të nenit 64 të Kodit Penal nëse gjykatat mund të lirojnë me kusht persona të dënuar më parë për krime të kryera me dashje, por që në momentin e bërjes së kërkesës kanë qenë të rehabilituar. Mënyra sesi është formuluar dispozita tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që të përjashtojë nga ky përfitim ligjor të gjithë të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje, duke ngushtuar sferën e përjashtimit të subjekteve përfitues. Pra, dispozita i referohet nocionit “i dënuar”.
13. Neni 64 në emërtimin e tij përdor formulimin “lirimi me kusht”. Duke qenë një parashkrim i tillë, kjo kohë nuk mund të njehsohet me kohën e provës, por do jetë një kohë tjetër. Ky argument përforcohet më tepër edhe nga fakti se dispozita ka pasur ndryshime kohët e fundit dhe nëse ligjvënësi do kishte si qëllim që kjo kohë të ishte e njëjtë me kohën e provës nuk do të kishte asnjë pengesë që ta parashikonte shprehimisht tek kjo dispozitë. Pra, qëllimi i ligjvënësit ka qenë për një kohë tjetër kushti, të ndryshme nga ajo e provës. Ajo që ligjvënësi nuk ka zgjidhur është pikërisht afati i kësaj kohe

kushti. Megjithatë, në këtë situatë faktike për oportunitet ligjor, koha e provës do ishte një afat kohe i përshtatshëm që mund të shërbente edhe si afat kushti, deri në një rregullim ligjor të dispozitës.

14. Një problem tjetër i dalë nga praktika gjyqësore në lidhje me këtë dispozitë është pikërisht fakti nëse personit të liruar me kusht duhet t'i vendosen detyrime apo jo. Nëse i referohemi në mënyrë strikte formulimit të dispozitës, nenit 64 të Kodit Penal, rezulton se ligjvënësi nuk ka parashikuar asnjë lloj detyrimi për gjykatën që t'i caktojë personit të liruar me kusht një ose disa detyrime, ashtu siç parashikon neni 60 dhe 61 i po këtij Kodi, për dënimet e tjera alternative. Nga ana tjetër, ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", në nenin 31/6 të tij, konkretisht te tre paragrafët e fundit të tij, ka parashikuar detyrimin e personit të liruar me kusht që t'i raportojë rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirimit me kusht. Ky i dënuar i liruar me kusht ka gjithashtu detyrimin të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës dhe organet vendore të policisë së shtetit në rast se ndryshon vendbanimin, duke dhënë edhe arsyet e këtij ndryshimi. Paragrafi i fundit i kësaj dispozite parashikon dhe të drejtën që ka shërbimi i provës që t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato. Një parashikim i tillë ligjor tregon se personit të liruar me kusht mund t'i vendosen një ose disa detyrime nga gjykata. Nga ana tjetër, dispozita materiale e Kodit Penal (neni 64) në lidhje me këtë moment është blankete. Po kështu dhe vetë ligji që parashikon nocionin "detyrime ndaj personit të liruar me kusht", nuk përcakton se cilat janë konkretisht këto detyrime.
15. Ajo që konstatohet gjithashtu në lidhje me këtë moment është fakti se dispozita (neni 64) nuk bën ndonjë parashikim ligjor për mënyrën se si veprohet apo për procedurat që duhet të respektojnë subjektet procedurale në rast se janë kushtet për revokimin e dënimit për personin e liruar me kusht, ashtu siç parashikohet për dënimet e tjera alternative në rastet kur shkelen kushtet dhe detyrimet gjatë kohës së provës në nenin 62 të Kodit Penal. Megjithatë, pavarësisht mungesës së një parashikimi të tillë juristët ndajnë mendimin që procedura e ndjekur duhet të jetë e njëjtë si tek dënimet e tjera alternative. Në këto raste është pikërisht organi i cili merret me mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi, që është shërbimi i provës, i cili në çdo rast njofton organin e prokurorisë, organ i cili kërkon revokimin e vendimit me të cilin është liruar me kusht i dënuari dhe bashkimin e dënimeve midis këtyre dy vendimeve. Nga ana tjetër dhe vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", në nenin 31/10 të tij, parashikon procedurat që duhen ndjekur gjatë shqyrtimit të një kërkesë me objekt revokimin e dënimit alternativ.
16. Praktika gjyqësore në lidhje me aplikimin e lirimit me kusht po gjen një përhapje të gjerë. Një gjë e tillë tregon qartë se nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve po kuptohet si duhet qëllimi i kësaj dispozite, duke e bërë të zbatueshme edhe në praktikë. Edhe shtetasit shqiptarë që janë dënuar jashtë shtetit për vepra të ndryshme penale dhe janë transferuar në Shqipëri për të vuajtur dënimin kanë të drejtë të kërkojnë lirimin me kusht nëse plotësojnë kriteret ligjore të nenit 64 të Kodit Penal. Kjo pasi këta shtetas pavarësisht nëse janë dënuar në shtete të ndryshme, nëse e kanë përfunduar procedurën ligjore të

njohjes dhe zbatimit të vendimit penal të atij shteti dhe janë transferuar në I.E.V.P-të në Shqipëri, ata përfitojnë njësoj si të gjithë shtetasit e tjerë që vuajnë dënimin në këto institucione, përfshirë dhe lirimën me kusht.

17. Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose liruar me kusht, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000 e cila është bërë pjesë e rendit juridik të brendshëm të shtetit shqiptar, rregullon në mënyrë të qartë se mbikëqyrja e dënimeve alternative të dhëna nga gjykatat shqiptare për shtetasit e huaj me vendbanim në territorin e një shteti tjetër është plotësisht e realizueshme. Kjo do të thotë që dhënia e dënimeve alternative duhet bërë njësoj jo vetëm për shtetasit shqiptarë por edhe për shtetasit e huaj, mjafton që të plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore të kërkuara nga ligji penal shqiptar.

LITERATURA

- Elezi Ismet, "Mbrojtja juridike penale e jetës së njeriut në Republikën Popullore të Shqipërisë", Tiranë, 1962
- Elezi Ismet, "Normat e së drejtës penale zakonore të mbledhura në KLD dhe kanune / vendime / të veçanta, " Referate e kumtesa " mbajtur në sesionin shkencor të Fakultetit të Drejtësisë, kushtuar 50 vjetorit të pavarësisë / I, Tiranë, 1965
- Elezi Ismet. "E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, pjesa e posaçme I dhe II, Tiranë 1999
- Hajdari Azem: " Krimet e luftës kundër popullsisë civile në Kosovë gjatë periudhës shkurt 1998-qershor 1999", Prishtinë 2002
- Hajdari Azem, "Kriminaliteti i të miturve në Kosovë 2001-2003", Prishtinë 2004
- Hajdari Azem, "E drejta e procedurës penale e të miturve" (me ligjin penal për të mitur, Prishtinë 2005
- Halili Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, 2005
- Halili Ragip, "Kriminaliteti kundër Martesës dhe familjes në KSA të Kosovës", Prishtinë, 1987
- Halili Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, tetor 2007, bot. i V-të
- Latifi Vesel, "Fenomenologjia dhe struktura e delikuençës së të miturve dhe luftimi i saj në KSA të Kosovës", "Përparimi" nr 4, Prishtinë, 1988
- Latifi Vesel, "Disa vrojtime mbi sjelljet delikuede të të miturve dhe fëmijëve" E drejta, Prishtinë, nr.1 / 1997
- Latifi Vesel, "Kriminalistika e delikuençës së të miturve", Prishtinë, 1882
- Latifi Vesel, "Kryesit e mitur të veprave penale dhe pozita e tyre në legjislacionin penal", E Drejta, nr. 3, Prishtinë, 1996
- Murati Rexhep, "Gjykimet penale politike në Kosovë, më vështrim të veçantë në disa prej atyre që u organizuan kohët e fundit në Kosovë", " E Drejta", Prishtinë, nr. 2 / 1997
- Salihu Ismet, "E drejta Penale", Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 1995
- Salihu Ismet, "E drejta Penale, Pjesa e përgjithshme ", Prishtinë, 2003
- Salihu Ismet, "E drejta Penale për të mitur (me ligjin penal për të mitur)", Prishtinë, 2005
- E drejta penale e Republikës Popullore të Shqipërisë, pjesa e përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1973, fq. 2010
- Kodi i Drejtësisë për të mitur i Kosoves
- Kodi i Procedrës penale i Kosovës
- Kodi Penal i Kosovës
- Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale i Kosovës
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1977
- Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1995
- Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Grup autorësh, Tiranë, 1999
- Kodit i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Botimi i publikimeve zyrtare, Tiranë, shtator 2002
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2002
- Deklarata mbi të drejtat e fëmijëve, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme në Rezolutën 1386 (XIV të 20 nëntorit 1959)

- Konventa mbi të drejtat e fëmijëve, miratuar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe pranim nga AP me Rezolutën 44 /25 të 20 nëntorit 1989 që ka hyre në fuqi më 2 shtator 1990
- Standardi i rregullave minimale të KB, për administrimin e të drejtave për të mitur “Regullat e Pekinit”, të adaptuar nga marrëveshja e Asamblesë së Përgjithshme nr. 40 / 33 të 29 nëntorit 1985
- Rregullat Standarde minimale për masat jo ndëshkimore (Rregullat e Tokios) të miratuara me Rezolutën 45 /110 të AP të 14 dhjetorit 1990
- Udhëzimet e KB për parandalimin e delikuencës së të miturve (Udhëzimet e Riadit), e miratuar dhe e shpallur më Rezolutën 45 / 112 të AP, më 14. Dhjetor 1990, sesioni i 68-të plenar
- Rregullat e KB për mbrojtjen e të miturve që janë privuar nga liria e miratuar me Rezolutën 45 / 113 të AP më 14 dhjetor 1990.
- Halili. R, Penalogjia, Blendi publishing, August (2000), Prishtina
- Hysi. V, Kriminolgjia, (2005), Crystallina-KH, Tirana
- Hysi.V, Penologjia, (2006), PEGI,Tirana
- Mandro. A The juvenile justice system in Albania, an analysis of the juvenile justice system and of the situation of juveniles in conflict with the law in Albania, a publication of the Center for Protection of Child Rights in Albania, (2007), Visi Design, Tirana;
- Albanian Helsinki Committee, Criminal justice system for juveniles in Albania, (2005) PEGI, Tirana;
- Foundation “Conflict Resolution and Reconciliation of Disputes”, Restorative justice and mediation in resolving criminal despotes, Manual for judges and prosecutors, UNICEF, (2007), Tirana;
- Albanian Helsinki Committee, Observance of the Rights of Juvenile Offenders in Criminal Proceedings, (2007) PEGI, Tirana;
- Center of services and integrated legal practices, Albanian legislation and the Convention of Child Rights, (2008), Tirana;
- Kambovski.V, Criminal Law, General part, (2006), Print ISM, Skopje
- 13. Pallazzo. F, Papa. M “ Lezioni di diritto penale comparato”, (2000), Giappichelli editors, Padova;
- Aos, S. (2003). *The criminal justice system in Washington state: Incarceration rates, taxpayer costs, crime rates, and prison economics*. Washington State Institute for Public Policy. Olympia: WA.
- Aos, S., Miller, M. & Drake, E. (2006). *Evidence-based public policy options to reduce future prison construction, criminal justice costs, and crime rates*. Washington State Institute for Public Policy. Olympia: WA.
- Austin, J, Fabelo, T, 2006 ‘The diminishing returns of increased incarceration’, viewed November 21, 2006, < <http://www.jfa-associates.com/BlueprintFinal.pdf>>.
- Department of Justice, US, 2002 ‘Recidivism of prisoners released in 1994’, Bureau of Justice Statistics, June, Washington, DC.
- North Carolina Sentencing and Policy Advisory Commission. (2006). *Correctional program evaluation: Offenders placed on probation or released from prison in fiscal year2001/02*. North Carolina Administrative Office of the Courts, Sentencing and Policy Advisory Commission. Raleigh, NC.

- Clear, T.R. (1997). *Ten unintended consequences of the growth in imprisonment*. Corrections Management Quarterly 12.
- Vera Institute. (2005) *The Impact of Sentencing Reforms on Prison Populations*. http://www.vera.org/project/project1_1.asp?section_id=3&project_id=57
- Aertsen, Ivo., Mackey, Robert., Pelikan, Christa., Willemsens, Jolien., Wright, Martin., (2004) *Rebuilding Community Connections – Mediation and Restorative Justice in Europe*, Council of Europe Publishing
- Basic Principles of United Nations on the Use of Restorative Justice. Programmes in Criminal Matters, 2002
- Benson, J. (2001) *Working More Creatively with Groups*, 2nd ed. London: Routledge
- Blumstein, A. “Criminal Carriers and Career Criminals”, Washington D.C: National Academy Press, 1986
- Bondenson, U.V. (1989). *Prisoners in Prison Societies*. Transaction Publishers. New Brunswick and New Jersey
- Canton, R. , Hancock, D. (2007) *Dictionary of Probation and Offender Management*, Cullompton: Willan Cartledge (1995) in: Harris, R. et al *Probation Round the World*, Coles, B. (1995) *Youth and Social Policy*, London: UCL Press
- Chapman, T. & Hough, M. (1998) *Evidence Based Practice – a Guide for Practitioners*.
- Christie, Nils. (1977), *British Journal of Criminology*, 17 (1)
- Conklin, J. “Criminology”, Tufts University, USA, 1995
- Gottfredson, M. & Hirschi, T. (1990), *A general theory of crime*, Stanford: Stanford Univ. Press
- Haines, K. (2000), *Referral Orders and the New Youth Justice*, in: Goldson, B. (ed) *The New Youth Justice*, Lyme Regis: Russell House Publishing
- Hirschi, T. (1969) *Causes of Delinquency*. Berkeley: Univ. of California Press.
- Haines, K. Jones, R. & Isles, E. (1999) *Promoting Positive Behaviour in Schools*,
- Leskoviku, M. “Teoritë e kontrollit social të kriminit, njohja dhe vlerësimi i tyre” *Revista Shkencore-Juridike e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Nr.1, 2005*
- McGuire, J. (2000) *Cognitive Behavioural Approaches: An Introduction to Theory and Research*
- McNeil, F. (2006). *A desistance paradigm for offender management*. In *Criminology & Criminal Justice*. Vol. 6(1): 39-62. Sage Publications
- *Howard Journal*, Vol. 39, No. 4, pp 382-397
- McNeill, F. (2003) “Desistance-focused probation practice” in Chui, W.H. and Nellis, M. (eds) *Moving Probation Forward*, Harlow: Pearson ‘s Longman
- McWilliams, W. (1983) *The Mission to the English Police Courts 1876-1936*,
- *The Howard Journal*, Vol. 22
- McWilliams, W. (1985) *The Mission Transformed*, *The Howard Journal*, Vol. 24
- Mehlbye, J. & Walgrave, L. (1998) *Confronting Youth in Europe*, Copenhagen: AKF
- Mehlbye, J. & Sommer, B. (1989) “Denmark”, in : Mehlbye, J. & Walgrave, L. (1998) *Confronting Youth in Europe*, Copenhagen: AKF
- Merrington, S., Stanley, S. (2007) “Effectiveness: who counts what?” in Gelsthorpe, L. and Morgan, R. (eds) *Handbook of Probation*. Cullompton: Willan
- Miller, W. & Rollnick, S. 2002, *Motivational Interviewing: Preparing People for Change*. 2nd edn. London: Guildford Press

- Milner, J. & O'Byrne, P. (2002) *Assessment in Social Work*. 2nd edn. Basingstoke: Palgrave
- Radzinowicz, L. (ed.) (1958) *The Results of Probation*, English Studies in Criminal Science. Macmillan. London
- Raynor, P (2006) "The 'What Works' Experiment in England dhe Wales: Achievements dhe Lessons to be Learned". Lecture to University of Wales, Newport, Gregynog, Powys. June 2006
- Rekomandimi CM/Rec(2008) 11 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare mbi Rregullat Evropiane për të dënuarit e mitur që u nënshtrohen sanksioneve ose masave
- Rekomandimi Nr. R (92) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat Komunitare
- Rekomandimi Nr. R (99) 22, i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Rritjen e Popullsisë në Burgje (dhe Shtojca e këtij rekomandimi)
- Rhys, M.T. (2001) *Reports of Serious Incidents 1995-2000*. London Probation Area. London Action Trust
- Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rekomandimi Nr. R 87 (3) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur ("Rregullat e Pekinit")
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios)
- Smale, G. (2000) *Social Work and Social Problems: Working Towards Social Inclusion and Social Change*. London: MacMillan
- Thorpe, D. et al (1980) *Out of Care*, London London: George Allen and Unwin
- Tournier, P.V. (2004). Aspects of good practice in the criminal justice system. In *Crime Policy in Europe*. Council of Europe Publishing.
- Tuckman, B. (1965) "Developmental Sequence in Small Groups". *Psychological Bulletin*, Vol. 63, No.6, pp. 384-399 UNICRI (1998) *Handbook on Probation Services*, Rome-London
- Van Kalmthout, A. & Derks, J. (2000) *Probation and Probation Services: A European Perspective*, Utrecht: CEP
- Vinding, S. (2000) 'Denmark', in: Van Kalmthout, A. & Derks, J. (2000) *Probation and Probation Services: A European Perspective*, Utrecht: CEP
- Vjetari Statistikor, botim i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë (për vitet 2003-2007)
- Waggrave, Lode. RJ and beyond – an Agenda for Europe, Paper presentation at the Conference of the European Forum for RJ, Barcelona, Spain 15-17 June 2006
- Wright, Martin. (1996), *Justice for victims and offenders: A Restorative Response to crime*, Winchester, Watergate Press, 2nd edition
- Zehr, Howard. (2002) *The Little Book of Restorative Justice*

ABSTRAKT

Sanksionet penale janë një nga çështjet themelore të së drejtës penale; këto janë edhe pjesa më dinamike e kësaj dege të së drejtës. Rrjedhimisht, gjatë historisë së të drejtës penale, ndryshimet më të shpeshta dhe më të mëdha janë shprehur në këtë fushë. Teoritë për qëllimin e dënimit kanë evoluuar nga koncepti i hakmarrjes dhe ndëshkimit ndaj autorit, drejt konceptit të riedukimit, risocializimit dhe rehabilitimit të tij, duke përfaqësuar këto të fundit idetë themelore të drejtësisë rehabilituese. Nga ana tjetër, në vendin tone duhet të gjenden zgjidhje edhe për kushtet e institucioneve të vuajtjes së dënimit, mbipopullimin e tyre, respektimin e të drejtave të të dënuarve, mundësitë reale për rishoqërim që ofrohen brenda burgjeve etj. Keto çështje nuk mund të zgjidhen vetëm duke ngritur institucione të reja për vuajtjen e dënimit ose duke përmirësuar kushtet e tyre, por kërkohet të përmirësohet legjislacioni, në mënyrë të tillë që krahas dënimeve me burgim, të zbatohen në mënyrë efikente masa ose sanksione të tjera, që synojnë nxitjen e zhvillimit të aftësive shoqërore e të cilësive vetjake të të dënuarve, duke përmirësuar kështu perspektivat që parashikohen në kreun VII të Kodit Penal, nën titullin “Alternativat e dënimit me burgim”.

Ky punim merr persiper të analizoje në mënyrë të detajuar parashikimet e këtij kreu, duke i vendosur ato në një rrafsh krahasues me alternativat ndaj dënimit me burgim në Kosovë e Maqedoni, me qëllim evidentimin e diferencave mes tyre dhe skicimin e rekomandimeve për përmirësimin e legjislacionit dhe strukturave të vendit.

Fjalë kyçe: dënim penal, alternative të dënimit me burgim, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, pezullim i ekzekutimit, punë në interes publik, lirim me kusht, venie në provë, gjysmëliri.

ABSTRACT

Penal sanctions are of the most critical issues in criminal law; and they also are one of the most dynamic parts of this legal subject. As a consequence, through the history of criminal law, this field has undergone more changes and at a higher frequency than any other. Theories on the purpose of criminal punishment have evolved from the concept of vengeance and punishment to the perpetrator towards the ideas of re-education, re-socialization and rehabilitation, and these concepts also are the fundamental ideas in restorative justice. On the other hand, in our country there is the need to find solutions to the issue of conditions in penitentiary institutions, their over population, the respect for the rights of convicted felons, the real possibilities for re-socializations that the prisons have to offer, etc. These issues cannot be resolved only through establishment of new institutions or improvement of conditions in the existing ones, but the legislations as well need to be improved so that, apart from prison sentences, other measures and sanctions can be applied efficiently, so that the social skills and personal capabilities of the convicts can be promoted, and the perspectives of chapter VII of the Criminal Code “Alternatives to prison sentences” can be improved.

This study undertakes a detailed analysis of the provisions of this chapter, and puts them into a comparative perspective to alternative sanctions in Kosovo and Macedonia, with the aim of identifying the differences between them and outlining recommendations for the improvement of domestic legislation and structures.

Key words: penal sanction, alternative to prison sentence, Albania, Kosovo, Macedonia, suspension of the execution, community work, parole, probation, half liberty.